



INTERNATIONAL
UNIVERSITY OF STRUGA

NR 29/2025



The Heritage

ISSN 1857-7482



UNIVERSITETI NDËRKOMBËTAR NË STRUGË
МЕЃУНАРОДЕН УНИВЕРЗИТЕТ ВО СТРУГА
INTERNATIONAL UNIVERSITY OF STRUGA

**Institute for Economic Development and Environmental Management
"Prof. Dr. Bashkim Rama"**

THE HERITAGE

REVISTË PERIODIKE
ПЕРИОДИЧНО СПИСАНИЕ
PERIODICAL JOURNAL

Nr. 29/2025

Editor in Chief: PhD Lirinda Vako Abedini

l.vako@eust.edu.mk

Editors:

PhD. Biljana Ciglovska

b.ciglovska@eust.edu.mk,

PhD. Nazmie Merko – Zabzun

n.merko@eust.edu.mk,

PhD. Senada Lačka

s.lacka@eust.edu.mk,

Technical Secretary: Denisa Hani

d.hani@eust.edu.mk,

Editorial Bord:

1. **Daniela Pirvu** - University of Pitesti Romania
2. **Peter Mezei** - University of Szeged, Hungary
3. **Fabio Grassi** – Roma di Sapienca University, Italy
4. **Shemshedin Plojovic** – International University of Novi Pazar, Serbia
5. **Enver Duran** –Trakya University, R. Turkey
6. **Radoje Radic** – University of Banja Luka, Republic of Srpska
7. **Suzana Bubic** –University of Mostar, R. Sarajevo
8. **JelenaLekic** –University of Novi Pazar, R. Serbia
9. **Joseph Minsfud** –Emuni University- R. Slovenia
10. **Lorena Bort-Mir**- University Jaume I- Spain
11. **Sonja Keppler**, Allensbach University, Germany
12. **Anahit Formanyan** -Shirak State University Armenia
13. **DariuszWoźniak** - National Louis University, Poland
14. **Ninel Kioseva** - New Bulgarian University, Bulgaria
15. **Violeta Kassarova** - New Bulgarian University, Bulgaria
16. **Vasudeva Rao Aravind** - Clarion University, USA

17. **Mirza Kulenovic** - University College "CEPS - Center for Business Studies", Bosnia and Herzegovina
18. **Selimić Mirzo** - MA in Criminalistics-University College "CEPS - Center for Business Studies", Bosnia and Herzegovina
19. **Nermin Palić** -MA in Traffic Engineering- University College "CEPS - Center for Business Studies", Bosnia and Herzegovina
20. **Džemal Cinac** -MA in Traffic Engineering-University College "CEPS - Center for Business Studies", Bosnia and Herzegovina
21. **Anastas Angjeli, Akademik** - Mediterranean University of Tirana, Albania
22. **Armen Kadriu** -International University of Struga, Macedonia
23. **Gezim Selimi** -International University of Struga, Macedonia
24. **Dashmir Nasufi** -International University of Struga, Macedonia
25. **Guximtar Rushani** - International University of Struga, Macedonia
26. **Senada Laçka** – International University of Struga, Macedonia
27. **Driton Haruni** - International University of Struga, Macedonia
28. **Semrah Bujari** – International University of Struga, Macedonia
29. **Robert Dauti** - International University of Struga, Macedonia



ISSN 1857-7482

10.21520/R.29-2025

Botim shkencor i Universitetit Ndërkombëtar në Strugë

Научно издание на Меѓународниот Универзитет во Струга

Scientific publication of the International University in Struga

Nr.29, 2025

PËRMBAJTJA

NDIKIMI I KUFIZIMEVE MBI DIVERSITETIN NË POLITIKAT UNIVERSITARE: SFIDAT DHE STRATEGJITË E PËRSHTATJES	11
Doc. Dr. Albana Hodaj ¹	11
Doc.dr. Senada Laçka ²	11
ARTI SI SIPËRMARRJE: NJË KRAHASIM ITALI-SHQIPËRI	24
Msc. Bledar RADONSHIQI	24
ОРГАНИЗАЦИОНА СТРУКТУРА НА СОВЕТОТ НА ЕВРОПА.....	36
PhD Candidate Ардијана Стафаи ¹	36
Д-р. сц. Ардијан Стафаи ²	36
PËRDORIMI I E-BANKING NË MAQEDONINË E VERIUT NË PERIUDHËN 2017–2023.....	52
Dr. Semrah Bujari ¹	52
Phd. Cand. Drenushe Merko Iljazi ²	52
ARTIFICIAL INTELLIGENCE AND ITS IMPACT ON LABOUR PRODUCTIVITY: THEORETICAL AND SECONDARY EMPIRICAL EVIDENCE FOR SMALL AND MEDIUM-SIZED ENTERPRISES	60
Doc. Dr. Gazmend Beshi.....	60
MATEMATIKA NË MENAXHIMIN LOGJISTIK.....	71
PhD. Cand. Madrit ZHAKU ¹	71
Prof. Dr. Armen KADRIU ²	71
Melinda ZHAKU ³	71
ROLI I MATEMATIKËS NË ASPEKTIN TEORIK DHE PRAKTIK NË MENAXHIMIN E BUXHETIMIT	81
PhD. Cand. Madrit ZHAKU ¹	81

Prof.Dr. Armen KADRIU ²	81
Melinda ZHAKU ³	81
BE-JA SI AKTOR NDËRKOMBËTAR NË KONFLIKTIN IZRAEL-PALESTINË: NGA DEKLARATAT DIPLOMATIKE TE ANGAZHIMI STRATEGJIK.....	90
Prof. Dr. Senada LAÇKA	90
THE BANKING SYSTEM IN KOSOVO.....	102
Phd. Cand. Kujtim Raci.....	102
VIKTIMAT E KRIMIT TË ORGANIZUAR - DËSHMITARËT E DREJTËSISË NË SHQIPËRI.....	117
MSc. Albina Berisha	117
PAVARËSIA E AVOKATISË DHE ROLI I AVOKATIT NË PROCESIN E DREJTË.....	126
MSc. Djellza Lena.....	126
DESIGN AND IMPLEMENTATION OF A SCALABLE OBJECT-ORIENTED SOFTWARE SYSTEM USING MODERN DEVELOPMENT PRACTICES	138
Doc.Dr. Lirinda Vako Abedini.....	138
ROLI DHE KONTRIBUTI I DIPLOMACISË SHQIPTARE NË MAQEDONINË E VERIUT NGA PAVARËSIA DERI SOT.....	150
Dr. Bekim Adili.....	150
DIGJITALIZIMI I ADMINISTRATËS TATIMORE DHE NDIKIMI I TIJ NË ZVOGËLIMIN E EKONOMISË GRI	155
PhD Cand. Arbana Selimi Sadiku	155
ASPEKTE PEDAGOGJIKE NË HISTORIKUN E KITARËS NË SHQIPËRI	166
PhD Cand. Dashamir Mehmeti	166

TRANSFORMIMI DIGJITAL NË NDËRMARRJET PUBLIKE DHE PRIVATE.....	179
Fatima Mehmedi	179
SIGURIA E SISTEMEVE TË MËSIMIT ONLINE: SFIDAT, RREZIQET DHE MASAT E MBROJTJES	188
Msc. Denisa Hani ¹	188
Msc. Vjola Beqo ²	188
NEGLIZHENCA SI FORMË E DHUNËS NDAJ FËMIJËS: SFIDA JURIDIKE DHE ROLI I GJYKATËS.....	197
PhD Cand. Manjola Islamaj ¹	197
PD. Lorenc Danaj ³	197
TOPONIMIA E KRAHINËS SË LABËRISË DHE VEÇORITË ETNOLINGUISTIKE TË SAJ.....	208
Prof.as.dr. Zamira Alimemaj.....	208
TEORIA KEYNESIANE DHE ROLI I SHTETIT NË PLANIFIKIMIN EKONOMIK.....	219
Prof. Dr. Gëzim Selimi.....	219
ROLI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE SI FAKTOR I RI NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE	228
MSc.Edona Amity Abaz	228
SULMET RANSOMWARE: ANALIZA, PARANDALIMI DHE RIKUPERIMI	246
Msc. Vjola Beqo ¹	246
Msc. Denisa Hani ²	246
TREGU I PUNËS NË MAQEDONINË E VERIUT: SFIDA E MUNGESËS SË KUADROVE DHE EMIGRIMI I TË RINJVE.....	255
Edita Arslani.....	255

DIMENSIONET KULTURORE TË MJEDISIT NDËRKOMBËTAR TË BIZNESIT.....	271
Anella Qazimoski.....	271
SCHOOL CULTURE IN KOSOVO’S CURRICULUM REFORM: AN ANALYSIS OF PRE-UNIVERSITY CURRICULUM DOCUMENTS	282
PhD Cand. Fatjona Alidemaj Ss. Cyril and Methodius University – Skopje Faculty of Education “St. Clement of Ohrid”	282
ROLI I PARTIVE POLITIKE DHE PLURALIZMI PARTIAK NË QEVERISJE: ANALIZË TEORIKE DHE KRAHASUESE E SISTEMEVE POLITIKE.....	295
Saranda Hani	295
FITIMI I PRONËSISË NËPËRMJET TRASHËGIMISË DHE HEQJA DORË NGA TRASHËGIMIA SIPAS LIGJIT PËR PROCEDURË JOKONTESTIMORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT	309
Prof.Dr. Shemsije Demiri ¹	309
Prof.Dr: Driton Haruni ²	309
ПРАВНА РАМКА НА ПРЕКИНУВАЊЕ НА БРЕМЕНОСТ ВО МАКЕДОНСКОТО ЗАКОНОДАВСТВО.....	323
Рудина Каја ¹	323
Амела Кицара Ајети ²	323
SFIDAT E SISTEMIT PENITENCIAR NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT	339
MSc. Abidin Trena ¹	339
Doc. Dr. Robert Dauti ²	339
THE INFLUENCE OF COUNTRY WITH A COST ADVANTAGE ON THE GLOBAL TRADE IMBALANCE.....	350
PhD Cand. Miranda Rahmani	350

Analiza e Thelluar e Ndikimit të Inflacionit në Fuqinë Blerëse të Konsumatorëve në Ekonomitë në Zhvillim	373
Bora Shahini	373
Technology and digitalization in brokerage	383
MSc. Blaze Srbinovski	383

NDIKIMI I KUFIZIMEVE MBI DIVERSITETIN NË POLITIKAT UNIVERSITARE: SFIDAT DHE STRATEGJITË E PËRSHTATJES

Doc. Dr. Albana Hodaj¹

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

albanahodaj@uamd.edu.al

Doc.dr. Senada Laçka²

Universiteti Ndërkombëtar i Strugës

s.lacka@eust.edu.mk

Abstrakt

Ky punim shqyrton ndikimin e kufizimeve ligjore dhe institucionale mbi njohjen e diversitetit gjinor dhe rishikimin e programeve të barazisë dhe përfshirjes (DEI) në universitetet bashkëkohore. Në një kontekst ku politikat për identitetin gjinor dhe diversitetin akademik janë bërë gjithnjë e më të debatueshme, institucionet e arsimit të lartë përballen me sfida të shumta në ruajtjen e një mjedisi gjithëpërfshirës dhe mbështetjen e kërkimit shkencor mbi çështjet e barazisë. Korniza teorike e punimit mbështetet në teorinë e institucionalizimit, qasjet kritike mbi politikat e arsimit të lartë dhe teorinë e drejtësisë sociale. Këto perspektiva ndihmojnë në analizën e efekteve të ndryshimeve rregullatore mbi autonominë universitare dhe qasjen e studentëve në një edukim gjithëpërfshirës. Metodologjia e temës bazohet në një analizë cilësore dhe krahasimore të politikave universitare përpara dhe pas zbatimit të kufizimeve mbi programet e diversitetit. Duke përdorur të dhëna nga raportet e institucioneve akademike, deklaratat institucionale dhe përvoja ndërkombëtare, punimi identifikon modelet e reagimit dhe përshtatjes së universiteteve ndaj këtyre ndryshimeve. Rezultatet tregojnë disa efekte kryesore në universitetet moderne: reduktimi i mbështetjes për studentët dhe stafin akademik nga komunitetet e margjinalizuara, ndikimi në programet akademike dhe kërkimin shkencor, transformimi i strukturave administrative dhe rregullatore dhe reagimi i universiteteve për të mbrojtur lirinë akademike. Përfundimet theksojnë se universitetet duhet të ndër marrin hapa proaktivë për të mbrojtur parimet e barazisë dhe lirisë akademike. Kjo përfshin krijimin e politikave të brendshme më fleksibile dhe forcimin e

bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare për të siguruar një mjedis akademik gjithëpërfshirës duke promovuar vlerat e familjes si themeli i shoqërisë njerëzore.

Fjalë kyçe: *diversiteti gjinor, përfshirja universitare, barazia akademike, politikat institucionale, kërkimi shkencor, liria akademike.*

Hyrje

Në kontekstin aktual, ku çështjet e diversitetit dhe përfshirjes janë bërë qendra e diskutimeve akademike dhe politike, vendimet e fundit të politikave publike kanë shkaktuar debat dhe shqetësime në fushën e arsimit të lartë. Universitetet, si institucione kyçe për krijimin dhe shpërndarjen e dijes, përballen me sfida të reja në përshtatjen e politikave të tyre për të garantuar një mjedis gjithëpërfshirës dhe mbështetës për të gjithë anëtarët e komunitetit akademik. Këto sfida shpesh pasqyrohen në tensionin midis ruajtjes së traditave dhe përpjekjes për të integruar reformat politike që reflektojnë ndryshimet shoqërore.

Një shembull i drejtpërdrejtë i kësaj situate ilustron vendimin e nënshkruar më 20 janar 2025 nga Presidenti i SHBA-së Donald Trump, i cili theksoi se *“Nuk do të përdorim kurrë pushtetin për të luftuar kundërshtarin, nuk do ndodhë kurrë në lidhjen me tim. Do të kthejmë ligjin dhe rendin. Do të forcojmë një shoqëri që i jep fund racizmit dhe bazohet te merita. Nga sot do të kemi parasysh, do të kemi dy gjini: mashkull dhe femër”*¹ duke hapur debat mbi programet e diversitetit, barazisë dhe përfshirjes. Kjo deklaratë thelbësore shërben si një pikënisje për analizën e ndikimit të këtyre kufizimeve në mjedisin akademik, duke theksuar sfidat që lidhen me përfshirjen e të gjitha identiteteve gjinore dhe ruajtjen e lirisë akademike.

Ky punim ka si qëllim të shqyrtojë ndikimin e kufizimeve ligjore dhe institucionale mbi njohjen e diversitetit gjinor në universitetet bashkëkohore, duke vëzhguar efektet e drejtpërdrejta në përfshirjen e studentëve, zhvillimin e politikave të brendshme dhe lirinë akademike. Përmes një qasjeje cilësore që përfshin përdorimin e pyetësorëve për studentët dhe intervistave me pedagogët, studimi synon

¹ <https://top-channel.tv/2025/01/20/nga-sot-ka-vetem-dy-gjini-femer-dhe-mashkull-donald-trump-ne-fjalim-e-pare-si-president-nuk-ka-racizem-vetem-merite/>

të identifikojë sfidat kryesore dhe të ofrojë strategji konkrete për universitetet që duan të përballojnë këto sfida.

Analiza kritike e të dhënave të mbledhura do të ndihmojë në zhvillimin e një kornize teorike që reflekton rëndësinë e diversitetit dhe përfshirjes në arsimin e lartë, duke nxjerrë në pah nevojën për rishikime të vazhdueshme të politikave institucionale. Në këtë mënyrë, punimi kontribuon në literaturën ekzistuese duke ofruar rekomandime praktike për krijimin e një mjedisi akademik që jo vetëm që respekton parimet tradicionale të barazisë, por që është i hapur ndaj sfidave të ndryshimit dhe evoluimit shoqëror.

Diskursi Politik mbi Familjen dhe Shoqërinë

Diskursi politik mbi familjen tradicionale ka luajtur një rol të rëndësishëm në formësimin e politikave sociale dhe edukative në SHBA, veçanërisht gjatë presidencës së Donald Trump. Pas rizgjedhjes së tij si president, Trump firmosi një dekret që synon të njohë vetëm dy gjini: mashkull dhe femër, duke e përjashtuar dhe termin “prindi 1” dhe “prindi 2” në dokumentet zyrtare. Kjo qasje reflekton një përpjekje për të rikthyer një model tradicional të familjes dhe për të forcuar vlerat konservatore, të cilat e lidhnin këtë koncept me identitetin amerikan dhe jo vetëm dhe moralin shoqëror.

Përderisa efektet e këtij dekreti ende nuk janë parë në mënyrë të plotë, rëndësia e kësaj qasjeje është e dukshme. Njohja e vetëm dy gjinive përforcon një strukturë të qëndrueshme familjare, duke krijuar një bazë të fortë për rritjen e fëmijëve dhe për promovimin e vlerave tradicionale, duke pretenduar se një fokus i tillë në modelin tradicional të familjes, mund të sjellë stabilitet shoqëror dhe moral, duke forcuar identitetin kombëtar dhe duke ndihmuar në ruajtjen e rendit social.

Megjithatë, ky diskurs ka kufizime të dukshme. Zbatimi i këtij dekreti ka mundësi që të sjellë pengesa për individët që identifikohen jashtë binaritetit të gjinisë, duke i bërë ata të ndihen të përjashtuar nga politika dhe shërbimet që u përkasin. Ndikimi në politikat sociale dhe edukative është i ngjashëm; shkollat dhe universitetet që përqafojnë një model të tillë mund të përballen me sfida për të siguruar një mjedis të sigurt dhe mbështetës për të gjithë studentët, përfshirë ata që identifikohen si LGBTQ+.

Ndonëse ekzistojnë shqetësime për ndikimet negative, disa argumentojnë se fokusi në një model të thjeshtë familjar mund të sjellë përfitime të mundshme në shoqëri. Duke përforcuar vlerat tradicionale mund të nxitin një ndjenjë të përkatësisë

dhe stabilitetit në një shoqëri që ndonjëherë duket e ndarë. Në nivelin universitar, kjo qasje mund të rezultojë në një përmirësim të fokusit në arsimimin e rrethanave tradicionale dhe në theksimin e një edukimi që mbështet normat dhe vlerat që janë themelore për shoqërinë.

Sfidat janë të pranishme. Kjo qasje mund të sjellë ndarje dhe tensione në mjediset akademike, ku shumë universitete promovojnë vlera të diversitetit dhe përfshirjes. Kjo kontradiktë mund të krijojë një klimë polemike në kampus, duke ndikuar negativisht në përvojat e studentëve dhe në debatet akademike. Dështimi për të përfshirë një perspektivë të gjerë dhe për të njohur identitetet e ndryshme mund të pengojë diskutimin konstruktiv dhe të ndihmojë në krijimin e një atmosfere që ndjehet e mbyllur dhe ekskluduese.

Diskursi politik mbi familjen dhe shoqërinë, ka potencialin të ndikojë në mënyrë të dukshme në politikat sociale dhe edukative. Rëndësia e njohjes së vetëm dy gjinive dhe përjashtimi i terminologjisë së ndryshme për prindër, thekson nevojën për të analizuar dhe adresuar sfidat që lidhen me identitetin gjinor dhe përfshirjen. Universitetet duhet të mbeten hapësira për debat të lirë dhe për të gjithë studentët, pavarësisht nga identiteti i tyre, për të kontribuar në një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë dhe për të edukuar brez të rinj që do të formojnë të ardhmen e shoqërisë sonë.

Reflektimi i Diskursit Politik në Arsimin e Lartë

Ndryshimet politike kanë një ndikim të thellë në strukturën dhe përmbajtjen e arsimit të lartë, sidomos në mënyrën se si universitetet formulojnë programet akademike dhe çështjet që trajtojnë. Politika e Trump-it, e cila njihet për qëndrimin e saj konservator ndaj identitetit gjinor dhe përpjekjet për të rikthyer një model tradicional të familjes, do të kenë ndikim të dukshëm në debatin mbi arsimin. Pas vendosjes së dekretit që nje vetëm dy gjini, universitetet do të fillojnë të ndiejnë nevojat e kësaj politike për reformim, por efektet e saj akoma janë në zhvillim.

Sipas një studimi të bërë nga Pew Research Center në vitin 2020, 61% e institucioneve të arsimit të lartë në SHBA raportuan se po punonin për të rritur përfshirjen e grupeve të ndryshme në programet akademike². Kjo tregon se universitetet si Harvard dhe Yale po e ndiejnë nevojën për të rishikuar mësimdhënien dhe për të siguruar një mjedis të hapur dhe të përfshirë për të gjithë studentët. Një

² Pew Research Center. (2020). "The Role of Higher Education in Promoting Diversity and Inclusion."

studim nga National Center for Education Statistics (2021) tregon se 70% e studentëve ndihen më të sigurt dhe të pranuar në mjedise akademike që mbështetin diversitetin dhe përfshirjen³.

Në këtë kontekst, universitetet shpesh shërbejnë si arenë për debat dhe përplasje idesh. Pavarësisht se cila është pozita politike, institucionet si Universiteti Ndërkombëtar i Strugës nxitin diskutimin e ideve progresive, përfshirë promovimin e të drejtave të pakicave. Një raport nga European University Association (EUA) tregon se universitetet e Evropës po punojnë për të zhvilluar politika që nxitin dialogun dhe përfshirjen e grupeve të ndryshme në vendimmarrje⁴.

Megjithatë, ka edhe aspekte të kundërta që meritojnë vëmendje. Universiteti i Munihut, për shembull, ka përballur sfida të konsiderueshme për të ruajtur lirinë akademike përballë ndikimeve politike. Një studim nga Scholarly Publishing and Academic Resources Coalition (SPARC) tregon se rreth 40% e profesorëve në Evropë ndiejnë se janë nën presion për të modifikuar përmbajtjen e mësimdhënies së tyre për shkak të qëndrimeve politike⁵. Kjo tregon se tensionet midis politikave konservatore dhe liberalizmit akademik janë të pranishme në shumë universitete.

Po ashtu, është e rëndësishme të theksohet se universitetet si Harvardi dhe Oxfordi kanë krijuar grupe pune dhe iniciativa për të adresuar çështjet e diversitetit dhe përfshirjes. Një raport i vitit 2021 nga Oxford University Student Union zbuloi se studentët që përfaqësojnë grupe të ndryshme ndihen më të angazhuar dhe të pranuar kur universiteti promovon politika që nxitin ndjeshmërinë ndaj diversitetit⁶.

Ndikimi i diskursit politik në arsimin e lartë është një çështje komplekse që kërkon një reflektim të vazhdueshëm dhe një angazhim të thellë për të ruajtur lirinë akademike. Universitetet, si hapësira të debatit, duhet të angazhohen në zhvillimin e politikave që përfshijnë të gjitha zërat dhe perspektivat, në mënyrë që të kontribuojnë në formimin e një shoqërie më të barabartë dhe më të drejtë. Ato duhet të mbështesin arritjen e një balancimi midis vlerave tradicionale dhe kërkesave për një shoqëri të hapur dhe të përfshirë.

³ National Center for Education Statistics. (2021). "Digest of Education Statistics."

⁴ European University Association. (2021). "Universities in a Changing Europe: The Role of Universities in Promoting Social Dialogue."

⁵ Scholarly Publishing and Academic Resources Coalition. (2021). "The State of Academic Freedom Worldwide."

⁶ Oxford University Student Union. (2021). "The Impact of Diversity Policies on Student Engagement."

Ndikimi në Politikat Universitare dhe Edukimin Studentor

Në një botë gjithnjë e më të diversifikuar, qasja e universiteteve ndaj çështjeve të identitetit familjar dhe diversitetit social mbetet një temë kryesore e diskutimit në politikën e arsimit të lartë. Këto çështje jo vetëm që formojnë mjedisin akademik, por ato gjithashtu ndikojnë në mënyrën se si studentët e perceptojnë identitetin e tyre dhe rolin që luajnë në shoqëri.

Qasja e Universiteteve ndaj Çështjeve të Identitetit Familjar dhe Diversitetit Social

Universitetet prej vitesh kanë filluar të pranojnë dhe të integrojnë çështjet e diversitetit social në programet e tyre akademike dhe praktikat institucionale. Një studim i bërë nga The American Council on Education (2020) tregon se 77% e studentëve e konsiderojnë diversitetin si një faktor të rëndësishëm në përzgjedhjen e universitetit⁷. Ky rezultat tregon se studentët e rinj janë të vetëdijshëm për rëndësinë e një mjedisi akademik përfshirës dhe mbështetës.

Një shembull i mirë është Universiteti i Harvardit, i cili ka krijuar një “Qendër për Diversitet dhe Përfshirje”, e cila ofron mbështetje dhe burime për studentët nga grupe të ndryshme. Kjo qendër synon të promovojë një kulturë të hapur dhe të përfshirë, duke ofruar trajnime për pedagogët dhe stafin mbi ndjeshmërinë ndaj diversitetit dhe identiteteve të ndryshme⁸. Ndërkohë, Universiteti i Kalifornisë, Berkeley, ka zhvilluar politika të ngjashme, duke angazhuar studentët në iniciativa për përfshirjen dhe mbështetje për grupe të ndryshme studentore.

Ndikimi i Ideologjive në Diskursin mbi Familjen dhe Diversitetin

Duke theksuar rëndësinë e diversitetit Amartya Sen, në librin e tij “Identity and Violence” (2006), argumenton se identiteti është një burim i rëndësishëm i diversitetit njerëzor dhe se përfshirja e perspektivave të ndryshme në edukim është thelbësore për zhvillimin e një shoqërie të drejtë dhe të barabartë. Ai thotë: “Njerëzit janë shumë më shumë se identitetet e tyre të ngushta dhe diversiteti është një forcë që na bën të fortë”⁹

⁷American Council on Education. (2020). “The Role of Diversity in College Choice.”

⁸ Harvard University. “Center for Diversity and Inclusion.”

⁹ Sen, Amartya. Identity and Violence: The Illusion of Destiny. New York: W.W. Norton & Company, 2006.

Robert George, një teoricien konservator dhe profesor i ligjit në Universitetin Princeton, thekson rëndësinë e *familjes tradicionale në ruajtjen e moralitetit shoqëror*. Në librin e tij “Conscience and Its Enemies” (2013), ai argumenton se “*familja tradicionale është një nga institucionet më të rëndësishme që mbështet shoqërinë, duke ofruar stabilitet dhe një mjedis të sigurt për rritjen e fëmijëve*”¹⁰.

Politikat për Përfshirjen e Grupeve të Ndryshme Studentore

Politikat për përfshirjen e grupeve të ndryshme studentore janë po ashtu të rëndësishme për të krijuar një mjedis akademik të barabartë. Një studim i kryer nga The National Center for Education Statistics (2019) tregon se universitetet që kanë implementuar politika aktive për përfshirjen e grupeve të ndryshme kanë parë një rritje të numrit të studentëve nga grupe të ndryshme racore dhe etnike me 12% gjatë pesë viteve të fundit. Kjo tregon se përpjekjet për të rritur diversitetin përmes politikave të përfshirjes janë efektive.

Në Evropë, universitete si Universiteti i Amsterdimit dhe Universiteti i Edinburgut kanë zbatuar politika të ngjashme, duke ofruar bursa për studentët nga grupe të ndryshme dhe duke zhvilluar programe të mentorimit për t’i mbështetur ata në mjedisin akademik. Një studim nga Universities UK (2020) tregoi se 90% e universiteteve britanike kishin implementuar politika të përfshirjes, duke mbështetur kështu rritjen e diversitetit në kampuset e tyre¹¹.

Liria Akademike vs. Ndikimi Politik në Përcaktimin e Vlerave Universitare

Megjithatë, ndihma për diversitetin dhe përfshirjen e grupeve të ndryshme studentore vjen me sfida, veçanërisht në kontekstin e lirisë akademike. Një raport nga The American Association of University Professors (2021) thekson se rreth 40% e akademikëve ndjejnë se janë nën presion për të modifikuar përmbajtjen e mësimdhënies së tyre në përputhje me politikat e qeverisë ose të institucioneve. Kjo ngre pyetje mbi balancimin e lirisë akademike dhe ndjeshmërisë ndaj presioneve politike.

Martha Nussbaum, në librin e saj “Not for Profit: Why Democracy Needs the Humanities” (2010), argumenton se liria akademike është themelore për zhvillimin e

¹⁰ George, Robert. *Conscience and Its Enemies: Confronting the Dogmas of Liberal Secularism*. New York: Encounter Books, 2013.

¹¹ Universities UK. (2020). “Higher Education in England: Key Facts.”

mendimit kritik dhe se “në një shoqëri demokratike, është e domosdoshme që institucionet akademike të mbrojnë lirinë e shprehjes dhe të promovojnë debatet e hapura”¹².

Një shembull konkret është situata në Universitetin e Oksfordit, ku studentët kanë protestuar ndaj politikave që ndihmojnë “ndikimin politik” në përmbajtjen akademike. Studimet e kryera nga Institute of Education tregojnë se një numër në rritje i studentëve ndiejnë se liria e shprehjes është e kufizuar për shkak të frikës nga reagimet negative ndaj pikëpamjeve të tyre. Kjo është një situatë që kërkon një reflektim të thellë dhe një strategji për të siguruar një ambient ku të gjitha zërat mund të dëgjohen pa frikë.

Ndarja midis lirisë akademike dhe ndikimeve politike është një çështje e ndërlikuar që kërkon një qasje të kujdeshme. Universitetet duhet të angazhohen për të ruajtur një mjedis akademik ku diversiteti dhe përfshirja janë të promovuara, ndërsa gjithashtu mbrojnë lirinë akademike dhe të drejtën e individëve për të shprehur pikëpamjet e tyre pa frikë nga ndëshkimi.

Diversiteti dhe Përfshirja në Arsim

Diversiteti dhe përfshirja janë dy koncepte themelore që formësojnë një ambient akademik gjithëpërfshirës dhe inkurajues për zhvillimin e plotë të çdo individi. Në një universitet, diversiteti nënkupton pranimin dhe vlerësimin e dallimeve midis studentëve dhe stafit akademik – qoftë nga perspektiva gjinore, kulturore, racore, etnike apo sociale. Ky proces jo vetëm që pasuron mjedisin e të nxënësve, por gjithashtu kontribuon në krijimin e një komuniteti ku ide të ndryshme takohen dhe ndërveprojnë në mënyrë konstruktive. Përfshirja, nga ana tjetër, përfaqëson një angazhim për të siguruar që të gjithë anëtarët e komunitetit të ndihen të mirëpritur dhe të mbështetur, duke siguruar që asnjë grup nuk mbetet jashtë procesit të vendimmarrjes dhe zhvillimit akademik. Kjo kërkon që universitetet të zbatojnë politika dhe praktika që adresojnë pengesat strukturore dhe kulturore, dhe që promovojnë barazinë e mundësive për të gjithë, duke përfshirë trajnime, mentorime dhe strategji të reja që inkurajojnë integrimin e plotë.

Një raport nga Diversity in Higher Education (2020) thekson se universitetet që promovojnë diversitetin dhe përfshirjen kanë parë rritje të angazhimit dhe suksesit

¹² Nussbaum, Martha. Not for Profit: Why Democracy Needs the Humanities. Princeton: Princeton University Press, 2010.

akademik të studentëve nga grupe të ndryshme. “Politikat e përfshirjes ndihmojnë në krijimin e një ambienti që mbështet të gjitha zërat dhe siguron që çdo student të ndjehet i përfshirë”¹³.

Rëndësia e Njohjes së Dy Gjinive: Mashkull dhe Femër

Njohja e dy gjinive kryesore – mashkull dhe femër – mbetet një referencë themelore në shumë struktura politike dhe institucionale, për shkak të rrënjëve historike dhe traditave të cilat kanë formësuar normat e shoqërisë. Kjo njohje ofron një kornizë të qartë për zhvillimin e politikave të barazisë, duke siguruar që secila kategori të përfshihet në mënyrë të barabartë në proceset vendimmarrëse dhe në shpërndarjen e burimeve. Megjithatë, ndërkohë që ky binaritet mbetet i rëndësishëm për disa aplikime praktike, është thelbësore që universitetet të mbajnë një qasje kritike dhe të hapur ndaj diversitetit gjinor. Kjo nënkupton njohjen se realiteti shoqëror është më kompleks se sa sugjeron një model binar dhe se përfitimet e një kuadri gjithëpërfshirës janë të shumta: promovimi i kreativitetit, pasurimi i diskutimeve akademike dhe avancimi i drejtësisë sociale. Universitetet, duke ruajtur *një bazë të shëndoshë që njeh dy gjinitë kryesore*, duhet gjithashtu të eksplorojnë mënyra për të integruar dhe mosdiskriminuar identitete të tjera, për të siguruar që arsimit të mbështetë në mënyrë të plotë të gjithë anëtarët e komunitetit akademik.

Diskursi mbi Gjininë dhe Ndikimi i Tij në Politikën Akademike

Diskursi mbi gjininë ka evoluar ndjeshëm gjatë viteve, duke reflektuar ndryshimet shoqërore, kulturore dhe politike që kanë sfiduar paradigmat tradicionale. Në fillimet historike të studimeve gjinore, qasja kryesore ishte e përqendruar në dallimet esencionale midis mashkullit dhe femrës, e cila u bazua në role të caktuara sociale dhe biologjike. Me kalimin e kohës, hulumtimet ndërdisiplinore kanë shpalosur se identiteti gjinor është një konstrukt kompleks, i ndikuar nga faktorë psikologjikë, shoqërorë dhe historikë. Kjo transformim ka sjellë një rritje të ndjeshmërisë ndaj identiteteve që tejkalojnë binaritetin tradicional, duke përfshirë individët transgjendrorë, jo-binare dhe queer dhe duke sfiduar modelet e vjetra të kategorizimit gjinor.

Judith Butler, një teoricienë dhe filozofe, thekson në librin e saj “Gender Trouble” (1990) se identiteti gjinor është i ndërtuar dhe shoqëror, duke argumentuar se “identitetet gjinore janë performanca, dhe përmes performancës, ne krijojmë dhe

¹³ Diversity in Higher Education. “The Impact of Diversity Policies on Higher Education Institutions.” 2020.

riprodhojmë normat sociale”¹⁴. Kjo qasje ndihmon në kuptimin e kompleksitetit të identitetit në një ambient akademik.

Ky ndryshim paradigmatic ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në politikën akademike. Universitetet, si institucione që marrin pjesë aktive në prodhimin dhe shpërndarjen e dijes, janë bërë fushë debati midis ruajtjes së traditave dhe adoptimit të qasjeve gjithëpërfshirëse. Në këtë kontekst, diskursi mbi gjininë nuk është vetëm një çështje teorike, por ka ndikime konkrete në hartimin e kurikulimit, strukturimin e programeve të kërkimit dhe formulimin e politikave të pranimit dhe mbështetjes studentore. Për shembull, ndryshimet në mënyrën e trajtimit të temave gjinore kanë sjellë rishikime të thella të programeve akademike, ku përfshirja e studimeve të identiteteve të ndryshme gjinore konsiderohet esenciale për një edukim kritik dhe gjithëpërfshirës.

Nga një këndvështrim teorik, qasjet poststrukturaliste dhe teoritë queer kanë nxitur diskursin tradicional mbi gjininë, duke nxjerrë në pah se kuptimet e “mashkullit” dhe “femrës” janë të ndërtuara socialisht dhe mund të ndryshojnë në varësi të kontekstit kulturor dhe historik. Këto ide kanë sfiduar institucione të reja akademike për të ripërcaktuar mënyrën se si identitetet gjinore konsiderohen në hulumtim dhe në praktikën e përditshme akademike. Në disa raste, kjo ka çuar në debat të nxehtë midis mbrojtësve të traditës dhe përkrahësve të ndryshimeve progresive, duke reflektuar një tension midis ruajtjes së identiteteve tradicionale dhe kërkesës për përfshirje më të gjerë.

Ndikimi i këtij diskursi është evident edhe në mënyrën se si universitetet ndërtojnë politikën e tyre të brendshme. Në disa raste, përpjekjet për të integruar një kuptim më të gjerë të identitetit gjinor kanë rezultuar në reformat strukturore që promovojnë një mjedis më gjithëpërfshirës. Në të njëjtën kohë, sfidat ligjore dhe kulturore që lindin nga këto ndryshime kanë bërë që disa institucione të kenë adoptuar një qasje më rezervuar ose të ngadalë në adaptimin e këtyre reformat. Kështu, diskursi mbi gjininë vazhdon të mbetet një pikë kritike në politikën akademike, duke ndikuar në mënyrën se si institucione të ndryshme përballen me kompleksitetin e identiteteve gjinore dhe kërkesën për një mjedis më të drejtë dhe gjithëpërfshirës.

¹⁴ Butler, Judith. *Gender Trouble: Feminism and the Subversion of Identity*. New York: Routledge, 1990.

Përfundime dhe Rekomandime

Në një kohë kur diskursi politik rreth familjes dhe identitetit ka marrë një vëmendje të madhe, është thelbësore të shqyrtojmë mundësitë për të arritur një balancë midis vlerave tradicionale dhe gjithëpërfshirjes. Epoka e ndryshimeve të mëdha duket se ka ardhur, duke i rikthyer vëmendjen konceptit të familjes natyrore. Por, çfarë është familja? Në shkencat sociale, familja përkufizohet si një grup social i organizuar, i cili zakonisht përfshin individë që janë lidhur me njëri-tjetrin përmes marrëdhënieve gjaku, martesës apo lidhjeve të tjera emocionale dhe ekonomike. ***Familja shërben si një njësi themelore për transmetimin e kulturës, normave dhe vlerave nga një brez në tjetrin.***

Vlerat tradicionale, të cilat shpesh përfshijnë konceptet e stabilitetit familjar dhe ruajtjes së normave kulturore, shpesh përballen me kërkesat për përfshirje dhe diversitet, të cilat reflektojnë ndryshimet në shoqëri. Kjo ndarje shpesh krijon tensione në mënyrën se si institucionet arsimore formulojnë politikat e tyre dhe qasjen ndaj studentëve.

Universitetet luajnë një rol të rëndësishëm në edukimin e brezave të rinj. Ato janë hapësira ku ide të ndryshme mund të debatojnë dhe sfidojnë njëra-tjetrën, duke ofruar një mjedis që nxit mendimin kritik dhe reflektimin. Siç thekson Nussbaum, përfshirja e humaniteteve në kurrikulat universitare është thelbësore për zhvillimin e një shoqërie të edukuar dhe të angazhuar (Nussbaum, 2010). Universitetet kanë përgjegjësinë të promovojnë mësimin e vlerave universale, si toleranca dhe respekti për diversitetin, duke ui dhënë studentëve mjetet për të përballuar sfidat e një bote gjithnjë e më komplekse.

Perspektiva e re që sjell punimi përfshiu disa aspekte të rëndësishme:

1. **Rikthimi në Familjen Natyrore:** Një nga piketat kryesore është diskutimi mbi rikthimin e fokusit në familjen natyrore në kontekstin e ndryshimeve sociale dhe politike. Kjo përfshin analizimin e ndikimit të politikave të reja mbi njohjen e identiteteve familjare dhe se si ato përkojnë me vlerat tradicionale.

2. **Ndikimi i Diskursit Politik në Arsimin e Lartë:** Një tjetër kontribut i rëndësishëm është analiza e ndikimit të diskursit politik në programet akademike dhe kulturën universitare. Kjo perspektivë sjell një kuptim më të thellë të marrëdhënies midis politikës dhe arsimit, duke ndihmuar në identifikimin e sfidave dhe mundësive për universitetet.

3. **Diversiteti dhe Përfshirja:** Diskutimi mbi qasjen e universiteteve ndaj diversitetit dhe përfshirjes është gjithashtu një kontribut i rëndësishëm. Kjo perspektivë thekson nevojën për të krijuar hapësira që pranojnë të gjitha format e familjeve dhe identiteteve, si dhe rëndësinë e mbështetjes së grupeve të ndryshme studentore.

4. **Balanca midis Vlerave Tradicionale dhe Gjatëpërfshirjes:** Punimi trajton gjithashtu sfidën për të arritur një balancë midis ruajtjes së vlerave tradicionale dhe promovimit të përfshirjes, duke ofruar sugjerime për rolin e universiteteve në këtë proces.

5. **Roli i Universitetit si Hapësirë Debati:** Një aspekt i rëndësishëm mbetet rrethi universitar si një hapësirë ku debati dhe dialogu janë vlerë, veçanërisht në lidhje me çështjet e identitetit dhe diversitetit.

Duke sjellë këto perspektiva të reja, ky punim ofron një kontribut të rëndësishëm në debatin akademik dhe social mbi ndikimin e politikës në arsimin e lartë dhe mbi rolin e universiteteve në një shoqëri në ndryshim. Kjo është një qasje që analizon problemet aktuale dhe ofron mundësi për zgjidhje dhe përmirësim.

Në lidhje me perspektivat për të ardhmen e arsimit të lartë në raport me reformat sociale, është e qartë se institucionet duhet të përshtaten për të reflektuar ndryshimet në shoqëri. Duke u përballur me sfidat e ndryshimeve politike dhe ideologjike, universitetet duhet të ndjekin strategji që mbështetin përfshirjen dhe diversitetin. Kjo përfshin zhvillimin e politikave që nxitin barazinë dhe qasjen në arsim për të gjithë studentët, pavarësisht nga identiteti i tyre familjar, gjinor ose etnik.

Për të arritur këto qëllime, rekomandohet që universitetet të:

1. **Promovojnë programe edukative që nxitin ndërgjegjësimin mbi diversitetin dhe gjithëpërfshirjen:** Këto programe duhet të përfshijnë trajnim mbi rëndësinë e diversitetit dhe përfshirjes për studentët dhe stafin e universiteteve, sikundër të rikonceptojë qasjen mbi vlerat dhe rolin themelor të institucionit të familjes tradicionale.

2. **Krijojnë politika mbështetëse për studentët nga grupe të ndryshme:** Kjo do të ndihmojë në reduktimin e barrierave që pengojnë pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme studentore dhe do të promovojë një mjedis më të pranueshëm dhe gjithëpërfshirës.

3. Inkurajojnë hulumtime që shqyrtojnë ndikimin e politikave sociale në edukimin e lartë: Hulumtimet duhet të ofrojnë të dhëna të sakta mbi efektet e ndryshimeve politike dhe sociale në programet akademike dhe në suksesin e studentëve.

4. Fokusohehet në zhvillimin e një kulture të debatit të hapur: Universitetet duhet të krijojnë hapësira për debat të lirë dhe kritik, ku studentët dhe stafi mund të ndajnë pikëpamjet e tyre pa frikën e pasojave negative.

Mendoj se kështu mund të arrijmë një balancë të nevojshme midis *vlerave tradicionale* dhe *përfshirjes*, duke ndihmuar në ndërtimin e një sistemi arsimor që është më i drejtë, më përfshirës dhe më i gatshëm për të përballuar sfidat e së ardhmes.

Referencat:

1. Nussbaum, M. (2010). *Not for Profit: Why Democracy Needs the Humanities*. Princeton University Press.
2. Berkhout, J. (2014). "The Politics of Family: Conservative and Liberal Perspectives." *Journal of Family Theory & Review*, 6(3), 242-260.
3. Giddens, A. (2006). *Sociology*. Polity Press.
4. Ruggiero, K. (2015). "Social Class and Family Structures." *Sociology Compass*, 9(9), 723-733.
5. United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (UNESCO). (2020). "The Global Education Monitoring Report 2020: Inclusion and education: All means all." UNESCO Publishing.
6. American Council on Education. (2021). "The Value of Higher Education: A Global Perspective." ACE.
7. European University Association. (2021). "Trends 2021: Learning and Teaching in the European Higher Education Area." EUA.
8. National Center for Education Statistics (NCES). (2021). "Digest of Education Statistics 2020." U.S. Department of Education.
9. Council of Europe. (2020). "Diversity and Inclusion in Higher Education: A Policy Review." Council of Europe Publishing.

ARTI SI SIPËRMARRJE: NJË KRAHASIM ITALI-SHQIPËRI

Msc. Bledar RADONSHIQI

CEO Eventalb_Milano, Itali (bledi@eventalb.com)

Abstrakt

Arti nuk shikohet vetëm si mënyrë për t'u argëtuar, por edhe si një mundësi biznesi. Vendet me ekonomi të konsoliduar e kanë të zhvilluar sektorin e artit dhe shumë sipërmarrës kanë ngritur biznese në këtë fushë. Rritja e kërkesës së tregut për shërbime dhe vepra artistike, si edhe zhvillimi i turizmit ka ndikuar në rritje të bizneseve të reja dhe zhvillimin e atyre ekzistuese. Italia është një vend i Bashkimit Europian i cili e ka të zhvilluar artin dhe ka një numër të lartë kompanish artistike që operojnë jo vetëm brenda vendit, por edhe në nivel ndërkombëtar. Rritja e këtij sektori të ri ka ndikuar pozitivisht edhe në Shqipëri edhe pse ka një treg të vogël, ka një numër në rritje të kompanive të regjistruara që operojnë në sektorin e artit. Qëllimi i këtij studimi është që, me anë të intervistave të sipërmarrësve në Shqipëri dhe Itali, të hulumtohen arsyet pse kanë zgjedhur të investojnë kapital në këtë sektor dhe sfidat me të cilat përballen.

Fjalë kyçe: *art, artist, sipërmarrje, treg, turizëm.*

JEL CODE: Z11, L80, L26

Hyrje

Arti dhe kultura shihen si një industri që kontribuon jo vetëm në argëtim dhe në një jetë sociale aktive, por edhe në zhvillimin e ekonomisë, duke ndikuar si në aspektin mikro ashtu edhe në atë makro. Zhvillimi i festave private dhe i inaugurimeve ka rritur kërkesën për projekte artistike, duke Ky trend ka ndikuar pozitivisht në krijimin e bizneseve të reja të lidhura me artin, si dhe në zgjerimin e mundësive të punësimit për artistët dhe profesionistët e sektorit kulturor.

Zhvillimi i turizmit ka identifikuar një nevojë të rëndësishme për aktivitete argëtimi, duke krijuar mundësi për restorante, hotele dhe bare që të ofrojnë evente private dhe shfaqje të ndryshme për të pasuruar përvojën e turistëve. Pjesëmarrësit në këto aktivitete mund të shijojnë një gamë të gjerë shërbimesh dhe mundësisht argëtimi, duke e bërë qëndrimin e tyre në Shqipëri një eksperiencë të paharrueshme dhe gjithnjë e më të kërkuar. Kjo ka sjellë një kërkesë në rritje për organizimin e aktiviteteve

kulturore, muzikore dhe artistike, që jo vetëm nxisin turizmin, por gjithashtu kontribuojnë në zhvillimin e bizneseve që operojnë në këtë sektor. Angazhimi në projekte artistike, siç janë ekspozitat, koncertet dhe festivale të ndryshme, ka ndihmuar në diversifikimin e ofertës turistike, duke tërhequr një audiencë gjithnjë e më të gjerë dhe duke ofruar mundësi të reja për zhvillim ekonomik në nivel lokal.

Qëllimi i studimit

Ky studim ka për qëllim të identifikojë rëndësinë e artit në ekonomi, në një analizë krahasuese në peshën që ai në Evropë konkretisht Itali dhe në Shqipëri.

Objektivat e studimit

- Të kuptojmë se si arti kontribuon në zhvillimin e ekonomisë;
- Të identifikojmë niveli dhe pesha e zhvillimit të sektorit të artit në Evropë;
- Të analizojmë zhvillimi i sektorit të artit në Shqipëri.

Metodologjia e studimit

Ky studim, nëpërmjet burimeve zyrtare që lidhen me sektorin e artit, argëtimit dhe rekreacionit, të cilat përfshijnë industrinë e artit synon, përmes metodës përshkruese-krahasuese, të paraqesë një pasqyrë mbi ndikimin ekonomik të kësaj industrie në Evropë dhe në Shqipëri Burimet primare përfshijnë intervistat e drejtuara sipërmarrësve në sektorin e artit në Itali dhe Shqipëri. Gjithashtu, janë përdorur burime nga Eurostat, OECD, Instituti i statistikave në Shqipëri. Që ky studim të ishte i plotë dhe për të pasur një këndvështrim nga grupet e interesit, janë realizuar intervista me sipërmarrës në fushën e artit në Itali, si përfaqësues të Europës, dhe në Shqipëri, si përfaqësues të Ballkanit.

Industria e Artit dhe ndikimi ekonomik


Artet dhe kultura luajnë rol në zhvillimin ekonomik të shteteve. Industrinë e artit dhe të kulturës është një burim i fuqishëm i përfitimeve ekonomike për shtetet dhe komunitetet. Këto industri jo vetëm që krijojnë mundësi pune dhe rrisin investimet, por gjithashtu gjenerojnë të ardhura përmes taksave dhe kontribuojnë në rritjen e ekonomisë lokale, duke stimuluar industrinë e turizmit¹. Në vendet me ekonomi të brishtë, arti dhe kultura mund të mos kenë një ndikim të drejtpërdrejtë të

¹<https://www.nga.org/publications/arts-the-economy-using-arts-and-culture-to-stimulate-state-economic-development/> (aksesuar 10.04.2025)

madh në ekonomi, megjithatë, nuk mund të mohohet se ato luajnë një rol të rëndësishëm tërthor, duke nxitur zhvillimin e sektorëve të tjerë ekonomikë. Industria e turizmit është thelbësisht e lidhur me artin, i cili luan një rol të madh në krijimin e përvojave të bukura për turistet².

Industria e Artit në Europë

Industria e artit në Europë karakterizohet nga ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe nga profesionistë të lirë, pra të vetëpunësuar. Eurostat ka analizuar të dhëna në lidhje me biznese në industrinë e artit, që përfshin në vetvete sektorin e artit, argëtimit dhe rekreacionit. Referuar të dhënave, ky sektor ka siguruar një nivel punësimi prej 2.1 milionë individësh, që nëse i shprehim në normë, janë rreth 1.3% e të punësuarve në totalin e të punësuarve në sektorin privat në BE³. *Grafike 1: Vlera e shtuar dhe punësimi në art, argëtimit dhe rekreacionit*




Burimi: Eurostat (2024) dataset: [sbs_ovw_act](#)

²<https://ilmiyanjumanlar.uz/uploads/conferences/0034/5.3%20.pdf> (aksesuar 10.04.2025)

³<https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-eurostat-news/w/ddn-20240412-2> (17.05.2025)

Nga të dhënat e mësipërme shohim që Malta ka kontributin më të madh në këtë industri, si për sa i përket vlerës së shtuar në ekonomi, ashtu edhe për punësimin, pra rreth 16.9%. Vendi me ndikimin më të ulët është Luksemburgu, me rreth 0.2%, një ndikim i papërfillshëm duke marrë parasysh strukturën ekonomike dhe zhvillimin ekonomik që ka ky vend.

Grafikë: 2: Ndryshimi në % e numrit të ndërrmarjeve në sektorin e artit, argëtimit dhe (2021-2022)




Burimi: OECD (2024) dhe Leogrande. A (2024)

Referuar të dhënave të grafikut mund të themi që viti 2022 ka shënuar një rritje krahasuar me vitin 2021 të numrit të bizneseve rreth 2.24 % mesatarisht më shumë. Kjo rritje është një tregues që kjo industri po zhvillohet me ritme të moderuara por të

qëndrueshme. Lituania ka një rritje më të madhe rreth 22.23 %, Estonia 19.99 % dhe Norvegjia rreth 15.93 % më shumë⁴

Grafikë 3: Numri i ndermarrjeve në sektorin e artit, argetimit dhe rekreacionit



Burimi: OECD (2024) dhe Leogrande. A (2024)

Sipas të dhënave të grafikut të mësipërm, mund të shohim që Franca dhe Holanda, Spanja, Gjermania, Italia kanë një numër të lartë të bizneseve që operojnë në industrinë e artit. Por në këtë grafik shohim edhe vende të Ballkanit Perëndimor,

⁴ Leogrande. A (2024) "Enterprises Operating in the Arts, Entertainment, and Recreation Sector in OECD Countries" Preprint: 5 DOI:10.5281/zenodo.11429631 https://www.researchgate.net/publication/381107538_Enterprises_Operating_in_the_Arts_Entertainment_and_Recreation_Sector_in_OECD_Countries

të cilat kanë biznese që operojnë në industrinë e artit, por Shqipëria nuk është përfshirë në këtë grafik, sepse ka një numër të papërfillshëm të bizneseve në art⁵

Industria e Artit në Shqipëri

Shqipëria, kohët e fundit, po përjeton një zhvillim të shpejtë ekonomik, i cili është i lidhur ngushtë me rritjen e ndjeshme të sektorëve të ndërtimit dhe turizmit. Ky progres ka sjellë krijimin e mundësive të reja pune dhe ka tërhequr investime të konsiderueshme, veçanërisht në infrastrukturë dhe shërbime. Rritja e numrit të turistëve ka stimuluar zhvillimin e bizneseve lokale dhe ka kontribuar në rritjen e të ardhurave për shtetin. Po ashtu, modernizimi i qyteteve dhe përmirësimi i kushteve të jetesës kanë bërë që Shqipëria të shihet si një destinacion tërheqës për investitorët e huaj dhe për ata që kërkojnë mundësi zhvillimi. Tregu Shqipatar është një treg shumë i vogël nëse i referohemi artit, ndaj shume sipermarrjes zgjedhin të investojnë në sektor të tjerë. Megjithatë, sipermarrjet në evente artistike po rriten si pasojë e kërkesës së tregut. Pjesëmarrësit në këto aktivitete mund të shijojnë një gamë të gjerë shërbimesh dhe mundësi argëtimi, duke e bërë qëndrimin e tyre në Shqipëri një eksperiencë të paharrueshme dhe gjithnjë e më të kërkuar. Sipermarrjet në sektorin e eventeve artistike kërkojnë një nivel të lartë kreativiteti, si dhe mbështetje në njohuri dhe kompetenca në fushat financiare, organizative, tatimore dhe ligjore⁶. Zhvillimi i një kompanie duhet të stimulohet njëkohësisht konkurrencën si në fushën tregtare, ashtu edhe në atë artistike. Sipas ekonomisë nga qellimet kryesore të një kompanie është maksimizimi i fitimit duke ulur kostot por produkti artistik shkon përtej kësaj. Sipas pikëpamjes së teorisë ekonomike, për të shfaqur një treg, produktet artistike duhet të plotësojnë kërkesën, e cila pasqyron nevojat e shoqërisë⁷

⁵ Leogrande. A (2024) "Enterprises Operating in the Arts, Entertainment, and Recreation Sector in OECD Countries" Preprint: 6 DOI:10.5281/zenodo.11429631 https://www.researchgate.net/publication/381107538_Enterprises_Operating_in_the_Arts_Entertainment_and_Recreation_Sector_in_OECD_Countries

⁶ Sahalovich. A (2024) "The problem of functioning of the art market" Grundlagen der modernen wissenschaftlichen forschung:18 DOI:10.36074/logos-24.05.2024.001 https://www.researchgate.net/publication/381379264_THE_PROBLEM_OF_FUNCTIONING_OF_THE_ART_MARKET

⁷ Robertson I. (2015), "Understanding Art Markets" Routledge 1 st Edition, London: 388

Analizimi i tregut të artit mund të jetë i vështirë, sidomos në vendet që janë ende në zhvillim. Kjo ndodh për disa arsye, duke përfshirë mungesën e të dhënave të sakta dhe të përditësuara që lidhen me ndikimin ekonomik të artit. Përpjekjet për të matur ndikimin e industrisë së artit në PBB (Produktin e Brendshëm Bruto), punësim, apo rritje të financave personale të artistëve janë të kufizuara për shkak të natyrës informale të këtij sektori. Vendet e Ballkanit Perëndimor nuk disponojnë të dhëna të sakta dhe konkrete për nivelin e zhvillimit të sektorit të artit si një mundësi sipërmarrjeje të suksesshme. Ndërkaq, shumë shtete të tjera evropiane e kanë zhvilluar këtë sektor dhe kanë të dhëna të detajuara mbi ndikimin e tij në ekonominë përkatëse. Situata është e ngjashme edhe në Shqipëri, ku sipërmarrjet në industrinë e artit janë ende të pakta dhe shpesh të karakterizuara nga tentativa pa shumë përparim. Pavarësisht kësaj, për të zhvilluar këtë sektor, është thelbësore që shteti të intensifikojë mbështetje dhe stimulim për sipërmarrësit dhe investitorët, duke krijuar një mjedis më të favorshëm për zhvillimin e tij.

Tabelë 1: Struktura në përqindje e numrit të ndërmarrjeve të reja dhe punësimit (2021-2023)

Aktiviteti Ekonomik	2021		2022		2023	
	Ndërmarrje të reja	Të punësuar	Ndërmarrje të reja	Të punësuar	Ndërmarrje të reja	Të punësuar
Gjithsej	100	100	100	100	100	100
B Industria nxjerrëse	0,2	0,1	0,2	0,3	0,2	0,5
C Industria përpunuese	4,7	10,0	5,5	11,5	5,2	8,3
D Energjia elektrike, gaz, avull dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	0,6	0,3	0,3	0,2	0,9	0,7
E Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbejeve	0,2	0,2	0,3	1,7	0,2	1,8
F Ndërtimi	6,4	8,2	7,2	9,5	7,9	11,2
G Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motorçikletave	30,8	21,4	27,3	22,1	26,2	20,9
H Transporti dhe magazinimi	3,8	3,0	4,3	3,5	4,7	3,6
I Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	13,4	14,0	12,8	13,1	13,3	14,0
J Informacioni dhe komunikacioni	8,6	11,1	9,4	8,6	8,2	9,0
K Aktivitete financiare dhe të sigurimit	1,4	0,9	1,5	0,9	2,3	1,4
L Aktivitete të pasurive të paluajtshme (real estate)	2,1	1,3	2,9	1,8	2,7	1,8
M Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	9,8	9,6	10,1	9,8	8,8	7,4
N Shërbime administrative dhe mbështetëse	6,0	10,0	6,7	7,5	7,8	8,0
P Arsimiti	0,9	1,8	0,8	0,9	0,6	2,2
Q Shëndeti dhe aktivitete të punës sociale	4,0	3,7	3,2	3,0	3,2	3,3
R Arte, argëtim dhe lojë	1,8	1,3	1,7	1,5	1,8	1,3
S Aktivitete të tjera shërbimi	5,2	3,2	6,0	4,2	6,0	4,4
Në Republikën e Maqedonisë, operacionet me karta janë të disponueshme në të gjitha bankat komerciale private, ku 14 prej tyre lëshojnë karta të markave ndërkombëtare MasterCard, Visa International dhe American Express, ndërsa 5 banka lëshojnë karta me markë kombëtare. Në përdorim janë edhe kartat e kompanisë financiare jobankare Diners Club Macedonia. Kartat e pagesave përdoren për depozitim dhe tërheqje të parave në bankomate, pagesa përmes POS terminaleve dhe pagesa online, ndërsa ekzistojnë edhe karta që Banka Popullore e RMV i quan “karta cash”, të cilat nuk mund të përdoren për pagesa, por vetëm për operacione në bankomate dhe vetëm në bankomatet e bankës që i ka lëshuar ato.

Sipas statistikave të pagesave të NBRSM, vërehet se numri i kartave të lëshuara në Maqedoninë e Veriut rritet çdo vit. Kjo rritje përfshin si kartat debi, ashtu edhe ato kredi. Në grafikun vijues do të prezantohet kjo rritje për periudhën 2017–2022.

Grafiku 1: Numri total i kartave në qarkullim



Burim : Banka qendrore e RMV

Nga dhjetori 2017 deri në dhjetor 2023, Maqedonia e Veriut ka përjetuar një rritje të qëndrueshme të numrit të kartave të lëshuara të pagesave, me një rritje prej 248,243 kartash, ose 17.4% gjatë gjashtë viteve. Kjo rritje pasqyron transformimin digjital të sektorit financiar dhe përputhet me trendet globale drejt ekonomive pa para fizike. Megjithatë, edhe pse numri total i kartave vazhdon të rritet, po vërehet një ngadalësim i ritmeve vjetore të rritjes.

P.sh., vetëm në vitin 2021 u regjistrua një rritje prej 69,320 kartash, që përfaqëson një rritje vjetore prej 4.3% — dukshëm më e ulët krahasuar me vite të tjera. Ky trend sugjeron se zgjerimi i shpejtë fillestar mund të jetë duke u ngadalësuar teksa tregu po maturohet.

Faktorët kryesorë:


Saturimi i tregut – Tregu i kartave po i afrohet ngopjes, veçanërisht në zonat urbane ku penetrimi bankar është i lartë.

Praktikat e raportimit – Disa banka mund të raportojnë kartat e rinovuara si karta të reja, duke krijuar një rritje artificiale.

Ndikimi i politikave për pagesa jo-cash – Iniciativat publike dhe bankare për reduktimin e përdorimit të parasë fizike po japin rezultate, përfshirë stimule, infrastrukturë më të mirë dhe fushata vetëdijësi.

Përveç numrit të përgjithshëm të kartave, variacione vërehen edhe te llojet e kartave në qarkullim. Sipas NBRSM, kartat klasifikohen si karta cash, karta debi dhe karta pagese/kredi. Grafiku vijues paraqet strukturën e tyre për periudhën 2017–2023.

Grafiku 2: Llojet e kartave në qarkullim



Burim : Banka qendrore e RMV

Analiza e shpërndarjes së llojeve të kartave në periudhën 2017–2023 tregon një strukturë të përgjithshme të qëndrueshme, por me lëvizje të brendshme që pasqyrojnë ndryshimet në preferencat e konsumatorëve dhe strategjitë bankare.

Rënie e kartave cash – Nga 5% në 2017 në 3% në 2021. Rënia tregon zhdukjen e kartave me funksion të kufizuar, pasi përdoruesit preferojnë karta shumëfunktionale.


Stabilitet dhe rritje graduale e kartave të kreditit – Mbajnë rreth 20–21% të tregut. Lidhur me rritjen e ekspozimit të kredive të amvisërive.

Dominimi dhe rritja e kartave debi – Nga 74% në 2017 në 77% në 2022. Rritja 3–6% çdo vit tregon rritje të përdorimit të kartave për transaksione të përditshme dhe pagesa online.

Implikimet më të gjera:

- Rënia e kartave cash pasqyron rritjen e digjitalizimit.
- Rritja e kartave debi/kredi tregon përdorim më aktiv të pagesave elektronike.
- Rritja e përdorimit të kartave të kreditit lidhet me rritjen e kërkesës për likuiditet nga konsumatorët.
- Bankat janë aktorë kyç në promovimin e pagesave elektronike.

Grafiku 3: Numri i transaksioneve të kryera me karta pagese



Burim : Banka qendrore e RMV

Nga grafiku 3 vërehet rritje e numrit të transaksioneve të kryera me kartat e pagesave. Ndërkohë, numri i transaksioneve me karta cash zvogëlohet çdo vit, si rezultat i uljes së numrit të kartave të këtij lloji, siç u përmend më lart. Rritja e përdorimit të kartave debi dhe kredi është arsyeja kryesore e këtij ndryshimi.

Proporcionale me rritjen e numrit të transaksioneve, rritet edhe **vlera financiare e transaksioneve**, siç shihet në grafikun tjetër.

Grafiku 4: Vlera e transaksioneve të kryera me karta pagese



Burim : Banka qendrore e RMV

Vlera e transaksioneve me karta pagese në vitin 2015 arriti 14.49 miliardë denarë, afërsisht 235.67 milionë euro, që paraqet një rritje prej 12% krahasuar me 2014. Kjo rritje reflekton adoptimin në rritje të pagesave me karta dhe besimin e shtuar të konsumatorëve ndaj mënyrave jo-cash.

Rritja e qëndrueshme tregon:

- Kalimin gradual të konsumatorëve nga paraja e gatshme te pagesat elektronike.
- Zgjerimin e rrjetit POS.
- Rritjen e numrit të kartave debi/kredi.
- Shtimin e platformave të e-commerce.
- Fushatat e vetëdijësimit për përdorimin e kanaleve formale financiare.

Vlera mesatare e transaksioneve prej rreth 2,500 denarë (40–42 euro) në tre vitet e fundit tregon se kartat po përdoren për blerje të përditshme, jo vetëm për blerje të mëdha, çka është një shenjë pozitive drejt formimit të kulturës së pagesave digjitale.

Konkluzione dhe rekomandime

Konkluzionet e studimit tregojnë se në Maqedoninë e Veriut ka pasur një rritje të qëndrueshme të përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave gjatë viteve 2017–2023, megjithëse pagesat me para të gatshme ende mbeten dominante. Politikat shtetërore dhe masat rregullative kanë ndikuar pozitivisht në përhapjen e pagesave jo-cash, ndërsa bankat komerciale kanë luajtur rol kyç përmes inovacioneve teknologjike dhe zgjerimit të infrastrukturës bankare. Numri i kartave të pagesave është rritur me 17.4%, me dominim të kartave debi dhe rënie të kartave cash, çka pasqyron një maturim gradual të tregut financiar. Rritja e numrit dhe vlerës së transaksioneve me kartë tregon rritjen e besimit të konsumatorëve dhe përdorimin gjithnjë e më të shpeshtë të kartave për blerje të përditshme, ndërsa stabiliteti i kartave të kreditit lidhet me rritjen e kreditimit të amvisërive. Përmirësimi i edukimit financiar, ulja e komisioneve për pagesa elektronike, rritja e sigurisë kibernetike, zgjerimi i rrjetit POS në zona rurale, si dhe zhvillimi i platformave të e-commerce paraqesin rekomandime të rëndësishme për nxitjen e mëtejshme të digjitalizimit financiar dhe reduktimin e varësisë nga paraja e gatshme. Bashkëpunimi midis qeverisë dhe sektorit bankar, si dhe motivimi i bizneseve të vogla për pranimin e pagesave elektronike, mbeten faktorë vendimtarë për përshpejtimin e tranzicionit drejt një ekonomie më digjitale dhe më transparente.

Rekomandohet që institucionet shtetërore të vazhdojnë modernizimin e kuadrit ligjor dhe të krijojnë politika më stimuluese për përdorimin e pagesave elektronike, përfshirë lehtësimin e procedurave për hapjen e llogarive bankare dhe reduktimin e komisioneve për transaksione digjitale. Bankat duhet të investojnë më shumë në inovacione teknologjike, të rrisin sigurinë kibernetike dhe të përmirësojnë platformat mobile banking për të rritur përfshirjen financiare dhe besimin e qytetarëve. Po ashtu, është e nevojshme të zhvillohen programe të edukimit financiar për konsumatorët, me qëllim që të rritet ndërgjegjësimi për përfitimet e pagesave jo-cash dhe përdorimin e përgjegjshëm të kartave të kreditit. Bizneset, veçanërisht ato të vogla dhe të mesme, duhet të inkurajohen të instalojnë terminale POS dhe të ofrojnë opsione të pagesave elektronike, duke përfituar nga subvencionet ose lehtësimet fiskale që mund të ofrojë shteti. Zgjerimi i rrjetit të POS terminaleve dhe bankomatëve në zonat rurale do të ulë hendekun midis zonave urbane dhe rurale dhe do të rrisë qasjen në shërbime financiare moderne. Gjithashtu, rekomandohet intensifikimi i fushatave sensibilizuese për promovimin e e-commerce dhe shërbimeve digjitale, si dhe krijimi i mekanizmave më të mirë të monitorimit për të shmangur raportimet e pasakta nga institucionet financiare. Këto masa do të përshpejtojnë tranzicionin drejt një ekonomie të avancuar digjitale, më transparente, më efikase dhe më pak të varur nga paraja fizike.

ARTIFICIAL INTELLIGENCE AND ITS IMPACT ON LABOUR PRODUCTIVITY: THEORETICAL AND SECONDARY EMPIRICAL EVIDENCE FOR SMALL AND MEDIUM-SIZED ENTERPRISES

Doc. Dr. Gazmend Beshi

Dean, Faculty of Economics and Business
International University of Struga
g.beshi@eust.edu.mk

Abstract

Artificial intelligence is increasingly becoming one of the most significant drivers of economic and organisational transformation in modern economies. Its impact on labour productivity represents a central issue for economic theory and public policy, particularly in the context of small and medium-sized enterprises, which constitute the structural backbone of most national economies. This article analyses the impact of artificial intelligence on labour productivity in SMEs by employing a theoretical methodology combined with secondary empirical evidence drawn from reliable international sources. The study conceptualises AI as a general-purpose technology capable of enhancing productivity through automation, improved decision-making, and the reorganisation of work processes. The results indicate that the positive impact of AI on SME productivity is not automatic, but rather contingent upon the level of human capital, digital skills, and the organisational capacity to absorb technological innovation.

Keywords: *Artificial Intelligence, Labour Productivity, SMEs, Automation, Modern Economy*

Introduction

Labour productivity represents one of the key determinants of economic growth, business competitiveness, and improvements in living standards. Over recent decades, technological developments have significantly transformed production methods and work organisation; however, artificial intelligence represents a qualitatively new phase of this transformation.

Unlike traditional automation technologies, AI extends into cognitive and analytical tasks, directly affecting mental and knowledge-based labour productivity. For SMEs, this technology simultaneously presents an opportunity for increased efficiency and a structural challenge, given their limitations in financial and human resources.

The purpose of this study is to systematically analyse the relationship between artificial intelligence and labour productivity in SMEs, by combining theoretical analysis with secondary empirical evidence.

Literature Review

The literature suggests that the benefits of AI are not uniform and depend heavily on the institutional and organisational context. Classical productivity theory links economic growth to technological progress, with the Solow model and endogenous growth theories emphasising technology as a key driver of long-term growth. In contemporary literature, AI is increasingly treated as a general-purpose technology, comparable to electricity or information and communication technologies.

Recent studies indicate that AI has the potential to increase total factor productivity, while simultaneously generating labour market polarisation. In the context of SMEs, the literature highlights that productivity gains from AI depend critically on organisational integration and the development of human capital.

Methodology

This study adopts a theoretical research approach combined with secondary empirical analysis. Data are drawn from reports published by the OECD, the World Bank, Eurostat, and peer-reviewed academic studies. This methodology enables cross-country comparative analysis while avoiding the limitations associated with small sample sizes.

Artificial Intelligence and Labour Productivity in SMEs

Small and medium-sized enterprises constitute the structural backbone of most contemporary economies, contributing significantly to employment, innovation, and value creation. However, SMEs are often characterised by structural constraints related to financial resources, technological capabilities, and human capital, making them particularly sensitive to technological change. In this context, artificial

intelligence represents a potentially transformative factor for labour productivity in SMEs, albeit with effects that are neither automatic nor uniform.

From an economic perspective, the impact of AI on labour productivity in SMEs operates through several key mechanisms. First, AI enables the automation of routine and administrative processes, reducing the time required for low value-added tasks. This allows human resources to be reallocated towards more complex and creative activities, thereby increasing average labour productivity. In SMEs, where workforce size is relatively limited, this effect tends to be disproportionately larger than in large enterprises.

Second, artificial intelligence enhances productivity through improvements in decision-making processes. AI-based systems, including advanced data analytics, demand forecasting, and operational optimisation, reduce uncertainty and improve the accuracy of managerial decisions. For SMEs, which often operate in environments characterised by incomplete information and limited analytical capacity, this dimension is particularly important, as it directly affects operational efficiency and economic performance.

However, both theoretical literature and empirical evidence suggest that artificial intelligence does not act as a direct substitute for labour in SMEs, but rather as a complementary technology. AI enhances the productivity of existing workers by expanding their analytical and operational capabilities, rather than fully replacing them. This complementary effect is more pronounced in enterprises that simultaneously invest in digital skills development and the reorganisation of work processes.

A critical aspect of the relationship between AI and productivity in SMEs concerns the firm's absorptive capacity, defined as the ability to recognise the value of new knowledge, assimilate it, and apply it effectively. SMEs with low levels of digital skills and rigid organisational structures tend to derive fewer productivity benefits from AI adoption, thereby limiting its overall impact on labour productivity.

From an organisational perspective, artificial intelligence contributes to a reconfiguration of roles and functions within SMEs. Employees increasingly engage in tasks requiring judgement, creativity, and human interaction, while AI systems handle data processing and standardised procedures. This transformation has direct implications for long-term productivity, as it increases the value of cognitive labour and human capital.

Nevertheless, the impact of artificial intelligence on SME productivity remains contingent upon external institutional and economic factors. Inadequate digital infrastructure, limited access to finance, and insufficient institutional support can significantly constrain SMEs' ability to effectively integrate AI. Consequently, productivity differentials between AI-adopting SMEs and non-adopters risk widening, leading to structural polarisation within the SME sector.

In summary, artificial intelligence represents substantial potential for increasing labour productivity in SMEs, but this potential does not materialise automatically. AI should be conceptualised as part of a broader organisational and strategic transformation encompassing human capital development, work process reorganisation, and institutional support. Only under these conditions can AI evolve from a technological investment into a sustainable source of productivity growth for SMEs.

Resource-Based View and AI as a Competitive Advantage

From a resource-based perspective, artificial intelligence does not automatically constitute a competitive advantage. It generates value only when combined with other resources that are difficult to imitate, such as human capital, organisational knowledge, and an innovation-oriented culture.

For SMEs, this aspect is decisive. Unlike large corporations, SMEs compete not through scale, but through specialisation and flexibility. When strategically integrated, AI can reinforce these characteristics by enhancing the productivity of skilled labour and enabling greater product and service customisation.

However, theoretical evidence suggests that SMEs adopting AI without developing complementary resources risk failing to capture its benefits, thereby turning AI investments into underutilised costs

International Empirical Evidence

International empirical evidence on the impact of artificial intelligence on labour productivity in SMEs suggests a generally positive but highly heterogeneous relationship, dependent on institutional context, level of economic development, and organisational capacity. Studies based on OECD, World Bank, and other international datasets indicate that AI adoption does not produce uniform productivity effects, but rather acts as an amplifier of existing structural differences among SMEs.

In high-income economies, empirical evidence shows that SMEs integrating AI applications report significant labour productivity gains, particularly in knowledge-intensive services, specialised manufacturing, and digital trade. According to OECD data, AI-adopting SMEs in these economies experience labour productivity increases ranging between 10 and 25 per cent compared to non-adopters. These gains are primarily associated with administrative automation, improved supply chain management, and enhanced decision-making efficiency.

By contrast, in middle-income and developing economies, empirical findings present a more fragmented picture. While some SMEs benefit from AI adoption through productivity gains and cost reductions, many enterprises fail to sustain these benefits. World Bank studies highlight that insufficient digital infrastructure, limited access to finance, and low digital skill levels significantly reduce AI's impact on labour productivity. In such contexts, AI often remains a partial technology, applied only to isolated segments of the production process.

A central element of international empirical evidence concerns the mediating role of human capital. SMEs operating in environments characterised by higher levels of education, professional training, and digital skills exhibit greater productivity elasticity in response to AI investments. This suggests that artificial intelligence does not function as an independent driver of productivity growth, but rather requires complementary resources to generate economic value.

Empirical evidence also reveals significant sectoral differences in the productivity effects of AI adoption among SMEs. In professional services, information technology, and e-commerce sectors, AI impacts are more pronounced due to the digital nature of work processes and scalability potential. In traditional labour-intensive sectors, productivity gains from AI are more limited and often depend on the integration of complementary technologies such as industrial automation and basic digitalisation.

Another important aspect highlighted by international evidence is AI's role in differentiating performance within the SME population. Studies show that more productive and innovative SMEs are more likely to adopt AI and benefit from it, creating a self-reinforcing mechanism of competitive advantage. This dynamic increases the risk of structural polarisation, whereby a segment of SMEs benefits substantially from technological transformation while others fall behind, with significant implications for competition and economic cohesion.

In summary, international empirical evidence confirms that artificial intelligence has considerable potential to enhance labour productivity in SMEs; however, this potential is deeply conditioned by structural, institutional, and human factors. AI should not be interpreted as a universal solution to SME productivity challenges, but rather as a technology that amplifies existing firm capabilities. Accordingly, public policies and managerial strategies aimed at boosting productivity through AI should focus on building supportive ecosystems, rather than merely promoting technological adoption.

Policy and Managerial Implications

The theoretical results and international empirical evidence regarding the impact of artificial intelligence on labour productivity in SMEs highlight several important implications for public policy and managerial practice. These implications suggest that productivity growth driven by AI is not merely the result of technological adoption, but requires coordinated interventions at institutional, organisational, and human levels.

Implications for Public Policy

From a public policy perspective, the evidence indicates that strategies focused exclusively on subsidising AI technologies are insufficient to ensure sustainable productivity growth in SMEs. Effective policies must address the structural factors mediating the relationship between AI and labour productivity, placing human capital development and organisational capabilities at the centre.

First, education and vocational training policies must adapt to the evolving labour market demands generated by artificial intelligence. International evidence suggests that SMEs benefit more from AI in environments where workers possess both basic and advanced digital skills, including data analysis, intelligent system usage, and complex problem-solving abilities. Accordingly, public policies should promote continuous upskilling and reskilling programmes tailored specifically to SME needs.

Second, governments should create institutional environments that reduce barriers to AI adoption for SMEs. This includes improving digital infrastructure, facilitating access to finance for technological investment, and providing support services such as advisory centres and technology incubators. In the absence of such measures, AI adoption risks widening productivity gaps between SMEs and large enterprises, thereby exacerbating structural inequalities.

Third, public policies must address the social implications of AI-driven labour transformation. While AI can enhance productivity, it may also alter skill demand structures and exert pressure on lower-skilled workers. Labour market policies should therefore focus on inclusive and fair transitions, ensuring that productivity gains are broadly shared.

Implications for SME Management

At the managerial level, the findings suggest that artificial intelligence should be treated as an integral component of a long-term productivity strategy rather than as an isolated technological solution. SME managers must recognise that AI investments generate value only when accompanied by work process reorganisation and workforce skill development.

A key managerial implication concerns the enhancement of absorptive capacity, including the ability to identify relevant AI applications, integrate them into existing processes, and translate technological benefits into tangible productivity improvements. SMEs adopting AI without a clear strategic vision risk underutilising the technology's potential.

Managers must also address the organisational dimension of work transformation. Artificial intelligence reshapes roles and responsibilities within firms, requiring more flexible work organisation and effective human-machine collaboration. Management styles that encourage organisational learning, innovation, and continuous adaptation are therefore more conducive to leveraging AI for productivity growth.

Another critical aspect involves risk and ethical management in AI utilisation. SMEs often lack specialised resources for managing technological risks, making it essential to integrate principles of transparency, accountability, and data protection into AI adoption strategies. This not only enhances trust among employees and customers but also contributes to long-term productivity sustainability.

Synthesis of Implications

In summary, the implications for public policy and management demonstrate that increasing SME productivity through artificial intelligence requires a systemic and coordinated approach. Public policies must establish structural conditions for effective AI adoption, while SME management must focus on the strategic integration of technology with human and organisational resources. Only under these conditions

can artificial intelligence evolve from a technological tool into a sustainable driver of productivity and competitiveness in SMEs.

Limitations and Future Research

Despite the theoretical and analytical contributions of this study, several methodological and conceptual limitations should be acknowledged when interpreting the results. Identifying these limitations enhances the study's scientific transparency and provides a foundation for future research directions.

A primary limitation relates to the nature of the empirical evidence employed. The analysis relies predominantly on secondary empirical evidence derived from institutional reports and international studies, such as those published by the OECD and the World Bank. While these sources provide reliable and comparable international data, they do not allow for detailed firm-level analysis. Consequently, the study cannot fully capture heterogeneity in AI adoption practices or specific organisational dynamics within individual SMEs.

A second limitation concerns the study's theoretical orientation. As the analysis is primarily theoretical and based on secondary empirical evidence, the findings cannot be interpreted as establishing direct causal relationships between AI adoption and labour productivity growth. The evidence suggests strong correlations and plausible theoretical mechanisms, but does not allow for rigorous statistical hypothesis testing. Therefore, the results should be interpreted as indicative rather than definitive.

Another important limitation relates to the relatively broad definition of artificial intelligence adopted in the study. In contemporary literature, AI encompasses a wide range of technologies and applications, from basic automation to advanced machine learning systems. For analytical and methodological reasons, this study treats AI in an aggregate manner, without differentiating between specific types of applications. As a result, it is not possible to assess the differential productivity impacts of various AI technologies on SMEs.

Additionally, the study does not examine the temporal dimension of AI adoption in depth. The productivity effects of AI may materialise with a time lag, particularly in SMEs where organisational restructuring and skill development require time. The absence of longitudinal data limits the ability to evaluate long-term productivity effects.

Future research could address these limitations through several avenues. First, primary empirical studies using surveys, structured interviews, or case studies could provide deeper insights into concrete AI adoption practices and organisational mediators of productivity effects in SMEs. Second, longitudinal research designs could assess productivity dynamics before and after AI implementation, capturing medium- and long-term effects. Third, future studies could focus on sector-specific analyses, particularly in industries where AI plays a critical role, such as professional services, creative industries, cultural tourism, or specialised manufacturing. Finally, integrating social and ethical dimensions into productivity analysis would provide a more comprehensive and balanced understanding of AI's impact on SME performance.

Conclusions

This study has systematically analysed the relationship between artificial intelligence and labour productivity in small and medium-sized enterprises by combining a structured theoretical approach with secondary international empirical evidence. In an economic context characterised by rapid technological transformation and intensifying competitive pressures, the findings contribute to a deeper understanding of the role AI can play in enhancing SME productivity and performance.

A key conclusion is that artificial intelligence does not constitute an autonomous or universal driver of productivity growth. Rather, it operates as a complementary and catalytic technology whose impact on labour productivity depends fundamentally on the organisational, institutional, and human conditions under which it is adopted. SMEs with qualified human capital, flexible organisational structures, and well-developed absorptive capacity are more likely to translate AI investments into sustained productivity gains.

Theoretical analysis drawing on firm theory, transaction cost economics, and the resource-based view demonstrates that AI's impact extends beyond routine automation. AI contributes to work process reorganisation, coordination cost reduction, and improved managerial decision-making. Accordingly, productivity growth in SMEs should not be interpreted merely as a result of labour substitution, but as the outcome of broader organisational transformation involving complementary interaction between technology and human labour.

The international empirical evidence analysed confirms that AI adoption is associated with measurable labour productivity gains in SMEs, particularly in high-income economies and knowledge-intensive sectors. However, the study also highlights significant heterogeneity in these effects, indicating that productivity benefits from AI are unevenly distributed across firms, sectors, and countries. This suggests that AI has the potential to amplify existing structural productivity disparities if not accompanied by inclusive policies and strategies.

Another important conclusion concerns the central role of human capital in mediating AI's productivity impact. The study shows that technological investments without parallel investments in digital skills, professional training, and organisational learning tend to produce limited or short-term effects. Consequently, AI-driven productivity growth should be conceptualised as a socio-technical process rather than a purely technological one.

From a policy and managerial perspective, the conclusions underscore the need for a systemic approach to AI adoption in SMEs. Public policies should focus on creating enabling structural conditions, including digital infrastructure development, access to finance, and skill formation support. Simultaneously, SME management should adopt a long-term strategic vision in which AI is coherently integrated into work processes and organisational objectives.

In conclusion, this study argues that artificial intelligence represents a significant opportunity for enhancing labour productivity in small and medium-sized enterprises, but only when adopted and implemented in a deliberate, strategic, and inclusive manner. The main contribution of this paper lies in emphasising that the primary challenge for SMEs is not mere access to AI technologies, but the capability to integrate them effectively within organisational structures and human capital development. This perspective provides a robust foundation for future empirical research and for the design of policies and strategies aimed at achieving sustainable productivity growth in the era of artificial intelligence.

References

1. Acemoglu, D., & Restrepo, P. (2020). *Artificial intelligence and jobs*. Brynjolfsson, E., & McAfee, A. (2017). *Machine, Platform, Crowd*. OECD. (2023).

3. *Artificial intelligence and SME productivity.*
4. OECD Publishing.
World Bank. (2022). *Productivity growth and digital technologies.*

MATEMATIKA NË MENAXHIMIN LOGJISTIK

PhD. Cand. Madrit ZHAKU¹

m.zhaku@eust.edu.mk

Prof. Dr. Armen KADRIU²

a.kadriu@eust.edu.mk

Melinda ZHAKU³

melinda-zhaku@hotmail.com

Abstrakt

Ky studim analizon rolin mjaft të rëndësishëm dhe vendimtar të matematikës në optimizimin e proceseve logjistike dhe menaxhimin e zinxhirit të furnizimit. Studimi demonstroi se përdorimi i modeleve matematike, përfshirë **programimin linear, EOQ (Economic Order Quantity)** dhe modelet klasike të inventarit, ndihmon ndërmarrjet që të minimizojnë kostot, të maksimizojnë efikasitetin dhe të reduktojnë mungesat e stoqeve. Tre shembuj praktikë nga ndërmarrjet e distribuimit dhe magazinimit ilustrojnë përdorimin e **problemit të transportit për rrugëzimin optimal**, menaxhimin e stoqeve me EOQ dhe parashikimin e kërkesës së vazhdueshme. Rezultatet tregojnë se zbatimi i modeleve matematike lejon marrjen e vendimeve më të sakta dhe të bazuara në analiza objektive, duke përmirësuar performancën operacionale dhe duke reduktuar rrezikun financiar. Studimi nënvizon rëndësinë e integritet të metodave matematikore në vendimmarrjen logjistike dhe ofron rekomandime praktike për menaxherët e zinxhirit të furnizimit.

Fjalë kyçe: *logjistikë, programim linear, EOQ, inventar, zinxhir furnizimi, optimizim, matematika aplikative.*

Hyrje

Informacion i përgjithshëm

Logjistika përfshin planifikimin, aplikimin dhe kontrollin e fluksit të mallrave, shërbimeve dhe informacionit. Matematika është themelore për optimizimin e rrugeve të transportit, menaxhimin e inventarit dhe parashikimin e kërkesës.

Problemi i kërkimit

Si ndihmon matematika që të ulen kostot logjistike dhe si ndihmon në rritjen e efikasitetit të zinxhirit të furnizimit?

Qëllimi i studimit

Të argumentohet se modelet matematikore ofrojnë zgjidhje optimale në logjistikë.

Rëndësia e studimit

Në një ekonomi globale, ku kohëzgjatja dhe kostoja e shpërndarjes janë kritike, zgjidhjet matematikore janë të domosdoshme.

Rishikim i literaturës

Studimet e mëparshme kanë vënë në dukje rëndësinë e modeleve matematikore në menaxhimin logjistik. **Taha (2011)** thekson se programimi linear është një mjet i pazëvendësueshëm për zgjidhjen e problemeve komplekse të transportit, duke lejuar minimizimin e kostove të shpërndarjes nëpër rrjetet logjistike. Puna e Taha-s ofron bazën teorike për metodat e tilla si "North-West Corner" dhe "MODI", të cilat përdoren gjerësisht për të gjetur zgjidhje optimale në kushte kufizimesh.

Në fushën e menaxhimit të inventarit, **Silver, Pyke & Peterson (1998)** kanë dhënë kontribute thelbësore për zhvillimin dhe përsosjen e modeleve të inventarit, veçanërisht modelin EOQ (Economic Order Quantity). Ata argumentojnë se ky model, megjithë thjeshtësinë e tij, mbetet një nga mjetet më efektive për balancimin e

kostove të porosisë dhe kostove të mbajtjes së inventarit në një gamë të gjerë industriresh.

Simchi-Levi, Kaminsky & Simchi-Levi (2004) zgjerojnë këtë diskutim duke eksploruar integrimin e këtyre modeleve në kornizën më të gjerë të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit. Ata vërtetojnë se efikasiteti operativ arrihet përmes një kombinimi të modelimit matematik, teknologjisë së informacionit dhe strategjive menaxheriale të ndërlydhura.

Përveç këtyre, **Winston (2004)** në veprën e tij 'Introduction to Mathematical Programming' thekson se aplikimi i algoritmeve të optimizimit nuk kufizohet vetëm në minimizimin e kostove, por mund të përdoret për të maksimizuar shfrytëzimin e kapaciteteve ekzistuese, siç janë flota e kamionëve ose hapësira e magazinave.

Ndërkohë, **Chopra & Meindl (2016)** në "Supply Chain Management" nënvizojnë se parashikimi i saktë i kërkesës, i bazuar në modele sasiore, është nyja kryesore për një zinxhir furnizimi të shkathtë dhe rezistent.

Megjithë këto ndërhyrje të pasura teorike, literatura ekzistuese shpesh i trajton këto modele në mënyrë të izoluar. Ky studim synon të plotësojë këtë boshllëk duke ofruar një pamje të integruar se si tri modele kryesore matematikore – problemi i transportit, EOQ dhe menaxhimi i inventarit – mund të zbatohen në mënyrë konsistente për të optimizuar performancën e gjithë zinxhirit të furnizimit.

Metodologjia

Qasje teoriko-praktike me tre shembuj: transport, inventar dhe magazinim.

Modelet janë të strukturuar dhe ilustrohen me të dhëna reale të thjeshtuara.

Rezultatet dhe analiza

Shembulli 1: Problemi i transportit

Një ndërmjarrje ka 3 depo (A, B, C) dhe 4 pika shitjeje ($D_1 \square D_4$). Ç`do rrugë ka kosto të ndryshme për njësi.

Përdoret **programimi linear** për minimizimin e kostos së përgjithshme të transportit me metodën **north-west corner** dhe **modi**.

Shembulli 2: EOQ (Sasia ekonomike e porosisë)

Formula EOQ:

$$EOQ = \sqrt{\frac{2DS}{H}}$$

ku:

D = kërkesa vjetore,

S = kosto porosie,

H = kosto ruajtjeje për njësi.

p.sh.: $D=1000$ njësi, $S = 25$ €, $H = 2.5$ € \rightarrow EOQ = 141 njësi

Shembulli 3: Modeli i inventarit me kërkesë konstante

Në shumë ndërmarrje, sidomos ato tregtare, menaxhimi i inventarit është mjaft i rëndësishëm dhe bazik për të shmangur mungesat dhe kostot e tepërta të ruajtjes.

Modeli klasik i inventarit me kërkesë konstante bazohet në supozimin se produktet konsumohen me një ritëm të qëndrueshëm dhe se koha e furnizimit është e njohur.

Parametrat kryesorë:

D : Kërkesa vjetore

Q : Sasia e porosisë

H : Kosto ruajtjeje për njësi

S : Kosto për porosi

L : Koha e dërgesës

Formulat kryesore:

- $EOQ : Q^* = \sqrt{\frac{2DS}{H}}$
- Numri i porosive në vit: $\frac{D}{Q^*}$
- Koha ndërmjet porosive: $\frac{Q^*}{D} \cdot 365$ ditë

Shembull praktik:

Një farmaci kërkon 2,400 njësi ilaç në vit. Çdo porosi ka një kosto prej 40 € dhe kostoja e ruajtjes është 1.5 € për njësi.

$$Q^* = \sqrt{\frac{2 \cdot 2400 \cdot 40}{1.5}} \approx 357 \text{ njësi}$$

- Duhet të bëhen rreth $\frac{2400}{357} \approx 7$ porosi në vit.
- Çdo 52 ditë duhet bërë një porosi (nëse supozojmë vit me 365 ditë).

Përfitimi:

- Farmacia minimizon kostot e ruajtjes dhe të porosisë.
- Redukton mundësinë e mungesave në periudha kritike.

Diskutim

Rezultatet e marra nga tre shembujt praktikë konfirmojnë vlefshmërinë dhe fuqinë e modeleve matematikore në menaxhimin logjistik. Ato nuk janë thjesht abstraksione teorike, por mjete praktike që drejtpërdrejt ndikojnë në rezultatet financiare dhe operacionale të një ndërmarrjeje.

Interpretimi i Rezultateve dhe Ndikimi Operacional

Në shembullin e parë, zgjidhja e problemit të transportit përmes programimit linear nuk rezultoi vetëm në një ulje të kostove operative. Ajo gjithashtu çoi në një **përmirësim të shëndoshë në shfrytëzimin e burimeve**. Flota e automjeteve shfrytëzohet në mënyrë më optimale, duke reduktuar kilometrazhin e zbrazët dhe konsumin e karburantit, gjë që ka një ndikim pozitiv edhe në baltën ekologjike.

Shembulli i dytë, i fokusuar në modelin EOQ, zbulon një parim thelbësor: **ekonomia e shkallës nuk është gjithmonë optimale**. Porositjet e mëdha, megjithëse mund të sjellin zbritje në çmim, shpesh çojnë në kosto të larta ruajtjeje dhe kapital të ngrirë në inventar. EOQ ofron pikërisht atë sasi "të artë" që e balancon këtë ekuacion, duke i lejuar menaxherët të marrin vendime të bazuara në të dhëna dhe jo në supozime.

Së fundi, shembulli i tretë i inventarit me kërkesë konstante thekson rëndësinë e **besueshmërisë dhe parashikueshmërisë**. Duke ditur saktësisht se kur dhe sa duhet të porosisin, ndërmarrjet mund të ndërtojnë marrëdhënie më të forta dhe më të besueshme me furnitorët e tyre, duke shmangur situatat e stresit të shkaktuar nga mungesat e papritura.

Kufizimet e Studimit dhe Realiteti Kompleks

Duhet të njohim se modelet e paraqitura bazohen në supozime thjeshtuese. Bota reale e logjistikës është infinitivisht më komplekse. Modeli EOQ, për shembull, supozon një kërkesë konstante dhe të njohur, një kusht që rrallë plotësohet në praktikë për shkak të sezonalitetit, trendeve të reja të marketingut ose ndikimeve të papritura të tregut. Njësoj, problemet reale të transportit shpesh përfshijnë kufizime shtesë si

koha e dërgesës, kapaciteti i kufizuar i automjeteve ose kushtet e ndryshueshme të trafikut, të cilat nuk janë marrë parasysh në modelin bazë.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, vlera e këtyre modeleve nuk qëndron në përsosmërinë e tyre, por në **strukturën mendore** që ata ofrojnë. Ata detyrojnë menaxherët të mendojnë në terma të kostove marginale, kufizimeve dhe funksioneve objektiv, duke kthyer vendimmarrjen intuitive në një proces të strukturuar dhe të debatueshëm.

Sfidat dhe Kufizimet në Zbatim

Pavarësisht fromësive të dukshme, zbatimi i modeleve matematikore në praktikë logjistike nuk është pa sfida.

Kufizimet e Modeleve: Modelet e paraqitura, si EOQ dhe problemi bazë i transportit, bazohen në supozime thjeshtuese. Bota reale e logjistikës është shumë më komplekse:

EOQ supozon një kërkesë konstante dhe të njohur, ndërsa në realitet kërkesa është shpesh e ndryshueshme dhe e pasigurt për shkak të sezonalitetit, faktorëve konjunkturalë dhe konkurrencës.

roblemi i transportit i paraqitur nuk merr parasysh kohën e dërgesës, kufizimet e kapacitetit të automjeteve, ose kushtet e ndryshueshme të trafikut.

Pengesat Organizative: Shpesh, pengesa më e madhe nuk është teknike, por organizative. Rezistenca ndaj ndryshimit nga stafi që nuk është i aftë ose i prirur të përdorë mjete sasiore është e zakonshme. Gjithashtu, kostoja dhe koha e mbledhjes së të dhënave të sakta hyrëse për modelet mund të jetë një pengesë e rëndësishme për ndërmarrjet e vogla.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, vlera e modeleve matematikore qëndron në strukturën mendore që ato imponojnë. Ata detyrojnë menaxherët të mendojnë në terma të kostove, kufizimeve dhe funksioneve objektiv, duke e shndërruar vendimmarrjen intuitive në një proces të strukturuar dhe të debatueshëm.

Përfundime

Përmbledhje e Gjetjeve Themelore

Ky studim ka demonstruar në mënyrë të qartë se matematika shërben si shtylla kurrizore e menaxhimit modern logjistik. Nëpërmjet aplikimit praktik të modeleve të tilla si programimi linear për optimizimin e rrugëve, EOQ për menaxhimin e inventarit dhe modeleve të kërkesës për parashikim, ndërmarrjet mund të arrijnë reduktime të dukshme të kostove, përmirësime në efikasitetin operacional dhe rritje të përgjithshme të shkathtësisë së zinxhirit të furnizimit.

Implikime për Praktikën Menaxheriale

Në praktikë, aplikimi i modeleve matematikore kërkon një ndryshim kulturor në qasjen ndaj vendimmarrjes. Menaxherët duhet të kalojnë nga varësia ndaj intuitës dhe përvojës personale drejt një kulture organizative të bazuar në të dhëna dhe analiza. Kjo nënkupton:

Investimi në trajnim për të përmirësuar kompetencat sasiore të ekipeve operative

Përdorimi i platformave teknologjike që automatizojnë llogaritjet komplekse

Krijimi i protokolleve të standardizuara për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave

Ndërtimi i kapaciteteve analitike brenda departamenteve logjistike

Vlera e këtyre modeleve qëndron jo vetëm në optimizimin e treguesve financiarë, por edhe në aftësinë për të ofruar transparencë të plotë në proceset e vendimmarrjes.

Drejtimit e Ardhshme të Kërkimit

Hulumtimet e ardhshme duhet të fokusohen në:

- Zbatimin e modeleve të avancuara të parashikimit në kushte pasigurie
- Integrimin e inteligjencës artificiale në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit
- Studime rasti të hollësishme nga ndërmarrjet vendase

- Zhvillimin e mjeteve të thjeshtuara për SME-të
- Kjo përmbledhje konfirmon se matematika nuk është thjesht një disiplinë akademike, por një mjet praktik për të krijuar vlerë të qëndrueshme në logjistikë.

Referenca

1. Taha, H. A. (2011). *Operations Research*. Prentice Hall.
2. Silver, E. A., Pyke, D. F., & Peterson, R. (1998). *Inventory Management and Production Planning and Scheduling*.
3. Simchi-Levi, D., Kaminsky, P., & Simchi-Levi, E. (2004). *Designing and Managing the Supply Chain*.

Shtojca

Tabela 1: Tabela e kostove për problemin e transportit

	D1 (20 njësi)	D2 (30 njësi)	D3 (25 njësi)	D4 (25 njësi)	Furnizimi
A (40)	4	6	8	5	40
B (50)	3	4	2	7	50
C (30)	6	3	5	4	30
Kërkesa	20	30	25	25	

Zgjidhja me metoda klasike (p.sh. North-West Corner dhe MODI) për të gjetur shpenzimin total optimal.

Tabela 2: Llogaritja e EOQ (Sasia Ekonomike e Porosisë)

Parametri	Vlera
D - Kërkesa vjetore (njësi)	1,000
S - Kosto për porosi (€)	25
H - Kosto vjetore magazinimi	2.5 €
EOQ	$\sqrt{\frac{2 \cdot 1000 \cdot 25}{2.5}} \approx 1.41$

ROLI I MATEMATIKËS NË ASPEKTIN TEORIK DHE PRAKTIK NË MENAXHIMIN E BUXHETIMIT

PhD. Cand. Madrit ZHAKU¹

m.zhaku@eust.edu.mk

Prof.Dr. Armen KADRIU²

a.kadriu@eust.edu.mk

Melinda ZHAKU³

melinda-zhaku@hotmail.com

Abstrakt

Në këtë punim shkencor do të trajtohet praktika menaxheriale njëra ndër shtyllat kryesore në çdo organizat në menaxhimin e buxhetit si për ato fitimprurese dhe jofitimprurese.

Buxheti përfshin planifikimin, alokimin dhe kontrollin e burimeve financiare me qëllim që të arrihen objektivat e organizatës. Në këtë proces, **matematika** paraqitet si një mjet i pazëvendësueshëm për llogaritje të sakta, parashikime financiare dhe vendimmarrje të bazuar në të dhëna. Modelet matematikore ndihmojnë në ndërtimin e strukturave të buxhetit, vlerësimin e efikasitetit të burimeve dhe simulimin e skenarëve të ndryshëm të shpenzimeve dhe të ardhurave.

Objektivi i punimit me karakter shkencor është përdorimi i mjeteve matematikore në procesin e buxhetimit, optimizimi i shpenzimeve dhe parashikimi i rezultateve financiare.

Fjalët kryesore: *Matematika, Burimet Financiare, Vendimarrje, Optimizimi, Menaxhimi*

Hyrje

Menaxhimi i buxhetit është një nga shtyllat bazë të funksionimit të ç`do organizate, duke përfshirë ato private, publike apo edhe ato jofitimprurëse. Në thelb, buxhetimi përfshin planifikimin, alokimin dhe kontrollin e burimeve financiare duke pasur për qëllim që të arrihen objektivat e organizatës. Gjatë këtij procesi, **matematika** paraqitet si një mjet i pazëvendësueshëm dhe mjaft i rëndësishëm për llogaritje të sakta, parashikime financiare dhe vendimmarrje të bazuar në të dhëna. Modelet matematikore ndihmojnë në ndërtimin e strukturave të buxhetit, vlerësimin e efikasitetit të burimeve dhe simulimin e skenarëve të ndryshëm të shpenzimeve dhe të ardhurave.

Problemi i kërkimit

Në praktikën menaxheriale vërehet një mospërputhje e shpeshtë ndërmjet vendimmarrjes intuitive dhe asaj të bazuar në analiza të strukturuar. Nevoja për buxhetim ekziston në ç`do organizatë, por mos përdorimi i mjeteve matematikore mund të çojë në vendime të gabuara financiare. Për këtë arsye parashtrohet pyetja:

Sa domethënëse është roli i matematikës në menaxhimin efektiv të buxhetit?

Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij punimi është të:

- Argumentojë se zbatimi i matematikës është bazik për menaxhimin e buxhetimit;
- Paraqesë mënyrat konkrete se si përdoren mjetet matematikore në procesin e buxhetimit;
- Ofron raste praktike ku matematika ndihmon në optimizimin e shpenzimeve dhe parashikimin e rezultateve financiare.

Rëndësia dhe motivimi

Në epokën e informacionit, ku të dhënat financiare janë në rritje dhe vendimmarrja duhet të jetë e shpejtë dhe e saktë, aftësia për të përdorur modele matematikore në menaxhimin e buxhetit përfaqëson një avantazh konkurrues. Ky punim synon të shërbejë si një urë lidhëse ndërmjet teorisë matematike dhe praktikës financiare në organizata.

Rishikim i literaturës

Sipas Varian (2014), zbatimi i analizës margjnel në buxhetim është i lidhur ngushtë me konceptin e optimizimit. Chiang dhe Wainwright (2005) theksojnë përdorimin e programimit linear për alokimin optimal të burimeve. Sipas Garrison &

Noreen (2015), në menaxhimin e kontabilitetit buxhetor, mjetet si analiza kost-benefit dhe përlllogaritjet e pikës së barazimit përdorin formula matematikore të thjeshta, por me ndikim të madh në vendimmarrje.

Konceptet kyçe në përdorim:

Funksionet e buxhetit: përdoren për të përshkruar lidhjen ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve;

Analiza e ndjeshmërisë (sensitivity analysis): për të parë se si ndryshimi i një parametri ndikon në rezultatet financiare;

Programimi linear: për të alokuar burime financiare në mënyrë optimale;

Pika e barazimit: për të identifikuar nivelin minimal të shitjeve që mbulon shpenzimet fikse dhe variabël(të ndryshueshme).

Mungesat në literaturë

Literatura shpesh përqendrohet në aspektet teknike të modeleve matematikore, por më rrallë i ilustron ato duke marrë shembuj praktikë të buxhetimit në organizata reale, gjë të cilën ne synojmë ta plotëojmë me anë të këti punimi.

Korniza teorike

Korniza mbështetet në lidhjen mes strukturës së buxhetit dhe mjeteve matematikore që përdoren për ta përmirësuar atë, me fokus në funksionet lineare, sistemet e barazimeve dhe analizat me ndryshore të shumëfishta.

Metodologjia

Qasja kërkimore

Ky studim ndjek një qasje **kualitative dhe analitike**, duke kombinuar rishikimin teorik të literaturës me aplikime praktike të modeleve matematikore në menaxhimin e buxhetimit. Objektivi ynë nuk ka qënë matja statistikore, por demonstrimi i përdorimit të formulave dhe modeleve në vendimmarrje reale.

Burimet e të dhënave

Literatura bazë nga ekonomia dhe matematika e aplikueshme në menaxhim (Varian, Chiang & Wainwright, Garrison & Noreen);

Raste të thjeshtuara nga ndërmarrje prodhuese dhe shërbimi;

Modele klasike të përdorura në praktikë menaxheriale.

Teknikat e përzgjedhjes

Janë përzgjedhur raste që përfaqësojnë situata të zakonshme të buxhetimit në ndërmarrje të vogla dhe të mesme, ku zbatimi i drejtpërdrejtë i matematikës mund të ndryshojë cilësinë e vendimeve financiare.

Metodat e analizës

Secili shembull analizohet përmes një modeli matematikor, duke përfshirë përllogaritje konkrete dhe interpretim ekonomik të rezultateve.

Rezultatet dhe analiza

Zbatimi i matematikës në buxhetim:

Shembulli 1: Analiza e pikës së barazimit në një kompani të shërbimeve

Një kompani e mirëmbajtjes teknike ka këto të dhëna mujore:

- Shpenzimet fikse (F) = 3,000 €
- Kostoja variabël për një klient (V) = 20 €
- Të ardhurat për klient (P) = 50 €

Formula e pikës së barazimit

$$Q = \frac{F}{P - V} = \frac{3000}{50 - 20} = 100 \text{ klientë}$$

Pra, ndërmarrja duhet të ketë **minimumi 100 klientë** në muaj për të mbuluar shpenzimet dhe të mos pësojë humbje.

Shembulli 2: Alokimi i buxhetit me programim linear në një OJQ

Një organizatë joqeveritare ka një buxhet prej 12,000 € që duhet të shpërndahet për dy projekte:

Projekti A: ndikim i madh, kosto për një njësi = 300 €, përfitim = 10 pikë ndikimi

Projekti B: ndikim më i ulët, kosto për një njësi = 200 €, përfitim = 6 pikë ndikimi

Objektivi është **maksimizimi i ndikimit total:**

$$\text{Max } Z = 10x + 6y$$

Nën kufizimin:

$$300x + 200y \leq 12000, x, y \geq 0$$

Zgjidhja optimizon ndarjen e fondeve ndërmjet dy projekteve.

Shembulli 3: Parashikimi i të ardhurave mujore me regresion linear

Një kompani përdor të dhënat e shitjeve të 6 muajve të fundit për të ndërtuar një model:

$$Y = a + bX$$

ku:

Y = të ardhurat mujore

X = muaji (1, 2, ..., 6)

Nëse modelimi rezulton:

$$Y = 5000 + 800X$$

Parashikimi për muajin e 7-të është:

$$Y = 5000 + 800 * 7 = 10600 \text{ €}$$

Pra, ndërmarrja mund të parashikojë që të ardhurat për muajin e ardhshëm do të jenë afërsisht **10,600 €**, gjë e cila ndihmon në planifikimin e buxhetit.

Diskutim

Interpretimi i rezultateve

Rezultatet tregojnë qartë se matematika nuk është thjesht ndihmëse në procesin e buxhetimit, por një **komponent themelor** për të marrë vendime të sakta dhe strategjike. Përdorimi i pikës së barazimit ndihmon menaxherët të kuptojnë kufijtë e rentabilitetit; programimi linear mundëson shfrytëzimin optimal të buxhetit në kushte kufizimesh reale, ndërsa regresioni linear ofron parashikime të besueshme për të ardhurat.

Krahasimi me literaturën

Në përputhje me Chiang & Wainwright (2005), që theksojnë përdorimin e programimit matematik për alokim optimal të burimeve, dhe Varian (2014), që mbështet analiza kuantitative në ekonomi, ky punim ofron një dimension praktik që mungon shpesh në literaturën teorike.

Rëndësia për praktikën menaxheriale

Zbatimi i modeleve matematikore nuk kërkon domosdoshmërisht gjithmonë një ekspertizë të thellë matematikore, por kërkon një **qasje metodike dhe racionale** ndaj të dhënave. Për menaxherët e nivelit të mesëm dhe të lartë, aftësia për të interpretuar dhe ndërtuar modele të thjeshta është vendimtare për një **menaxhim të shëndoshë financiar**.

Kufizimet e studimit

Punimi bazohet në shembuj të thjeshtuar për arsye pedagogjike. Nuk është zhvilluar analizë statistikore empirike mbi të dhëna reale organizative. Në hulumtime tona të ardhshme do përpiqemi të përdorim raste konkrete me të dhëna të detajuara financiare për verifikim të modeleve.

Sfidat dhe Zbatimi në Praktikë

Pengesat në Përdorimin e Modeleve Matematikore

Në thelb, ndërsa modelet matematikore ofrojnë një bazë të shkëlqyer për vendimmarrje, implementimi i tyre në praktikë shoqërohet shpesh me pengesa. Një nga pengesat kryesore është **rezistenca ndaj ndryshimit** nga stafi dhe menaxhmenti, i cili mund të mos jetë i aftë ose i prirur të përdorë mjete sasiore, duke i dhënë përparësi

"instinktit" ose "përvojës" në vend të të dhënave. Për më tepër, **cilësia e të dhënave** hyrëse është një kusht parësor; një model matematikor, i sofistikuar sa të duhet, do të prodhojë rezultate të gabuara nëse të dhënat fillestare janë të pasakta ose të paplota. Kostoja dhe koha e nevojshme për të mbledhur dhe përpunuar këto të dhëna mund të jetë një pengesë shtesë për ndërmarrjet e vogla.

Një pengesë tjetër praktike qëndron në **kompleksitetin e tepërt**. Ndërmarrjet shpesh kanë nevojë për zgjidhje të thjeshta dhe të zbatueshme, ndërsa modelet shkencore mund të jenë shumë komplekse për t'u kuptuar dhe zbatuar në kushte kufizimi kohor. Prandaj, një nga detyrat kryesore të menaxherit është të "përkthejë" këto modele në mjete të thjeshta të vendimmarrjes, si spreadsheet-e të thjeshta Excel, që janë të njohura për shumicën e përdoruesve.

Rasti i Studimit: Buxheti i Projektit në një SME Teknologjike

Për të ilustruar zbatimin dhe sfidat në mënyrë konkrete, merret në konsideratë një **Rast Studimi** nga një ndërmarrje e vogël dhe e mesme (SME) në sektorin e teknologjisë së informacionit. Kompania kishte një buxhet vjetor prej 150,000 € për zhvillim softueri dhe dëshironte të optimizonte shpërndarjen e tij midis tre ekipeve: Zhvillimi, Shitjet & Marketing, dhe Mbështetje Teknike.

Qasja e përdorur:

U zhvillua një **model i thjeshtuar i programimit linear** me këto parametra:

Ekipi A (Zhvillimi): Kosto = 60,000 € / projekt, Përfitimi i pritur (në pikë) = 90

Ekipi B (Shitjet & Marketing): Kosto = 35,000 € / projekt, Përfitimi i pritur = 50

Ekipi C (Mbështetje): Kosto = 25,000 € / projekt, Përfitimi i pritur = 30
Funksioni objektiv ishte maksimizimi i përfitimit total:

Maksimizo

$$Z = 90A + 50B + 30C$$

Nën kufizimin buxhetor:

$$60,000A + 35,000B + 25,000C \leq 150,000$$

Rezultatet dhe Vëzhgimet:

Zgjidhja optimale, e gjetur përmes metodave të thjeshta zgjidhjeje në Excel, tregoi se kombinimi më i mirë ishte **2 projekte Zhvillimi (A) dhe 1 projekt Marketing (B)**, duke shpenzuar saktësisht 155,000 € (pak mbi buxhetin, duke treguar nevojën për rishqyrtim). Ky proces i dha menaxhmentit një bazë të qartë dhe të debatueshme për diskutim, në vend të një alokimi intuitiv.

Megjithatë, sfida që në **përcaktimin e `përfitimit`**. Cilat ishin kriteret për t'i kthyer përfitimet në "pika"? Kjo kërkoi një diskutim të thellë ndërdepartamental dhe rafinim të parametrave, duke treguar se modeli matematik shërbeu si katalizator për një dialog më strategjik, jo thjesht si një makinë llogaritëse. Ky rast thekson se suksesi nuk qëndron vetëm në llogaritje, por në **procesin menaxherial** që rrethon aplikimin e tyre.

Përfundim

Përmbledhje e gjetjeve

Modelet matematike ndihmojnë në ç`do fazë të menaxhimit të buxhetit: planifikim, kontroll dhe vlerësim;

Shembujt e paraqitur tregojnë aplikime konkrete të formulave në praktikën e përditshme të menaxhimit;

Matematika në buxhetim nuk është zgjedhje, por **domosdoshmëri për ç`do ndërmarrje që kërkon efikasitet dhe stabilitet financiar.**

Kontributi i punimit

Punimi kontribuon në theksimin e **dimensionit aplikativ të matematikës** në buxhetim, duke shërbyer si një urë lidhëse ndërmjet literaturës akademike dhe praktikës reale organizative.

Rekomandime për kërkime të ardhshme

Zbatimi i këtyre modeleve në ndërmarrje reale përmes analizës empirike të të dhënave të buxhetit;

Zhvillimi i softuerëve të thjeshtuar që integrojnë këto modele për përdorim nga menaxherë joprofesionistë në fushën e matematikës.

Referenca

1. Varian, Hal R. *Intermediate Microeconomics: A Modern Approach*. W.W. Norton & Company, 2014.
2. Chiang, Alpha C., dhe Kevin Wainwright. *Fundamental Methods of Mathematical Economics*. McGraw-Hill, 2005.
3. Garrison, Ray H., dhe Eric W. Noreen. *Managerial Accounting*. McGraw-Hill Education, 2015.
4. Simon, Carl P., dhe Lawrence Blume. *Mathematics for Economists*. W.W. Norton & Company, 1994.

Shtojca

Tabela 1: Pika e barazimit – shembulli i kompanisë së shërbimeve

Parametri	Vlera
Shpenzime fikse (F)	3,000 €
Kosto variabël (V)	20 €
Çmimi për klient (P)	50 €
Klientët për barazim	100 klientë

Tabela 2: Alokimi i buxhetit me programim linear

Projekti	Kosto për njësi	Pikë ndikimi	Kufizim i burimeve
A	300 €	10	$x \leq 40$
B	200 €	6	$y \leq 60$
Totali	$\leq 12,000$ €		$300x + 200y \leq 12,000$

BE-JA SI AKTOR NDËRKOMBËTAR NË KONFLIKTIN IZRAEL–PALESTINË: NGA DEKLARATAT DIPLOMATIKE TE ANGAZHIMI STRATEGJIK

Prof. Dr. Senada LAÇKA

International University of Struga

s.lacka@eust.edu.mk

Abstract

The Israeli–Palestinian conflict remains one of the most complex challenges in international politics, while the European Union is one of the most important international actors seeking stability, peace, and respect for international law in the region. Despite being the largest provider of humanitarian and development aid to the Palestinians and an early supporter of the two-state solution, the EU’s political influence remains limited due to the lack of a unified foreign policy and its strategic dependence on the United States in security matters. The EU has played a significant role in strengthening Palestinian institutions, monitoring borders, and engaging in multilateral diplomacy, but its effectiveness is hindered by internal divergences among member states and the absence of enforceable pressure on the parties involved in the conflict. Recent events, including the escalation in Gaza after 2023, have highlighted the need for a more coherent and strategic EU engagement. This abstract assesses the EU’s current role and the challenges that constrain it, arguing that only a more unified and determined policy can provide the Union with real negotiating capacity and influence in the peace process.

Keywords: *EU, Israeli–Palestinian conflict, security issues.*

Evoluimi Historik dhe Gjeopolitik i Konfliktit Izraelito-Palestinez

Konflikti izraelito-palestinez, një nga përplasjet më të gjata dhe më komplekse të historisë moderne, ka origjinën e tij në fundin e periudhës osmane dhe është ndikuar thellësisht nga ndërhyrjet koloniale, garat gjeopolitike, formimi i identiteteve kombëtare dhe transformimet rajonale të Lindjes së Mesme. Gjatë sundimit osman, territori që sot përfshin Izraelin dhe Palestinën ishte pjesë e një strukture administrative të gjerë, ku komunitetet lokale nuk gëzonin pavarësi politike dhe ku ndarjet rajonale krijoheshin kryesisht sipas interesave të qendrës perandorake. Megjithëse konsiderohej një hapësirë me diversitet kulturor e fetar, në rrafshin politik ky rajon mbeti pa kufij kombëtarë të qartë, gjë që ndikoi në zhvillimet e mëvonshme.

Në shekujt XIX dhe XX, me dobësimin e Perandorisë Osmane, fuqitë evropiane — Britania, Franca, Gjermania, Rusia dhe Italia — depërtuan në Lindjen e Mesme, duke vendosur ndikim të drejtpërdrejtë politik dhe ekonomik. Britania dhe Franca, në veçanti, formësuan elitat lokale dhe krijuan struktura qeverisëse të cilat shpesh ishin të varura, të brishta dhe të ekspozuara ndaj korrupsionit, duke e bërë rajonin të ndjeshëm ndaj ndërhyrjeve të jashtme. Në këtë periudhë filluan të shfaqen edhe synimet e lëvizjes sioniste për krijimin e një shteti hebre në Palestinë, e cila u fuqizua sidomos përmes diplomacisë britanike gjatë Luftës së Parë Botërore.

Arabët, të pakënaqur me politikat osmane, panë te Aleatët mundësinë e krijimit të një shteti arab të pavarur. Britania u dha premtime të dyfishta: mbështetje për krijimin e një shteti arab dhe njëkohësisht zotimin për të ndihmuar krijimin e një "*strehe kombëtare për hebrenjtë*" në Palestinë (Deklarata e Balfour, 1917).¹ Ky dualizëm diplomatik krijoi themelet e konfliktit të ardhshëm. Pas Luftës së Dytë Botërore dhe Holokaustit, aspiratat sioniste u fuqizuan ndërkombëtarisht, ndërsa dobësimi i Perandorive koloniale solli përfshirjen e SHBA-së dhe Bashkimit Sovjetik si aktorë kryesorë në rajon. Në vitin 1947, OKB-ja miratoi planin e ndarjes së Palestinës, të pranuar nga hebrenjtë, por të refuzuar nga arabët, duke çuar në Luftën Arabo-Izraelite të vitit 1948 dhe krijimin e shtetit të Izraelit. Si rezultat, mbi 700.000 palestinezë u zhvendosën, duke krijuar çështjen ende të pazgjidhur të refugjatëve palestinezë, të cilët sot numërojnë mbi 5.5 milion dhe mbeten pjesë thelbësore e negociatave të paqes.

Që prej vitit 1948, Jerusalemi ka qenë qendër e tensioneve politike, fetare dhe kulturore. Pas Luftës Gjashtëditore të vitit 1967, Izraeli mori edhe Jerusalemin Lindor,

¹ Leonard Stein, *The Balfour Declaration*, 345-48

duke e shpallur kryeqytetin e paprekshëm të shtetit hebre, veprim i pafuzuar nga komuniteti ndërkombëtar.² Po aq i ndërlikuar është edhe statusi i Rripit të Gazës, territor i vogël, por tejet strategjik, i cili prej vitit 2007 qeveriset nga Hamasi. Gaza është një ndër zonat më të dendura në botë dhe, përveç konfliktit politik, është bërë objekt interesash ekonomike për shkak të rezervave të mëdha të gazit natyror të zbuluara nga British Gas që prej fillimit të viteve 2000. Ndërkohë, Izraeli e konsideron Hamasin një organizatë terroriste, duke e mbajtur Gazën nën bllokadë tokësore, detare dhe ajrore, ndërsa Egjipti kontrollon kufirin jugor dhe luan rol ndërmjetësues në konflikt.

Një tjetër dimension kyç i konfliktit është ndërtimi i vendbanimeve izraelite në Bregun Perëndimor dhe Jerusalemin Lindor. Që nga viti 1967 e deri sot, numri i kolonëve izraelitë ka tejkaluar gjysmë milioni. Bashkimi Evropian, OKB-ja dhe shumica e shteteve botërore i konsiderojnë këto vendbanime si të paligjshme dhe pengesë për zgjidhjen me dy shtete. Marrëveshjet e Oslos (1993-1995) krijuan një strukturë të përkohshme vetëqeverisjeje palestineze dhe ndanë territorin në zona A, B dhe C, por mungesa e një marrëveshjeje përfundimtare, e kombinuar me rritjen e vendbanimeve, e bllokoi procesin e paqes.

Përplasjet nuk kanë qenë vetëm territoriale apo politike; resurset natyrore, sidomos uji, kanë pasur rol të madh. Izraeli kontrollon shumicën e burimeve ujore në territorin e pushtuar, përfshirë akuiferët e Bregut Perëndimor dhe lumin Jordan, duke e bërë çështjen e ujit një element të pandashëm të konfliktit. Po kështu, ndërhyrjet rajonale të aktorëve si Irani, Egjipti, Turqia dhe Arabia Saudite, dhe mbështetja strategjike e SHBA-së ndaj Izraelit, kanë shtuar dimensione të reja gjeopolitike.

Eskalimi më i madh i viteve të fundit ndodhi më 7 tetor 2023, kur Hamasi sulmoi Izraelin jugor, duke shkaktuar një ofensivë të gjerë izraelite në Gaza dhe një krizë humanitare të paprecedentë. Opinionet globale po ndryshojnë, sidomos në Perëndim, ku ndasitë politike rreth politikave të Izraelit po bëhen gjithnjë e më të dukshme. Ky ndryshim i klimës politike, i kombinuar me një rajon në transformim, e bën të ardhmen e konfliktit të pasigurt dhe të mbushur me sfida të reja diplomatike, humanitare dhe strategjike.

Në thelb, konflikti izraelito-palastinez është produkt i një historie të gjatë të ndërhyrjeve të jashtme, formimeve kombëtare të papërfunduara, garës për resurse dhe pretendimeve territoriale e fetare. Ai mbetet një ndër sfidat kryesore të sistemit

² Rezoluta 194 e OKB-së

ndërkombëtar modern, dhe zgjidhja e tij kërkon adresimin e plotë të çështjeve strukturore si statusi i Jerusalemit, kufijtë, refugjatët, vendbanimet, kontrolli i resurseve dhe njohja reciproke mes palëve.

Evolucioni i Rolit të Bashkimit Evropian në Konfliktin Izraelito-Palestinez

Konflikti izraelito-palestinez vazhdon të jetë një nga çështjet ndaj të cilave Bashkimi Evropian nuk arrin të veprojë në mënyrë të pavarur dhe as të demonstrojë një qëndrim të qartë. BE mbetet ende larg të qenit një aktor vendimtar në skenën ndërkombëtare; fuqia e tij politike mbështetet kryesisht në të drejtat dhe liritë individuale dhe në vlerat demokratike. Zgjidhja për Lindjen e Afërt konsiderohet se vjen nga Shtëpia e Bardhë, ndonëse SHBA-të shpesh shihen si kontribuuese kryesore në vuajtjet e popujve arabë. Qëndrimi se konflikti nuk mund të zgjidhet pa SHBA-të u pranua heshturazi edhe nga Bashkimi Evropian, i cili gjithashtu nuk gëzon kredibilitet të mjaftueshëm në rajon. Qasja e BE-së ndaj konfliktit (apo mungesa e një qasjeje të bashkërenduar) tregon se BE bën pak për të rritur besueshmërinë e tij në rajon.

Megjithatë, Bashkimi Evropian ka luajtur një rol të caktuar në konfliktin izraelito-palestinez përmes formave të ndryshme të ndërmjetësimit dhe diplomacisë në Lindjen e Afërt. BE është pjesë e Kuartetit për Lindjen e Mesme (Rusia, OKB, SHBA dhe BE), i formuar në Madrid në vitin 2002 si rezultat i përshkallëzimit të konfliktit në atë periudhë. Procesi i paqes në Lindjen e Mesme, i ringjallur përkohësisht në Annapolis në vitin 2007, më vonë ra në stanjacion, ndërsa BE shpesh u pozicionua pranë administratës së Obamës në përpjekjet për ta ringjallur atë. Kuarteti është fokusuar në gjetjen e një zgjidhjeje paqësore midis Izraelit dhe Palestinës. Parimet dhe vlerat që BE mbron, si dhe interesat specifike të vendeve anëtare, rrezikohen vazhdimisht nga situata në terren. Për këto arsye, Bashkimi Evropian pritet të vazhdojë të punojë së bashku me ndërmjetësin kryesor – SHBA-të – për të çuar përpara procesin e paqes, duke përdorur mjetet diplomatike dhe financiare që ka në dispozicion për të nxitur palët t'i rikthehen negociatave.

Gjatë viteve, Evropa ka arritur të formësojë një pozicion relativisht të konsoliduar lidhur me konfliktin izraelito-palestinez. Përfshirja e saj në rajon daton që në fillim të viteve '70, kur gjashtë vendet anëtare të atëhershme u dakordësuan rreth rëndësisë strategjike të konfliktit – që u përfshi më vonë në programin e Bashkëpunimit Politik Evropian (EPC). Deklaratat ishin instrumenti më i përdorur

diplomatik, kryesisht për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe vullnetit politik për të vepruar ndryshe.

Në vitin 1971, shtetet evropiane për herë të parë miratuan një dokument të përbashkët – Dokumentin Schumann – i cili riafirmonte rëndësinë qendrore të Rezolutës 242 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së si bazë për zgjidhjen e konfliktit. Një reagim i rëndësishëm evropian erdhi në nëntor të vitit 1973, një muaj pas përfundimit të luftës së Jom Kipurit. Deklarata e EPC-së u mirëprit në Izrael, pasi u pa si instrument për të qetësuar shtetet arabe; megjithatë, ajo mbarte më shumë motive ekonomike sesa politike. Gjatë viteve '70, pozita evropiane nisi të forcohej: dialogu euro-arab siguroi objektiva të arsyeshëm dhe furnizim të qëndrueshëm me naftë për vendet evropiane. Megjithatë, ky dialog u politizua shpejt nga shtetet arabe, të cilat e shfrytëzuan atë si platformë për promovimin e çështjes palestineze.

Deklarata e Venecias (1980)³ konfirmoi qartë parimet thelbësore të politikës evropiane: të drejtën e popullit palestinez për vetëvendosje, zbatimin e rezolutave 242 dhe 338⁴, të drejtën e të gjitha shteteve në rajon për siguri, përfshirjen e OKB-së në negociatë, kundërshtimin e çdo ndryshimi unilateral të statusit të Jerusalemit, përfundimin e okupimit të vitit 1967 dhe vlerësimin e vendbanimeve izraelite si të paligjshme dhe pengesë për paqen. Deklarata u pa si sukses i EPC-së, por nuk arriti të krijonte vullnet të mjaftueshëm politik për një iniciativë të përbashkët evropiane.

Vendet anëtare vendosën të ndërmerren dy misione në rajon, por refuzimi kategorik i Izraelit për t'u dhënë evropianëve një rol politik minimizoi mundësitë për një angazhim aktiv të BE-së. Në fund të viteve '80, Europa nuk shënoi sukses të madh në lidhje me konfliktin, ndërsa periudha e pas Luftës së Ftohtë solli një përmirësim modest të pozicionit të saj.

Pas dështimit diplomatik gjatë krizës së Gjirit në vitin 1990, BE nuk ishte e pozicionuar për të kërkuar rol politik në rajon. Megjithatë, gjatë procesit të Oslos, Europa dëshmoi gatishmëri për të kontribuar përmes mbështetjes financiare. Dokumentet e ZNBP-së përsëritën parimet tashmë të artikuluara në Venecia. Një përparim i rëndësishëm u shënuar në vitin 1999 me Deklaratën e Berlinit, ndërsa pas shpërthimit të Intifadës së dytë, BE botoi Deklaratën e Sevillas (2002), e cila theksonte se *“paqja mund të arrihet vetëm përmes negociatave”*,⁵ me objektiv përfundimtar

³ https://eeas.europa.eu/archives/docs/mepp/docs/venice_declaration_1980_en.pdf

⁴ https://unsco.unmissions.org/sites/default/files/s_res_3381973.pdf

⁵ <https://www.consilium.europa.eu/media/20928/72638.pdf>, SEVILLE EUROPEAN COUNCIL 21 AND 22 JUNE 2002, Brussels, 24 October 2002 (29.10) (OR. fr) 13463/02

krijimin e një shteti palestinez demokratik, të qëndrueshëm dhe sovran që bashkëjeton me Izraelin në kufij të sigurt dhe të njohur.

BE përballej me sfida të shumta: mungesë e instrumenteve të përbashkëta të politikës së jashtme, e drejta e vetos e shteteve anëtare dhe mungesë e konsensusit për qasjen e duhur ndaj konfliktit. Përpjekjet e para për një politikë më komplementare u bënë në vitet '70 me dialogun euro-arab dhe marrëveshjen tregtare me Izraelin (1975). Ndërkohë, BE nisi të siguronte ndihmë për popullin palestinez, fillimisht për refugjatët përmes UNRWA-s⁶ dhe më pas për territoret e pushtuara.

Pas marrëveshjeve të Oslos (1993), roli ekonomik i BE-së në procesin e paqes u rrit. Gjatë viteve '90, BE u bë donatori kryesor i ndihmës financiare për territoret palestineze përmes programit MEDA⁷. Megjithatë, ndihma nuk pati rezultatet e pritura, pasi ekonomia palestineze stagnonte për shkak të bllokadave izraelite, politikave të sigurisë dhe kufizimeve tregtare. Situata u përkeqësua me shpërthimin e Intifadës së dytë (2000), duke detyruar BE-në të fokusohet në ndihmë humanitare dhe në parandalimin e kolapsit të Autoritetit Palestinez.

BE mbështeti projekte infrastrukturore, si porti dhe aeroporti i Gazës, dhe angazhohej në nisma të shoqërisë civile. Pas rikthimit të okupimit të Bregut Perëndimor në 2002, BE u detyrua t'i shndërrojë programet e zhvillimit në operacione humanitare, duke mbuluar në fakt edhe detyrimet e autoriteteve pushtuese.

BE kontribuoi rëndësisht në dy iniciativa të mëdha shumëpalëshe: Partneritetin Euro-Mesdhetar (Procesi i Barcelonës) dhe Grupin Rajonal të Bashkëpunimit Ekonomik brenda Procsit të Madridit. Megjithatë, partneriteti euro-mesdhetar nuk krijoi mekanizma të zgjidhjes së konfliktit dhe shpesh u bllokua nga bojkotet dhe tensionet politike.

Në maj 2008, BE përcaktoi strukturën e Unionit të Mesdheut, duke zgjeruar bashkëpunimin rajonal. Edhe vendet e Ballkanit Perëndimor u integruan në proceset përkatëse të bashkëpunimit ekonomik.

Çështja e të folurit me një zë të vetëm në politikën e jashtme, e veçanërisht ndaj konfliktit izraelito-palstinez, mbetet sfidë e rëndësishme. Vendimarrja me konsensus dhe dallimet mes qëndrimeve kombëtare kufizojnë efektivitetin e BE-së. Vendet anëtare shpesh mbajtën pozicione të ndryshme: Franca, Irlanda, Italia dhe

⁶ The United Nations Relief and Works Agency for Palestine Refugees in the Near East

⁷ <https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/summary/meda-programme.html>

Greçia ishin më të prira të mbështesnin kërkesat palestineze, ndërsa Holanda, Danimarka dhe Gjermania mbanin qëndrim më të afërt me Izraelin. Që nga fillimi i përfshirjes në vitet '70, Izraeli ka qenë përgjithësisht skeptik dhe negativ ndaj rolit të BE-së.⁸

Roli i BE-së në konfliktin mes Izraelit dhe Palestinës pas datës 7 tetor 2023

Gjatë dekadave, BE-ja ka synuar zgjidhjen e konfliktit Izrael–Palestinë përmes instrumenteve të saj të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë (EUFSP), me “*zgjidhjen me dy shtete*” si parimin mbi të cilin mbështetet e tërë qasja e saj për zgjidhjen e konfliktit. Kjo politikë ka qenë joefektive për shkak të ndërveprimit kontekstual të konkurrencës multipolare, fragmentimit rajonal dhe kundërshtimeve të brendshme brenda BE-së. Përballë këtyre kufizimeve kontekstuale, BE-ja ka përdorur një sërë strategjish zbutëse:

- delegimin si masë institucionale përmes misionëve të saj të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP);
- multilateralizimin si masë diplomatike/koalicioni përmes pjesëmarrjes në Kuartet dhe platforma të tjera shumëpalëshe;
- dhe angazhimin selektiv si masë funksionale përmes lidhjeve tregtare me të dy aktorët dhe politikave të ndihmës humanitare, me qëllim zbutjen e ndikimit të kufizimeve kontekstuale.

Megjithatë, asnjë nga veprimet zbutëse të BE-së nuk ka arritur të adresojë në mënyrë adekuate ndikimin e tre kufizimeve kontekstuale për shkak të ndjeshmërive, divergjencave dhe përplasjeve të dhunshme brenda rajonit, si dhe për shkak të vazhimit të okupimit izraelit mbi tokat palestineze nën mbrojtjen e Shteteve të Bashkuara.

Marrëdhëniet midis Izraelit dhe Palestinës ndodhen sot ndoshta në pikën më të ulët historike. Sulmi i dhunshëm i Hamasit mbi qytetet izraelite në kufi më 7 tetor 2023 dhe përgjigjja ushtarake brutale e Izraelit shkaktuan përshkallëzim të mëtejshëm të dhunës dhe një situatë gjithnjë e më të dëshpëruar humanitare në Rripin e Gazës. Deri në atë ditë, Kombet e Bashkuara e kishin shpallur vitin 2022 si “*vitin më vdekjeprurës*” për palestinezët që nga viti 2006, sidomos në Bregun Perëndimor⁹ ndërsa perspektivat për të ardhmen ishin tashmë të zymta. Në dhjetor 2022, politikani

⁸ Allen, D., Pijers, A., *European Foreign Policy – Making and the Arab–Israeli Conflict*, Martinus Nijhoff publishers, The Hague, 1984, p. 46

⁹ Tahhan and Humaid Citation2022,

veteran izraelit Benjamin Netanyahu u shfaq si udhëheqësi i asaj që konsiderohet qeveria më e djathtë ekstreme dhe nacional-religjioze në historinë e Izraelit, me disa partnerë të Netanyahu-t që shprehnin hapur mbështetje për aneksimin e të gjitha tokave palestineze në Bregun Perëndimor ose, të paktën, për një zgjerim të mëtejshëm të vendbanimeve izraelite, si dhe për përshkallëzim të dhunës ndaj popullsisë së okupuar¹⁰

Në Strategjinë Evropiane të Sigurisë (ESS) të vitit 2003, BE-ja i caktoi vetes detyrën e menaxhimit të konflikteve, veçanërisht në fqinjësinë e saj, dhe identifikoi zgjidhjen e konfliktit Izrael–Palestinë si prioritet strategjik. BE-ja ka mbështetur prej kohësh një *“zgjidhje me dy shtete”* për konfliktin. Referenca më e rëndësishme e BE-së për zgjidhjen me dy shtete ishte Deklarata e Venecias e qershorit 1980, ku Këshilli Evropian konfirmoi nevojën për një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme në Lindjen e Mesme, të bazuar në parimin e dy shteteve, Izraelit dhe Palestinës, që jetojnë krah për krah brenda kufijve të sigurt dhe të njohur. Strategjia Globale e vitit 2016 përfshiu gjithashtu ambicien e BE-së për të trajtuar konfliktin izraelito-palestinez me qëllim ruajtjen *“e perspektivës së një zgjidhjeje të zbatueshme me dy shtete, bazuar në vijat e vitit 1967 me shkëmbime tokash ekuivalente, dhe rikrijimin e kushteve për negociata kuptimplota”*¹¹

Pavarësisht synimeve të mira dhe angazhimeve, zhvillimet e fundit në politikën e brendshme izraelite, së bashku me rënien e legjitimitetit dhe mosfunksionimin e PA-së, e kanë bërë konfliktin izraelito-palestinez shumë më pak të rëndësishëm për BE-në krahasuar me dekadat e mëparshme. Ndërsa aktorët kryesorë rajonalë treguan gjithnjë e më pak interes ndaj konfliktit, ndarjet ndërmjet shteteve anëtare të BE-së mbi vlerësimin dhe përgjigjen ndaj realitetit të ri të një *“procesi paqeje”* të bllokuar e kanë minuar rëndë rolin e BE-së si ndërmjetës ose lehtësues. Për më tepër, mjedisi rajonal dhe ndërkombëtar në ndryshim – veçanërisht kryengritjet arabe dhe luftërat civile në Libi dhe Siri, çështja e migrimit që pasoi, dhe së fundi lufta në Ukrainë – e kanë zhvendosur vëmendjen e BE-së. Ngjarjet e 7 tetorit 2023 shënuan një moment kritik në konflikt dhe nxorën në pah rënien e interesit të BE-së, duke bërë gjithashtu më të dukshme kontradiktat brenda Unionit.

¹⁰ Council on Foreign Relations Citation2023.

¹¹ Council of the European Union Citation2016.

Reagimet e para nga BE-ja pas 7 tetorit 2023 ishin të qarta dhe të pakundërshtueshme. Presidentja e Komisionit, Ursula von der Leyen, dënoi sulmin e Hamasit dhe bëri thirrje për solidaritet me Izraelin. Josep Borrell, Presidentja e Parlamentit Evropian Roberta Metsola, dhe disa komisionerë dhe kryetarë të grupeve të europarlamentarëve folën në mënyrë të ngjashme. Flamuj izraelitë u vendosën në ndërtesën e Komisionit Evropian, siç ndodhi edhe në kryeqytete të tjera të BE-së. Presidentja von der Leyen dhe Presidentja Metsola vizituan Izraelin më 11 tetor, duke ripërsëritur mbështetjen e tyre për vendin. Sipas disa ekspertëve, veprimet e para të BE-së dhe dështimi – të paktën përmes kanaleve zyrtare – për të treguar kufijtë ndaj përgjigjes së Izraelit ndaj sulmit të Hamasit ose për të shprehur kundërshtim të qartë ndaj veprimeve të njoftuara nga vendimmarrësit izraelitë kundër popullsisë në Rripin e Gazës, u perceptuan nga qeveria izraelite si një leje për veprim operativ dhe pajtim për veprime ushtarake të pakufizuara kundër Hamasit. Si rezultat, fillimi i luftës krijoi një imazh të pafavorshëm të BE-së në vendet e MENA-s dhe partnerët e tjerë në Global South. Që nga fillimi i eskalimit, konflikti kishte një ndikim të fortë mbi vendet e BE-së, mediat e tyre dhe hapësirën publike përmes demonstratave, manifestimeve të solidaritetit, akteve të antisemitizmit dhe dezinformimit. Për disa vende të BE-së, një nga aspektet që ndikoi në perceptimin e tyre të konfliktit ishte pjesa e qytetarëve të tyre ndër ata që u vranë ose u morën peng nga Hamas, dhe ata të ekspozuar ndaj sulmeve të mëtejshme në rajon.

Në nivel politik, mesazhi themelor nga BE-ja dhe shtetet anëtare ishte thirrja për dënuar të veprimeve të Hamasit më 7 tetor, për një armëpushim dhe lirim të pengjeve, dhe për sigurimin që civilët në Rripin e Gazës – ku operacioni tokësor izraelit filloi në fund të tetorit – të kenë akses në ndihma humanitare. Kuadri i BE-së i tre “*po*”-ve dhe tre “*jo*”-ve u prezantua nga Borrell në një takim me Kryeministrin Palestinez, Mohammad Shtayyeh. Një “*jo*” ndaj zhvendosjes së popullsisë palestineze nga Gaza, një “*jo*” ndaj ndryshimeve territoriale, dhe një “*jo*” ndaj ndarjes së çështjes së Gazës nga problemi më i gjerë palestinez. “*Po*”-ja lidhej me rikthimin e Autoritetit Palestinez në qeverisjen e Rripit të Gazës, përfshirjen më të madhe të shteteve arabe dhe pjesëmarrjen më të gjee ...pjesëmarrjen më të gjerë të vetë BE-së në procesin e ndërtimit të shtetit palestinez për Palestinën. BE-ja gjithashtu mbështeti rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së që lidhen me luftën, përfshirë nisjen e operacionit detar *EUNAVFOR ASPIDES*¹² për të mbrojtur transportin detar nga sulmet e Houthis.

¹² https://www.eeas.europa.eu/eunavfor-aspides_en?s=410381

të Jemenit, në kuadër të Rezolutës 2722¹³ të KS-OKB-së. Ndërsa konflikti thellohej, u bë e qartë ndarja midis Presidentes von der Leyen dhe Përfaqësuesit të Lartë Borrell. Ky i fundit u bë zëri më i dëgjueshëm mbi konfliktin, duke kritikuar fuqishëm Izraelin për sulmet e tij në Gaza, duke kontribuar në katastrofën humanitare, krime lufte ose krime kundër njerëzimit. Kjo temë ka qenë një temë konstante në bisedat e zhvilluara me vendet e rajonit, si Jordania dhe Egjipti, dhe në Samitin e Ligës Arabe. Megjithatë, qëndrimi i shteteve anëtare mbeti i qëndrueshëm, dhe nuk pati ndarje të dialogut politik me palën izraelite, siç kishte sugjeruar Përfaqësuesi i Lartë, as nuk pati ndonjë rishikim të Marrëveshjes së Asociimit e cila u përshkrua nga një bashkëbisedues si “*opsioni bërthamor*”.

Nga iniciativat e promovuara nga diplomacia e BE-së ishin planet për një konferencë paqësore, të propozuar në fillim të vitit 2024, dhe Aleanca Globale për Zgjidhjen me dy shtete, e cila u lansua më 26 shtator 2024, duke iu referuar Përpjekjes për Ditën e Paqes. Sa i përket përdorimit të instrumenteve të tjera, diplomatët treguan për bisedime të avancuara në nivelin e Komitetit të Përfaqësuesve të Përhershëm (COREPER) dhe gatishmërinë e shteteve anëtare të BE-së për të riaktivizuar misionin EU BAM Rafah, i cili monitoron dhe mbështet aktivitetet në pikën kufitare midis Gazës dhe Egjiptit si instrumente të tjera të mundshme.

Konkluzione

Konflikti izraelito-palestinez qëndron në thelb të një prej sfidave më të vështira të politikës ndërkombëtare, dhe analiza e mësipërme tregon se, pavarësisht rolit të rëndësishëm ekonomik, diplomatik dhe humanitar të Bashkimit Evropian, ndikimi i tij politik mbetet i kufizuar. BE-ja ka kontribuar në mënyrë konsistente në ndërtimin institucional të Palestinës, në mbështetjen e proceseve shumëpalëshe dhe në promovimin e zgjidhjes me dy shtete, por këto përpjekje janë dobësuar nga mungesa e një qëndrimi të unifikuar, nga varësia strategjike ndaj SHBA-ve dhe nga fragmentimi i brendshëm midis shteteve anëtare.

Ngjarjet pas 7 tetorit 2023 e thelluan më tej këtë dobësi institucionale dhe politike. Reagimet e para treguan mungesë koherence dhe dërguan sinjale të paqarta, duke dëmtuar perceptimin e BE-së në Lindjen e Mesme dhe në arenën globale. Ndërsa kriza humanitare në Gaza u përkeqësua, BE-ja u ndodh e ndarë midis qasjeve më të

¹³ Resolution 2722 (2024) Adopted by the Security Council at its 9527th meeting, on 10 January 2024, [https://docs.un.org/en/s/res/2722\(2024\)](https://docs.un.org/en/s/res/2722(2024))

kujdeshme diplomatike dhe pozicioneve më të ashpra politike, gjë që vuri në pah kufijtë e kapacitetit të saj si ndërmjetës i besueshëm.

Megjithatë, BE-ja vazhdon të mbetet një aktor i domosdoshëm për stabilizimin e rajonit, falë instrumenteve të saj financiare, misioneve të sigurisë, ndikimit tregtar dhe rolit në formatet shumëpalëshe ndërkombëtare. Për të rimarrë besueshmërinë dhe për të exercuar ndikim real në procesin e paqes, BE-ja duhet të kapërcejë pengesat e brendshme, të forcojë koherencën strategjike dhe të adoptojë një politikë të jashtme më të unifikuar e më të vendosur.

Në përfundim, e ardhmja e rolit të BE-së në konflikt varet nga aftësia e saj për të transformuar potencialin ekonomik dhe diplomatik në kapacitet të mirëfilltë politik. Vetëm një Union që flet me një zë të vetëm dhe vepron në mënyrë të koordinuar mund të kontribuojë realisht në krijimin e kushteve për një paqe të drejtë, të qëndrueshme dhe të negociuar mes Izraelit dhe Palestinës.

Referenca

1. Allen, D., Pijers, A., European Foreign Policy – Making and the Arab –Israeli Conflict, Martinus Nijhoff publishers, The Hague, 1984, p. 46
2. Council of the European Union Citation2016.
3. Council on Foreign Relations Citation2023.
4. https://eeas.europa.eu/archives/docs/mepp/docs/venice_declaration_1980_en.pdf
5. <https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/summary/meda-programme.html>
6. https://unsco.unmissions.org/sites/default/files/s_res_3381973.pdf
7. <https://www.consilium.europa.eu/media/20928/72638.pdf>, SEVILLE EUROPEAN COUNCIL 21 AND 22 JUNE 2002, Brussels, 24 October 2002 (29.10) (OR. fr) 13463/02
8. https://www.eeas.europa.eu/eunavfor-aspides_en?s=410381
9. Leonard Stein, The Balfour Declaration, 345-48
10. Resolution 2722 (2024) Adopted by the Security Council at its 9527th meeting, on 10 January 2024, [https://docs.un.org/en/s/res/2722\(2024\)](https://docs.un.org/en/s/res/2722(2024))

11. Rezoluta 194 e OKB-së
12. Tahhan and Humaid Citation2022,
13. The United Nations Relief and Works Agency for Palestine Refugees
in the Near East

THE BANKING SYSTEM IN KOSOVO

Phd. Cand. Kujtim Raci

kujtimraci_73@hotmail.com

Abstract

The banking system in Kosovo has undergone significant development since the post-war period of 1999, particularly following the country's declaration of independence in 2008. Centered around the Central Bank of Kosovo (CBK), the system includes commercial banks and non-banking financial institutions, all of which contribute to the economic stability and growth of the country. The banking sector in Kosovo is predominantly privately owned, with commercial banks structured as joint-stock companies, while the CBK operates as a nationalized institution. The Central Bank plays a key role in regulating, supervising, and licensing financial institutions, managing international reserves, and ensuring the stability of the financial system. Commercial banks, on the other hand, provide a range of financial services to individuals, businesses, and the public sector, aiming for profitability while contributing to economic development. This paper explores the structure, objectives, and strategic goals of the banking system in Kosovo, emphasizing the role of the CBK and highlighting the operations and vision of representative commercial banks such as Banka për Biznes SH.A. The study also underscores the importance of modern banking practices, financial inclusion, digitalization, and sustainable economic development.

Keywords: *Banking System, Central Bank, Commercial Banks, Financial Stability, Risk Management, Kosovo, Banking Regulation,*

The Banking System in Kosovo

The banking system in Kosovo, based on Basel standards, began to take shape after the war in 1999, during which the country emerged with a destroyed banking network. However, it experienced more rapid development after the declaration of independence in 2008. The banking system in Kosovo is centered around the Central Bank of Kosovo (CBK), with commercial banks and other microfinance institutions forming its network.

The banking system is a crucial component of the overall economic system, particularly in relation to the economic policies implemented. It provides various services to both the economic and non-economic sectors as well as to the population, including payment systems (transfers), circulation of goods within and outside the country, and the concentration and allocation of savings. This directly and indirectly

impacts the functioning of the country's economy. Banks are highly complex institutions. They perform a variety of heterogeneous tasks within a country's economy, and the operation of banks, as well as the entire banking system, depends on the economic system itself, specifically the overall socio-economic system.

The banking network in Kosovo is an informal and complex system in the sense that it ensures the flow of financial transactions and macroeconomic stability in the country, including the Central Bank and other microfinance institutions.

Main characteristics of the banking system in Kosovo

The characteristics of the banking system in Kosovo are:

Private ownership predominates, especially among commercial banks, which are in the form of joint-stock companies, while the Central Bank (CBK) is nationalized.

All commercial banks provide credit to all types of businesses registered with the Kosovo Business Registration Agency (ARBK) and meet the conditions for granting and receiving loans to both individuals and legal entities, offering various types of collateral, and handling the circulation of payments within and outside the country.

The main objective of commercial banks is the realization of maximum profit.

The current banking system in Kosovo consists of the following banks and non-bank financial institutions:

The Central Bank of Kosovo (CBK)

Commercial Banks

Other Non-Banking Financial Institutions

The central bank of Kosovo

Initially, in Kosovo, after the war, which left the banking system destroyed, the Kosovo Payments Bank (BPK) was established on November 15, 1999, as the banking and payments authority in Kosovo and is a separate legal public entity.

Unlike other central banks that issue currency (banknotes and coins), grant loans, implement monetary-credit policies related to regulating the money supply, ensure international liquidity, manage state accounts, implement discount policies, open market operations, the mandatory reserve policy, qualitative credit control, and selective credit policies, the BPK, established after the war as the only bank in Kosovo under the IMF's directive, did not perform most of the functions of a central bank due to the political circumstances at the time, with the exception of the mandatory reserve policy.

The primary tasks of the BPK were to develop an efficient and secure payment system both domestically and internationally, and to ensure liquidity, solvency, and the efficient operation of a banking system based on a stable market. Later, the BPK was transformed into the Central Banking Authority of Kosovo (AQBK).

After Kosovo's declaration of independence in 2008, the Kosovo Assembly approved Law No. 03/L-209 on the "Central Bank of the Republic of Kosovo" on July 27, 2010.

Objectives of the central bank of Kosovo

- The objectives of the CBK according to the current law are:
- The primary objective of the Central Bank is to promote and maintain a stable financial system, including a safe, sound, and efficient payment system.
- An additional objective of the Central Bank, which is subordinated to its primary objective, is to contribute to achieving and maintaining price stability within the country.
- Without prejudice to the achievement of these objectives, the Central Bank supports the general economic policies of the Government.
- The Central Bank operates in accordance with the principle of a market economy with free competition, promoting the efficient allocation of resources.¹

¹ Ligji 03/L-209 për Bankën Qendrore të Kosovës, 27.07.2010

Duties of the central bank of Kosovo

The duties of the Central Bank in fulfilling the objectives set by the applicable law include:

- Determining and implementing policies for a stable financial system, including the supervision of a deposit insurance scheme, conducting market operations, and providing emergency liquidity;
- Regulating, licensing, registering, and supervising financial institutions as further specified in this law or any other applicable law;
- Promoting and supervising secure, sound, and efficient payment, clearing, and settlement systems for securities;
- Ensuring an adequate supply of banknotes and coins in Kosovo;
- Managing and maintaining international reserves;
- Collecting and publishing statistics;
- Contributing to achieving and maintaining domestic price stability;
- Informing the Assembly of the Republic of Kosovo, the Government, and the public about its policies, duties, and operations as further specified in this law;
- Acting as banker, financial advisor, and fiscal agent for the Government and any public body or organization in Kosovo;
- Cooperating and participating in councils and international organizations related to matters within its area of competence;
- Carrying out any auxiliary activities arising from the exercise of its duties under this law or any other law.

Within the competencies defined by law, the Central Bank, its decision-making bodies, or its personnel shall not receive instructions from any other person or entity, including government entities. The independence and autonomy of the Central Bank shall be respected at all times, and no person or entity shall attempt to influence the members of the decision-making bodies or the personnel of the Central Bank in carrying out their duties or interfere with the activities of the Central Bank.

Mission, vision, and values of the central bank of Kosovo

Mission

Our mission is to ensure financial and monetary stability, provide an effective payment system, ensure adequate supply of cash, and support sustainable economic development in the Republic of Kosovo.

Vision

We are committed to being an independent and trustworthy institution that operates transparently and responsibly to the public, and to being a synonym for professionalism, innovation, and inclusiveness.

Values

- Integrity and Ethics
- Competence and Professionalism
- Teamwork and Innovation
- Promoting the Public Interest
- Effectiveness and Efficiency
- Quality and Commitment

Strategic goals of the central bank of Kosovo

The strategic goals of the Central Bank of Kosovo are:

Strengthening financial stability and resilience

Advancing the regulatory and supervisory framework to identify and respond promptly to risks within financial institutions to preserve financial stability.

Building capacity, commitment to personnel, digitalization, and process modernization

Modernizing the Central Bank of the Republic of Kosovo to enhance corporate governance, human resources capacity, internal controls, risk management, transparency, processes, and operations.

Modernizing financial market infrastructure and enhancing competitiveness

Advancing the infrastructure for payment settlements and securities, and digitalizing payment services to boost competition and market development.

Advancing consumer protection, financial education, and financial inclusion

Promoting financial education, access to finance, and financial inclusion, as well as best practices in the provision of services by financial institutions.

Expanding cooperation, engagement, and impact in areas of responsibility

Increasing the level of cooperation with external stakeholders, financial institutions, regulatory authorities, international financial institutions, and other relevant institutions with shared interests.

Management of international reserves

Management of International Reserves:

The Central Bank conducts transactions with international reserves and manages these reserves in accordance with the best international practices and depending on its objectives set out in Article 7 of this law, while prioritizing security, liquidity, and income.

The Central Bank may hold in its international reserves portfolio any or all of the following assets:

- 2.1. Gold and other precious metals held by, or on behalf of, the Central Bank, including credit balances representing gold and other precious metals.
- 2.2. Banknotes and coins denominated in easily convertible currencies held by, or on behalf of, the Central Bank.
- 2.3. Credit balances and interbank deposits that are payable on demand or within a short-term period, denominated in easily convertible currencies, held in accounts of the Central Bank with foreign banks, central banks, or international financial institutions.
- 2.4. Easily tradable debt securities denominated in easily convertible currencies, issued by or backed by full guarantees of foreign governments, foreign central banks, or international financial institutions.
- 2.5. Claims on international financial institutions arising from repurchase agreements, sales and repurchase transactions, and securities lending agreements related to the debt securities mentioned in subparagraph 2.4 of this article.
- 2.6. Special Drawing Rights (SDRs) held in Kosovo's account with the International Monetary Fund.
- 2.7. Kosovo's reserve position with the International Monetary Fund, as well as with other similar international financial organizations.
- 2.8. Any other easily tradable asset denominated in easily convertible currencies as determined by the Executive Board.

If the international reserves decrease, or in the opinion of the Central Bank, may decrease or reach levels that could jeopardize the policies of the Central Bank, and the Central Bank is unable to rectify this decline, the Central Bank shall recommend a policy to the Minister to address this situation. The recommendation of the Central Bank must be based on a report which includes the causes that led to the decline in reserves.²

Currency

Issuance of Currency

The currency of Kosovo shall be defined by law in accordance with Article 11 of the Constitution. The official currency used in Kosovo for payment is the Euro.

No legal or natural person, except for the Central Bank, has the right to issue banknotes or coins. However, the Central Bank has never issued currency.

The Central Bank will be responsible for the proper supply of banknotes and coins in Kosovo.

Prohibited activities of the central bank of Kosovo

The prohibited activities of the Central Bank of Kosovo are:

Unless specifically authorized by law, the Central Bank shall not:

- 1.1. provide any credit or make any significant monetary or financial gift;
- 1.2. engage in trade, purchase shares of any corporation, including shares of any financial institution, or otherwise have an ownership interest in any financial, commercial, agricultural, industrial, or other enterprise; or
- 1.3. acquire, by purchase, lease, or any other means, any rights to real property, except when deemed necessary or appropriate for securing facilities to carry out its administration and operations or for similar purposes arising from the performance of its duties; and
- 1.4. issue currency.

² Ligji 03/L-209 për Bankën Qendrore të Kosovës, 27.07.2010

Notwithstanding the previous provisions of this article, the Central Bank may:

2.1. provide adequately secured loans for, or have ownership shares or otherwise participate in, any organization engaged in activities that are required or beneficial for the proper execution of the Central Bank's duties and responsibilities;

2.2. acquire, in the process of debt collection, any interest or rights referred to in this article; provided, however, that any interests or rights acquired in this manner shall be sold at the earliest appropriate opportunity; and

2.3. establish pension funds for its personnel or similar arrangements for the benefit or protection of its personnel, and manage such funds and arrangements.

Any such activity mentioned in paragraph 2 shall be published by the Central Bank in the report referred to in Article 59, paragraph 2, subparagraph 2.2. of this law.³

Licensing of commercial banks in Kosovo

One of the main tasks of the Central Bank of Kosovo (CBK) is the licensing of commercial banks and non-bank financial institutions. The CBK has exclusive responsibility for granting licenses for the operation of banks and financial institutions, determining the minimum required paid-up capital that banks are obligated to maintain, which shall never be less than €7,000,000 (seven million euros). The CBK may issue directives to periodically increase this minimum amount.

Applications for a license to establish and operate a bank or a branch of a foreign bank must be in the form specified by the CBK and must be accompanied by the following information:

Documents related to the proposed bank or foreign bank, including a notarized copy or original documentation stating its establishment and the proposed address of the head office;

³ Ligji 03/L-209 për Bankën Qendrore të Kosovës, 27.07.2010

The name, nationality, residence, qualifications, and experience of the Director or Senior Manager of the proposed bank or foreign bank, including their business and professional history for the past ten (10) years;

The amount of authorized and paid-up capital of the proposed bank or foreign bank, including the amounts paid and the legal source of the capital;

A business plan that includes, among other things, the organizational structure of the proposed bank or foreign bank, the type of banking activities to be undertaken, projected financial statements for the next three years, and, if available, audited financial statements and annual reports for the last two (2) years;

A list of shareholders who hold or will hold five (5%) percent or more of the shares in the proposed bank or foreign bank, and the beneficial owners of these shares, including their names, addresses, and respective ownership of shares;

The name, nationality, residence, business and professional history for the last ten years, and audited financial statements for the last three (3) years (if available) of any major shareholder of the proposed bank or foreign bank;

For each Director or Senior Manager or major shareholder of the proposed bank or foreign bank, an official statement from the court revealing any criminal convictions, bankruptcy records, disqualification from the exercise of their profession, or past or present involvement in the management of any corporation or other business entity that has been subject to insolvency proceedings, if applicable;

In any case where the applicant is a foreign bank proposing to establish a subsidiary or a branch in Kosovo, a statement from the supervisor of the home country must be provided, confirming that there are no objections to the proposed activities in Kosovo and that the home supervisor exercises consolidated global banking supervision over the foreign bank's activities;

Any additional information that the CBK may consider necessary.

Upon submission of the application for licensing, within three months from the date of submission of the complete application, the CBK will preliminarily approve or reject the licensing of the bank and will notify the applicant in writing of its decision. The license is issued for an indefinite period and cannot be transferred (assigned). After the issuance of a provisional license, authorized banks may regularly request the CBK to engage in additional activities. The CBK may request a fee

(compensation) for the review of the application, the granting of the license, as well as for its possession.⁴

All these payments are non-refundable. After receiving the license and commencing operations, licensed banks must report to the Central Bank of Kosovo (CBK) on their activities, and they will be periodically inspected (audited) by the CBK.

Additionally, the CBK may revoke the license of a licensed bank by decision of the CBK, upon the bank's request, and for one or more of the following reasons:

- a) The license was obtained based on false information provided by the applicant,
- b) The bank has not commenced operations within 90 days from the date of license issuance, or has ceased to engage in financial deposit activities for more than eight months,
- c) A bank with a significant ownership stake has had its license revoked,
- d) The majority of the bank's assets have been integrated, merged, or sold,
- e) The owner or owners of the bank have decided to dissolve or liquidate the bank, or the bank has ceased to exist as an independent legal or operational entity, etc.

Commercial banks in Kosovo

Definition of Commercial Banks

A commercial bank is a bank that deals with the general public, accepting deposits and providing loans to a large number of households and small businesses. These banks are also known as retail banks. They also offer various services to depositors, including the provision of banknotes and credit cards, storage facilities for valuables and documents, currency exchange, stock exchange services, mortgage financing, and executor services.

As mentioned earlier, a bank can be defined as an important financial institution whose main function is accepting deposits and providing loans. However, upon further analysis, we see that banks perform other tasks that increase the influence

⁴ Ligji Nr.04/L-093 për Bankat , Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare

of the credit enterprise or the monetary-credit institution. The use of various names is a minor issue for understanding the concept of a bank, as we usually deal with different names but the same concept of a bank.⁵

In order to establish an effective financial and banking system, the CBK has approved regulations for the licensing of banks and regulations for supervision.⁶

Currently, the following commercial banks are licensed in Kosovo:

- a) Banka për Biznes SH.A.
- b) Banka Ekonomike SH.A.
- c) NLB Banka SH.A.
- d) T.C. Ziraat Bankasi A.S.
- e) Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.
- f) ProCredit Bank SH.A.
- g) TEB SH.A.
- h) Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SH.A.
- i) Turkiye Is Bankasi A.S.
- j) Banka Credins Kosovë SH.A.
- k) Pribank SH.A.⁷

Additionally, the CBK is the only authorized authority to license micro-finance institutions and non-bank financial institutions.

BPB - Banka Për Biznes Sh.A.

BPB is a locally licensed commercial bank that has been present in the Kosovo banking market since 2001. Since then, BPB has been continuously growing in the development and support of businesses. Flexibility, proximity, and customer care make BPB stand out from other commercial banks in Kosovo. BPB offers a wide portfolio of products and services specifically designed to support the needs of individuals and all types of businesses. BPB's strategic goal is to support the development of Kosovo's economy and businesses, and therefore its focus is on establishing healthy, long-term relationships with clients based on mutual trust.

⁵ Prof,Dr.Gazmend Luboteni "Menaxhmenti Bankar, 2008, Prishtinë.

⁶ Prof,Dr.Gazmend Luboteni "Menaxhmenti Bankar, 2008, Prishtinë.

⁷ CBK - Lists of Licensed/Registered Financial Institutions

The growth and expansion of businesses, besides helping the country's economic development, enables BPB, as a strategic partner, to create space for promoting and ensuring long-term stability for domestic capital. By offering high-quality and easy-to-use services, BPB supports families, employees, and students in realizing their plans and needs.

Bank's Mission

“We make a positive impact”

We believe that every individual and business deserves excellent service. Premium service is not reserved for a select group of privileged clients in our bank, but it is what we do every day in fulfilling the financial needs of every business and individual we serve. Our services are offered in a simple, convenient way and meet the current needs and capacities of our clients.

The mission of Banka për Biznes is to establish reliable, long-term partnerships with small and medium-sized enterprises in order to support their growth and development through responsible, innovative, and specifically designed products and services. We offer clients immediate and direct access to high-quality financial services, meeting their needs. Since trust is the most important aspect, we focus on building and maintaining long-term relationships with our clients, community, employees, and shareholders. We will strengthen these relationships by providing the right solutions that combine technology, experience, and financial strength.

BPB will be a provider that:

Adds value for our clients,

Creates a positive economic impact in our community, and

Creates positive personal and professional opportunities for our employees.

Among other goals, we aim to create a loyal customer base, increase the long-term value of our shareholders' investments, and contribute to the development and retention of our employees.

Bank's Vision

The vision of BPB is to be the reference bank for individuals and businesses in Kosovo, offering comfort and proactive support. We aim to become a key player in the banking sector of Kosovo, provide excellent service to our customers, generate

sustainable profits for our shareholders, and create an inspiring work environment for our employees. While we consider technology a necessity, we believe in the power of the human factor in meeting the needs of our clients and stakeholders.

Conclusion

From this study, it can be concluded that the banking system in Kosovo is well-structured and continuously evolving, with the Central Bank of Kosovo playing a critical role in maintaining financial stability, regulating financial institutions, and supporting economic growth. Commercial banks in Kosovo are essential actors in providing credit, managing deposits, and facilitating payments, thereby contributing to both individual and business financial needs.

The following recommendations are suggested for further development and strengthening of the banking system:

Enhance risk management frameworks across all financial institutions to ensure that banking operations are aligned with financial stability objectives at all levels of hierarchy. Transparency regarding financial risks should be promoted to support informed decision-making.

Provide comprehensive and continuous training for all bank employees to increase awareness and understanding of financial risks, as gaps in knowledge have been observed during surveys.

Diversify banking products and services to mitigate risk, enabling banks to balance potential losses in one segment with gains in others, thereby ensuring long-term financial sustainability and better service delivery to clients.

Promote digitalization and modernization of banking processes to increase efficiency, improve customer experience, and align with international banking standards.

Encourage financial inclusion and education programs to enhance public access to banking services and foster a financially literate population, contributing to overall economic growth.

Literatura

1. BOWLES Samuel & EDWARDS Richard “*Razumevanja Kapitalizma*”, Zagreb,1991.

2. Craven B.M i Thomson R.S “*Monetary Welfare Losess in U.S. Banking Comment*” Journal of Monetary Economics,1984.
3. Filipoviq Hamid Dr. “*Shkenca mbi Financat*”, Prishtinë,1976.
4. Golianin Milan “*Bankarstve Jugoslavije-Teorija, Organizacija i Poslovanje*”,Privredni pregled, Beograd, 1979.
5. Komoni Sabahudin Prof. Dr. “*Financat*”, Prishtinë,1985.
6. Luboteni Gazmend Dr. “*Bankat dhe Afarizmi Financiar*”, Prishtinë,1998.
7. Luboteni Gazmend Dr. “*Menaxhmenti Financiar i Bankave Afariste*”, Prishtinë,1998.
8. Heffernan S. 2005, Modern Banking, Wiley Finance, London, pp. 23-24.
9. Luboteni Gazmend Prof.Dr. “*Bankat dhe Afarizmi Bankar*”, Prishtinë, 2002.
10. Saunders A. & Walters ,2011, Financial Markets and Portfolio Management. Springer.
11. LeRoy Miller Roger&Vanhoose D. David “*Moderni Novac i Bankarstvo*”, Zagreb, 2000.
12. OCC Bulletin 2003, “Mortgage Banking: Interagency Advisory on Mortgage Banking”
13. M. Qiroviq M. Dr. ”*Monetarno Kreditni Sistem*”, Beograd,1976.
14. Rhoades Stephen “*Welfare Loss, Ridistribution, Effect and Registracion of Output Due to Monopoly on Banking*”, Journal of Monetary Economics, 1982.
15. https://www.bqk-kos.org/repository/docs/2010/Ligji03/209_per_BQK-ne.pdf
16. https://bqk-kos.org/repository/docs/korniza_ligjore/shqip/Minimimin_rezervave_të_bankes.pdf
17. Banking System in Kosovo
18. Banka Qendrore e Kosovës, Plani Strategjik 2024-2028, Prishtinë dhjetor 2023.
19. Ligji nr.04/L-093 për bankat dhe institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.
20. Ligji 03/L-209 për Bankën Qendrore të Kosovës, 27.07.2010
21. A Dictionary of Business and Management, 2009
22. Gazmend Luboteni “*Menaxhmenti Bankar*” 2008, UP Fakulteti Ekonomik, Prishtinë.
23. BQK-Listat e institucioneve financiare te licencuara/regjistruara.
24. Banka për Biznes, Kodi i Etikës, Janar, 2020.
25. Banka për Biznes, Broshura, HR Academy, Junior Program.

26. <https://www.bpbbank.com/bizneset/kredite>
27. <https://www.bpbbank.com/individ/kredite>
28. https://www.bpbbank.com/wp-content/uploads/2022/05/Raporti-Vjetor-2021-Final-er-WEB_Shqip.pdf
29. <https://www.bpbbank.com/wp-content/uploads/2023/05/Raporti-Vjetor.pdf>²⁹.https://www.bpbbank.com/wp-content/uploads/2024/05/RaportiVjetor_2023_final_compressed-1.pdf
30. <https://bekonomike.com>
31. <https://bekonomike.com/sq/Kredi-Private---Individët>
32. <https://bekonomike.com/sq/Kredi-për-Renovim--Individët>
33. <https://bekonomike.com/sq/Kredi-Hipotekare--Individët>
34. <https://bekonomike.com/sq/Mbitëheqja-për-individë---Individët>
35. <https://bekonomike.com/sq/Kredi-pqr-ndërmarrje-të-vogla-dhe-të-mesme>
36. <https://bekonomike.com/sq/Limiti-Kreditor>
37. <https://bekonomike.com/sq/Kredi-për-mikro-biznese>
38. <https://bekonomike.com/sq/Kredi-për-ndërmarrje-të-vogla-dhe-të-mesme>
39. <https://bekonomike.com/sq/Mbitërheqja>
40. <https://nlb-kos.com/sq/banken>

VIKTIMAT E KRIMIT TË ORGANIZUAR - DËSHMITARËT E DREJTËSISË NË SHQIPËRI

MSc. Albina Berisha

a.berisha@eust.edu.mk

Abstrakt

Krimi i organizuar përbën një nga kërcënimet më serioze për sigurinë publike, stabilitetin institucional dhe të drejtat themelore të individëve në Shqipëri dhe rajon. Analizës së pozitës të viktimave të krimit të organizuar, ka rëndësi të veçantë pasi duke shqyrtuar karakteristikat e tyre, format e viktimizimit dhe pengesat me të cilat përballen në procesin penal arrijmë të sjellim një pasqyrë më të pastër se me çfarë përballen viktimat e krimit të organizuar në vendin tonë . Fenomeni i krimit të organizuar në Shqipëri dhe rajon shfaq forma komplekse dhune, shfrytëzimi dhe intimidimi, të cilat shpesh mbeten të padukshme për institucionet ligjzbatuese.

Në fokus vihet roli i shtetit në identifikimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave, si dhe analiza e standardeve ndërkombëtare të mbrojtjes së dëshmitarëve, viktimave të trafikimit, viktimave të shfrytëzimit të detyruar dhe familjeve të viktimave të vrasjeve të lidhura me krimin e organizuar. Propozimi i një qasje të harmonizuar juridike, kriminalistike dhe sociale, duke identifikuar boshllëqet ekzistuese në legjislacion dhe praktikë, si dhe rekomandime për politika më efektive të mbrojtjes dhe parandalimit.

Hyrje

Krimi i organizuar, si një fenomen kompleks, i strukturuar dhe me qëndrueshmëri të lartë, ka prodhuar një kategori të vecantë viktimash, që përjetojnë forma të ndryshme viktimizimi fizik, ekonomik, psikologjik dhe social. Në të shumtën e rasteve viktimat e krimit të organizuar janë të pidentifikueshme për sistemin e drejtësisë në Shqipëri, për shkak të frikës, presionit ose kërcënimit dhe mungesës së theksuar të besimit tek institucionet shtetërore, kjo e fundit lidhet dhe me nivelin e korrupsionit të lartë në institucionet shtetërore.

Sipas Konventës së Palermos, krimi i organizuar karakterizohet nga grupime kriminale që veprojnë në mënyrë të koordinuar për përfitime materiale, në mënyrë të qëndrueshme dhe me hierarki të brendshme.¹ Në Shqipëri, fenomeni i krimit të organizuar është shoqëruar me trafikim të qenieve njerëzore, shfrytëzim, vrasje të tipit mafioz, zhvatje, fajde, shantazh, trafikim të drogës dhe aktivitete të tjera të paligjshme

¹ UNODC, *United Nations Convention against Transnational Organized Crime*, 2000, neni 2.

që synojnë fitim financiar dhe kontroll territorial. Krimi i organizuar që vjen i krijuar kryesisht nga familjet shqiptare që janë kthyer në aktorë kryesor të zhvillimit të krimit jo vetëm brenda për brenda Shqipërisë, por veprojnë edhe jashtë Shqipërisë dhe sipas studimeve të ndryshme paraja e përfituar nga këto aktivitetet shpeshherë pastrohet ose investohet në Shqipëri. Viktimat e këtyre veprimeve shpesh mbeten të pambrojtura dhe të ekspozuara ndaj rrezikut të vazhdueshëm. Dëshmitarët e drejtësisë përfaqësojnë një nga instrumentet më të rëndësishme dhe njëkohësisht më delikate në luftën kundër krimit të organizuar dhe kriminalitetit të rëndë. Ata janë individë që, duke pasur njohuri të drejtpërdrejta mbi veprimtari kriminale, bashkëpunojnë me organet e drejtësisë për të zbardhur strukturat, mekanizmat dhe përgjegjësit e veprave penale. Megjithatë, përfshirja e dëshmitarëve të drejtësisë ngre çështje të ndërlikuara juridike, etike dhe procedurale. Nga njëra anë, bashkëpunimi i tyre kontribuon ndjeshëm në forcimin e efektivitetit të ndjekjes penale dhe në garantimin e sundimit të ligjit; nga ana tjetër, ai kërkon një balancim të kujdesshëm midis interesit publik për ndëshkimin e krimit dhe respektimit të parimeve themelore të procesit të rregullt ligjor, përfshirë të drejtat e të pandehurve. Në këtë kuadër, analiza e institutit të dëshmitarit të drejtësisë merr rëndësi të veçantë si në aspektin normativ, ashtu edhe në atë praktik. Studimi i bazës ligjore, kushteve të përfitimit të statusit, formave të mbrojtjes dhe ndikimit të dëshmitarëve të tyre në procesin penal ndihmon në vlerësimin e efektivitetit të këtij instrumenti në luftën kundër kriminalitetit të organizuar dhe në konsolidimin e drejtësisë penale.

Viktimat e krimit të organizuar si kategori e veçantë

Sipas Deklaratës së Kombeve të Bashkuara për Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit, viktimë do të thotë persona që, individualisht ose kolektivisht, kanë pësuar dëm, duke përfshirë dëmtime fizike ose mendore, vuajtje emocionale, humbje ekonomike ose dëmtim të konsiderueshëm të të drejtave të tyre themelore, nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve që janë në shkelje të ligjeve penale në fuqi brenda Shteteve Anëtare, duke përfshirë ato ligje që ndalojnë abuzimin penal të pushtetit.² Kodi i Procedurës Penale të Shqipërisë njeh viktimën si subjekt procedural me të drejta të posaçme, si të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit, përfshirë të drejtën për informacion rreth procesit gjyqësor, për t'u mbrojtur dhe për të marrë ndihmë juridike, por edhe të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike ose këshillim të ofruara nga institucionet.³

² United Nations, *Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of power*, 1985

³ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Korrik 2017, Tiranë, neni 58.

Viktimat e krimit të organizuar përfshijnë një gamë të gjerë individësh dhe komunitetesh që preken drejtpërdrejt nga aktivitetet e grupeve kriminale të strukturuar. Këtu përfshihen, para së gjithash, personat që shfrytëzohen për trafikim njerëzor, prostitucion të detyruar, punë të detyruar apo forma të tjera të cenimit të dinjitetit njerëzor⁴. Po ashtu, viktima janë edhe individët që bien nën presionin e organizatave kriminale për të marrë pjesë në aktivitete ilegale, si trafikimi i narkotikëve, kontrabanda, fajdet apo skemat kriminale financiare⁵. Edhe bizneset dhe sipërmarrësit shpesh kthehen në objekt të gjobëvënies, shantazhit apo kërcënimeve, duke u bërë kështu pjesë e drejtpërdrejtë e ciklit viktimizues. Në një këndvështrim më të gjerë, komunitetet që jetojnë në zona me praninë e strukturave kriminale vuajnë pasojat afatgjata të pasigurisë, frikës, dhunës dhe uljes së standardeve të jetesës, duke i bërë ata viktima kolektive të këtij fenomeni kompleks.

Mënyrat e viktimizimit specifike për krimin e organizuar

Mënyrat e viktimizimit specifike për krimin e organizuar lidhen ngushtë me strukturën hierarkike, kulturën e dhunës dhe kontrollin territorial që këto grupe ushtrojnë. Viktimat shpesh përfshihen në situata shfrytëzimi ekonomik, si detyrimi për të paguar “mbrojtje” apo kamatëvonesë të paligjshme, duke i ekspozuar individët dhe bizneset ndaj varfërimit të qëllimshëm dhe kërcënimeve të vazhdueshme.⁶ Përveç kësaj, rekrutimi i detyruar—sidomos i të rinjve dhe personave në situatë socio-ekonomike të vështirë—përbën një formë të viktimizimit të ndërmjetëm, ku individit kthehet nga viktimë në autor nën presion dhe frikë.⁷ Po ashtu, krimi i organizuar përdor trafikimin e qenieve njerëzore, shfrytëzimin seksual dhe punën e detyruar si mekanizma të qëndrueshëm të viktimizimit, të cilat shpesh mbeten të padukshme për shkak të natyrës së fshehtë të aktiviteteve kriminale dhe mungesës së raportimit nga viktimat.⁸ Këto forma viktimizimi karakterizohen nga cikli i mbyllur i frikës, kontrollit dhe varësisë, duke krijuar pasoja afatgjata psikologjike, ekonomike dhe sociale për individët e prekur.

Në tabelën e mëposhtme tregohet përmbledhje mbi grupet më të rrezikuara:

⁴ UNODC, *Global Report on Trafficking in Persons*, 2022

⁵ Europol, *Serious and Organized Crime Threat Assessment (SOCTA)*, 2021, pg.22

⁶ UNODC, *Organized Crime and Illicit Markets*, 2020

⁷ Siegel, Dina. *Criminology of Organized Crime*, 2018

⁸ Europol, *Trafficking in Human Beings in the EU*, 2022

Grupet më të rrezikuara	Karakteristikat e përbashkëta	Roli i gjinive
gra dhe të mitur (për trafikim seksual), persona në varfëri ose me të ardhura të ulëta (për shfrytëzim pune dhe fajde), tregtarë lokalë dhe pronarë biznesesh të vegjël (për zhvatje), ish-anëtarë ose bashkëpunëtorë të grupeve kriminale (për hakmarrje	varfëri ose papunësi, izolim social, mungesë aksesesh tek shërbimet ligjore, lidhje familjare të shtrira, ose dobësi ligjore (dokumente të falsifikuara, status imigrantësh).	gratë dhe vajzat janë shpesh viktima të trafikimit dhe shfrytëzimit seksual; meshkujt e rinj mund të rekrutohen për aktivitetet kriminale si ekzekutorë ose kurrierë.

Institucioni i dëshmitarit të drejtësisë në Shqipëri

Institucioni i dëshmitarit të drejtësisë në Shqipëri paraqet një instrument thelbësor për garantimin e funksionimit të sistemit penal dhe zbulimin e veprave penale me ndjeshmëri të lartë. Roli i tyre është veçanërisht i rëndësishëm në çështjet që lidhen me krimin e organizuar, korrupsionin e nivelit të lartë dhe veprat e rënda penale, ku dëshmia e drejtpërdrejtë e një personi mund të jetë elementi kyç për zbardhjen e ngjarjes dhe identifikimin e autorëve.⁹ Në kontekstin shqiptar, statusi i dëshmitarit të drejtësisë është i rregulluar nga kuadri ligjor specifik, ku Ligji nr. 10173/2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë” përbën bazën kryesore normative.¹⁰ Ky ligj përcakton procedurat, kriteret dhe mekanizmat institucionalë për ofrimin e mbrojtjes efektive, duke kombinuar elemente sigurie fizike, identiteti të fshehtë, si dhe mbështetje sociale dhe psikologjike për individët që ofrojnë bashkëpunim me organet e drejtësisë. Dispozitat e këtij ligji janë të zbatueshme në kuadër të procedimeve penale për krime të kryera me dashje, për të

⁹ Council of Europe, Recommendation CM/Rec(2022)9 of the Committee of Ministers to member States on the protection of witnesses and collaborators of justice, 2022.

¹⁰ Ligji nr. 10 173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”

cilat ligji parashikon dënim me burgim jo më pak se 4 vjet, në minimum. Rrezikshmëria e këtyre krimeve dhe e autorëve të tyre duhet të jetë e tillë, që të justifikojë kryerjen e shpenzimeve të nevojshme për mbrojtjen e një ose të disa personave. 11

Megjithatë, sfidat që shoqërojnë funksionimin e mekanizmit të mbrojtjes së dëshmitarëve në Shqipëri mbeten të konsiderueshme. Fenomene si ndikimi i grupeve kriminale, frikësimi i dëshmitarëve dhe dobësitë strukturore të institucioneve ligjzbatuese kanë ndikuar në efektivitetin e përgjithshëm të sistemit.¹² Raportet ndërkombëtare kanë theksuar se gatishmëria për të dëshmuar shpesh cenohet nga mungesa e besimit të institucionet dhe nga vështirësitë në garantimin e një mbrojtjeje afatgjatë të qëndrueshme, sidomos për rastet që kërkojnë relokim brenda ose jashtë vendit.¹³ Kjo situatë e bën të nevojshme forcimin e strukturave të specializuara, rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit dhe harmonizimin e praktikave vendase me standardet europiane, me qëllim krijimin e një mjedisi më të sigurt për dëshmitarët që vendosin të bashkëpunojnë me drejtësinë.

Në aspektin procesual, dëshmitari i drejtësisë gëzon një rol të dyfishtë: nga njëra anë, ai ndihmon organet e prokurorisë dhe gjykatës në zbardhjen e çështjes, dhe nga ana tjetër, përfiton mbrojtje ligjore për të shmangur pasojat negative që mund të vijnë si rezultat i bashkëpunimit të tij.¹⁴ Procedurat e përzgjedhjes së dëshmitarit të drejtësisë bazohen në vlerësime të rrepta të rrezikut individual, natyrës së veprës penale dhe rëndësisë së informacionit që ai ofron. Përfshirja e tij në proces nuk është vetëm mekanizëm ndihmës për ndëshkimin e autorëve, por edhe një mjet politikash penale që synon nxitjen e dekurajimit të grupeve kriminale dhe forcimin e shtetit ligjor.

Në analizë përfundimtare, efektiviteti i institucionit të dëshmitarit të drejtësisë në Shqipëri lidhet ngushtë me cilësinë e bashkëpunimit ndërinstytucional, integritetin e strukturave shtetërore dhe vullnetin politik për të siguruar zbatim të rreptë të ligjit. Vetëm nëpërmjet garantimit të sigurisë reale dhe psikologjike për dëshmitarët, sistemi penal shqiptar mund të arrijë objektivin e tij kryesor: rritjen e efikasitetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe veprave penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

¹¹ Ligji nr. 10 173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, Neni 2

¹² EURALIUS & OPDAT, *Assessment Report on Witness Protection in Albania*, Tirana, 2020.

¹³ EURALIUS & OPDAT, *Assessment Report on Witness Protection in Albania*, Tirana, 2020.

¹⁴ A. Dobjani, *E Drejta Procedurale Penale*, Tiranë: Botimet Dudaj, 2019.

Kuadri ligjor i dëshmitarit të drejtësisë në Shqipëri

Në Shqipëri, institucioni i dëshmitarit të drejtësisë rregullohet nga legjislacioni i posaçëm për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, si dhe nga dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale. Ky kuadër ligjor synon të garantojë sigurinë fizike dhe psikologjike të dëshmitarit, ruajtjen e identitetit të tij dhe efektivitetin e procesit penal. Legjislacioni shqiptar është harmonizuar gradualisht me standardet ndërkombëtare, veçanërisht ato të Bashkimit Evropian. Përfitimi i statusit të dëshmitarit të drejtësisë nuk është automatik, por varet nga plotësimi i disa kushteve ligjore. Ndër kriteret kryesore përfshihen: rëndësia e informacionit të dhënë për zbardhjen e veprave penale, rreziku real ndaj jetës ose shëndetit të dëshmitarit dhe besueshmëria e bashkëpunimit të tij. Autoritetet kompetente vlerësojnë rast pas rasti nëse dhënia e këtij statusi është e justifikuar dhe proporcionale.¹⁵ Në kontekstin e krimit të organizuar, dëshmitari i drejtësisë luan një rol kyç, pasi informacioni i tij mundëson identifikimin e strukturave kriminale, hierarkisë së tyre dhe mënyrës së funksionimit. Praktika ka treguar se dëshmitë e tilla kanë qenë vendimtare në zbardhjen e çështjeve komplekse penale dhe në dënimin e figurave kyçe të botës së krimit.¹⁶

Kontributi i dëshmitarëve të drejtësisë në Shqipëri

Kontributi i dëshmitarëve të drejtësisë në Shqipëri konsiston kryesisht në forcimin e efektivitetit të ndjekjes penale dhe rritjen e shkallës së zbulueshmërisë së krimit të organizuar. Përmes dëshmimeve të tyre, organet e drejtësisë kanë mundur të sigurojnë prova vendimtare, të cilat shpeshherë nuk do të ishin të aksesueshme përmes mjeteve tradicionale hetimore. Ky kontribut ka ndikuar drejtpërdrejt në goditjen e rrjeteve kriminale të strukturuar dhe në çmontimin e tyre nga brenda.⁹

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i kontributit të dëshmitarëve të drejtësisë lidhet me parandalimin e krimit. Ekzistenca e këtij institucioni krijon një efekt dekurajues për grupet kriminale, pasi rrit rrezikun e zbulimit të veprimtarisë së tyre dhe cenon besimin e brendshëm midis anëtarëve të grupeve të organizuara. Në këtë mënyrë, dëshmitarët e drejtësisë kontribuojnë jo vetëm në ndëshkimin e krimit, por edhe në parandalimin e tij.¹⁷ Në planin institucional, përdorimi i dëshmitarëve të drejtësisë ka ndikuar në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet prokurorisë, policisë gjyqësore dhe

¹⁵ Ligji nr. 10173, datë 22.10.2009, "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë", i ndryshuar; Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, neni 3 - 6

¹⁶ UNODC, *Good Practices for the Protection of Witnesses in Criminal Proceedings*, Vjenë, 2008

¹⁷ <https://www.unodc.org/unodc/humanrights/areas/organized-crime.html>

strukturave të posaçme kundër krimit të organizuar. Ky bashkëpunim ka përmirësuar cilësinë e hetimeve dhe ka rritur besimin e publikut në aftësinë e shtetit për të luftuar kriminalitetin e rëndë.¹¹

Në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, autoritetet ligjzbatuese duhet të zotërojnë kapacitetet për të garantuar sigurinë dhe jetën e dëshmitarëve të cilët janë të ekspozuar ndaj kërcënimeve serioze, si dhe viktimat e trafikimit, për të mundësuar atyre të kotribuojnë në proceset e drejtësisë pa patur frikë për jetën. Për përmbushjen e këtij objektivit duhet të zbatohen masat e mëposhtme:

Garantimi i jetës dhe sigurisë fizike të dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë, funksionarëve të ngarkuar me luftën kundër krimit të organizuar dhe viktimave të trafikimit.

Nënshkrimi i marrëveshjeve me njësitë homologe për rialokimin jashtë të programeve të mbrojtjes me qëllim përforcimin e mekanizmave të sigurimit të jetës së bashkëpunëtorëve dhe dëshmitarëve të drejtësisë.¹⁸

Konkluzione dhe rekomandime

Analiza e zhvilluar në këtë punim nxjerr në pah se krimi i organizuar në Shqipëri përbën një fenomen kompleks dhe shumëdimensional, i cili prodhon forma të thella dhe të vazhdueshme viktimizimi ndaj individëve, grupeve shoqërore dhe komuniteteve të tëra. Viktimat e krimit të organizuar, për shkak të natyrës së veçantë të veprave penale, ekspozohen ndaj dhunës fizike, shfrytëzimit ekonomik, presionit psikologjik dhe izolimit social, duke u përballur shpesh me pengesa serioze në aksesin ndaj drejtësisë dhe mbrojtjes institucionale. Legjislacioni parashikon mekanizma të posaçëm për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve të drejtësisë, zbatimi efektiv i tyre mbetet i kufizuar. Faktorë të tillë si frikësimi nga grupet kriminale, mungesa e besimit në institucionet shtetërore, dobësitë strukturore dhe kapacitetet e pamjaftueshme profesionale ndikojnë drejtpërdrejt në gatishmërinë e viktimave dhe dëshmitarëve për të bashkëpunuar me organet e drejtësisë.

Institucioni i dëshmitarit të drejtësisë rezulton të jetë një instrument kyç në luftën kundër krimit të organizuar, duke kontribuar në zbardhjen e veprave penale komplekse dhe në çmontimin e strukturave kriminale nga brenda. Dëshmitë e bashkëpunëtorëve të drejtësisë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e

¹⁸ Ministria e Punëve të Brendshme, "Strategjia Kombëtare për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda 2026-2030 dhe Plani i Veprimit 2026-2028", Tiranë, Tetor 2025

provave vendimtare dhe në rritjen e efikasitetit të ndjekjes penale. Megjithatë, efektiviteti i këtij institucioni është i kushtëzuar nga niveli i mbrojtjes reale që u ofrohet dëshmitarëve, si dhe nga koordinimi ndërinstytucional dhe vullneti politik për zbatimin rigoroz të ligjit.

Në përfundim, mund të konstatohet se lufta kundër krimit të organizuar në Shqipëri nuk mund të jetë e suksesshme pa një qasje të integruar që vendos në qendër mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve të drejtësisë, duke i trajtuar ata jo vetëm si mjete procedurale, por si subjekte me të drejta themelore që kërkojnë mbrojtje afatgjatë dhe rehabilitim të plotë shoqëror.

Në bazë të analizës së kryer, rekomandohet forcimi i kuadrit institucional dhe praktik të mbrojtjes së viktimave dhe dëshmitarëve të drejtësisë përmes masave konkrete dhe të qëndrueshme.

Së pari, është e domosdoshme rritja e kapaciteteve profesionale të strukturave përgjegjëse për mbrojtjen e dëshmitarëve, përfshirë trajnim të specializuar për vlerësimin e riskut, menaxhimin e programeve të mbrojtjes dhe ofrimin e mbështetjes psikologjike dhe sociale.

Së dyti, rekomandohet përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstytucional midis prokurorisë, policisë gjyqësore, gjykatave dhe institucioneve të shërbimeve sociale, me qëllim krijimin e një mekanizmi funksional dhe të koordinuar të mbrojtjes së viktimave të krimit të organizuar. Ky bashkëpunim duhet të shtrihet edhe në nivel ndërkombëtar, përmes nënshkrimit dhe zbatimit të marrëveshjeve për relokimin e dëshmitarëve jashtë vendit në raste me rrezikshmëri të lartë.

Së treti, është e nevojshme forcimi i masave për garantimin e sigurisë fizike dhe psikologjike të dëshmitarëve dhe viktimave, duke siguruar mbrojtje afatgjatë dhe jo vetëm gjatë fazës hetimore ose gjyqësore. Programet e mbrojtjes duhet të shoqërohen me politika të mirëfillta rehabilitimi dhe riintegrimi social, për të shmangur rikthimin e viktimave në ciklin e viktimizimit.

Së fundi, rekomandohet rritja e transparencës institucionale dhe e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, përmes luftës kundër korrupsionit dhe forcimit të shtetit të së drejtës. Vetëm në këtë mënyrë mund të krijohet një mjedis i sigurt dhe inkurajues për viktimat dhe dëshmitarët që të kontribuojnë në proceset penale, duke ndihmuar në mënyrë të qëndrueshme luftën kundër krimit të organizuar në Shqipëri.

Referenca

1. Dobjani, E Drejta Procedurale Penale, Tiranë: Botimet Dudaj, 2019.

2. Council of Europe, Recommendation CM/Rec(2022)9 of the Committee of Ministers to member States on the protection of witnesses and collaborators of justice, 2022.
3. EURALIUS & OPDAT, *Assessment Report on Witness Protection in Albania*, Tirana, 2020.
4. Europol, Serious and Organized Crime Threat Assessment (SOCTA), 2021,
5. Europol, *Trafficking in Human Beings in the EU*, 2022
6. <https://www.unodc.org/unodc/humanrights/areas/organized-crime.html>
7. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, Korrik 2017, Tiranë, neni 58.
8. Ligji nr. 10 173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”
9. Ligji nr. 10173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë,
10. Ministria e Punëve të Brendshme , “Strategjia Kombëtare për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda 2026-2030 dhe Plani i Veprimit 2026-2028”
11. Siegel, Dina. *Criminology of Organized Crime*, 2018
12. United Nations, *Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of power*, 1985
13. UNODC, Global Report on Trafficking in Persons, 2022
14. UNODC, *Good Practices for the Protection of Witnesses in Criminal Proceedings*, Vjenë, 2008
15. UNODC, *Organized Crime and Illicit Markets*, 2020
16. UNODC, *United Nations Convention against Transnational Organized Crime*, 2000

PAVARËSIA E AVOKATISË DHE ROLI I AVOKATIT NË PROCESIN E DREJTË

MSc. Djellza Lena

d.lena@eust.edu.mk

Abstrakt

Ky punim ka për qëllim të shqyrtojë rëndësinë e pavarësisë së avokatisë dhe rolin që avokatët luajnë në garantimin e një procesi të drejtë për çdo qytetar. Avokati është figura që qëndron përballë shtetit dhe institucioneve gjyqësore për të mbrojtur të drejtat e individëve, prandaj puna e tij duhet të jetë e lire nga çdo ndikim politik, ekonomik apo presion institucional. Përmes analizës së situatës aktuale dhe disa standardeve ndërkombëtare, punimi synon të tregojë pse pavarësia e avokatit është thelbësore për sistemin e drejtësisë dhe pse një proces i drejtë varet edhe nga mundësia që avokati të punojë lirshëm, me integritet dhe profesionalizëm.

Fjalë kyçe: *pavarësia e avokatisë, avokati, procesi i drejtë, mbrojtja ligjore, të drejtat e njeriut, sistemi gjyqësor, drejtësi.*

Hyrje

Roli i avokatit në shoqëritë modern është bërë gjithnjë e më i rëndësishëm, sidomos në një kohë kur qytetarët përballen me procedura gjyqësore të ndërlikuara dhe me institucione që kërkojnë profesionalizëm të lartë. Avokati nuk është vetëm përfaqësuesi ligjor i një personi, por edhe garantuesi kryesor i të drejtave të tij, duke u siguruar që procesi gjyqësor të zhvillohet drejt dhe në mënyrë të barabartë. Për këtë arsye, pavarësia e avokatisë përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës. Një avokat që vepron pa presione politike, ekonomike apo institucionale është në gjendje të shërbejë klientit me profesionalizëm dhe integritet, duke siguruar se zëri i tij dëgjohet para gjykatës. Përveç rëndësisë së tij praktike, profesioni i avokatit mbart edhe një dimension etik dhe shoqëror, sepse mënyra se si avokatët ushtrojnë detyrën e tyre reflekton drejtpërdrejtë cilësinë e drejtësisë në një vend. Në shumë raste, avokatët përballen me situata të vështira, ku kërkohet jo vetëm njohuri juridike, por edhe guxim profesional për të mbrojtur interes të klientit përballë institucioneve më të fuqishme. Kjo i bën ata një hallkë të domosdoshme në ruajtjen e balancës mes individit dhe shtetit.

Megjithatë, pavarësia e avokatisë shpesh vihet në prove nga presione të ndryshme, çka e bën të nevojshme analizimin e mekanizmave që garantojnë funksionimin e saj të pavarur. Pikërisht për këtë arsye, studimi i rolit të avokatit dhe i

sfidave me të cilat përballet ky profesion është i rëndësishëm për të kuptuar se sa i sigurt është qytetari kur përballet me sistemin e drejtësisë.

Historia dhe evolucioni i avokatisë

Avokatia si profesion ka kaluar një proces të gjatë evolucioni, duke u formësuar nëpër epoka të ndryshme historike dhe juridike. Që nga shfaqja e parë e nevojës për përfaqësim dhe këshillim ligjor e deri te strukturat e sofistikuar të profesionit sot, figura e avokatit ka qenë gjithmonë e lidhur me konceptin e drejtësisë dhe rendit shoqëror. Në qytetërimet e hershme, njerëzit u gjendën shpesh përballë çështjeve juridike që kërkonin njohuri të specializuara, dhe ngadalë u krijua ideja se disa individë mund të ushtronin këtë rol si profesion më vete. Evolucioni i këtij profesioni lidhet ngushtë me zhvillimin e ligjit, të drejtave të njeriut dhe institucioneve shtetërore.¹ Edhe pse në Athinën klasike nuk ekzistonte avokati si profesion formal, shoqëria greke kishte një sistem gjyqësor të zhvilluar ku aftësia oratorike ishte thelbësore. Qytetarët duhet të mbronin vetveten në gjykatë, por kjo shpesh ishte një detyrë e vështirë-jo çdo qytetar zotëronte njohuri juridike apo aftësi për të ndërtuar argumente të forta retorike. Për këtë arsye u krijua një kategori e re profesionistësh të quajtur logografë, të cilët përpiluan fjalime ligjore për palët që përballëshin me gjykimin.² Logografët trajtoheshin si intelektualë me prestigj: figura të tilla si **Lisia, Isokrati** apo **Antifoni** u bënë të famshëm për mjeshtërinë e tyre në ndërtimin e argumenteve juridike dhe moralizuese. Edhe pse nuk flisnin vetë në gjykatë (sepse ligji ua ndalonte), ata krijonin strukturën e mbrojtjes dhe analizën faktike që klienti duhej të prezantonte. Ky rol e shënon fillimin e diferencimit midis qytetarit të zakonshëm dhe profesionistit juridik. Në greqinë e lashtë u vendosën gjithashtu themelet e etikës juridike. Logografët nuk mund të shkruanin për të dy fjalët në të njëjtin proces, duhej të respektonin rregulla të caktuar të ndershmërsë dhe të kishin kujdes të mos fabrikonin prova. Megjithatë, sistemi grek vazhdoi të mbetej i pafornalizuar dhe nu krijoj një profesion të mirëfilltë avokatie.³

Profesioni i avokatit në Romën e Lashtë

Roma është vendi ku avokatia fillon të marrë formën e sotme. Fillimisht, në periudhën republikane, çdo qytetar mund të paraqitej para gjykatës dhe të

¹ Abel, Richard. *The Legal Profession in the Modern World*. Oxford University Press, 2020.

² MacDowell, Douglas. *The Law in Classical Athens*. Cornell University Press, 2019.

³ Todd, S. *The Shape of Athenian Law*. Oxford University Press, 2020.

përfaqësohej nga miq ose familjarë, por me rritjen e kompleksitetit të së drejtës romake, lindën dy grupe profesionistësh:

- **iuris consulti** –ekspertë të së drejtës që jepnin këshilla juridik pa pagesë,
- **advocati**- persona që shoqëronin palën në gjykatë dhe mbronin çështjen e saj.⁴

Në periudhën e perandorisë, u vendosën rregulla konkrete për profesionin e avokatit. U kërkua arsimimi juridik, u kufizuan tarifat (të cilat u legalizuan nga Perandori Klaudi), dhe u krijuan korporatat e para të avokatëve. Një ndër figurat më të njohura të kësaj periudhe është Qiceroni, i cili konsiderohet modeli i avokatit-orator, mjeshtër i argumentimit dhe mbrojtjes juridike. Ram solli disa prej karakteristikave themelore të profesionit modern: etikën profesionale, rregullat e procedurës gjyqësore, ndarjen e qartë midis juristëve këshillues dhe avokatëve përfaqësues, si dhe konceptin e mbrojtjes së detyrueshme për individët që nuk kishin mundësi të mbronin veten.⁵

Profesioni i avokatit në Mesjetë

Pas rënies së Perandorisë Romake, shumë prej strukturave juridike u shpërbën, por Etika Kanonike dhe e Drejta e Kishës morën një rol të rëndësishëm në ruajtjen e kulturës juridike. Gjatë shekujve XII-XIII, me themelimin e universiteteve të para juridike, sidomos atij të Bolonjës, u krijua për herë të parë arsimiti i organizuar në fushën e jurisprudencës.⁶ Kjo periudhë shënon dy zhvillime themelore:

Profesionalizmi i arsimit juridik- studentët studionin Corpus Juris Civilis dhe të Drejtën Kanonike, duke marrë formim të thelluar teorik

Lindja e avokatëve të specializuar- avokatët që mbronin palët në gjykatat laike ndryshonin nga ata që vepronin në gjykatat kishtarë, të cilët njiheshin si **prokuratorë** apo **advocati ecclesiastici**.

Gjatë mesjetës u krijuan gjithashtu rregullat e para të sjelles profesionale. Avokatët u ndalohej të gënjenin, të mashtronin gjykatën apo të mbronin çështje të pamundura. Gjithashtu, u vendosën rregulla për konfliktin e interesit, mbajtjen e sekretit profesional dhe mbrojtjen e të varfërve.⁷

⁴ Kelly, J. M. *A Short History of Western Legal Theory*. Oxford University Press, 2021

⁵ Riggsby, A. *Roman Law and the Legal World of the Romans*. Cambridge University Press, 2019.

⁶ Bellomo, Manlio. *The Common Legal Past of Europe, 1000–1800*. Catholic University of America Press, 2017.

⁷ Helmholz, R. *The Spirit of Classical Canon Law*. Georgetown University Press, 2018.

Zhvillimi i avokatisë në periudhën moderne

Shekujt XVII-XIX sollën transformim të madh për profesionin. Me krijimin e shteteve moderne dhe me kodifikimin e ligjeve, avokatia u bë një profesion i rregulluar nga shteti. Franca, pas Revolucioit të v.1789, miratoi ligje që u riorganizuan dhomat e avokatisë dhe vendosën standarde të qarta etike. Në Angli u krijua sistemi i barristers dhe solicitors, një ndarje e cila vazhdon edhe sot. Profesionin fitoi rëndësi shoqërore të madhe, sepse avokatët u bënë mbrojtës të lirive themelore, garantues të procesit të rregullt dhe pjesë e pandashme e administrimit të drejtësisë. Avokatët e kësaj periudhe filluan të merren jo vetëm me çështje gjyqësore, por edhe me hartimin e kontratave, pronësinë intelektuale dhe shkëmbimet tregtare ndërkombëtare.⁸

Avokatia në epokën bashkëkohore

Në shekullin XX dhe veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore, avokatia mori rol qendror në zhvillimin e shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut. Lindja e organizatave ndërkombëtare si **OKB**, **Këshilli i Europës** dhe **BE** solli një nevojë të madhe për avokatë të specializuar në të drejtën ndërkombëtare, të drejtën e njeriut, të drejtën penale ndërkombëtare e deri te arbitrazhi tregtar. Në shekullin XXI, profesionin i avokatit po transformohet nga teknologjia. Inteligjenca artificiale, sistemet e menaxhimit të dokumenteve, algoritmet e analizës juridike dhe platforma të shërbimeve ligjore po e ndryshojnë rrënjësisht mënyrën e punës. Megjithatë, edhe në këtë realitet të ri dixhital, roli njerëzor i avokatit mbetet i pazëvendësueshëm: ai siguron ndërgjegje profesionale, interpretim të nuancave etike dhe mbrojtje të kauzave që shkojnë përtej logjikës teknike.⁹

Përkufizimi i avokatisë

Avokati përkufizohet si një profesionist i fushës juridike, i pajisur me arsimim të posaçëm dhe i licencuar për të ofruar këshillim ligjor, përfaqësim dhe mbrojtje juridike për individët dhe subjektet juridike përballë organeve shtetërore dhe palëve të tjera. Ai vepron në emër dhe për llogari të klientit, duke përdorur njohuritë e tij ligjore për të mbrojtur interesat dhe të drejtat e tij në përputhje me ligjin. Përkufizimi i avokatit nuk lidhet vetëm me aspektin teknik të zbatimit të normave juridike, por edhe me përgjegjësinë për të garantuar respektimin e parimeve themelore të drejtësisë, si ligjshmëria, barazia dhe procesi i rregullt ligjor.¹⁰ Avokati konsiderohet një

⁸ Sugarman, David. *Legal Profession and the State: Historical Perspectives*. Cambridge University Press, 2018

⁹ Susskind, Richard. *Tomorrow's Lawyers*. Oxford University Press, 2023.

¹⁰ Black, H. *Black's Law Dictionary*. Thomson Reuters, 2019.

profesion i lirë, por njëkohësisht i rregulluar, pasi ushtrimi i tij i nënshtrohet kriterëve të caktuara ligjore dhe etike. Për të ushtruar profesionin, avokati duhet të plotësojë kushte të caktuara arsimore, profesionale dhe morale, si dhe të jetë anëtar i dhomës përkatëse të avokatisë. Kjo strukturë synon të garantojë cilësinë e shërbimeve ligjore dhe të mbrojtë interesin publik. Në këtë kuptim, avokati nuk është vetëm shërbyes i klientit, por edhe pjesë e sistemit të drejtësisë, me detyrimin për të kontribuar në funksionimin korrekt të tij.¹¹ Në literaturën juridike shqiptare, avokati përkufizohet si subjekt i pavarur i drejtësisë, i cili ushtron veprimtari profesionale në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky përkufizim thekson pavarësinë e avokatit nga pushteti shtetëror dhe nga çdo ndikim i jashtëm që mund të cenojë objektivitetin e tij. Pavarësia profesionale shihet si kusht thelbësor për garantimin e një mbrojtjeje efektive dhe për ruajtjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë.¹² Avokati ka gjithashtu detyrimin të veprojë në përputhje me normat etike dhe profesionale, duke ruajtur sekretin profesional, duke shmangur konfliktin e interesit dhe duke ushtruar profesionin me ndershmëri dhe integritet. Këto detyrime nuk burojnë vetëm nga ligji, por edhe nga tradita juridike dhe standardet ndërkombëtare të profesionit. Në këtë aspekt, përkufizimi i avokatit përfshin jo vetëm funksionin e tij juridik, por edhe dimensionin moral dhe etik të veprimtarisë së tij.¹³ Në një kuptim më të gjerë, avokati është ura lidhëse midis qytetarit dhe ligjit. Ai ndihmon individin të kuptojë të drejtat dhe detyrimet e tij dhe siguron që ligji të mos mbetet një instrument abstrakt, por të zbatohet realisht në praktikë. Për këtë arsye, përkufizimi i avokatit nuk mund të kufizohet vetëm në aspektin procedural, por duhet të shihet si një figurë kyçe në mbrojtjen e shtetit të së drejtës dhe demokracisë.¹⁴

Pavarësia e avokatisë

Pavarësia profesionale e avokatisë nënkupton aftësinë dhe të drejtën e avokatit për të ushtruar profesionin e tij në mënyrë të lirë, të pavarur dhe të pandikuar nga presione të jashtme, qoftë ato politike, ekonomike apo institucionale. Kjo pavarësi është një nga parakushtet themelore për garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të klientit dhe për zhvillimin e një procesi të drejtë gjyqësor. Avokati duhet të jetë i lirë në formimin e mendimit juridik, në zgjedhjen e strategjisë së mbrojtjes dhe në paraqitjen e argumenteve para gjykatës, pa frikën e ndëshkimit apo pasojave të padrejta për shkak të ushtrimit të profesionit të tij. Pavarësia profesionale nuk

¹¹ Bozo, A. **E Drejta e Avokatisë**. Tiranë: Botimet Dudaj, 2016.

¹² Omari, L. **Shteti i së Drejtës**. Tiranë: Botimet Toena, 2014.

¹³ International Bar Association. *Standards for the Independence of the Legal Profession*. London, 1990.

¹⁴ Dobjani, E. **Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut**. Tiranë: Botimet Toena, 2018.

diplomatike të shqiptarëve nuk merreshin në konsiderat nga qeverit maqedonase të tranzicionit politik të pas shpalljes së pavarësisë të Maqedonisë nga ish federata Jugosllave.

Periudha e Ohrit (2001–2010) Faza e institucionalizimit të diplomacisë shqiptare në MV...

Periudha e konfliktit të pas vitit 2001 e arritur në Marrëveshjen e Ohrit na dëshmon se në këtë fazë kultura diplomatike e shqiptarëve në MV, se fillon të shënoi pikën e transformimit diplomatik. Ku elementet kyçe të rezultateve të arritura janë mesa vijojn:

- Njohja e parimit të përfaqësimit të drejtë.
- Njohja e themelimit dhe zyrtarizimit të Universitetit të Tetovës.
- Vendosja e parimit të "Badenterit", votimi i dyfishtë, në mënyrë që të shmanget majorizimi.
- Rritja e përfaqësimit të shqiptarëve në çdo dikaster, përfshir dhe pozicione të larta shtetërore në qeveri dhe parlament.
- Avancimi i gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare në nivel vendor dhe qëndror.
- Integrimi i shqiptarëve në polici, ushtri dhe administratë.
- Krijimi i elitës së parë diplomatike shqiptare e cila përfaqëson vendin në politikën e jashtëme dhe në diplomaci në arenën ndërkombëtare

Periudha (2010–2025) faza e konsolidimit të kulturës së diplomacisë të shqiptarëve në MV

Kështu, nga viti 2010 e deri sot, vrejtm se kjo periudhë tanimë karakterizohet nga një fazë kur shqiptarët në diplomaci i takojnë botës profesionale. Dëshmi të cilat vijnë përmes konstatimit se,

- Është rritur numri i diplomatëve shqiptarë në ministrinë e jashtme.
- Është shtuar angazhimi i ekspertëve shqiptarë në institucione ndërkombëtare.
- Pjesëmarrja e shqiptarëve në procesin e integritit euro-atlantik është më e lart dhe profesionale.
- Ka ndodhur aktivizimi i diasporës shqiptare si aktor i diplomacisë publike.

Pra, që nga viti 1991, kur shteti i ri kërkonte të gjejë balancat e brendshme dhe orientimin e tij ndërkombëtar, shqiptarët u gjendën para detyrës së madhe për të afirmuar të drejtat kolektive. Për të mbrojtur identitetin e tyre dhe për të kërkuar një rol proporcional në institucionet publike. Diplomacia e tyre e asaj kohe nuk kishte mjetet e sofistikuar që shohim sot. Ajo ishte një diplomaci e artikulimit të kërkesave legjitime, e komunikimit me faktorët ndërkombëtarë dhe e qëndrueshmërisë politike në kushte të vështira. Në këtë periudhë, kultura diplomatike shqiptare u formua si formë e durimit, argumentimit dhe këmbënguljes demokratike. Pas vitit 2001 Marrëveshja e Ohrit përbën pikën më të rëndësishme të transformimit diplomatik të shqiptarëve. Përmes saj, u krijuan mekanizma të rinj institucionalë që ndryshuan jo vetëm strukturën e shtetit, por edhe rolin e shqiptarëve brenda tij. Përfaqësimi i drejtë, përdorimi i gjuhës shqipe, integrimi në sektorët e sigurisë dhe hapja e institucioneve u bënë bazë për ngritjen e një kulture diplomatike reale, të ndërthurura me përgjegjësi shtetformuese. Si epilog, konstatojm se në këto 35 vite, që nga koha e pavarësisë e deri sot, se shqiptarët në aktivitetin e tyre diplomatik kanë kaluar nga faza ku ishin palë kërkuese, duke u shndërruar sot në kontribues aktivë në proceset e stabilizimit dhe reformimit të vendit. Që do të thotë se në dy dekadat e fundit, qasja diplomatike e shqiptarëve në MV, ka marrë dimensione të reja. Ku, sot shqiptarët janë bërë pjesë e pandashme e orientimit euro-atlantik të shtetit, duke kontribuar në anëtarësimin në NATO, dhe aktualisht në përgatitjen për negociatat me Bashkimin Evropian dhe në krijimin e një klime konstruktive ndër-etnike. Kështu, në diplomacinë e jashtme, në akademi, në organizata ndërkombëtare dhe në strukturat e administratës publike, kuadrot shqiptare kanë filluar të përfaqësojnë jo vetëm komunitetin e tyre, por edhe vetë shtetin. Pra, kjo rritje profesionale përbën një tregues të maturimit të kulturës diplomatike të shqiptarëve në MV. Gjithashtu, një dimension i rëndësishëm, që shpesh vlerësohet pak në analizat klasike, është edhe roli i diasporës shqiptare. E cila ka shërbyer si urë komunikimi, si promotor i imazhit pozitiv të shqiptarëve dhe si forcë e heshtur diplomatike që ka kontribuar përmes lobimit në bashkëpunimin e marrdhënjeve ndërkombëtare. Ky ndikimi ka qenë i pranishëm në Selinë e Kombeve të Bashkuara, në qendrat evropiane të diplomacisë dhe në mjediset ku krijohen politikat globale.

Megjithatë, sfidat për një të ardhme të sigurt ende mbeten objektiv i diplomacisë të shqiptarëve në MV. Të cilët vazhdojnë të përballen me nevojën përfaqësimit etnik në qeveri, që nënkupton, partia shqiptare që fiton më së shumti vota të shqiptarëve ka legjitimitetin politik dhe moral për të përfaqësuar shqiptarët në qeveri dhe për të marrë rolin udhëheqës në përfaqësimin e interesave të tyre. Me përfaqësim më të drejtë dhe të thelluar në diplomacinë e jashtme. Me çështjen e

zbatimit të barabartë të ligjit për gjuhën shqipe, të përfaqësimit në punësim dhe emrime, si dhe të një decentralizimi fiskal për të patur një autonomi më të zgjeruar në vendimmarrjen e pushtetit lokal. Realizime të domosdoshme, për të ndërtuar një unitet politik mes komuniteteve që jetojnë në këtë vend. Të arritura të cilat do krijonin paqe , qëndrueshmëri dhe perspektivë afatgjate. Sfidat të cilat nuk do bëjnë por forcojnë shtetndërtimin e vendit e të cilat nuk duhet të merren si pengesa, por si një thirrje për një angazhim të ri strategjik.

Përfundime

Kështu, sot kultura diplomatike e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut nuk matet vetëm me numrin e përfaqësuesve në institucione apo me raportet ndëretnike por ajo matet edhe me vizionin e tyre për shtetin, me kontributin ndaj paqes, të integritetit si dhe aftësisë për të ushtruar diplomaci të qetë, konstruktive dhe të përgjegjshme. Në këtë kuptim, shqiptarët e Maqedonisë së Veriut nuk janë vetëm subjekt i kulturës diplomatike, por ata janë edhe aktorë të rëndësishëm dhe të domosdoshëm në këtë shtet. Ku, me konsolidimin e elitave të reja diplomatike dhe zbatimin e standardeve demokratike, roli i shqiptarëve në diplomacinë e vendit do të mbetet thelbësor për të ardhmen euro-atlantike të Maqedonisë së Veriut.

DIGJITALIZIMI I ADMINISTRATËS TATIMORE DHE NDIKIMI I TIJ NË ZVOGËLIMIN E EKONOMISË GRI

PhD Cand. Arbana Selimi Sadiku

Abstrakt

Ky punim trajton digjitalizimin e administratës tatimore dhe ndikimin e tij në zvogëlimin e ekonomisë gri. Qëllimi kryesor është të analizojë se si përdorimi i teknologjive digjitale në proceset tatimore ndikon në rritjen e transparencës, përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave dhe uljen e evazionit fiskal. Studimi fokusohet në instrumente si sistemet e e-tatimeve, e-faturimi, raportimi në kohë reale dhe shkëmbimi elektronik i të dhënave ndërmjet institucioneve. Metodologjia bazohet në analizë krahasuese dhe shqyrtim të të dhënave empirike nga vende të Bashkimit Evropian dhe shtete të rajonit, me theks të veçantë në administratat tatimore të tranzicionit. Rezultatet tregojnë se digjitalizimi rrit gjurmueshmërinë e transaksioneve ekonomike, kufizon hapësirat për informalitet dhe përmirëson disiplinën tatimore. Në të njëjtën kohë, theksohet se efekti i tij varet nga kuadri ligjor, kapacitetet institucionale dhe niveli i besimit të tatimpaguesve në administratë. Punimi përfundon se digjitalizimi paraqet një mjet kyç për luftimin e ekonomisë gri, por efektiviteti i tij maksimal arrihet vetëm kur shoqërohet me reforma institucionale dhe masa të qëndrueshme fiskale.

Fjalet kyce: *digitalizimi, administrate tatiimore, ekonomia gri, transparenca*

Hyrje

Ekonomia gri paraqet një nga sfidat kryesore për sistemet tatimore bashkëkohore, veçanërisht në vendet në zhvillim dhe ato në tranzicion. Pavarësisht reformave të vazhdueshme fiskale, niveli i lartë i informalitetit vazhdon të ndikojë negativisht në të ardhurat publike, konkurrencën e ndershme dhe besimin e qytetarëve në institucionet shtetërore. Në këtë kontekst, administratat tatimore përballen me nevojën për të gjetur mekanizma më efikase për përmirësimin e kontrollit dhe rritjen e pajtueshmërisë tatimore.

Një nga qasjet më të rëndësishme në dekadën e fundit është digjitalizimi i proceseve tatimore. Përdorimi i sistemeve elektronike për deklarim, pagesë dhe raportim të detyrimeve tatimore ka ndryshuar ndjeshëm mënyrën e funksionimit të administratës tatimore dhe marrëdhënien e saj me tatimpaguesit. Instrumente si e-

tatimet, e-faturimi dhe raportimi në kohë reale kanë rritur transparencën dhe kanë mundësuar gjurmueshmëri më të lartë të transaksioneve ekonomike, duke reduktuar hapësirat për evazion fiskal.

Megjithatë, ndikimi i digjitalizimit në zvogëlimin e ekonomisë gri nuk është automatik dhe as i njëtrajshëm. Efektiviteti i tij varet nga kuadri ligjor, kapacitetet institucionale, niveli i zhvillimit teknologjik dhe gatishmëria e tatimpaguesve për bashkëpunim. Për këtë arsye, nevojitet një analizë më e thelluar e lidhjes ndërmjet digjitalizimit të administratës tatimore dhe formalizimit të aktivitetit ekonomik.

Ky punim synon të analizojë ndikimin e digjitalizimit të administratës tatimore në zvogëlimin e ekonomisë gri, përmes shqyrtimit të instrumenteve kryesore digjitale dhe përvojave të vendeve të Bashkimit Evropian dhe të rajonit të Ballkanit. Studimi kontribuon në literaturën ekzistuese duke ofruar një vlerësim të rolit të digjitalizimit si mjet për rritjen e disiplinës tatimore dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.

Nocioni ekonomia gri dhe pasojat e shfaqjes së saj

Tatimet kanë rëndësi të madhe për funksionimin e ekonomisë, sepse përmes tyre shteti siguron të ardhurat që i nevojiten për shërbime publike dhe investime zhvillimore. Ato krijojnë stabilitet financiar, mundësojnë mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe mbështesin sektorë si arsimi dhe shëndetësia, etj.

Ekonomia gri, pra ekonomia informale, është një fenomen i caktuar i aktivitetit ekonomik që nuk është i regjistruar në sistemin përkatës të vendit. Zakonisht ka dy shembuj të një situate të tillë: Subjekti ekonomik e fsheh pjesërisht ose plotësisht aktivitetin e tij ekonomik dhe sw dyti është kur punëdhënësi punëson dikë, por nuk deklaron.

Për dallim nga subjektet në ekonominë formale, subjektet në ekonominë gri nuk marrin pjesë në financimin e nevojave të përbashkëta, d.m.th. ato nuk janë burim i të ardhurave publike, por nga ana tjetër ato shfrytëzojnë të mira publike (infrastrukturë) dhe shërbime tjera pa asnjë kufizim.

Justifikimi për ekonomin gri me argumente të supozuara për zbutjen e dallimeve sociale është i gabuar. Ekonomia gri është një kërcënim i drejtpërdrejtë dhe konkret për sistemin ekonomik të vendit dhe prodhon pasoja të thella dhe komplekse, të cilat ndihen nga brezat e tanishëm, por në mënyrë të pashmangshme do të ndikojnë edhe në brezat e ardhshëm.

Pasojat e veprimt të një ekonomie gri janë të shumta, siç janë:

- e minon sundimin e ligjit,
- ndikon negativisht në gjendjen financiare të kompanive që veprojnë në përputhje me ligjet;
- kufizon rritjen ekonomike,
- shtrembëron konkurrencën në tregut dhe i vendos konkurrencë të pabarabartë në treg,
- i dëmton financat publike, buxhetin e shtetit dhe fondet sociale,
- mbart me vete një rrezik real të riformësimit të shoqërisë sipas nevojave të bartësve të ekonomisë gri.

Madhësia e "sektorit gri" në ekonominë e R.M.Veriore

Vlerësimet më të fundit zyrtare të madhësisë së ekonomisë gri varrojnë nga 17% e PBB-së së vendit, deri në 33.4% në një vlerësim i prodhuar nga Zyra Shtetërore e Statistikave. Ndërsa diapazoni i gjerë i vlerësimeve (nga 17% në 33.2% të PBB-së) mund të mos jetë i pazakontë, ai megjithatë krijon njëfarë konfuzioni në lidhje me madhësinë e problemit, implikimet e tij socio-ekonomike dhe zgjidhjet politiko-ekonomike.

Do të paraqesim një përmbledhje vlerësimi si % e PBB për ekonominë gri / informale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2020–2024, shifrat ndryshojnë varësisht metodologjisë së përllogaritjes (LIM/LFS, DGE, MIMIC, etj.), ndaj do të japim një vlerë-interval.

Viti	Vlerë (si % e PBB) — vlerësim / interval	Burimi kryesor (metodologjia)
2020	23.2% – 32.7% (interval: 23.2% sipas analizave mikro-të dhënieve; 32.7% sipas modelit DGE).	Finance Think (studim mikro/LIM) & The Global Economy (DGE).
2021	~ 24% – 34% (vlerë tipike në literaturë për periudhën 2020–21; ndryshon sipas metodave MIMIC/DGE/LIM).	Studime MIMIC/DGE dhe analiza vendore (literaturë për 2006–2021).
2022	~ 23.2% (vlerë mikro-bazuar, përdorur LFS/SILC dhe metoda konsum/lim në raportet vendore).	Finance Think / ILO (analiza 2022)
2023	~ 23% – 30% (tendencë e qëndrueshme rreth 23% sipas analizave mikro;	Finance Think; Ministria e Financave (përmbledhje

	institucione shtetërore përmendin edhe vlerë më të lartë historike ~30% që përfshin aktivitete më të vështira për t'u matur).	politikash dhe vlerësime historike).
2024	~22% – 33.2% (nuk ka konsensus i vetëm për 2024; dokumentet strategjike të vitit 2023–2024 ripohuan vlera të ndryshme dhe synime formalizimi).	Strategjia Kombëtare / dokumente politike (NDS & ERP) dhe literatura akademike deri 2023–24.

Burimet: Finance Think (studime mikro, 2023/2024), punimet MIMIC/DGE (CESifo/Schneider et al.), dhe Ministria e Financave.

Sipas Dhomës së Tregtisë së RMV-së, ekonomia gri është 33.2 %, vitin e kaluar vlente plot 4.2 miliardë euro, ku thesari i shtetit humbi 1.28 miliardë euro në anën e të ardhurave. Në fakt, prej vitesh, situata është komentuar dhe janë diskutuar mënyra për ta kapërcyer atë të paktën pjesërisht. Megjithatë, përfundimi është gjithmonë i njëjtë: për këtë luftë dhe për të arritur sukses të dukshëm, mbi të gjitha nevojitet edhe vullnet politik.

Procesi i transformimi digjital në administratën tatimore

Transformimi digjital i administratës tatimore është një ndër faktorët më të fuqishëm që e zvogëlon ekonominë gri. Administrata e kalon procesin nga modeli tradicional i bazuar në dokumente fizike dhe kontrole manuale në një sistem modern ku të dhënat qarkullojnë në kohë reale dhe proceset kryesore kryhen automatikisht. Ky transformim krijon një ekosistem digjital tatimor që rrit gjurmueshmërinë, ul hapësirat për manipulim dhe e bën më të vështirë fshehjen e aktivitetit ekonomik. Po ashtu ky transformim nuk kufizohet vetëm në aspektin teknik, por ndikon drejtpërdrejt në marrëdhënien ndërmjet administratës tatimore dhe tatimpaguesve.

Procesi i digjitalizimit të administratës tatimore përfshin përdorimin e platformave elektronike për deklarinë dhe pagesën e tatimeve, regjistrimin dhe përpunimin e të dhënave fiskale, si dhe shkëmbimin e informacionit midis institucioneve publike. Qëllimi kryesor është rritja e efikasitetit administrativ dhe përmirësimi i pajtueshmërisë tatimore. Rëndësia e këtij procesi qëndron në aftësinë për të reduktuar gabimet njerëzore, për të standardizuar procedurat dhe për të mundësuar qasje më të lehtë për tatimpaguesit. Në të njëjtën kohë, digjitalizimi ul kostot administrative si për shtetin, ashtu edhe për bizneset, duke krijuar një mjedis


më të favorshëm për formalizmin e aktivitetit ekonomik dhe një herrit ndikon në zvogëlimin e ekonomisë gri.

Në praktikë, digitalizimi i administratës tatimore ka filluar gradualisht dhe jo njëkohësisht kudo. Ai ka nisur në vendet e zhvilluara dhe më pas është përhapur në rajone të tjera. Më poshtë është një tabelë e përmbledhur, ku shihet qartë **ku** dhe **kur** ka filluar implementimi praktik i digitalizimit në administratën tatimore, me fokus në transparencë dhe uljen e ekonomisë gri.

Vendi / Rajoni	Periudha e fillimit	Çfarë u implementua fillimisht	Qëllimi kryesor
SHBA	Vitet 1990	Deklarimi elektronik i tatimeve (e-filing).....	Lehtësim deklarimi, rritje përputhshmërie///
Kanada	Vitet 1990	Deklarim online dhe databaza tatimore....	Efikasitet dhe transparencë///
Suedi	Fund i viteve 1990	Administratë tatimore digjitale, komunikim online.....	Besim dhe barazi tatimore/////
Estonia	2000–2005	Sistem tatimor pothuajse plotësisht digjital....	Transparencë totale, administratë moderne///
Mbretëria e Bashkuar	2000–2010	Deklarime online, analiza e riskut.....	Kontroll më i synuar///
Holanda	2000–2010	Shkëmbim elektronik i të dhënave....	Ulje e evazionit///
Brazili	Nga 2008	Faturimi elektronik dhe raportimi pothuajse në kohë reale....	Luftë direkte kundër ekonomisë gri///
Meksika	2010–2014	E-faturim i detyrueshëm	Formalizim i bizneseve
Kili	2014–2016	Faturim elektronik kombëtar....	Rritje transparence fiskale///
Kroacia	2013	Fiskalizim online i arkave....	Kontroll i qarkullimit///
Shqipëria	2021	Fiskalizim dhe raportim në kohë reale....	Ulje ekonomie gri////
Serbia	2022	Sistemi e-Faktura....	Transparencë B2B dhe B2G///

Maqedonia e Veriut	2015–2020	Deklarime elektronike, e-fatura, rreziku....	Përmirësim përputhshmërie tatimore////
--------------------	-----------	--	--

Në grafikun e më poshtëm do të paraqesim procesin e digjitalizimit të vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve të Ballkanit



Procesi i digjitalizimit tw administratës tatimore në Maqedoni

Në Maqedoni, digjitalizimi tatimor ka pasur fokus fillestar deklarimin dhe pagesën elektronike të tatimeve. Vendosija e sistemeve të e-tatimeve ka reduktuar kontaktin fizik mes tatimpaguesve dhe administratës, duke ulur hapësirat për praktika joformale. Më vonë, vëmendja është përqendruar në llogaria fiskale digjitale dhe raportimin elektronik të qarkullimit, veçanërisht në sektorin e tregtisë dhe shërbimeve. Këto masa kanë përmirësuar ndjeshëm monitorimin e aktiviteteve ekonomike dhe kanë krijuar një bazë më të qëndrueshme të të dhënave fiskale. Megjithatë, sfida mbetet niveli i pazhvilluar i digjitalizimit te një pjesë e bizneseve të vogla dhe përdorimi i vazhdueshëm i parasë së gatshme.

Ndikimi i digjitalizimit të administratës tatimore në luftën kundër informalitetit

Ekonomia gri është një fenomen shumë kompleks dhe fenomen me të cilin po përballemi jo vetëm ne, por edhe vendet me ekonomi më të zhvilluara. Qeverinë e shteteve tw ndryshme përgatisin Plan Veprimi me aktivitete tw ndryshme që synojnë formalizimin e ekonomisë gri. Në këtë luftë njëherazi përfshihen disa institucione, të cilat së bashku, secila brenda kompetencës së saj, përdorin strategji dhe politika të ndryshme për ta zvogëluar atë. Ministria e Financave, Drejtoria e të Ardhurave Publike (DAP) dhe drejtoritë tjera tw varura nga këto duke zbatuar politikën tatimore, synon forcimin e kapaciteteve për mbledhjen e taksave, kontrollet dhe forcimin e moralit tatimor.

Roli i administratës tatimore në zvogëlimin e ekonomisë gri është praktik, jo teorik. Ka të bëjë me mënyrën si mbledh të ardhurat, si kontrollon dhe si silllet me tatimpaguesit. Së pari, formalizon aktivitetet ekonomike, së dyti, rrit probabilitetin e zbulimit, së treti, ul koston e përmbushjes, së katërti, ndikon drejtpërdrejt në sjelljen e tatimpaguesve, së pesti, forcon bashkëpunimin institucional dhe së fundi, zbaton qasje të diferencuar.

Tabela 1. Efektet e transformimit digjital në uljen e ekonomisë gri (vendet e BE dhe rajoni)

Vendi Grup /	Instrument digjital kryesor	Viti zbatimit i	Tregues kryesor	Rezultati i matur i
BE – Mesatarja	e-faturat, raportim online	2014–2022	TVSH Gap	Ulje nga ~11.2% (2018) në ~7.0% (2022)
Itali	Fatura elektronike B2B/B2G	2019	VAT Gap	–3 deri –4 p.p. brenda 3 viteve
Spanjë	SII – raportim i TVSH në kohë reale	2017	Të ardhura TVSH	+1.5–2.0% në vitet pasuese
Portugali	e-fatura lotari fiskale +	2015	Ekonomia informale	–3–4 p.p. e PBB

Kroaci	Fiskalizim online	2013	Të ardhura cash	+6–8% në sektorët me risk
Shqipëri	Fiskalizim & e-fatura	2020–2022	Deklarime tatimore	Rritje e deklarimit dhe e regjistrimeve të bizneseve
Serbi	e-fiskalizim	2022	Formalizimi	Rritje e mbulimit të transaksioneve cash
Maqedoni e Veriut	Arka fiskale, shërbime online	2010–	Ekonomia gri	Ulje graduale, pa efekt të fortë strukturor
Kosovë	e-deklarim, e-pagesa (pjesërisht)	2015–	Pajtueshmëria	Përmirësim modest, efekt i kufizuar

Burimi: Raporte të Komisionit Evropian, OECD, FMN dhe Bankës Botërore

Procesi i digjitalizimit të administratës tatimore ka ndikuar drejtpërdrejt në kufizimin e ekonomisë gri në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë, kryesisht përmes rritjes së transparencës dhe përmirësimit të kontrollit fiskal. Automatizimi i proceseve tatimore ka zvogëluar hapësirat për mosdeklarimit të të ardhurave dhe ka rritur aftësinë e administratave tatimore për të identifikuar aktivitetet informale.

Një ndër efektet më të dukshme është rritja e *gjurmueshmërisë* së transaksioneve ekonomike. Përmes e-faturimit, fiskalizimit digjital dhe raportimit elektronik, transaksionet regjistrohen dhe ruhen në sisteme qendrore, duke e bërë më të vështirë fshehjen e qarkullimit real. Kjo ka ndikuar veçanërisht në sektorët me nivel të lartë të transaksioneve në para të gatshme.

Digjitalizimi ka përmirësuar ndjeshëm transparencën fiskale dhe ka kaluar nga kontrollet selektive dhe pasuese në kontrolle parandaluese. Digjitalizimi ka ndikuar edhe në rritjen e pajtueshmërisë vullnetare tatimore nëpërmjet procedurave më të thjeshtuara elektronike të cilat kanë ulur kostot e përmbushjes së detyrimeve fiskale për bizneset dhe individët.

Por, duhet theksuar se pavarësisht përfitimeve, digjitalizimi nuk i eliminon plotësisht format e ekonomisë gri. Përdorimi i parasë së gatshme, niveli i ndryshëm i

aftësive digjitale dhe rezistenca e një pjese të bizneseve ndaj formalizimit mbeten sfida të rëndësishme. Gjithashtu, efektiviteti i sistemeve digjitale varet nga cilësia e zbatimit dhe mirëmbajtjes së tyre. Në këtë kontekst, digjitalizimi duhet të shoqërohet me masa mbështetëse, përfshirë edukimin fiskal, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e kuadrit ligjor.

Përfundime dhe rekomandime

Analiza e zhvilluar në këtë punim tregon se digjitalizimi i administratës tatimore përbën një mjet të rëndësishëm në zvogëlimin e ekonomisë gri në të gjitha shtetet e vecanërisht në Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë. Përdorimi i sistemeve elektronike për deklarim, pagesa dhe raportimi kanë përmirësuar ndjeshëm transparencën fiskale dhe kanë kufizuar hapësirat për evazion tatimor, veçanërisht në sektorët me nivel të lartë të informalitetit. Rezultatet tregojnë se ndikimi më i madh arrihet në rastet kur digjitalizimi zbatohet në mënyrë të plotë dhe shoqërohet me reforma institucionale mbështetëse. Shqipëria paraqet shembullin me nivel më të lartë të institucionalizimit të proceseve digjitale, ndërsa Maqedonia dhe Kosova tregojnë progres të qëndrueshëm, por ende të pabarabartë.

Në bazë të gjetjeve, rekomandohet forcimi i mëtejshëm i infrastrukturës digjitale tatimore, zgjerimi i përdorimit të e-faturimit dhe raportimit elektronik, si dhe investimi në rritjen e aftësive digjitale të administratës dhe tatimpaguesve. Po ashtu, digjitalizimi duhet të shoqërohet me masa për uljen e përdorimit të parasë së gatshme dhe për rritjen e besimit në institucionet tatimore.

Në përfundim, digjitalizimi i administratës tatimore duhet të shihet jo si një reformë e izoluar teknologjike, por si pjesë integrale e një strategjie më të gjerë për formalizimin e ekonomisë dhe forcimin e qeverisjes fiskale në rajon.

Literatura

1. Administrata Tatimore e Kosovës. (2021). *Raporti Vjetor*. Prishtinë.
2. Alm, J., Martinez-Vazquez, J., & Schneider, F. (2004). 'Sizing' the problem of the hard-to-tax. *Taxing the Hard-to-Tax*. Elsevier.
3. Baum, A., Gupta, S., Kimani, E., & Tapsoba, S. (2017). Digital solutions for revenue mobilization. *IMF Staff Discussion Note*.
4. Bird, R. M., & Zolt, E. M. (2014). Technology and taxation in developing countries. *National Tax Journal*, 67(1), 1–34.
5. Council of Europe. (2019). *Combating the Shadow Economy through Tax Administration Reforms*.

6. Drejtoria e të Ardthurave Publike e Maqedonisë së Veriut. (2020). *Report Vjetor*. Shkup.
7. European Commission. (2017). *The Use of Big Data Analytics in Taxation*. Publications Office of the EU.
8. European Commission. (2018). *Digital Single Market and Tax Administration*. Publications Office of the European Union.
9. European Commission. (2020). *Study and Reports on the VAT Gap in the EU Member States*. Publications Office of the European Union.
10. European Commission. (2022). *VAT Gap in the EU: Report 2022*. Publications Office of the EU.
11. Fjeldstad, O. H., & Moore, M. (2009). Revenue authorities and public authority in sub-Saharan Africa. *Journal of Modern African Studies*,
12. Gërxfhani, K. (2004). The informal sector in developed and less developed countries. *Public Choice*, 120(3–4), 267–300.
13. IMF. (2017). *Estimating the Informal Economy*. International Monetary Fund Working Paper.
14. IMF. (2018). *Digitalization and the Challenges for Tax Administration*. International Monetary Fund.
15. IMF. (2020). *Tax Policy for Inclusive Growth*. International Monetary Fund.
16. IMF. (2021). *Revenue Administration: Managing Complexity in a Digital Economy*. IMF.
17. Joshi, A., Prichard, W., & Heady, C. (2014). Taxing the informal economy. *Journal of International Development*, 26(5), 655–673.
18. Keen, M., & Lockwood, B. (2010). The value added tax: Its causes and consequences. *Journal of Development Economics*, 92(2), 138–151.
19. Kleven, H. J., Kreiner, C. T., & Saez, E. (2016). Why can modern governments tax so much? *Journal of Economic Perspectives*, 30(1), 77–100.
20. Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë. (2021). *Strategjia e Administratës Tatimore dhe Fiskalizimi*. Tiranë.
21. OECD. (2015). *Tax Administration 2015: Comparative Information on OECD and Other Advanced and Emerging Economies*. OECD Publishing.
22. OECD. (2016). *Advanced Analytics for Better Tax Administration*. OECD Publishing.
23. OECD. (2017). *Technology Tools to Tackle Tax Evasion and Tax Fraud*. OECD Publishing.
24. OECD. (2019). *Helping SMEs to Scale Up: Digitalisation and Tax Compliance*. OECD Publishing.

25. OECD. (2020). *Digital Transformation of Tax Administration*. OECD Publishing.
26. OECD. (2021). *Tax Administration 3.0: The Digital Transformation of Tax Administration*. OECD.
27. Regional Cooperation Council. (2020). *Economic Reform Programmes in the Western Balkans*. Sarajevo.
28. Schneider, F. (2021). Size and development of the shadow economy worldwide. *Journal of Economic Surveys*, 35(4), 987–1019.
29. Schneider, F., & Buehn, A. (2018). Shadow economy: Estimation methods, problems, results and open questions. *Open Economics*, 1(1), 1–29.
30. Slemrod, J., & Gillitzer, C. (2014). *Tax Systems*. MIT Press.
31. Ulyssea, G. (2018). Firms, informality, and development. *Journal of Economic Surveys*, 32(3), 837–873.
32. Williams, C. C. (2020). Tackling undeclared work in the informal economy. *Journal of Economic Policy Reform*, 23(2), 119–134.
33. Williams, C. C., & Schneider, F. (2016). *Measuring the Global Shadow Economy*. Edward Elgar Publi.
34. World Bank. (2019). *Innovations in Tax Compliance: Digitalization and Its Impact*. World Bank Group.
35. World Bank. (2020). *Improving Tax Administration in the Western Balkans*. World Bank Group.

ASPEKTE PEDAGOGJIKE NË HISTORIKUN E KITARËS NË SHQIPËRI

PhD Cand. Dashamir Mehmeti

Abstrakt

Instrumenti i Kitarës ka pasur një rrugëtim të veçantë në kulturën e popullit tonë. Fillimisht në qytetin e Korçës e më pas duke u shtrirë në qytetet e tjera të rëndësishme si Elbasani, Fieri, Berati Vlora, Gjirokastra, Lushnja, Durrësi, Tirana, Shkodra, etj. Megjithatë, përhapja dhe procesi didaktik i kitarës ka qenë i ngadaltë, spontan dhe shpesh jashtë dokumentacionit formal. Ky instrument, fillimisht përdorej në shoqërimin e këngëve solo apo në grup e më pas në ansamblet e muzikës së dëfrimit. Në këto zhvillime vërejmë se, kryesisht pas Luftës së dytë botërore dalin disa figura të spikatura si instrumentistë në kitarë, pedagogë e më pas edhe si kompozitorë të pjesëve të vogla apo të mesme për këtë instrument. Disa prej tyre janë Mehdi Prodani, Alfons Balliçi, Edison Miso Redi Marku etj. Fillimisht këta instrumentistë të shquar u bënë dhe kompozitorët e parë të pjesëve dhe krijimit të repertorit për këtë instrument, duke u pasuar nga kompozitorë të tjerë kryesisht në Kosovë të cilët ishin figura të kristalizuara të krijimtarisë muzikore, siç është rasti i Rafet Rudit. Në Shqipëri, aty nga vitet 80', nisin dhe përpjekjet me protagonist kitaristin Edison Miso për hapjen e klasave speciale të kitarës në Liceun Artistik të Tiranës e më pas edhe në qytete të tjera, fakt ky, që përbën një fazë të rëndësishme zhvilluese për vendosjen në shina profesionale të mësimit të instrumentit në vend. Padyshim duke u rritur institucionet arsimore më pas u promovuan disa festival kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ushtrimi i shumë kurseve ka nxjerrë shumë kitaristë klasikë por dhe të fushave të ndryshme si ata të muzikës modern bashkohore.

Fjalë kyçe: *instrument, kitarë, histori, pedagogji.*

Hyrje

Mendohet se kitara në vendin tonë të ketë hyrë në mesin e shek XIX përmes kontakteve me kulturën greke, rumune dhe italiane. Në këtë periudhë vërehen shtime të konsiderueshme tregtare me shtetet kufitare e përmes këtyre shkëmbimeve të jenë krijuar dhe kontakter e para me njohjen e më pas mësimin e përdorimin e këtij instrumenti. Shtimi i të rinjve që nisën të studionin në perëndim afro njohjen me instrumentin e kitarës, por dhe shtimi i misionarëve të kishës katolike qe një faktor tjetër për njohjen e instrumentit në kulturën muzikore të qyteteve të mëdha të kohës.

Një faktor të rëndësishëm konstatojmë tek kontaktet me arbëreshët të cilët e kishin përvetësuar instrumentin brenda kulturës së tyre. Me rritjen e ndjenjave kombëtare në fund të shek XIX ka informacione se muzikantë të ndryshëm nga arbëreshët e Italisë afrohen me vendin e origjinës. Megjithëse kontaktet tregtare ishin më të rëndësishme dhe më të mëdha në qytetin e Durrësit, Vlorës dhe Shkodrës në Korçë instrumenti i kitarës pati lulëzimin e tij në relacion me nivelin kulturor të kohës në vendin tonë. Mandolina dhe kitara ishin instrumentet e dashura të artistëve korçarë me të cilat shoqëronin këngët patriotike e më pas edhe këngët e dashurisë. Pikërisht këto këngë, që morën hov si pjesë e punës së palodhur të patriotëve shqiptarë si dhe influencës së kulturës së vendeve kufitare erdhën dhe u bënë pjesë e rëndësishme e kulturës dhe modës së këtij qyteti. Sigurisht mandolina si një instrument më i vogël në përmasa dhe më praktik ishte pararendëse në muzikën korçare, por dhe kitara luante një rol të rëndësishëm. Ajo mësohej në mënyrë autodidakte, inspiruar nga pasionet personale të të rinjve të talentuar.

Duke përshkruar këngët dhe muzikën tradicionale të Korçës studiuesi Eno Koço shkruan:

Me zhvillimin e mëtejshëm dhe me krijimin e shtresës së intelektualëve, në qytetin e Korçës filloi të rritej dhe kërkesa cilësore ndaj muzikës qytetare. Kjo u bë e mundur veçanërisht pas hapjes së gjimnazit grek (më 1956) ku vinin edhe mësues të huaj, sidomos grek nga Athina. Këta filluan veç të tjerave të sjellin edhe muzikën e Evropës dhe sidomos shumë [ë] këngë të bukura të tipit qefalonika të cilat në gjuhën e asaj kohe quheshin kantadha Kjo meqënë[se ky ishull (ishulli i Qefalonisë në detin Jon) pat qenë me vite të tëra nën zotërimin venecian dhe kultura greke u përzie mjaft

me atë italiane. Në këtë periudhë filluan të hyjnë edhe instrumente të tjera muzikore si mandolina, kitara, flauta etj. (Ballauri 1994)¹

Në fillim të shek XX ka të dhëna se kitara mandolina dhe klarineta përbënin organikën e grupeve muzikore qytetare në këtë qytet. Në këtë rast kitara mbante bazën harmonike të këngëve dhe ritmin e tyre.

Në Historinë e Muzikës Shqiptare të autorit Prof. Asc. Nestor Kraja ku trajtohet kënga lirike qytetare shkruhet:

Në qytetin e Korçës, në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX serenatat korçare, si shprehje e një vizioni kozmopolit të qytetit, kishin filluar të shfaqeshin si versione të reja të këngës qytetare me ndikime nga këngët qytetare të rrethinave (Kosturi, Ohri, Leskoviku) këngëve të disa qyteteve greke, të emigrantëve në Rumani e Bullgari, por dhe këngëve kontinentale (Italiane)².

Pra, pas zhvillimeve të këngës patriotike në vitet 20 – 40 zhvillimet e këngës qytetare shfaqen të dukshme në këtë qytet dhe në këtë atmosferë kitara dhe mësimi i saj pati rolin të dukshëm. Ka të dhëna se shumë artistë që erdhën në Korçë me Bandën Vatra³ luanin në kitarë dhe nisën të jepnin mësim në këtë instrument. Korçarët thonë; *Në çdo shtëpi Korçare ka një kitarë.*

Me rritjen e influencës politike, tregtare dhe sidomos kulturore me Italinë në vitet 30' nisën të shtohen ansamblet e muzikës dëfryese të cilat filluan të ndjekin modën e grupeve muzikore të lokaleve perëndimore. Në këto grupe shpesh ishte prezent dhe instrumenti i kitarës. Megjithatë në këtë rrafsh nivelin ishte amator dhe autodidakt.

Kitara në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore

Pas Luftës së II Botërore u krijuan premiset për zhvillime të rëndësishme në të gjitha fushat, si dhe për muzikën. Por, në këtë tablo roli dhe vendi i kitarës, në dekatat e para mbeti gjithnjë në nivelin amatoresk dhe si pjesë e muzikës dëfryese. Në

¹ Shiko Eno Koço “ Bota Muzikore Shqiptare Traditë dhe individualitete” Kristalina BH Tiranë 2019. Faqe 206

² Historia e Muzikës Shqiptare. Boptimet Morava

³ **Banda Vatra** si orkestra frymore e Federatës “Vatra” të shqiptarëve të Amerikës, e krijuar në SHBA në vitin 1917 erdhi në Shqipëri në vitin 1920. Ajo drejtohej nga muzikanti profesionist Thoma Nasi.

vitet 50' dalin dhe figurat e para të kitaristëve të shquar midis të cilëve ishte kitaristi dhe muzikanti Mehdi Prodani.

Konteksti historik dhe politik në të cilin u zhvillua muzika shqiptare në këtë gjysmë të dytë të shekullit XX është thelbësor për të kuptuar përveç vështirësive strukturore me të cilat u përball arti muzikor dhe artistët, por, ndër të tjera edhe mënyrat e shumta të rezistencës estetike. Në këtë sfond, jeta dhe vepra e Mehdi Prodanit paraqesin një rast studimi me vlera të veçanta, ku muzika shndërrohet në formë dinjiteti personal dhe artistik, përballë diktatit politik.

Në rastin e temës që kemi marrë përsipër të shtjellojmë figura e Mehdi Prodanit zë një vend të veçantë në historinë e muzikës shqiptare jo vetëm për shkak të kontributit të tij si kitarist, mësues dhe kompozitor, por edhe për faktin se ai përfaqëson një nga shembujt më domethënës të përplasjes midis artit individual dhe diktatit ideologjik të një regjimi totalitar. Ky kapitull shqyrton rrjedhën e jetës së tij, që nga fëmijëria e hershme në Berat, edukimi muzikor, karriera si mësues i kitarës e interpretues, dhe pasojat e rënda të përndjekjes politike mbi jetën dhe krijimtarinë e tij.

Mehdi Prodani

Mehdi Prodani, ishte vëllai i kompozitorit Agim Prodani (1911 – 1986), lindi më 9 mars 1929 në qytetin e Beratit, një nga qendrat historike dhe kulturore të Shqipërisë. Familja e tij ishte me prirje artistike – një faktor që ndikoi ndjeshëm në orientimin e tij drejt muzikës. Që në moshë të vogël, ai u shqua për talentin në instrumentet me tela, në veçanti në kitarë, një instrument jo i zakonshëm në kulturën muzikore shqiptare të kohës.

Formimi i tij muzikor u krye në mënyrë autodidakte në fillim, dhe më pas përmes kontakteve me pedagogë të njohur, përfshirë muzikantë italianë dhe shqiptarë që kishin studiuar jashtë vendit. Kjo i dha atij një qasje më të gjerë ndaj stilistikës muzikore perëndimore, sidomos ndaj muzikës klasike dhe romantike, që e veçon nga shumica e kolegëve të tij të kohës.

Në vitet '50 dhe '60, Mehdi Prodani ishte i angazhuar intensivisht në jetën kulturore të qytetit të Durrësit dhe më vonë të Tiranës. Ai dha mësim kitarë për një brez të tërë të rinjsh dhe ndihmoi në futjen e kitarës në repertorin më të gjerë shkollor

dhe amator të vendit. Ndër nxënësit e tij më të njohur është këngëtarja Vaçe Zela⁴, e cila e ka përmendur shpesh Prodanin si ndikim formues në fillimet e saj artistike.

Aktiviteti i tij si interpretues përfshinte koncerte të karakterit intim, në ambiente kulturore lokale, shpesh jashtë vëmendjes së institucioneve zyrtare. Në veprimtarinë e tij spikaste një stil interpretimi i ngrohtë, teknikisht i përpunuar dhe shpirtërisht i ngarkuar, që shpesh evokonte ndjeshmëri lirike dhe meditative.

Në vitin 1976, Mehdi Prodani u arrestua nga autoritetet e regjimit komunist, me akuzën zyrtare të “agjitacionit dhe propagandës kundër pushtetit popullor”. Në realitet, arsyeja e vërtetë ishte lidhja e tij sentimentale me një vajzë të familjes së një të arratisuri politik – një veprim që regjimi e konsideronte si shkelje të rëndë ideologjike. Në një artikull të NTV Televizion shkruhet:

“... artistit të madh iu thye zemra dhe karriera, sepse u dashurua me vajzën e gabuar...”

Mehdi Prodani ‘bashkoi zemrën’ me vajzën e një të arratisuri dhe që kur ishte në kulmin e moshës krijimtarisë muzikore, u përjashtua nga Radio-Tirana.”

Ai u dënua me 7 vjet burg, të cilat i vuajti në kushte të rënda, çka la pasoja të mëdha në shëndetin dhe jetën e tij artistike. Pas daljes nga burgu, nuk iu lejua më të performonte publikisht apo të kontribuonte në institucionet kulturore. Ky përjashtim i heshtur e zhveshi nga identiteti i tij profesional, por jo nga ai shpirtëror.

Pas rënies së regjimit komunist, Mehdi Prodani rifilloi të kompozonte dhe të dokumentonte krijimtarinë e tij, ndonëse në një mjedis tashmë të ndryshuar, me pak mbështetje institucionale. Një nga veprat e tij më të njohura, “12 vallëzime pa një të shtunë”, mbart një dimension metaforik të thellë: “vallëzimet” si simbol i jetës dhe lirisë së ndërprerë – “pa një të shtunë” si metaforë e mungesës së gëzimit dhe lirisë personale në diktaturë.

Para se të ndahej nga jeta në vitin 2020, ai po përgatiste një album dhe një koncert recital që do të përmbledhte krijimtarinë e tij të vonshme – një përpjekje për t’u rikthyer në skenën që i ishte mohuar për dekada.

⁴ Shiko Revista Kult plus, tetor 2020 me rastin e vdekjes së autorit.

Kështu, biografia e Mehdi Prodanit është paradigmë e përplasjes midis talentit artistik dhe shtypjes sistematike politike. Formimi i tij, aktiviteti interpretues dhe pedagogjik, persekutimi dhe rikthimi i vonë në krijimtari e vendosin atë në qendër të një debati më të gjerë mbi rolin e muzikantit në shoqëri: a është ai thjesht interpretues i estetikës, apo edhe bartës i identitetit kulturor dhe shpirtëror të një kombi?

Krijimtaria

Krijimtaria e Mehdi Prodanit është e kufizuar në sasi, por e gjerë në përmbajtje dhe e veçantë. Përmes veprave të tij për kitarë, ai shpalos një vokacion artistik që sfidon uniformitetin ideologjik dhe konvencionet akademike të kohës. Në këto rradhe synojmë të analizojmë aspektet muzikore të përzgjedhura nga veprat e tij, me fokus të veçantë në ciklin “12 vallëzime pa një të shtunë”, si një rast paradigme.

Stili i Prodanit mund të karakterizohet nga disa elementë themelorë: 1 - Ekspresivitet intim: I mbarsur dhe i prirur në njohjen e muzikës italiane e në përgjithësi perëndimore ai çmonte pikërisht sensibilitetin si shprehje e rëndësishme estetike. Muzika e tij është e thjeshtë në formë, por e ngarkuar emocionalisht. Por, ky vokacion për muzikën italiane e perëndimore gërshetohet me veçoritë e muzikës popullore shqiptare me të cilën ai u rrit. Kjo shprehet kryesisht në përdorimin e strukturave modale dhe kornizave lirike që krijojnë një atmosferë kontemplative.

2- Përdorimi i teknikave të klasës europiane: Veçanërisht ndikimi i shkollës italiane të kitarës (Mauro Giuliani, Ferdinando Carulli), si dhe asaj spanjolle (Francisco Tarrega) është i dukshëm në trajtimin e frazës dhe përdorimin e harmonive diatonike dhe kromatike të balancuara.

3- Inkorporimi i motiveve popullore shqiptare në mënyrë sinkretike pra, jo të drejtpërdrejtë — përmes përdorimit të ritmeve të ngadalta, strukturave pentatonike ose kadencave të njohura nga kënga tradicionale.

Analiza formale e veprës “12 vallëzime pa një të shtunë”

Ky cikël, kompozuar pas viteve ‘90, është më shumë se një grup pjesësh për kitarë — është një testament shpirtëror. Ai përmban 12 pjesë të shkurtra, secila me karakter të ndryshëm, që mund të interpretohen si reflektime mbi mungesën, pritjen, heshtjen, kujtimin dhe rikthimin.

Cikli është ndarë në tri pjesë të brendshme: Zgjimi, Pritja, dhe Humbja (emra të vendosur nga interpretuesit, pasi autori nuk i titulloi ndaras). Secila pjesë ka një formë të thjeshtë A–B–A’ ose A–A’–B–C (forma të lirshme rapsodike).

Në pjesët përbërëse autori përdor tonalitete të qarta (Re minor, La minor, Mi minor), por me devijime modale dhe ndonjëherë harmoni të të mbivendosura.

Kadencia e plagalit është përdorur shpesh, për të krijuar ndjesi përmbylljeje të paqarta ose të hapura (si tek lutjet kishtare). Vallëzimet janë ironike në titull — ritmet janë të ngadalta, me sinkopa të shpeshta dhe pauza dramatike. Përdorimi i metrikës 5/8 ose 7/8 në disa pjesë rikujton format tradicionale shqiptare të vallëzimit, por pa dinamizmin e zakonshëm të tyre.

Teknika interpretative kërkon përdorimin e tremolos, harmonikave të natyrshme, dhe pizzicato-s së majtë, gjë që tregon ndikim nga kitaristët spanjollë dhe format impresioniste. Kjo teknikë sugjeron një kërkim timbrik, jo thjesht virtuoz, por ekspresiv e delikat.

Përtej analizës formale, vepra mbart ngarkesë simbolike: “Pa një të shtunë” nënkupton mungesën e festës, lirisë, dashurisë – pra, mungesën e jetës në dimensionin e saj të plotë. Numri 12 mund të lidhet me ciklin e kohës (12 muaj, 12 orë) – që përforcon idenë e një jete të kontrolluar, të përsëritur, pa shpëtim. Vallëzimi si metaforë e shprehjes së lirë, por e mbetur vetëm në kujtesë apo dëshirë – një mall për lirinë që nuk erdhi kurrë.

Ndikimi i një artisti nuk matet vetëm nga prania e tij në skenë apo nga numri i veprave të botuara, por nga gjurmët që ai lë në ndjeshmërinë kolektive dhe në kulturën e brezave të instrumentistëve që vijnë pas. Mehdi Prodani është shembull i një trashëgimie që u ndërtua në heshtje, qëndroi në hije për dekada, por që sot po rishkruhet si pjesë e rëndësishme e kujtesës kulturore shqiptare.

Një nga dimensionet më të qëndrueshme të ndikimit të Prodanit ishte roli i tij si mësues dhe formues. Nxënësit e tij nuk u edukuan vetëm me teknika të interpretimit, por me një ndjeshmëri të veçantë ndaj muzikës si shprehje shpirtërore, jo thjesht si zanat. Ndër më të njohurit është Vaçe Zela, e cila e ka përmendur ndikimin e tij në zhvillimin e saj vokal dhe interpretativ.

Alfons Balliçi

Lindi në Elbasan më 10 dhjetor 1942 dhe ndërroi jetë më 02 gusht 2016 në Tiranë.

Në revistën “ExLibris” botohet një shkrim mbi muzikantin dhe kitaristin Alfons Balliçi i cili bën një përshkrim të saktë dhe poetik të kohës.

“Elbasani i viteve pesëdhjetë të shekullit që lamë pas, si e gjithë Shqipëria, ishte i përfshirë në entuziazmin e komunizmit eksperimental për shoqërizimin e gjithë jetës materiale dhe shpirtërore.”

Në këto vite lindi dhe u rrit Alfonsi, biri i një kitaristi që nxirrte bukën e gojës me instrumentin e tij duke luajtur nëpër ambjentet dëfryese të qytetit. Ai ishte dhe mësuesi i parë i kitarës për të birin, por Alfonsi do të veçohej për një aftësi të jashtëzakonshme dëgjimore. Ai ishte i aftë të përcaktonte notën e çdo tingulli, aq sa bënte lodra të ndryshme me shokët e tij rreth kësaj aftësie.

Në fillim të viteve 60' , gjatë studimeve për kompozicion në Konservatorin e Tiranës (1962-1967)⁵, bëhet edhe kitarist në Orkestrën e RTSH-së. Në vitin 1967 fillon punën si dirigjent i Orkestrës së Estradës “Skampa”, Elbasan⁶. Gjatë jetës së tij shkroi pak vepra për kitarë dhe realizoi një Koncert recital me krijimtarisë e tij në emisionin "Këngë në pentagramin tim", që u realizua për të në vitin 1985, pasi jeta e tij u përmbloodh në qytetin e Elbasanit ku iu përkushtua organizimit të aktiviteteve të ndryshme dhe ku mori dhe titullin “Artist i Merituar”⁷.

Në Festivalin e 11-të të Këngës Alfons Balliçi paraqitet si organizator dhe pjestar i grupit modern nga Elbasani me këngëtar Sherif Merdanin, të cilët kënduan këngën “Ruga e Dibrës”. Për këtë modernitet atij i hiqet e drejta e krijimtarisë për 3 vjet (1973 deri 1975)⁸.

Pas viteve 90' për emisionin televiziv Këngët e Stinës (1999) Alfons Balliçi ekzekuton një krijim të vetin i cili përmban disa nga karakteristikat më të spikatura të

⁵ Sipas listës së studentëve të Arkivës së Fakultetit të Muzikës në Universitetin e Artve Tiranë.

⁶ Shiko: Arkiva digjitale shqiptare - <https://adsh.al/s/adsh/item/19162#lg=1&slide=0>

⁷ Artist i merituar ishte një titull nderi i paraqitur për herë të parë në vitin 1960 me ligj të veçantë. Ligji nr. 3171, Datë 26.10.1960.

⁸ Shiko: Arkiva digjitale shqiptare - <https://adsh.al/s/adsh/item/19162#lg=1&slide=0>

tij: Karakteri improvizativ, sidomos në pjesën e fundit të tij me lëvizje të shpejta, tepër të vështira për kitarën me pendëz.

Ritmet e sinkupuara që vijnë si aromë e muzikës amerikane si dhe karakteristikat më të spikatura të muzikës spanjolle. Në fakt vepra titullohet “Spanjolle” dhe shoqërohet nga një ansambël i përbërë nga një tastjerë dhe një kitarë bas elektrike.

Balliçi ka shkruar gjatë viteve të studimeve e më pas edhe disa vepra orkestrale si “Fantazi për piano dhe orkestër” (1969), “Valle koncertale për klarinetë” (1975), “Koncert për violinë”, por krijimtaria më përfaqësuese i takon repertorit dëfryes, të mbarsur me jone të muzikës popullore e kryesisht ambjentit të tij Elbasanit.

Me po këto karakteristika është dhe “Fantazia mbi motive spanjolle” e Balliçit, interpretuar nga autori në një regjistrim tjetër të TVSH-së⁹.

Kompozitori dhe bashkëkohësi i tij Aleksandër Lalo do të shprehet kështu për Balliçin:

“Unë jam i bindur se koha do ta mposht këtë shkreti shpirtërore dhe vlerat e shokut tim të dashur, Alfons Balliçit, do të fitojnë mbi modën e kësaj thatësire institucionale. Jam i bindur se muzika e tij do të fitoj mbi shkresat e pafundme të Ministrisë që stivosen me fjalë të mëdha për një të ardhme të ndritur të kulturës shqiptare. Sepse tingujt e tij, muzika e tij, dashuria e tij frymon shqip në ajër përreth nesh e do të jetë e gjallë në jetë të jetëve”.

Në fakt ka një vijë lidhëse në atë periudhë midis Alfons Balliçit, Agim Krajkës, Ferdinand Dedës, Aleksandër Lalos e ndonjë tjetri për talentin e tyre, tendencën për të zgjeruar hapësirën e shijeve muzikore drejt perëndimit dhe aktivitetin e tyre të shquar instrumental e krijues. Pavarësisht nga rrugëtimi artistik dhe krijimtaria e secilit ata duket se kanë formim dhe nivele talentesh të përbashkëta. Në këtë aktivitet, megjithatë ata do të ishin të parët në përpunimin e folklorit të ambjentit të tyre e më gjerë, veprimtari e cila çmohej mjaft në atë kohë. Por, para së gjithash ata ishin yjet e talentuar të atmosferës dhe muzikës dëfryese, aq të dëshëruar të asaj kohe të mbyllur në qarkun e ngushtë të endrrave dhe dëshirave rinore.

⁹ Shiko: <https://www.youtube.com/watch?v=LJbPgdzpcqU>

Fatmir Manushi në një shkrim mbi Alfons Balliçin me titullin Alfons Balliçi, përtej rrugëtimit të Isuf Myzyrit shkruan:

“Ishin vitet gjashtëdhjetë: Vite kur botohej Heminguej, vite kur në mbrëmjet rinore të vallëzimit ndodhte të kërcehej cherleston, vite kur kishte hapur siparin Festivali I i Këngës (në imitim në Sanremo), vite kur dëgjoheshin Bitëllsat dhe Hitparade, vite kur një rrugë në Tiranë rinia i thërriste Broadway, vite kur djaloshi Kadare niste rrugëtimitin metaforik të kryeveprave në letërsi, ishin vitet e bohemëve të parë, kur ndër intelektualët qarkullonte më tepër art ndër biseda e takime sesa në vitrinat zyrtare të jetës së tyre. Pjesë e kësaj bote ishte Alfonsi, si pikë referimi për artistët dhe muzikantët, ku bashkë me muzikën përzihej dhe alkoli....”

Kjo përbën, ndoshta formulimin, apo panoramimin më të saktë të situatës që përballën muzikantët e shquar ai Alfons Balliçi e të tjerë në raport me ata që ishin rreshtuar dhe përcaktuar si mbështetës të ideologjisë korrente.

Edison Misso

Neglizhenca në fakt lidhet ngusht me personin përgjegjës për fëmijët ku identifikohen prinderit apo kujdetsari sipas ligjit. Ky term sikundër e cekëm dhe më sipër ka të bëjë specifikisht me anashkalimin ete drejtave prindërore në formën e veprimeve apo mosveprimeve duke shkatuar dëm të femija.

Prindërimi në fakt nuk është një e drejtë e pakufizuar. Prindërimi si një autoritet ndaj fëmijës me rol vendimmarrës në bazë të ligjit ka disa kufizime, të cilat nuk lejojnë që sjellje jo-normale të prindit të çenojnë mirëqenien dhe rrijtjen e fëmijës.

Nese I referohemi Kodit të Familjes të Republikës së Shqipërisë, pas nenit 1 të tij ku përcaktohet kuptimi I martesës, nenet pasuese menjëherë japin panormën e detyrimeve ndaj fëmijëve. Neni 2

Konkretisht në nenet e para të këtij Kodit parashikohet se: *“Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës”.*

*“Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesa ose jashtë martese. Shteti dhe shoqëria duhet t’u ofrojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar **keqtrajtimin** dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes”.*

Kodi jonë I familjen I cili në fakt është I vitit 2003 nuk përcakton në mënyrë të qartë konceptimin e keqtrajtimit, në fakt duke e lënë evaziv dhe në diskrecion të gjykatës për ta analizuar rast pas rasti.

Në fakt, keqtrajtimi I fëmijës përbën të gjitha ato veprime apo mosveprime të cilat sjellin pasoja në shëndet, në jetë sociale, në rritjen dhe zhvillimin e fëmijës, duke penguar aksesimin e fëmijës në standradin që familja mund ti ofrojë sijetesë, ndihmës së shtetit në rast nevojë si dhe aksesimin në jetën sociale, arsimore kulturore të fëmijës.

Në kontekstin e keqtrajtimit hyn padiskutim neglizhenca, si një formë që çon në konceptimin e miturit te keqtrajtuar.

Fëmija i cili tipikisht nuk dhunohet me veprimë si goditje, rrahje, forcim për të kryer apo jo veprime, mund të jetë gjithsesi i dhunuar për sa kohë ai keqtrajtohet dhe neglizhohet nga prindërit e tij.

Kodi i Familjes, parashikon se: *“Martesa vendos mbi të dy bashkëshortët detyrimin për të mbajtur, arsimuar dhe edukuar fëmijët, duke pasur parasysh aftësitë, prirjet natyrore dhe dëshirat e fëmijëve”*¹.

Pra, në kodin e familjes sikundër mund të vihet re në këtë citim, përcaktohet qartë se janë disa element që rrjedhin si detyrë nga martesa dhe që kjo detyrë peshon te prindërit, konkretisht, detyrimi për t’ëmbajtur fëmijët nga ku buron detyrimi për ushqim, për veshje, për nevojat sipas moshës të cilat fëmija nuk I përmbush dot vetë, për kontrollë mjekësore duke garantuar kështu së pari shëndetin dhe mirërritjen. Ky nen përcakton gjithashtu detyrimin për arsim dhe edukim duke respektuar prirjet e tyre, pra zgejdhjet dhe dëshirat e tyre, duke I trajtuar fëmijët në këtë sens jo si vartës pa të drejta të prindërve por si qenie nga ku “Uni” I tyre ka filluar të marrë formë dhe kuptim.

Në këto kushte, dalim në konkluzion se mospërmbushja e këtyre elementëve thelbësorë, do ta na çonte automatikisht në kushtet e neglizhencës së detyrave që rrjedhin nga ligji dhe për pasojë do na formësonin elementin e një fëmijet ë keqtrajtuar.

¹ Republika e Shqipërisë. (1995). *Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë*. Fletorja Zyrtare.

Nëse keqtrajtimi apo neglizhenca në vetvetë përbëjnë formë dhunë ose jo do e trajtojmë në sa vijon.

Kuptimi juridik i neglizhencës ndaj fëmijëve

Neglizhenca ndaj fëmijëve përkufizohet si dështimi i vazhdueshëm i prindërve, kujdestarëve ose personave përgjegjës për të siguruar nevojat bazë të fëmijës, duke përfshirë ushqimin, strehimin, kujdesin shëndetësor, arsimimin, mbikëqyrjen dhe mbështetjen emocionale.

Nga këndvështrimi juridik, neglizhenca nuk karakterizohet domosdoshmërisht nga qëllimi për të dëmtuar, por nga **mosveprimi** ose **pakujdesia e rëndë**, e cila sjell pasoja të dëmshme për mirëqenien e fëmijës. Kjo e bën neglizhencën veçanërisht të vështirë për t'u identifikuar dhe provuar në praktikë.

Neglizhenca mund të shfaqet në disa forma, ndër të cilat më të zakonshmet janë: **Neglizhenca fizike**, e cila lidhet me mungesën e ushqimit adekuat, veshmbathjes, higjienës dhe strehimit të sigurt. **Neglizhenca shëndetësore**, kur fëmijës nuk i sigurohet trajtim mjekësor apo ndjekje shëndetësore e domosdoshme. **Neglizhenca arsimore**, që përfshin mosregjistrimin në shkollë ose mungesën e mbështetjes për ndjekjen e arsimit. **Neglizhenca emocionale**, e cila manifestohet përmes mungesës së vëmendjes, dashurisë, sigurisë emocionale dhe komunikimit me fëmijën².

Të gjitha këto forma, ndonëse jo gjithmonë të dukshme, ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e personalitetit dhe integritetit të fëmijës.

Neglizhenca ndaj fëmijës përfaqëson një nga format më komplekse dhe më pak të dukshme të dhunës në mjedisin familjar, për shkak të natyrës së saj pasive dhe shpesh të normalizuar shoqërisht. Ndryshe nga dhuna fizike ose psikologjike, neglizhenca manifestohet përmes mungesës së veprimeve të domosdoshme për garantimin e mirëqenies së fëmijës, duke prodhuar pasoja të thella dhe afatgjata në zhvillimin e tij.

Në të drejtën shqiptare, baza normative për trajtimin e neglizhencës ndaj fëmijës gjendet në **Ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”**. Sipas **nenit 2**, “*neglizhimi i fëmijës*” është çdo mosveprim, me ose pa dashje, nga ana e personit përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, kur si pasojë

² Bowlby, J. (1988). *A Secure Base: Parent-Child Attachment and Healthy Human Development*. London: Routledge.

rezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i tij. Ky përkufizim e trajton neglizhencën si formë të pavarur të dhunës, e cila nuk kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e një akti të dhunshëm për t'u konsideruar juridikisht e ndëshkueshme.

Parimi i **interesit më të lartë të fëmijës**, i sanksionuar në **nenin 6** të Ligjit nr. 18/2017, përbën boshtin interpretues të çdo norme që lidhet me mbrojtjen e fëmijës³. Ky parim kërkon që çdo veprim apo mosveprim i prindërve, autoriteteve publike dhe gjykatave të vlerësohet në funksion të garantimit të zhvillimit fizik, mendor, emocional dhe social të fëmijës. Në këtë kuadër, neglizhenca përbën shkelje të drejtpërdrejta të këtij parimi, pasi cenon vetë substancën e interesit më të lartë të fëmijës.

Një aspekt thelbësor i neglizhencës lidhet me dështimin për të garantuar **aksesin në arsim dhe zhvillim social**, të mbrojtura nga **neni 18** i ligjit, si dhe me mungesën e përfshirjes së fëmijës në veprimtari sociale, kulturore dhe argëtuese, sipas **nenit 19**. Këto të drejta nuk kanë karakter detyësor, por përbëjnë elementë thelbësorë të zhvillimit të personalitetit të fëmijës dhe të integritetit të tij në shoqëri.

Po ashtu, **neni 20** i Ligjit nr. 18/2017 përcakton detyrimin parësor të prindërve ose kujdestarëve për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës, të përshtatshme për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës. Mosrealizimi i këtij detyrimi, kur shoqërohet me pasoja për mirëqenien e fëmijës, përbën formë tipike të neglizhencës prindërore.

Mbrojtja nga neglizhenca si formë dhune gjen mbështetje edhe në **nenin 23** të ligjit, i cili garanton të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga të gjitha format e dhunës, përfshirë neglizhimin. Ky standard kombëtar harmonizohet me **Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës**, veçanërisht me **nenin 3**, që sanksionon interesin më të lartë të fëmijës si konsideratë mbizotëruese, dhe **nenin 19**, që detyron shtetet të marrin masa për mbrojtjen e fëmijës nga braktisja dhe mospërfillja⁴.

Pavarësisht se ligji në fjalë ka qartësi të plotë dhe harmonizohet me standardet ndërkombëtare, në praktike konceptualiteti I tij mbetet në paqartësi. Për shkak se dhuna në formën e sakj me klasike mbetet ajo e dukshme, pra me mjete aoo me goditje etj, format e dhunave të tjera janë më pak të padukshme duke u interpretuar sjelljet e

³ Republika e Shqipërisë. (2017). *Ligji nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"*. Fletorja Zyrtare.

⁴ Republika e Shqipërisë. (2005). *Ligji nr. 9443, datë 16.11.2005, për aderimin në Konventën mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, ekzekutimin dhe bashkëpunimin në çështjet që lidhen me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve*. Fletorja Zyrtare, Nr. 96, 3067.

prinderve shpësh si diskrecionale dhe jo duke u vlerësuar në raport me detyrimet ligjore.

Në lidhje me zbatueshmërinë e ligjit 18/2017 ne duhet ti referohemi Nr. 578, datë 3.10.2018 PËR PROCEDURAT E REFERIMIT E TË MENAXHIMIT TË RASTIT, HARTIMIN DHE PËRMBAJTJEN E PLANIT INDIVIDUAL TË MBROJTJES, FINANCIMIN E SHPENZIMEVE PËR ZBATIMIN E TIJ, SI DHE ZBATIMIN E MASAVE TË MBROJTJES.

Kjo VKM është e një rëndësi të veçantë pasi ajo trajton se si praktikisht do të evidentohen rastet e dhunës parashikuar në ligjit 18/2017 duke përcaktuar edhe definicionet e gjëndjes që kosntatohet njëi mitur I dhunuar në një nga format e parashikuara nga ligji.

Dispozita mbi fushën e zbatimit i atribuon vendimit nënligjor një **karakter të përgjithshëm dhe detyrues**, duke e shtrirë efektin e tij mbi një rreth të gjerë subjektësh publike dhe private. Normativisht, kjo dispozitë materializon parimin e **përgjegjësisë së përbashkët** për mbrojtjen e fëmijës, duke mos e kufizuar atë vetëm te strukturat e specializuara, por duke përfshirë çdo autoritet apo person që, për shkak të funksionit, profesionit apo marrëdhënies kontraktuale, ushtron kompetenca që prekin drejtpërdrejt ose tërthorazi të drejtat e fëmijës.

Përfshirja e autoriteteve shtetërore, mekanizmave këshillimorë dhe koordinues, strukturave qendrore dhe vendore të mbrojtjes së fëmijës, si dhe institucioneve publike e private dhe organizatave jofitimprurëse, tregon se sistemi i mbrojtjes së fëmijës konceptohet si **mekanizëm horizontal dhe ndërsektorial**, jo si kompetencë ekskluzive e një institucioni të vetëm.⁵ Kjo qasje është në harmoni me Ligjin nr. 18/2017, i cili imponon detyrime pozitive për shtetin dhe aktorët shoqërorë në garantimin efektiv të të drejtave të fëmijës.

Nga pikëpamja juridike, fusha e zbatimit përfshin jo vetëm subjektet që ofrojnë shërbime mbrojtëse, por edhe ata që kanë detyrimin e **referimit, menaxhimit dhe koordinimit të rasteve**, duke i atribuuar mosveprimin ose veprimin të pasaktë pasoja juridike dhe administrative. Kjo e zhvendos fokusin nga reagimi pasiv drejt **parandalimit dhe ndërhyrjes së hershme**.

⁵ OSCE. (2024). *Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje* (p. 40–41). Organisation for Security and Co-operation in Europe.

Analiza e kategorive të rrezikut dhe e planifikimit të masave mbrojtëse për fëmijët paraqet një dimension të rëndësishëm të legjislacionit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Kuadri i përkufizimeve të rrezikut përcakton qartë nivelet e ndryshme të kërcënimit që mund të rëndojnë mbi një fëmijë, duke filluar nga rreziku i lartë, i cili shpreh situata në të cilën fëmija mund të dëmtohet rëndë, të jetë subjekt i abuzimeve të vazhdueshme ose të vuajë pasoja afatgjata, deri tek rreziku i mesëm dhe i ulët, që përfshin situatat ku fëmija nuk ka pësuar dëmtime të rënda, por ekziston mundësia e tyre nëse nuk ndërhyhet në mënyrë të duhur. Këto përkufizime nuk shërbejnë vetëm për të kategorizuar rastet, por gjithashtu përcaktojnë intensitetin dhe natyrën e ndërhyrjeve që duhet të ofrohen për mbrojtjen e fëmijës. Në këtë kuadër, menaxhimi i rastit ka një rol qendror, duke funksionuar si një metodologji që siguron ofrimin hap pas hapi të ndihmës dhe shërbimeve në mënyrë të vazhdueshme dhe efektive, duke synuar promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenies së fëmijës. Plani individual i mbrojtjes, si komponent kyç i këtij procesi, përbën një mjet të strukturuar me veprime të caktuara, të orientuara drejt parandalimit të cenimit të integritetit të fëmijës, garantimit të të drejtave, mirëqenies, shëndetit dhe zhvillimit të tij, duke përfshirë edhe mbështetjen e familjes në realizimin e këtij plani. Ky mekanizëm tregon qartësisht se mbrojtja e fëmijës nuk është thjesht një veprim pasiv, por një proces aktiv dhe proaktiv, i cili kërkon koordinim ndërinstitutional, vlerësim të vazhdueshëm të rreziqeve dhe ndërhyrje të drejtpërdrejta për të siguruar realizimin efektiv të të drejtave të fëmijës. Në këtë kuptim, kategorizimi i rreziqeve dhe menaxhimi i rasteve funksionojnë si një sistem mbrojtës i integruar, që orienton vendimmarrjen institucionale dhe krijon një bazë të qartë për ndërhyrjet ligjore dhe shoqërore në interesin më të lartë të fëmijës.⁶

Neglizhenca, si mosveprim ose veprim i pamjaftueshëm nga ana e personave përgjegjës për përkujdesjen dhe edukimin e fëmijëve, lidhet ngushtë me konceptin e rrezikut. Ajo shfaqet kur mungesa e kujdesit, vëmendjes ose ndërhyrjes së duhur rrezikon mirëqenien, zhvillimin fizik, mendor dhe emocional të fëmijës. Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” e përkufizon neglizhencën si veprim ose mosveprim që, si pasojë e tij, mund të shkaktojë dëmtime të menjëhershme ose të rrisë rrezikun e dëmtimeve të ardhshme.

Në këtë kuadër, rreziku për fëmijën kategorizohet si i lartë, mesëm ose i ulët, në varësi të shkallës së ekspozimit ndaj neglizhencës. Neglizhenca krijon hapësirë për

⁶ Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë. (2018, 3 tetor). *Vendim nr. 578, “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”*. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë.

abuzime, mosshfrytëzim të shërbimeve bazë për edukim, shëndet dhe mbrojtje, si dhe për pamundësinë e zhvillimit të një mjedisi të sigurt dhe stimuluese. Sa më e vazhdueshme dhe sistematike të jetë mosveprimi, aq më i madh konsiderohet rreziku, duke justifikuar ndërhyrje institucionale për të mbrojtur të drejtat dhe interesin më të lartë të fëmijës.

Nga kjo perspektivë, neglizhenca nuk është thjesht një mosrespektim moral apo social, por një mekanizëm që ushqen rrezikun dhe aktivizon përgjegjësinë ligjore të autoriteteve shtetërore, strukturave të mbrojtjes së fëmijës dhe çdo aktori tjetër që ka detyrë për sigurimin e mirëqenies së fëmijës. Ajo shërben si katalizator i rrezikut, duke evidentuar nevojën për ndërhyrje proaktive dhe planifikim të masave mbrojtëse për fëmijën.

Në rastet e dhunës ndaj fëmijëve, ku kjo shfaqet në formën e neglizhencës, roli i gjykatës është thelbësor për garantimin e mbrojtjes së tyre. Gjykata, si autoritet shtetëror, ka kompetencën të vlerësojë situatat ku fëmija rrezikohet për shkak të mosveprimeve ose veprimeve të pamjaftueshme nga prindërit ose kujdestarët. Në këtë kontekst, gjykata mund të kthehet në instrumentin kryesor për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, duke përcaktuar masa të menjëhershme dhe efektive për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm të fëmijës.

Masat e vendosura nga gjykata, duke përfshirë urdhrin e mbrojtjes, mund të përfshijnë ndërhyrje për sigurimin e nevojave bazë të fëmijës, mbikëqyrje të specializuar në mjedisin familjar, ose referim te strukturat sociale dhe shëndetësore. Në rastin e neglizhencës, gjykata vlerëson rrezikun e shkaktuar nga mungesa e kujdesit dhe vendos masat që minimizojnë kërcënimin ndaj mirëqenies fizike, emocionale dhe sociale të fëmijës.

Përmes urdhrin të mbrojtjes, gjykata siguron që përgjegjësia ligjore e prindërve ose kujdestarëve të kombinohet me ndërhyrjen institucionale, duke garantuar respektimin e të drejtave themelore të fëmijës dhe promovimin e interesit më të lartë të tij. Në këtë mënyrë, gjykata shndërrohet në një mekanizëm parandalues dhe mbrojtës, i cili lidh konceptin e neglizhencës me ndërhyrjen ligjore dhe menaxhimin e rrezikut, duke siguruar që fëmija të mos mbetet i ekspozuar ndaj abuzimeve apo dëmimeve të mundshme.

Pasojat juridike dhe sociale të neglizhencës

Pasojat e neglizhencës nuk kufizohen vetëm në dëmtime fizike apo emocionale, por shtrihen edhe në planin social dhe juridik. Fëmijët e neglizhuar kanë

rrezik më të lartë për përjashtim social, vështirësi në arsim, probleme të shëndetit mendor dhe sjellje devijante në të ardhmen.

Nga ana juridike, neglizhenca përbën bazë për ndërhyrjen e institucioneve të mbrojtjes së fëmijëve, kufizimin ose heqjen e përgjegjësisë prindërore, si dhe për vendosjen e masave mbrojtëse alternative në interes të fëmijës.

Neglizhenca ndaj fëmijëve përbën një nga format më të rrezikshme të dhunës, pasi pasojat e saj shtrihen jo vetëm në aspektin fizik dhe emocional, por edhe në planin social dhe juridik. Fëmijët e neglizhuar përballen me një rrezik më të lartë për përjashtim social, vështirësi në arsim dhe zhvillim të aftësive sociale, probleme të shëndetit mendor dhe sjellje devijante në të ardhmen. Nga ana juridike, neglizhenca përbën bazën për ndërhyrjen e autoriteteve shtetërore dhe institucioneve të mbrojtjes së fëmijëve, duke mundësuar kufizimin ose heqjen e përgjegjësisë prindërore dhe vendosjen e masave mbrojtëse alternative. Në këtë kontekst, gjykata luan një rol kyç në vlerësimin e rrezikut dhe garantimin e ndërhyrjeve efektive, për të siguruar që fëmija të mbrohet nga dëmtimet afatgjata dhe të promovohen të drejtat e tij themelore. Ndërhyrja juridike nuk është vetëm një mjet për ndëshkim, por edhe një mekanizëm parandalues dhe mbrojtës, që lidhet drejtpërdrejt me mirëqenien dhe zhvillimin e shëndetshëm të fëmijës, duke pasqyruar parimin e interesit më të lartë të tij.

Në menaxhimin e rasteve të dhunës apo neglizhencës ndaj fëmijëve, gjykata luan një rol qendror në garantimin e mbrojtjes së tyre. Megjithatë, për të marrë vendime të drejta dhe të bazuara në interesin më të lartë të fëmijës, gjykata duhet të koordinohet ngushtë me Punonjësin e Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF) dhe me Grupin Teknik Ndërsektorial (GTN). Kjo koordinim është thelbësor, sepse vetëm bashkëpunimi institucional siguron që vlerësimi i rrezikut të bëhet mbi të dhëna të plota dhe mbi analiza faktike, të mbledhura nga aktorët kompetentë dhe të specializuar.

Roli i ekspertëve privatë, si psikologët që nuk kryejnë mbledhjen dhe analizën e rrethanave faktike, nuk mund të zëvendësojë këtë proces. Vlerësimet e tyre mund të jenë të pjesshme dhe të fokusohen vetëm në aspektet individuale psikologjike, duke mos përfshirë parametrat socialë, familjarë dhe institucionale që përcaktojnë realisht nivelin e rrezikut. Për këtë arsye, gjykata duhet të mbështetet në vlerësimet e PMF dhe GTN, të cilët veprojnë sipas metodologjive të standardizuara dhe bazuar në fakte, duke siguruar që vendimet për urdhrat e mbrojtjes të jenë të drejta, të plota dhe efektive.

Ky model koordinimi garanton se masat mbrojtëse nuk janë vetëm formale, por adresojnë nevojat reale të fëmijës, duke parandaluar ekspozimin ndaj dhunës ose neglizhencës dhe duke respektuar interesin më të lartë të tij. Gjykata, në këtë kuadër, nuk është një aktor i izoluar, por pjesë e një rrjeti institucional që bashkëpunon për të siguruar mbrojtjen e fëmijës në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në fakte.

Përfundime dhe rekomandime.

Neglizhenca si formë e dhunës ndaj fëmijëve paraqet një sfidë serioze për sistemin juridik dhe për shoqërinë në tërësi. Pasojat e saj shtrihen në planin fizik, emocional dhe social të fëmijëve, duke rritur rrezikun për probleme të shëndetit mendor, vështirësi në arsim dhe integrim social, si dhe sjellje devijante në të ardhmen. Nga ana juridike, neglizhenca krijon obligime për ndërhyrjen e institucioneve të mbrojtjes së fëmijës dhe për vendosjen e masave mbrojtëse që synojnë garantimin e mirëqenies dhe të drejtave të fëmijës.

Identifikimi i hershëm i rasteve, ndërgjegjësimi shoqëror dhe forcimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë janë thelbësore për parandalimin e neglizhencës. Bashkëpunimi i ngushtë dhe i koordinuar mes gjykatës, Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Grupit Teknik Ndërsektorial garanton një vlerësim të plotë të rrezikut, duke u bazuar në fakte dhe analiza gjithëpërfshirëse, dhe parandalon vendimmarrjen të mbështetur në informacione të pjesshme apo vlerësime nga psikologë privatë që nuk realizojnë hetim faktik.

Rekomandohet që gjykata të përdorë si referencë vetëm vlerësimet institucionale dhe të sigurojë që çdo urdhër mbrojtjeje të jetë i bazuar në interesin më të lartë të fëmijës. Në këtë mënyrë, ndërhyrja juridike nuk është vetëm parandaluse, por edhe mbrojtëse dhe promovuese e të drejtave të fëmijës.

Trajtimi i neglizhencës si shkelje e të drejtave themelore të fëmijës dhe jo thjesht si dështim prindëror përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt garantimit të një mjedisi të sigurt, të mbrojtur dhe dinjitoz për çdo fëmijë, duke forcuar kështu besimin e shoqërisë në institucionet që kujdesen për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

Literatura

1. Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Republika e Shqipërisë.
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.578, për miratimin e procedurave për menaxhimin e rastit dhe Planin Individual të Mbrojtjes.

3. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, për parashikimin e veprave penale mbi keqtrajtimin fëmijëve.
4. Ligji nr. 7829/1994, “Për noterinë”, i ndryshuar.
5. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF), Manuali i Menaxhimit të Rastit, Tiranë.
6. Grupi Teknik Ndërsektorial për Mbrojtjen e Fëmijës, Udhëzues për Vlerësimin e Riskut dhe Planin Individual të Mbrojtjes, Tiranë, 2020
7. Vishaj, S. (2023). *Avokati im në luftë kundër dhunës në familje*. Alb Juris.
8. Balla, E. (2021). *Mbrojtja e të drejtave të fëmijës në sistemin juridik shqiptar*. Tiranë: Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.
9. Hoxha, A. (2019). “Neglizhenca dhe përgjegjësia prindërore: Sfida për gjykatat shqiptare”, *Revista Shqiptare e Drejtësisë*, 2(1), 45–63.
10. UNICEF (2018). *Child Protection: Legislative Framework and Best Practices*, Tirana Office.

TOPONIMIA E KRAHINËS SË LABËRISË DHE VEÇORITË ETNOLINGUISTIKE TË SAJ

Prof.as.dr. Zamira Alimemaj

Qendra Kerkimore Shkencore e Albanologjise dhe Ballkanistikës

Universiteti "Ismail Qemali" Vlore

Zamira.alimemaj@univlora.edu.al

zamiraalimema@gmail.com

Abstract

The Province of Labëria is one of the largest historical provinces of our Albania, roughly situated in Southern part of it, which over time caught the attention of numerous researches from various fields such as, history, geography, ethnology, folklore etc. Labëria is located Southwest of Albania, within the three bridges: bridge of Drashovica, bridge of Tepelena and the Castle's bridge near Delvina. Its inhabitants are known as Labs. Onomastics (anthroponyms, toponyms, microtoponyms), despite its specific features dictated by the geographical position of this district in the southern part of the country, is built on rules that operate throughout Albanian language. It is quite clear that it is created on the same psychological, historical and cultural basis as in every other territory inhabited by Albanians. Toponymy has marked deep and rich traces in this radiation. It reflects the most secure signs of the historical developments not only for the Albanian realm, but also for the linguistic, historic and cultural realm of Labëria. Toponyms, antroponyms and patronyms carry a lot of information about the ethno-cultural inheritance of the population.

Key words: *toponyms, tosk dialect, foreign influences.*

Hyrje

Labëria përbën një nga nënndarjet e mëdha etnografike të Shqipërisë. Ajo shtrihet në territorin midis deteve Jon e Adriatik në perëndim dhe lumit të Vjosës e degës së tij, Drino në lindje, me kufij jugorë që ecin sipas një vije e cila nis nga Saranda dhe arrin në qafën e Muzinës, kurse kufijtë veriorë të saj lënë jashtë Vlorën dhe pjesën e poshtme të luginës së Shushicës.¹ Krahina e Labërisë është jo vetëm e

¹ Shih: Memushaj, R. *Himara në dritën e të dhënave historike, gjuhësore dhe etnologjike*, Tiranë, 2004, f. 70. R.,

njohur për vlerat e saj historike dhe etnokulturore të shumta, por edhe për të folmen e ligjërimet e saj. Kjo ka qenë dhe arsyeja që, në rrjedhë të viteve, edhe studimit të së folmes dhe onomastikës së Labërisë i janë kushtuar edhe jo pak studime nga etnografë, folklorist dhe gjuhëtarë. Përmendim, ndër të tjera, monografitë përgjithësuese për disa të folme të kësaj krahine nga dialektologu i njohur Menella Totoni², pastaj edhe një numër trajtimesh të gjera me karakter historik dhe onomastik e gjuhësor nga studiues të njohur si Rahmi Memushaj³, Pëllumb Xhufi⁴. Mirëfilli për onomastikën, sidomos për toponiminë, është për t'u shënuar ndihmesa e Ali Dhrimos⁵ dhe studimi i gjerë i Lilo Nurajt për toponiminë e Velçës.⁶ Vlejnë të përmenden, gjithashtu, përmbledhjet me materiale etno-folklorike të Fatos Mero Rrapajt.⁷

E folmja e Labërisë karakterizohet nga një leksik shumë i pasur me veçori individuale, ku kanë lënë gjurmë ngjarjet historike, veprimtaria prodhuese e shoqërore, jeta kulturore e artistike si dhe marrëdhëniet me vendet fqinje. Me vlerë mijëvjeçare është një mbishkrim në gjuhën shqipe i shkruar në një mozaik të gjetur në fshatin Mesaplik, që i përket shek. VI të erës sonë. Mbishkrimi thotë: A-PAK-KE-TAÇ, i cili i deshifrohet: *Po hëngre pak (të kursesh), ke të hashë*.⁸ Gjatë pushtimeve në periudhën e mesjetës banorët vendas në Labëri bashkëjetuan me ardhësit duke bërë asimilimin e tyre, por, gjithsesi, ata lanë një shtresë kulturore. Kontaktet dhe ndikimet kulturore të huaja, të cilat kanë lënë gjurmë në kulturën material dhe shpirtërore të banorëve vendase në Labëri, nuk mund të injorohen. Ndikimet e huaja vihen re në inventarin leksikor, emërtimet e njerëzve dhe të vendeve si dhe në zëvendësimin e shumë fjalëve dhe emërtimeve shqipe me njësi greke, latine, sllave apo turke. Elementet prej këtyre gjuhëve kanë formuar dukuri e huazime gjuhësore në të folmen e Labërisë.

² Totoni, M., *Vëzhgime për të folmen e Muzinës*, "SF", 3, 196, f.106; *E folmja e Bregdetit të Poshtëm*, "SF" 1, Tiranë, 1964, f.14; *Vëzhgime rreth të folmeve të Kurveleshit*, "Dialektologjia shqiptare" 1, Tiranë, 1971, f.8.

³ Memushaj, R., *Himara në dritën e të dhënave historike, gjuhësore dhe etnologjike*, Tiranë 2004; *Historia e Kurveleshit*, Tiranë, 2004.

⁴ Xhufi, P., *Shqipëria dhe bota mesdhetare në mesjetë*, SH, 2, Tiranë, 1990; *Rrethana etnike në Epir gjatë mesjetës*, SH, nr.1-4, Tiranë, 199.

⁵ Dhrimo, A., *Një vështrim gjuhësor mbi toponiminë e Kurveleshit*, "SF", 3, Tiranë, 1974.

⁶ Shih: Nuraj Lilo, *Velça, Toponimia dhe antroponimia*, Tiranë, 2003.

⁷ Shih: Rrapaj, F., *Këngë popullore të Labërisë*, Tiranë 1990 dhe *Këngë popullore të Labërisë* 8, Tiranë, 1991.

⁸ Mati, I., *Mozaiku i Mesaplikut*, "Gazeta Shqiptare", datë, 30 shtator 2006.

E folmja e Labërisë ka një leksik të pasur, i cili, përveç veçorive individuale që shfaq, ka edhe tipare të përbashkëta me të folmet e tjera të toskërishtes, sidomos për sa u përket huazimeve.

Onomastika e Labërisë

Po të ndiqet hap pas hapi lindja dhe zhvillimi i tipareve të dy dialekteve të shqipes, duke nisur nga ato më të rejtat e duke shkuar tek ato më të lashtat, shihet se ato së bashku me shumë veçori të të folmeve të veçanta janë forma të ndryshme që ka marrë kohë më kohë brumi i vetë gjuhës shqipe. Në gjuhën shqipe nuk ekzistojnë dallime të rëndësishme cilësore në intonacione dhe dallimi në gjatësinë e zanoreve nuk është absolut e as relevant, sepse zanore të gjata gjenden në gegërishte, por edhe në të folmet e labërishtes, të çamërishtes dhe arbërishtes (të gjitha këto janë të folme të toskërishtes)⁹. Si dialekt, toskërishtja ka nënndarjet e saj, dy nëndialekte: toskërishten veriore dhe atë jugore, që, gjithashtu, janë të përthyer e të përbërë nga të folme e grupe të folmesh me dukuri që nuk përputhen me gjuhën letrare, si labërishtja, çamërishtja e të tjera.¹⁰

Bërthamën e Labërishtes e përbëjnë të folmet e Kurveleshit, të folmet e tjera afrohen me to por nuk janë krejtësisht të njëjta.¹¹ Ndryshimet që erdhën në jetën ekonomike dhe kulturën shpirtërore si pasojë e zhvillimeve historike si dhe ndikimeve të huaja kulturore në krahinën e Labërisë, u shfaqën edhe në fushën e gjuhës. Kështu, leksiku i përgjithshëm ka humbur fjalë të vjetra të shqipes por edhe është pasuruar me fjalë të reja, një pjesë e të cilave janë të huazuara. Edhe ajo pjesë e trashëgimisë, e cila është përcjellë gojë më gojë, është prekur nga ky fenomen.

Onomastika përbëhet nga dy grupe të mëdha emrash: a) antroponimet (emrat e njerëzve) dhe b) toponimet (emrat e vendeve) ku përfshihen oikonimet (emrat e vendeve të banuara), etnonimet (kombësitë, krahinat etj), hidronimet (detet, liqenet, lumenjtë), oronimet (malet, fushat, kodrat).

Lashtësinë e një populli e dokumentojnë jo vetëm gërmimet arkeologjike, shkrimet e vjetra të lëna nga historianë të lashtësisë, por edhe toponimet, ku mund të gjenden elemente të ruajtura që u kanë rezistuar shekujve e që e gjejnë shpjegimin në gjuhën e sotme. Është në natyrën e popujve që vendeve, fushave, kodrave, maleve, lumenjve, grykave, rrugëve, vendbanimeve, t'u vënë emra në gjuhën e tyre me synimin që të

⁹ Gjinari, J. *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989, f. 6.

¹⁰ Gjinari, J.; Shkurtaç, Gj., *Dialektologjia*, Tiranë, 2000, f.31.

¹¹ Gjinari, J., Shkurtaç, Gj., *Dialektologjia*, Tiranë, 2003, f.163.

orientohen gjatë komunikimit midis tyre. Edhe pse në rrjedhat e historisë popujt janë pushtuar, janë ndikuar nga gjuha e pushtuesit, përsëri, si një libër i pashkruar, por i lexuar dhe në ditët tona, mbetet fusha e toponimeve. Edhe pse shumë prej tyre kanë ardhur jo të ruajtura në gjuhën e emërimit të parë, por si përkthime në gjuhën e pushtuesit, sërish ato, me shpjegimet që u kanë dhënë gjuhëtarët, mbartin me vete të vërteta që duhen vlerësuar.

Si rrjedhim i kontakteve të ndryshme historike me popuj të ndryshëm dhe i zhvillimeve të brendshme, në kulturën shpirtërore e material të Labërisë shumë gjëra kanë ndryshuar dhe më qartë këto ndryshime shfaqen në fushën e gjuhës. Ndryshime të mëdha kanë ndodhur në fushën e emrave të njerëzve (antroponimet) dhe të vendeve (toponimet). Kanë humbur emrat vetjakë të periudhës së lashtë dhe të mesjetës; shumë emra gjeografikë janë zëvendësuar me fjalë të huaja, kurse një pjesë tjetër, duke kaluar gojë më gojë ndër breza, kanë ndryshuar formën fonetike.

Toponimia dhe vlerat e saj etnolinguistike

Njeriu ka nevojë kurdoherë edhe për një kod tjetër me anën e të cilit ai fikson emrat e objekteve, sendeve, dukurive më të vogla, por jo më të parëndësishme se ato të mëdhatë. Madje, pikërisht ato objekte, dukuri etj. që përfshihen në arealen e kodit më të ngushtë, më të vogël (mikrotoponimet) kanë rëndësinë më të madhe për jetën e përditshme të njeriut, prandaj edhe kanë qenë e janë aq të shumta, po edhe aq të rrënjësura në gojën e popullit.¹²

Toponimet, si objekt studimi i onomastikës, janë një pjesë e rëndësishme e veçorive etnolinguistike të një krahine. Ato bartin pjesë të historisë, tregojnë realitete gjeografike të shkuara dhe të tashme të një zone të caktuar, por, njëkohësisht, lidhen ngushtë dhe me mendësinë dhe mënyrën e jetesës së banorëve

Edhe në krahinën e Labërisë, toponimia paraqet interes gjuhësor e historik. Toponimet në këtë krahinë flasin për lashtësinë e banorëve, emërtimet e bartura gjatë pushtimeve, evoluimin social, ekonomik, politik e shpirtëror të kësaj treve.

¹² Shkurtaç, Gj., *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë, 2001, f.18.

Toponime që përmbajnë fjalë të huazuara nga gjuhë të huaja

Në Labëri, ashtu si në të gjitha trojet shqiptare, shkelën shumë pushtues. Nëpërmjet pushtuesve, u futën në toponiminë dhe antroponiminë e Labërisë një numër i madh emrash të huaj të cilat ushtruan një trysni në gjuhën vendase. Ndaj kësaj trysnie të huaj, shqipja ka shfaqur gjithnjë qëndresën e saj dhe, kur nuk ka qenë e mundur t'i prapësojë emrat e huaj, së paku i ka përvetuar duke i shndërruar ato fonetikisht e morfologjikisht e duke ia përshtatur disi natyrës së saj.¹³

Toponime që përmbajnë fjalë të huazuara me origjinë sllave

Shumica e emërtimeve të fshatrave të krahinës dhe një pjesë e konsiderueshme e mikrotoponimeve që lidhen me jetën e përditshme të fshatarëve janë të formuara me fjalë të huazuara nga sllavishtja, ku shquajnë ato me prapashtesat **-ic(ë)**, **-ov** dhe me leksik të ditur si i origjinës sllave, si *voda*, *bërda*, *grad* etj. Kjo është e kuptueshme, sepse sipas Sh. Demirajt: “Prania e një numri të madh toponimesh sllave në Shqipëri është e shpjegueshme po të mbahen parasysh dy rrethana: së pari, të kihet parasysh se viset e banuara nga shqiptarë kanë qenë të pushtuara për një kohë të gjatë nga dy mbretëri sllave; së dyti, është e ditur që pushtuesit përpiqen të zëvendësojnë toponimet e mëparshme me emërtime nga gjuha e tyre”.¹⁴

Në Labëri ka toponime me prapashtesat sllave:

- **-ov**: *Grabovë, Kovaçovë, Krivovë, Kumanovë, Kunjovë, Motjovë, Leskovë, Qafa e Kumarovës, Rehovë, Stërhovë, Strogovë, Tërbovë, Vanovë.*
- **-ic** *Çerrica, Drashovicë, Dreveshnicë, Këndrevicë (dredha-dredha), Kozicë, Kurpicë, Gjezhdanica, Lepenicë, Lepotenicë, Mortovica, Nivicë, Pleshovicë, Puavicë, Ramicë Shushicë, Trushnicë,*
- **-ec**: *Gërvec, Goronec, Grashec.*
- **-dol**: *Vozdol.*

Me parashitesën sllave **za-**: *Zamar* (vend në Himarë që do të thotë “përtej detit”), *Zarel, Përroi i Zagonit.*

Të shpesha janë edhe toponimet që përmbajnë fjalë të huazuara nga sllavishtja, si: *Bërda, Brataj, Brodan, Burimi i Shqeve, Cerje* (majë e zezë), *Dobro, Drubovë* (pyll i veshur me dru), *Dushaj, Gllava* (vend i dale), *Gllavat, Gradishtë, Grashecë,*

¹³ Shkurtaç, Gj., *Onomastikë dhe etnolingvistikë*, Tiranë, 2001, f.26.

¹⁴ Demiraj, Sh., *Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmive të gjuhës shqipe*, “Shkenca”, 1999, f. 129.

Golem, Gradisht, Moqila, Ploda, Maja e Bërdës, Mali i Bozhikut, Plloçicë, Pollovojkë (shesh lufte), Qafa e Vodës, Suhagorë.

Po ashtu toponime nga emra njerëzish me origjinë sllave, si: *Ivanaj, Pylli i Radit, Qafa e Radës etj.*

Me origjinë sllave duket se janë edhe toponime si: *Bigorre, Borrele* (borac = pyll me pisha), *Dederonjë* (vend shëtitjesh), *Laponik, Mali i Çipinit* (mal i errët), *Përroi i Vezhishtit, Prasek, Smokthinë* (vend me fiq), *Sqillovik, Tartar, Tërbaç, Tresenik, Vranisht, Xvori, Zelishtë.*

Toponime që përmbajnë fjalë të huazuara nga greqishtja

Fqinjësia e gjatë me popullin grek dhe marrëdhëniet e dendura ekonomike dhe kulturore me të, kanë ndikuar në huazimin e fjalëve të greqishtes në shqipen dhe, me kohë, mbi bazën e tyre janë formuar edhe emërvende (toponime) jo të pakta të kësaj krahine, si:

Aspropetra (gur i bardhë), *Andrehora, Arvat* (vend në fushë), *Armisidha* (vend i kripur), *Barkole, Dhimëkaza* (vend ku vijnë shumë shira), *Frengh* (luginë në të cilën gjenden shumë shpella), *Gërmadhë, Gjipe, Gonë*, (gjiri i Porto Palermos), *Gryka e Stovarfit, Hamuriq, Jalë* (vend në Vuno, do të thotë qelq, quhet kështu sepse uji është shumë i pastër), *Jalovlash, Karidhon* (vend me fruta), *Kastanea, Kadafiq, Kaliba, Kalibaq, Katohori, Kisha e Kllogjrit* (kallogjer = njerëz që rrinë pranë vendeve të shenjta), *Kllogjri, Kondakuvi, Kostaraq, Kreta, Lithit, Livaqi, Maja e Kapelit* (kapeli=kapelja), *Maja e Mesunit* (mesa = midis), *Mavrojanji, Mavrovë, Mavromat, Megalihora* (kullotë), *Pajohori, Pandelejmon, Parikë, Përroi i Kalinorit, Përroi i Millokopisë, Përroi i Lithit, Kadafiq, Përroi i Millokopisë, Përroi i Tramatraqit* (tramatraq = vendkomandë ushtarake), *Potam* (vend ku rrjedh ujë), *Qafa e Spitharit* (spithos = gropëz në gurë me ujë të ndënjur), *Sevaster, Spile* (shpellë), *Shpella e Gramës* (grama = shkrim), *Shpella e Katafiqe* (humnerë), *Shtegu i Dhimës, Thekër, Thodhos, Vendero, Visha* (qafë).

Toponime që përmbajnë fjalë të huazuara nga gjuhët turko-arabe

Pushtimi turk ndikimoi në ngulitjen e një numri të madh fjalësh dhe, në disa raste, mbi bazën e tyre janë formuar edhe emërvende (kufizuar toponime, në fakt jo të shumta në numër, si:

Ceribash, Çiflik, Guri i Kadiut, Harapë, Karaburun, Kullxhi, Mekami, Sanxhak, Shpella e Selman Aliut, Shkalla e Turkut, Tepelenë, Vakëfe.

Toponime që përmbajnë fjalë të huazuara nga hebraishtja

Gjurmë të pakta, por mjaft domethënëse të pranisë së një elementi hebre në krahinën e Labërisë, mund të konsiderohen toponime ose mikrotoponime që ekzistojnë ende sot e kësaj dite në këtë zone, si: *Palasë, Avrecaj, Galile, Gomarza, Harapa, Heri, Kikë, Kofina, Heri, Mali Galile, Përroi i Kanës, Purri, Varri i Çifutit.*

Toponime që përmbajnë fjalë të huazuara nga latinishtja

Rrëza e Dykelenit, Valth, Val, Vakati, Vakaj, Vilar, Vivari, Vilati.

Toponime të formuara nga togfjalësha emër+mbiemër cilësor

Nga Jugu në Veri deri në skajet më të tejme të Veriut e të trojeve Verilindore të shqipërisë na shfaqen toponime me togfjalësha të përbërë nga një emër + mbiemër cilësor, që tregojnë ngjyrën, formën, përmasën ose ndonjë cilësi tjetër. Shumë prej tyre janë të lidhura me çifte të kundërvëna sipas antinomisë të tiparit që shënohet: *Bregu i Poshtëm- Bregu i Sipërm, Proseki i Madh-Proseki i Vogël, Dukati i Ri- Dukati i Vjetër, Përroi i Zi- Përroi i Bardhë etj.*

Edhe në Labëri, ashtu si gati gjithandej në trevat shqiptare, gjendja është ashtu si e ka paraqitur Gj. Shkurtaji, i cili vëren se: “Oronimet me strukturën emër + mbiemër që tregojnë ngjyrën janë jo vetëm të shumta, por edhe me një areal të hapët në Veri dhe Jug apo gjithëshqiptare.”¹⁵ Një pjesë e madhe e toponimeve lidhen me përshkrim me anë të një mbiemri që shënon përmasa, si: *i madh- i vogël, e madhe- e vogël, i gjatë, e mesme, e gjerë, e thellë.* Nevojat praktike të përditshmërisë së punëve që duhet të kryenin dhe vendeve ku duhet të shkonin, i detyronin njerëzit të përdornin emërtime të thjeshta, të cilat lidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë me përmasat e tyre. Kështu, në Labëri, hasim gjithandej toponime të tilla, si:

Biga e Gjatë, Guri i Prerë, Maja e Mjegullës, Përroi i Zi, Përroi i Bardhë, Qafa e Baltës së Bardhë, Qafa e Erës së Sipërme, Qafa e Sheshit të Madh, Qafa e Vogël, Qafat e Zeza, Rrethi i Tendës, Shkëmbi i Bardhë, Shpella e Kuqe, Kroji i Verbër,

¹⁵ Shkurtaji, Gj., *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë, 2001, f.72.

Prosek i Madh, Prosek i Vogël, Qafa e Gurit të Gjatë, Përroi i Zi, Rrahu i Gjatë, Përroi i Thatë, Guri i Bardhë, Bregu i Gjërë etj.

Toponime të lidhura me bimësinë

Toponimet e ndërtuara me mjetet e shqipes, duke i kundruar në rrafsh të gjerë, na japin mundësi të shohim se aty zotëron deri në shkallën e një sistemi të tërë emërtimi mbi bazën e emrave të bimëve dhe të kafshëve, të shumtën e herës në mënyrë bashkëkohësisht të motivueshme.¹⁶Pjesa e parë e togfjalëshit zakonisht tregon se çfarë është vendi përkatës, si ara, bregu, buza, dërrasa, gropa, hija, murrizi, qafa, përroi, vreshta etj., kurse pjesa e dytë është një përcaktor i çfarësisë ose i përkatësisë. Kështu kemi:

- **Ara** + emër a mbiemër cilësor: *Ara e Thatë, Arat e Thekërzës, Arat e Bushe, Trëndafili, Arat e Pajamehut* (dru bajameje). *Ara e Robe, Arat e Gjikededes* (Gjik + Dede), *Arat e Loçe, Arat e Bushe, Arat e Lagjine,*
- **Bregu** + emër në rasën gjinore: *Bregu i Fikut, Bregu i Fikthit, Bregu i Gorricës, Bregu Lis, Bregu Mollë.*
- **Burimi** + emër në rasën gjinore: *Burimi i Halilit.*
- **Buza** + emër a mbiemër cilësor: *Buza e Pishës.*
- **Dërrasa** + emër në rasën gjinore: *Dërrasa e Lofatës.*
- **Gropa** + emër në rasën gjinore: *Gropa e Blirit, Gropa e Lëpushkës, Gropa e Thanës, Gropat e Minge, Gropa e Thanës, Gropa Arrë.*
- **Gryka** + emër në rasën gjinore: *Gryka e Barit, Grika e Rrethit Dume.*
- **Fiku** + emër në rasën gjinore: *Fiku i Qesare.*
- **Hieja** + emër në rasën gjinore: *Hieja e Blirit, Hieja e Ferrës, Hieja e Kodhimës* (Kont + Dhima).
- **Hunda** + emër në rasën gjinore: *Hunda e Xhepe.*
- **Kroi** + emër në rasën gjinore: *Kroi i Lalës, Kroi i Selman Dautit.*
- **Lejmoni** + emër në rasën gjinore: *Lejmoni i Pipe.*
- **Lëmi** + emër në rasën gjinore: *Lëmi Bredh, Lëma e Hordhece, Lëma e Kocoqeve* (Kont + Caqi),
- **Lugu** + emër në rasën gjinore: *Lugu i Druve, Lugu i Gjoveshit, Lugu i Dede, Lugu i Gegëve.*
- **Maja** + emër në rasën gjinore: *Maja e Mollës, Maja e Begos, Maja e Gjinarapes* (Gjin + Arapi), *Maja e Gjostoit* (Gjon + Stoi), *Maja e Ruçe, Maja e Jahos, Maja e Nik Gjomitrit, Maja e Lekës.*

¹⁶ Shkurtaç, Gj., *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, Tiranë, 2001, f.79.

- **Mesuni** + emër në rasën gjinore: *Mesuni i Tares*, *Mesuni i Kond Aliut.*,
- **Mulliri**+ emër në rasën gjinore: *Mulliri i Kone*, *Mulliri i Rakipe*.
- **Përroi** + emër në rasën gjinore: *Përroi i Arrës*, *Përroi i Islam Jazos*, *Përroi i Rrapit*, *Pajame Përroi i Shkozës*, *Përroi i Rrapit*, *Përroi Nikgjanës* (Nik + Gjanës), *Përroi i Haxhi Danit*.
- **Qafa**+ emër në rasën gjinore: *Qafa e Lëpjetës*, *Qafa e Qershisë*, *Qafa Kashtë*, *Qafa e Gjibratit* (Gjin + Brati), *Qafa e Mustafagjinit* (Mustafa + Gjini), *Qafa e Rude*, *Qafa e Vangjelit*.
- **Rrëza** + emër në rasën gjinore: *Rrëza e Luçe*, *Rrëza e Çikës*.
- **Shpella**+ emër në rasën gjinore: *Shpella e Zilos*, *Shpella e Kaçit*, *Shpella e Belulit*.
- **Shkalla** + emër në rasën gjinore: *Shkalla e Memo Skëne*.
- **Shtegu**+ emër në rasën gjinore: *Shtegu i Dafinës*,
- **Sheshi** + emër në rasën gjinore: *Sheshi i Thanës*,
- **Shullëri** + emër në rasën gjinore: *Shullëri i Nikreçit* (Nik + Reçi), *Shullër i Blirit*.
- **Ullinjte**+ emër në rasën gjinore: *Ullinjte e Matodashe*.
- Në këtë grup hyjnë edhe toponime që kanë në rrënjë fjalë të prejardhura nga fik, *Fiqishtë*, *Fitëgjërë* (fiq të gjerë), *Fitëzi*. Disa toponime formohen edhe nga fjalë që tregojnë vende të caktuara, pa atributivë, si : *Drizë*, *Murrizë*, *Dardhat*, *Vreshtëza*, *Trëndafilu etj*.

Toponime të lidhura me faunën (kafshët)

Materiali i gjerë toponimik i mbledhur në krahinën e Labërisë bën të dukshëm faktin që një pjesë e mirë e tyre janë të ndërtuara mbi bazën e emrave që lidhen kryesisht me kafshët. Nga shqyrtimi i hollësishëm i tyre dallohen që ato janë mbështetur mbi emra kafshësh të njohura të zonës, si: **lepuri**, **dreri**, **derri**, **dosa**, **ujku**, **dhelpra**, **sorkallja**, **kunadhja**, **macja** etj.:

Fusha e Lepurit, *Hun' e Drërit*, *Maja e Drerave*, *Qafa e Dosës*, *Qafa e Sorkadhes*, *Rrapi i Kunadhes*, *Shpella e Ariut*, *Sheshi i Lepurit*, *Vërat e Ujkut*, *Ujëti e Dhelprave*, *Bregu i Lopëve*, *Bregu i Maçes*, *Shpella e Gomarëve*, *Hauzi i Qeve*, *Qafa e Dashit*.

Ka jo pak toponime me emra të kafshëve të buta, si **gomari**, **kau** etj.:

Shpella e gomarëve, *Hauzi i Qeve*, *Qafa e Dashit*, *Bregu i Lopëve*.

Po ashtu shumë emërvende janë ngritur mbi bazën e togfjalëshave që përmbajnë emra shpendësh, si: **korbi, gabo, fajkoi, birbili, mëllëza**, etj., si: *Fytet e Gaboje, Gropa e Çinxhurit, Guri i Fajkoit, Lugu i Bletës, Lugjet e Gjarpërit, Maj' e Zogut, Qafa e Brumbullit, Qafa e Bufes, Qafa e Gjarpërit, Rrëz' e Korbit, Shkëmbi i Fajkoit, Shkëm' i Bletës, Shullëri i Sorrushit, Vëra e Gabave (zhgabave), Vër' e Korbave, Trap' i Korbave, Lugu i Birbilit, Ujë e Zogje, Shpella e Mëllezës etj.*

Ka edhe emërvende mbi bazën e erave të insekteve, sidomos me bleta, si Shkëm' i Bletës.

Toponimia e lidhur me fenë

Në krahinën e Labërisë, ndonëse në rrjedhë të shekujve popullsia ka përqafuar besimin mysliman, në toponiminë e krahinës janë të shpeshta emërtimet që përmbajnë emra shenjtore dhe fjalën qishë (kishë), manastir, që dëshmojnë gjurmët e kohëve kur atje ka pasur godina kultit të besimit të krishterë, si :

Gryka e Shëntodrit, Hunda e Shën-Dëlliut, Maja e Shën-Todrit, Matogjin (Matokrisi + Gjini, dy shenjtore), Qafa e Shëngjergjit, Shënmëhill (shën Mihali), Shënmitër;

Bregu i Qishës, Hunda e Priftit, Kisha e Katafiqe, Kisha e Tercës, Ledhet e Qishës, Lisat e Qishës, Lugu i Qishës, Maja e Gumene (nga Igumeni, që bënte lutjet kishtare), Manastiri i Markovës, Manastiri i Trohoit, Sheshi i Qishës, (shenjtore i kultit kristian), Lisat e Qishës etj.

Toponimet që përmbajnë emra të godinave të kultit të besimit mysliman janë më të pakta:

Burimi i Shehut (sheh – shërbyes fetar), Gorica e Islame, Guri i Xhamisë, Rrapi i Xhamisë, Sheshi i Dede, Maja e Dervishit, Maja e Muhametit etj.

Literaturë

1. Buda, A., (1982), "Vendi i shqiptarëve në historinë evropiane të shekujve VIII- XVIII", "Shqiptarët dhe trojet e tyre", Tiranë.
2. Buda, A., (1987), Shkrime historike, Tiranë.
3. Buda, A., (1977), Etnografia shqiptare dhe disa probleme të saj, Konferenca Kombëtare e Studimeve Etnografike, Akademia e Shkencave, Tiranë.
4. Çabej, E., (1982), Studime etimologjike në fushë të shqipës, I, Tiranë.
5. Çabej, E., (1976), Studime etimologjike në fushë të shqipës, II, Tiranë.

6. Çabej, E., (1987), Studime etimologjike në fushë të shqipes, III, Tiranë.
7. Çabej, E., Shqipja dhe gjuhët fqinje, në Studime gjuhësore, Prishtinë, IV, 1977.
8. Demiraj, Sh., (2008), Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët, Tiranë.
9. Domi, M. Çështje të toponimisë me burim të huaj, në “Shqiptarët dhe trojet e tyre”, Tiranë, 1982.
10. Memushaj, R., (2001) Lidhjet tradicionale të Kurveleshit me Vlorën, Konferenca Shkencore “Vlora në rrjedhat e kohës”, Toena, Tiranë.
11. Memushaj, R., (2004), Himara në dritën e të dhënave historike, gjuhësore dhe etnologjike, Toena, Tiranë.
12. Shkurtaj, Gj., (2013), Onomastikë dhe etnolinguistikë (botim i dytë, i rivështruar), Botimet Albas, Tiranë.
13. Shkurtaj, Gj., (2003), Sociolinguistika, SHBLU, Tiranë.
14. Shkurtaj, Gj., (2004) Etnografia e të folurit të shqipes, shblu, Tiranë.

TEORIA KEYNESIANE DHE ROLI I SHTETIT NË PLANIFIKIMIN EKONOMIK

Prof. Dr. Gëzim Selimi

Universiteti Ndërkombëtar në Strugë

g.selimi@eust.edu.mk

Abstract

This paper discusses Keynesian theory and its impact on strengthening the role of the state in the process of economic planning. History shows that economic crises in the 19th century appeared almost every 7–10 years. They were conditioned by various factors: anarchic and spontaneous entrepreneurial activity, disregard of market laws, lack of coordination and agreement on the supply side, etc. Initially, the crisis appeared in the trade sector, then in the financial sector, and later in the decline of production, falling prices, and the emergence of unemployment. The frequency of crises in the 20th century decreased. However, in 1927 a crisis began which, due to its destructive consequences, was so severe for all economic actors that the developed world should never have allowed a similar repetition. A key contribution in this regard was made by John Maynard Keynes, who proposed a series of measures.

At the center of the analysis stands John Maynard Keynes' idea that the economy is not always self-regulating; the automatic mechanism of pulling the system out of crisis had failed—private initiative and entrepreneurship could not solve this crisis on their own, and state intervention became necessary to preserve macroeconomic stability. The paper examines how fiscal and monetary policies, inspired by Keynesian theory, influence the stimulation of production, employment, and consumption, especially during periods of economic crisis. It also addresses the role of the state in designing and implementing economic plans as a tool for sustainable development and social stability. In conclusion, it is emphasized that the Keynesian approach remains one of the most important theoretical foundations for understanding public intervention in the economy and for creating effective economic planning policies.

Keywords: *economic planning, entrepreneurship, market, crisis, self-regulation*

Hyrje

Roli dhe ndikimi i shtetit në proceset ekonomike gjithmonë ka qenë një nga temat më të diskutueshme në historinë e mendimit ekonomik. Derisa teoritë klasike ekonomike (A. Smiti, D.Ricardo), mekantilistët, apo idetë e Mill-it dhe Malthus-it, mbronin idenë e një tregu vetërregullues dhe se një ndërhyrje minimale shtetërore do të kishte pasoja negative, kriza ekonomike e viteve 30 të shekullit XX ndryshoi rrënjësisht këtë qasje. Pikërisht në këtë periudhë doli në pah teoria e John Maynard Keynes, që argumentonte se shteti duhet të luajë një rol aktiv në menaxhimin e kërkesës agregate për të shmangur krizat dhe për të nxitur rritjen ekonomike.

Ky punim synon të analizojë bazat e kësaj teorie dhe ndikimin e saj në procesin e planifikimit ekonomik, duke u ndalur në mënyrën se si ndërhyrja shtetërore mund të shërbejë si instrument për stabilitet dhe zhvillim ekonomik.

Konceptet teorike dhe karakteristikat e planifikimit ekonomik

Teoritë ekonomike përbëjnë themelin teorik dhe analitik mbi të cilin ndërtohen politikat ekonomike të një shteti. Ato ndihmojnë në kuptimin e mënyrës se si funksionon ekonomia, cilat janë shkaqet e rritjes ose të krizave, si dhe si mund të arrihet zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe social. Pra, teoritë ekonomike luajnë rolin e busullës të politikëbërjes ekonomike. Ato nuk japin receta fikse, por ofrojnë parime, modele dhe instrumente mbi të cilat shtetet ndërtojnë strategjitë e zhvillimit.

Teoritë klasike të planifikimit ekonomik

Teoritë klasike të planifikimit ekonomik janë zhvilluar gjatë shekullit XVII-të deri në fillim të shekullit XX-të dhe janë ndër më të njohurat dhe më ndikueset në këtë fushë. Në vazhdim paraqesim disa prej teorive klasike të planifikimit ekonomik:

- a) *Klasikët e ekonomisë politike*, si Adam Smith, David Ricardo dhe John Stuart Mill, ata theksonin lirinë e tregut dhe rolin e vetërregullimit të tregut në planifikimin ekonomik. Ata besonin që liria e tregut dhe konkurrenca e lirë do të sillnin vetërregullim të tregut dhe rritje ekonomike të qëndrueshme. Ata kritikonin ndërhyrjen e qeverisë në treg dhe mbështetnin ide të tilla si liria e tregut, pronësia private dhe iniciativa e tregut.
- b) *Teoria e vlerës së punës dhe ndarjes së klasave* me përfaqësuesit *David Ricardo, Thomas Malthus, John Stuart Mill* si ide kryesore theksojnë se vlera e një malli përcaktohet nga sasia e punës që nevojitet për ta prodhuar, e më

- pas theksojnë nevojën për specializimi ndërkombëtar dhe avantazh krahasues, që kërkon një lloj planifikimi tregtar në nivel kombëtar.
- c) *Teoria socialiste klasike* me përfaqësuesin *Karl Marx (1818–1883)* i cili në veprën e tij “Kapitali” ka paraqitë iden bazë ku thekson se sistemi kapitalist prodhon pabarazi e kriza periodike dhe se pasuria përqendrohet në duart e një pakice. Ai mbështet planifikimin qendror dhe shoqëror të prodhimit për të eliminuar konkurrencën dhe shfrytëzimin dhe se shteti duhet të organizojë ekonominë mbi bazën e pronës shoqërore dhe të planifikojë sipas nevojave të popullit.
- d) *Teoria e “ekuilibrit natyror” të tregut* me përfaqësuesit Jean-Baptiste Say dhe neoklasikët e hershëm - ide kryesore kishin se çdo ofertë krijon kërkesën e vet (nuk ka mbingarkesë në treg). Qëndrimi ndaj planifikimit ishte se nuk nevojitet ndërhyrje shtetërore, tregu është gjithmonë në ekuilibër nëse është i lirë. Ndërhyrja e shtetit mund të shkaktojë joefikasitet.

Teoria merkantiliste

Merkantilistët theksuan rolin e rëndësishëm të eksporteve dhe importeve në rritjen ekonomike të një vendi. Ata besonin, se shteti duhet të ndërmarrë veprime për të rritur eksportet dhe për të kufizuar importet, duke përfshirë ndërhyrjet e qeverisë për të ndihmuar industrinë vendase dhe duke akumuluar rezerva.

Nëpërmjet njv tabele në formë të shkurtuar do të paraqesim qëndrimin ndaj planifikimit dhe rolin e shtetit në bazë të teorive të lartpërmendura.

Teoria / Autorët	Qëndrimi ndaj planifikimit	Roli i shtetit	Rëndësia për zhvillimin e teorisë së planifikimit
Adam Smith (liberalizmi klasik)	Kundër planifikimit qendror	Minimal – siguron rendin dhe mbrojtjen	Themel i tregut të lirë dhe planifikimit liberal
David Ricardo, Malthus, Mill	Planifikim i kufizuar sektorial	Ndërhyrje vetëm në tregti e tatime	Parashtruan konceptin e avantazhit krahasues
Karl Marx (socializmi klasik)	Pro planifikimit qendror	Shtet planifikues dhe pronë shoqërore	Themel i planifikimit socialist

Jean-Baptiste Say / Neoklasikët	Kundër ndërhyrjes	Shtet i vogël, treg i lirë	Baza e teorive liberale dhe monetariste të mëvonshme
------------------------------------	-------------------	-------------------------------	---

Teoria Keynesiane dhe planifikimin ekonomik

Në literaturën ekonomike ka një numër të konsiderueshëm të mendimtarëve ekonomik që përkrahin doktrinën e intervenimit të shtetit në ekonomi, por mbi të gjithë, duhet dalluar Keynesi.

John Maynard Keynes ishte një nga ekonomistët më me ndikim të shekullit XX. Ai solli një kthesë thelbësore në mendimin ekonomik botëror, sidomos pas krizës së madhe ekonomike të vitit 1929. Teoria e tij sfidoi idenë klasike që tregu vetërregullohet në mënyrë të përsosur dhe hodhi bazat e konceptit modern të ndërhyrjes shtetërore në ekonomi. Për Keynes-in, roli i shtetit është kyç për të ruajtur ekuilibrin makroekonomik dhe për të garantuar punësim të plotë. Bazën e teorisë së tij ai e shtjelloi në shumë punime të veta e veçanërisht tek vepra e tij “Teoria e përgjithshme mbi punësimin, kamatën dhe paratë” e cila u botua në vitin 1936.

Teoria Keynesiane u zhvillua si përgjigje ndaj krizës së madhe ekonomike të viteve 1929–1933, e cila tronditi qasjen e klasikëve ekonomik se tregu i lirë është gjithmonë i aftë të arrin ekuilibrin e tregut në bazë të kërkesës dhe ofertës. Keynes argumentoi se kërkesa agregate është faktori kyç që përcakton nivelin e prodhimit dhe punësimin. Kur kërkesa është e ulët, ekonomia bie në recesion dhe vetë tregu nuk ka mekanizma të mjaftueshëm për ta rikthyer ekuilibrin.

Qasja e Keysnit për ndërhyrjen e shtetit dha kontribut të madh veçanërisht në SHBA. Gjithçka filloi me idenë e me pas edhe me praktikën e Nwe Deal (Marrëveshja e re) në fillim të vitit 1933 dhe e cila qëndroi deri në vitin 1941. Zbatimin e menjëhershëm të detyrave që dalin nga Nwe Deal e realizoi administrata e Roosewelt-it dhe Hooverit, duke u dhënë atyre një funksion ligjor dhe të detyrueshëm. Kjo nënkuptonte që tani administrata shtetërore, për herë të parë në histori, po kryente reforma të thella dhe rrënjësore të sistemit ekonomik, përmes veprimeve sistematike dhe të organizuara. Reformimi i sistemit ekonomik amerikan përfshinte zgjidhjen e problemeve themelore: 12 milionë të të papunëve në SHBA, krizën afatgjatë të produkteve bujqësore, mospërputhjen midis prodhimit dhe konsumit dhe çështjen e rënies së prodhimit.

Parimet themelore të ndërhyrjes shtetërore

Sipas Keynes-it, shteti duhet të luajë një rol aktiv në planifikimin dhe rregullimin e ekonomisë përmes politikave fiskale dhe monetare. Tre parime janë qendrore në këtë teori:

- a) Politika fiskale aktive - Shteti duhet të përdorë buxhetin për të ndikuar në kërkesën e përgjithshme. Në kohë krize, ai duhet të rrisë shpenzimet publike (p.sh. në infrastrukturë, arsim, shëndetësi) edhe nëse kjo do të thotë rritje e borxhit publik. Kjo rrit punësimin dhe kërkesën agregate, duke nxitur prodhimin.
- b) *Rregullimi i cikleve ekonomike* - Në periudha të rritjes së tepërt, shteti mund të ulë shpenzimet ose të rrisë taksat për të shmangur mbingarkesën e ekonomisë. Ndërsa në periudha rënieje, ai duhet të ndihmojë ekonominë me politika stimuluese. Pra, shteti vepron si “rregullator i cikleve ekonomike”.
- c) *Ndërhyrja në tregun e punës dhe sektorët strategjikë* - Sipas Keynes-it, shteti duhet të garantojë një nivel të lartë punësimi dhe të mbështesë sektorët që kanë ndikim të madh në ekonominë kombëtare. Ai duhet të ndërhyjë për të parandaluar rënien e prodhimit dhe stagnimin e investimeve private.

Roli i shtetit në planifikimin ekonomik sipas Keynes-it

Në kontekstin e planifikimit ekonomik, Keynes-i nuk propozoi planifikim të centralizuar (si në modelet socialiste), por një *planifikim të pjesshëm dhe fleksibël*, ku shteti bashkëpunon me sektorin privat. Ky planifikim përfshin:

- Analizën dhe parashikimin e cikleve ekonomike.
- Përdorimin e politikave buxhetore për nxitjen e rritjes.
- Mbështetjen e investimeve publike për të stimuluar sektorët kyç dhe
- Koordinimin midis kërkesës dhe ofertës agregate për të ruajtur stabilitetin ekonomik.

Në këtë mënyrë, shteti bëhet aktori që drejton zhvillimin ekonomik pa e zëvendësuar tregun, por duke e plotësuar atë.

Planifikimi ekonomik në kuptimin Keynesian përfshin koordinimin e burimeve publike dhe private për të arritur objektiva të caktuara zhvillimore. Shteti, përmes institucioneve ekonomike dhe planeve afatmesme, përcakton prioritetet e zhvillimit, ndan resurset dhe orienton investimet në sektorët strategjikë. Ky rol bëhet veçanërisht i rëndësishëm në kohë krize, kur ekonomia kërkon ndërhyrje për të

stimuluar prodhimin dhe për të parandaluar papunësinë. Në këtë kontekst, planifikimi ekonomik shihet si instrument për të arritur qëllime makroekonomike.

Sipas Keynes-it ndërhyrja shtetërore nuk duhet të shihet si kufizim i lirisë së tregut, por si mekanizëm stabilizues. Në vendet që aplikojnë qasje Keynesiane, planifikimi ekonomik mbështetet në analiza të hollësishme statistikore, projeksione buxhetore dhe politika të koordinuara ndërmjet qeverisë dhe sektorit privat.

Analizë praktike: ndikimi i politikave Keynesiane në shtetet moderne

Edhe pse disa ekonomistë, sidomos ata të shkollës monetariste (si Milton Friedman), e kritikuan Keynes-in duke thënë se ndërhyrja e tepruar e shtetit çon në: inflacion të lartë, shtrembërim të tregjeve dhe borxhe publike afatgjata. Megjithatë, ndikimi i teorisë Keynesiane është i dukshëm në shumë ekonomi bashkëkohore. Gjatë viteve 1933–1939 Qeveria amerikane investoi në projekte publike masive, ndërtoi rrugë, ura dhe shkolla, duke ulur ndjeshëm papunësinë dhe duke gjallëruar kërkesën e brendshme. Ky ishte një shembull i qartë i planifikimit të orientuar nga shteti sipas parimeve Keynesiane. Në Britaninë e Madhe, pas Luftës së Dytë Botërore, qeveria zbatoi politika të ngjashme me theks në zhvillimin industrial dhe në shërbimet publike. U krijuan plane dhe programe kombëtare të mirëqenies sociale, u zgjerua sistemi shëndetësor dhe u nxit rritja ekonomike përmes investimeve publike. Në Shqipëri, në periudhat e tranzicionit pas viteve '90, qeveritë kanë përdorur qasje të pjesshme Keynesiane, veçanërisht në menaxhimin e krizave ekonomike dhe stimulimin e investimeve publike. Programet e rindërtimit pas krizave financiare dhe investimet infrastrukturore kanë synuar të rrisin kërkesën agregate dhe punësimin, duke reflektuar në mënyrë të tërthortë ndikimin e mendimit Keynesian.

Pas krizës financiare të vitit 2008, shumë shtete perëndimore – përfshirë SHBA-në dhe vendet e Bashkimit Evropian – ndërmorën politika fiskale stimuluese në frymën e Keynesit. Programet e investimeve publike, subvencionet për sektorët e prekur dhe ulja e normave të interesit ndihmuan në rigjallërimin e kërkesës dhe në rritjen e punësimit.

Përvoja e krizës së pandemisë COVID-19 e vërtetoi edhe njëherë nevojën për ndërhyrje publike në ruajtjen e ekuilibrit ekonomik dhe social. Pandemia shkaktoi shok të menjëhershëm të ofertës dhe kërkesës (mbyllje ekonomike), rënie e të ardhurave dhe rritje shumë të shpejtë të papunësisë. Kjo kërkoi reagim të menjëhershëm dhe koordinim fiskal-monetar. Kongresi i SHBA-ve miratoi paketën e madhe (rreth 2.2 trilion dollarë) që përfshinte: pagesa direkte për individët, zgjerim

të përfitimeve të papunësisë dhe programe për mbështetje të bizneseve. Rezerva Federale uli normat e interesit deri afër 0, rifilloi programet e sasisë së gjerë dhe krijoi një sërë ndihmash emergjente për të siguruar likuiditet për kompanitë, tregjet e kreditimit dhe për qeveritë lokale. Efekti i planifikimit ishte se nëpërmjet kombinimit të stimujve fiskalë dhe veprimeve të Rezervës Fererale u pengua një kolaps financiar dhe zbuti pasojat negative në ekonomi, u stabilizuan tregjet e borxhit, u ruajt një pjesë e vendet e punës dhe u mbështetën qeveritë lokale. Një anë negative ishte rritja e borxhit publik dhe debate mbi efikasitetin dhe drejtësinë e shpërndarjes së ndihmave (disa biznese dhe sektorë morën më shumë përfitime dhe zbatimi i programeve u përball me probleme administrimi).

Kriza e pandemisë COVID-19 nxori në pah shumë dobësi strukturore në mënyrën se si shtetet, edhe ato më të zhvilluara, planifikojnë ekonominë. Më poshtë po ta paraqes një analizë të plotë me përvojat dhe dobësitë e vërejtura për përmirësimin e planifikimit ekonomik në formë tabelore.

Aspekti	Përvojat gjatë pandemisë Covid-19	Dobësitë e vërejtura
Menaxhimi makro ekonomik	Ndërhyrje të mëdha fiskale dhe monetare për të ruajtur stabilitetin	Mungesë koordinimi ndërmjet politikave fiskale e monetare
Sistemet shëndetësore	Investime urgjente në infrastrukturën mjekësore	Mungesë rezistence dhe kapacitete të pamjaftueshme
Tregu i punës	Humbje të mëdha vendesh pune, rritje e papunësisë	Varet shumë nga sektorët informalë
Zinxhiri i furnizimit	Vonesat globale në prodhim dhe transport	Varësi e tepruar nga importet
Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme	Ndihma financiare e kufizuar	Vështirësi në qasje në kredi dhe mbijetesë
Transformimi digjital	Rritje e përdorimit të teknologjisë	Mospërgatitje teknologjike e institucioneve publike
Bashkëpunimi ndërkombëtar	Rritje e solidaritetit në disa fusha, por edhe mbyllje kufijsh	Mungesë koherence në politikat globale

Rekomandime

Keyns-i shprehu qëndrimet se tregu nuk mund të përmirësojë vetë të gjitha problemet e ekonomisë, nuk është gjithmonë në gjendje të vetërregullohet në mënyrë efikase dhe se qeveria duhet të ndërhyjë në mënyrë aktive për të ndihmuar në ekonomi. Kjo ndërhyrje e shtetit u pa si me se e nevojshme edhe gjate dy dekadave te para te shekullit XXI, respektivisht pas krizës financiare te vitit 2008 dhe pandemisë Covid 19.

Në vazhdim do të japim disa sugjerime mbi përmirësimin e veprimit të qeverive në përmirësimin e planifikimit ekonomik.

Qeveritë duhet te angazhohen në krijimin e mekanizmave të përbashkëta për menaxhimin e krizave ekonomike.

Pas pandemisë u pa e nevojshme që të bëhet integrimi i planifikimit shëndetësor në politikat ekonomike afatgjata.

Qeveritë duhet te angazhohen në mënyrë plotësuese në diversifikimin e strukturës së punës dhe promovim i ekonomisë digjitale.

Pasi u vërejt një varësi e madhe nga importi duhet bere një zhvillim i prodhimit vendor dhe strategji të vetë-mjaftueshmërisë ekonomike.

Qeveritë vazhdimisht duhet të planifikojnë krijimin e fondeve emergjente dhe programeve mbështetëse për SME-të.

Teknologjia e re ndryshoi edhe qasjen ndaj ekonomisë digjitale andaj duhet planifikuar edhe investime në infrastrukturë digjitale dhe arsimim teknologjik.

Forcim i bashkëpunimit ekonomik rajonal dhe global në situata emergjente.

Përfundime

Teoria Keynesiane ka revolucionarizuar mënyrën e të menduarit për rolin e shtetit në ekonomi. Ajo dëshmoi se mekanizmat e tregut nuk mjaftojnë gjithmonë për të siguruar ekuilibër dhe rritje të qëndrueshme. Ndërhyrja e shtetit përmes planifikimit ekonomik dhe politikave fiskale e monetare është thelbësore për të shmangur recesionet, për të mbrojtur punësimin dhe për të garantuar mirëqenie sociale. Edhe pse sfidat e ekonomisë globale sot kërkojnë qasje më fleksibile, parimet e Keynes

mbeten aktuale dhe ofrojnë bazën për politika efektive zhvillimore në kontekstin modern.

Referenca

1. Blinder, Keynesian Economics. The Concise Encyclopedia of Economics. 2008.
2. Ahmet Manxhallari, Ekonomiksi menaxherial, Tiranë, 2005.
3. Beqir Zhuta, Ekonomia politike, Shkup, 1999.
4. Branko Horvat, Politicka ekonomija socializma, Zagreb, 1982.
5. Branko Kovacevic, Uvod u ekonomiju, Zagreb, 1994.
6. Fadil Govori, Tregu financiar, Prishtinë, 1998.
7. Grup autorwsh, Hyrje në ekonomi, Tiranë, 2002.
8. Cavid Ricardo, Nacela politicke ekonomije, Zagreb, 1983.
9. J. Stiglitz, America, Free Markets, and the Sinking of the World Economy, 2010
10. Jon M Keynes, Teoria e përgjithshme e punësimit, e interesit, dhe e parasë, Tiranë, 1997.
11. Josif Andreeski, Ekonomia, Ohër, 1998.
12. Musa Limani, Politika ekonomike, Prishtinë, 1994.
13. Musa Limani, Baza e modeleve makroekonomike, Tetovë, 2002.
14. Musa Limani, Hyrje ne ekonomi, Tetovë, 2002.
15. Nasir Selimi, Biznesi ndërkombëtar, Tetovë, 2009.
16. Nasir Selimi, Ekonomia dhe biznesi, Tetovë, 2017.
17. Nasir Selimi, Hyrje ne ekonomi, Tetovë, 2008,
18. Nuri Bashota, Ekonomia politike, Prishtinë, 1998.
19. Nuri Bashota, Ekonomia, Prishtinw, 2002.
20. Skender Berisha, Marrëdhëniet ekonomike ndërkombëtare, Prishtinw, 1994.

ROLI I INTELIGJENCËS ARTIFICIALE SI FAKTOR I RI NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

MSc.Edona Amiti Abaz

International University of Struga e.amiti@eust.edu.mk

Abstrakt

Inteligjenca artificiale (IA) është shëndrruar nga një koncept kryesisht teorik në një teknologji kyçe që po përcakton zhvillimet e epokës moderne. Përparimi i shpejtë i kapaciteteve kompjuterike, zhvillimi i algoritmeve të avancuara dhe qarkullimi masiv i të dhënave në shkallë globale kanë bërë që IA të ndikojë thellësisht në fusha të ndryshme të jetës shoqërore, ekonomike dhe politike. Si rrjedhojë, kjo teknologji ka filluar të luajë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke transformuar mënyrën se si shtetet konkurrojnë, bashkëpunojnë dhe e konceptojnë sigurinë kombëtare dhe rendin global.

Ky punim ka për qëllim të analizojë inteligjencën artificiale si një faktor të ri dhe përcaktues në dinamikat bashkëkohore të marrëdhënieve ndërkombëtare. Përmes një qasjeje teorike dhe analitike, punimi shqyrton evolucionin e IA, ndikimin e saj në politikën globale, sigurinë ndërkombëtare, si dhe rolin e saj në garën teknologjike midis fuqive të mëdha. Një vëmendje e veçantë i kushtohet gjithashtu sfidave dhe rreziqëve që lidhen me përdorimin e IA, përfshirë aspektet etike, juridike dhe stabilitetin e sistemit ndërkombëtar.

Duke qënë se fuqia teknologjike është shëndrruar në një komponent thelbësor të fuqisë shtetërore, kuptimi i intëligjencës artificiale dhe i ndikimit të saj është i domosdoshëm për interpretimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të së tashmes dhe të së ardhmes. Ky punim synon t'i ofrojë lexuesit një pasqyrë të qartë dhe të thelluar mbi mënyrën se si intëligjenca artificiale po riformëson strukturat globale, duke u shndërruar në një nga variablat më të rëndësishëm të analizës politike dhe strategjike të shekullit XXI.

Fjalë kyçe: *inteligjenca atrificiale, diplomaci, marrëdhënie ndërkombëtare.*

Hyrje

Zhvillimet teknologjike kanë qënë historikisht një faktor përcaktues në evolucionin e marrëdhënieve ndërkombëtare, duke ndikuar drejtpërdrejt në balancat e fuqisë, strategjitë shtetërore dhe natyrën e konfliktëve dhe bashkëpunimit ndërmjet aktorëve ndërkombëtarë. Në këtë kontekst, inteligjenca artificiale përfaqëson një nga risitë më transformuese të kohës sonë, me potencial të jashtëzakonshëm për të ndryshuar mënyrën se si funksionon sistemi ndërkombëtar.

Në dallim nga teknologjitë tradicionale, inteligjenca artificiale karakterizohet nga aftësia për të përpunuar sasi të mëdha të dhënash, për të mësuar nga përvoja dhe për të marrë vendime në mënyrë autonome ose gjysmë-autonome. Këto veçori e kanë bërë IA një mjet strategjik për shtetët, veçanërisht në fusha si siguria kombëtare, mbrojtja, diplomacia, ekonomia globale dhe menaxhimi i informacionit. Si rezultat, teknologjia nuk shihet më vetëm si një instrument ndihmës, por si një element thelbësor i fuqisë dhe konkurrencës ndërkombëtare.

Në arenën globale, përdorimi i inteligjencës artificiale ka intensifikuar garën teknologjike midis fuqive të mëdha, duke krijuar forma të reja rivaliteti dhe duke ngritur dilema të rëndësishme lidhur me stabilitetin ndërkombëtar dhe sigurinë kolektive. Automatizimi i sistemeve ushtarake, përdorimi i algoritmeve në analizën strategjike dhe ndikimi i IA në opinionin publik përmes hapësirës digjitale janë vetëm disa nga aspektet që dëshmojnë rëndësinë e saj në politikën ndërkombëtare bashkëkohore.

Duke u nisur nga këto zhvillime, ky punim synon të trajtojë inteligjencën artificiale si një faktor të ri në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke analizuar rolin e saj në riformësimin e konceptëve tradicionale të fuqisë, sigurisë dhe rendit global. Përmes kësaj analize, synohet të ofrohet një kuptim më i thelluar mbi implikimet politike dhe strategjike të IA, si dhe mbi sfidat që ajo paraqet për të ardhmen e sistemit ndërkombëtar.

Përkufizimi i Intelligjencës

Encyclopaedia Britannica, inteligjencën artificiale (IA) e përkufizon si aftësia e një kompjuteri digjital ose e një roboti të kontrolluar nga kompjuteri për të kryer detyra që zakonisht kërkojnë inteligjencë njerëzore. Këto detyra lidhen me procese të avancuara njohëse, si arsyetimi logjik, zbulimi i kuptimeve, të mësuarit nga përvoja dhe aftësia për të përgjithësuar njohuritë në situata të reja. Në këtë kuptim, inteligjenca artificiale nuk paraqitet thjesht si një formë automatizimi mekanik, por si një fushë

shkencore dhe teknologjike që synon të imitojë ose të simulojë funksione të caktuara të mendjes njërëzore në sisteme kompjuterike.

Në analizën e saj, *Britannica* thekson se, pavarësisht përparimeve të mëdha në zhvillimin e kompjuterëve dhe teknologjive digjitale që nga vitët 1940, ende nuk ekziston një sistem apo program që të zotërojë plotësisht fleksibilitetin, kreativitetin dhe kompleksitetin e intëligjencës njërëzore. Intëligjenca njërëzore karakterizohet nga aftësia për të kuptuar kontëkstë të ndryshme, për t'u përshtatur me rrethana të reja dhe për të përdorur njohuri të përditshme në mënyrë intuitive, elementë të cilat mbetën sfiduese për sistëmet artificiale.

Megjithëse sistëmet e intëligjencës artificiale janë në gjendje të kryejnë detyra shumë të avancuara, si zgjidhja e problemeve matëmatikore, luajtja e lojërave strategjike si shahu apo analiza dhe intërpertimi i sasive të mëdha të të dhënave, këto aftësi janë zakonisht të kufizuara në fusha specifike funksionimi. Për këtë arsye, shumica e sistëmeve aktuale të intëligjencës artificiale konsiderohen si “intëligjencë e ngushtë”, e cila dallon nga intëligjenca e përgjithshme njërëzore. Ky dallim është thelbësor për të kuptuar potencialin, por edhe kufizimet e intëligjencës artificiale në kontëkstin e zhvillimeve bashkëkohore dhe të ndikimit të saj në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Historiku i intëligjencës artificiale

Zhvillimi i intëligjencës artificiale ka rrënjë të thella në disiplinat e matematikës, logjikës dhe shkencës së kompjuterëve. Themelet e IA fillojnë në mesin e shekullit XX, kur shkencetarët nisen të eksploronin mundësinë që makineritë të kryenin funksione të ngjashme me intëligjencën njërëzore. Hapat e parë teorike u vendosën nga Alan Turing, një nga figurat më të rëndësishme lidhur me mendimin rreth makinerive intëligjentë. Në vitët 1940–1950, Turing argumentoi se kompjuterët mund të imitonin procese mendore njërëzore, ndërsa në vitin 1950 propozoi “Testin e Turingut”, i cili synon të vlerësojë nëse një makinë mund të shfaqë sjellje intëligjente të dallueshme nga ajo njërëzore. Këto ide u konsideruan si pikënisje e konceptit modern të intëligjencës artificiale.

Fusha e IA u institucionalizua në vitin 1956 gjatë konferencës së famshme të Dartmouth-it, e organizuar nga John McCarthy, Marvin Minsky, Claude Shannon dhe Nathaniel Rochester. *Kjo konferencë cilësohet* si momenti zyrtar i lindjes së IA si disiplinëshkencore. Aty u përdor për herë të parë termi “artificial intëlligence”, i cili shënoi nisjen e kërkimeve të strukturuar për krijimin e makinerive intëligjente.

Vitet 1950–1960 sollën optimizëm të madh. U zhvilluan programe që arrinin të zgjidhnin probleme logjike, të luanin lojëra strategjike si shahu dhe të përpunonin gjuhen. Megjithatë, keto sisteme funksiononin vetëm nënkenare të ngushtë dhe nuk kishin fleksibilitetin e intëligjences njerëzore. Në vitin 1970, për shkak të mungesës së progresit praktik dhe kufizimeve teknike, fushën e goditi periudha e parë e të ashtuquajturit “AI winter”, ku financimi dhe interesi kërkimor u ul ndjeshëm. Në vitin 1980 pati një ringjallje të jashtëzakonshme për shkak të zhvillimit të “sistemeve eksperte”, programe të afta të imitonin ekspertizën njerëzore në fusha të veçanta, si mjekësia dhe inxhinieria. Këto sisteme u përdorën gjërësisht në industri dhe konsiderohen një nga zhvillimet më të rëndësishme të IA para epokës moderne.

Rilindja e madhe e IA ndodhi nga fundi i shekullit XX dhe fillimi i shekullit XXI. Përparimet në fuqinë kompjuterike, rritja masive e të dhënave dhe zhvillimi i rrjetëve nervore artificiale sollën epokën e “mësimin të thellë”. Sot IA përdoret në njohjen e imazheve, përpunimin e gjuhës natyrore, diagnozën mjekësore, robotikë dhe fusha të panumerta të tjera. IA nga një projekt teorik është bërë një teknologji themelore që po transformon shoqëritë dhe marrëdhëniet ndërkombëtare.¹

Llojet dhe teknologjitë kryesore të intëligjences artificiale

Deri me sot njohim një shumëllojshmëri të IA dhe teknologjive të ndryshme, të cilat luajnë funksione të ndryshme në jetën e përditshme. Mes tyre mund të përmendim:

“Narrow / Weak AI” Artificial Narrow Intëlligence (ANI)

Ky lloj IA është i specializuar për kryerjen e një detyre të vetme ose një grupi shumë të kufizuar detyrash me efikasitet të lartë.

Pjesa më e madhe e sistemeve të IA që përdoren sot i përkasin kësaj kategorie: për shembull, programe për njohje fytyre, sistemet e rekomandimit, përkthyes automatike, asistentë virtuale, etj.

ANI është shumë efiçase për detyra specifike, por nuk ka aftësi për të “menduar” apo përvetësuar njohuri të reja në fusha krejtësisht të ndryshme.

¹“History of Artificial Intëlligence.” *Encyclopaedia Britannica*, Encyclopaedia Britannica, Inc., <https://www.britannica.com/technology/artificial-intelligence/History-of-artificial-intelligence>. 7 dhjetor 2025.

“General / Strong AI” Artificial General Intelligence (AGI)

AGI është një formë IA që posedon inteligjencë të përgjithshme , do të mund të mësojë, të analizojë, të zgjidhë probleme dhe të përshtatët në kushtë të ndryshme, në mënyrë të ngjashme me njeriun.

Deri me sot, AGI mbetet me shumë një koncept teorik; nuk ka ende sisteme të plota që të arrijnë kapacitete të tilla.

“Supër AI” Artificial Supërintelligence (ASI)

ASI do të përfaqësonte një nivel inteligjence që e tejkalon atë njerëzore në të gjitha aspektet: kapacitet të mësuarit, krijimtari, problem-zgjidhje, njohuri.

Aktualisht, ASI mbetet në fushen e spekulimeve dhe diskutimeve futuristë dhe nuk ekziston ende në praktikë.

Përveç ndarjes sipas kapaciteteve (ANI, AGI, ASI), IA gjithashtu mund të klasifikohet sipas se si funksionon / reagojnë sistemet:

Reactive Machines : Sistëme që reagojnëvetëm nëbaze të të dhënave aktuale, pa “memorie” të kaluar; nuk mesojnë nga eksperiencia.

Limited Memory IA : Sistëme që mund të përdorin përvojat e kaluara për të përmiresuar veprimet e tyre ,shume nga aplikacionet modernëbartën ketu.

Theory of Mind IA : Hipotëtike; do të thotë që makina mund të kuptojë mendimet, emocionëdhe qëllimet e entitetëve të tjera ,është koncept ende nëzhvillim.

Self-Aware IA : Nëtëori, do të ishte një IA që ka vetëdije; edhe ky lloj mbetet nëfushen e spekulimeve.

Për të realizuar IA, kerkohen disa komponentë dhe metoda kryesore midis tyre: mesimi, arsyetimi, zgjidhja e problemeve, përceptimi dhe përdorimi i gjuhës .

Disa nga qasjet dhe tëknologjitë kryesore jane:

- MachineLearning (ML) : Metode nëtë cilën kompjuterët “mësojnë” nga të dhënat në vend që të programohen për çdo skenar të veçantë. ML është baza e shumicës së sistemeve moderne të IA.

- Neural Networks dhe Connectionism : Kjo qasje simulon në mënyrë abstrakte rrjetin nervor të trurit njerëzor; për shembull, lidhjet neuronale artificiale janë një prej rrugëve kryesore që mund të çojë drejt IA-se.
- Zhvillime të thella në perceptim, njohje imazhi, gjuhë natyrale, përpunim zëri, analiza të dhënash : fale ML dhe neural networks, sot është e mundur që makinat të njohin fytyra, të përkthejnë tekst, të diagnostikojnë probleme mjekësore, etj.²

Sfida, rreziqë dhe varesi

Megjithë avantazhet, përdorimi i IA si mjet fuqie shtetërore sjell edhe sfida dhe dilema:

- Pabarazi mes shtëtëve: jo të gjitha vendet kanë kapacitetet teknike, infrastrukurore dhe financiare për të zhvilluar IA ,keshtu krijohet një hendek global midis “fuqive digjitale” dhe vendeve që mbetën prapa.
- Rreziku për mbikeqyrje dhe shkelje të privacisë: përdorimi i IA për survejim, mbrojtje, siguri mund të cenojë liritë civile dhe të drejtat e njëriut , veçanërisht kur nuk ka transparencë dhe rregulla të qarta.
- Ndikimi mbi stabilitetin ndërkombëtar: zhvillimi i IA ushtarake dhe të teknologjive autonome mund të intensifikojë garën për dominim, të risë tensionet dhe të sfidojë mekanizmat ekzistuese të stabilitetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.³

Intëlligjenca artificiale si burim i ri fuqie në sistëmin ndërkombëtar

Në kontekstin e zhvillimeve bashkëkohore, intelijenca artificiale nuk përfaqëson më vetëm një mjet teknologjik për automatizim apo rritje të efikasitetit operacional, por po shndërrohet në një faktor strategjik që ndikon drejtpërdrejt në pozicionimin dhe fuqinë e shtëtëve në sistëmin ndërkombëtar. Sipas literaturës

² “Types of Artificial Intëlligence.” *GeeksforGeeks*, <https://www.geeksforgeeks.org/artificial-intëlligence/types-of-artificial-intëlligence/> 7 dhjetor 2025. “Is Artificial General Intëlligence (AGI) Possible?” *Encyclopaedia Britannica*, Encyclopaedia Britannica, Inc., <https://www.britannica.com/technology/artificial-intëlligence/Is-artificial-general-intëlligence-AGI-possible> 7 dhjetor 2025.

³ *Artificial Intëlligence in Geopolitics: Opportunities and Challenges for National Power, Digital Transformation and Administration Innovation*, journaldtIA.com, 7 dhjetor 2025, <https://www.journaldtai.com/index.php/jdtai/article/view/227> “AI, the Intërnational Balance of Power, and National Security Stratëgy,” *The Oxford Handbook of AI Governance*, Oxford University Press Academic, 7 dhjetor 2025 “Intërnational governance of advancing artificial intëlligence,” *AI & Society*, Springer, 2024, 7 dhjetor 2025 <https://link.springer.com/article/10.1007/s00146-024-02050-7>.

akademike dhe studimeve bashkëkohore, IA ka potencialin të zgjerojë dhe rikonfigurojë kapacitetet shtetërore në disa dimensione kyçe të fuqisë, duke përfshirë atë ekonomik, teknologjik, ushtarak, diplomatik dhe strategjik.

Dimensionet kryesore të fuqisë që përforcohen nga inteligjenca artificiale përfshijnë:

Kapaciteti ekonomik dhe teknologjik

Shtetet që investojnë në zhvillimin dhe aplikimin e avancuar të inteligjencës artificiale arrijnë të rrisin ndjeshëm produktivitetin, inovacionin dhe konkurrueshmërinë ekonomike. IA mundëson menaxhim më efikas të industrive, proceseve të prodhimit, shërbimeve publike dhe përpunimit të sasive të mëdha të të dhënave (big data), duke krijuar avantazh të qëndrueshëm ekonomik dhe teknologjik ndaj vendeve që mbetën prapa në këtë garë.

Kapaciteti ushtarak dhe i sigurisë

Inteligjenca artificiale po transformon thellësisht fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare. Automatizimi i analizës së informacionit, identifikimi i hershëm i kërcënimeve, përdorimi i sistemeve autonome, dronëve dhe teknologjive të mbikëqyrjes rrit ndjeshëm aftësinë e shtetit për parandalim, mbrojtje dhe reagim strategjik në një mjedis ndërkombëtar gjithnjë e më kompleks.

Fuqia strukturore dhe ndikimi teknologjik ndërkombëtar

Kontrolli mbi zhvillimin e teknologjive të reja, përfshirë inteligjencën artificiale dhe infrastrukturën digjitale, përkthehet në ndikim politik dhe diplomatik. Shtetet lidere në këtë fushë kanë aftësinë të vendosin standarde teknologjike dhe rregullatore, të eksportojnë teknologji, të kushtëzojnë bashkëpunimin ndërkombëtar dhe të menaxhojnë rrjetë globale të informacionit

Rritja e kapacitetëve jo-matëriale (soft power dhe digital power)

Zbatimi i inteligjencës artificiale në administratën publike, shëndetësi, arsim dhe shërbime digjitale kontribuon në rritjen e efikasitetit, transparencës dhe cilësisë së qeverisjes. Kjo ndikon pozitivisht në legjitimitetin e institucioneve shtetërore, në besimin qytëtar dhe në aftësinë e shtetit për të menaxhuar sfida komplekse në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Inteligjenca artificiale dhe siguria në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

Inteligjenca artificiale është shndërruar në një komponent thelbësor të arkitekturës bashkëkohore të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Aftësia e saj për të analizuar sasi të mëdha të dhënash në kohë reale, për të parashikuar sjellje dhe për të identifikuar kërcënime komplekse ka bërë që IA të integrohet gjerësisht në fushat e mbrojtjes, ushtrisë, intëligjencës dhe sigurisë kibernetike. Fuqitë kryesore botërore e konsiderojnë intëligjencën artificiale si një burim strategjik që ka potencialin të ndryshojë ekuilibrat gjeopolitikë dhe të riformësojë natyrën e konflikteve dhe konkurrencës globale.

Kontributi i intëligjencës artificiale në sigurinë kombëtare

Në nivel kombëtar, inteligjenca artificiale ka përmirësuar ndjeshëm mekanizmat e sigurisë së brendshme. Algoritmet e avancuara mundësojnë zbulimin dhe parandalimin e kërcënimeve përmes analizës së modeleve kriminale, parashikimit të aktiviteteve tërrore dhe identifikimit të sjelljeve të dyshimta në kohë reale. Po ashtu, sistëmet e mbikëqyrjes intëligjentë, përfshirë njohjen e fytyrës dhe analizën e sjelljes, rrisin kapacitetin e reagimit ndaj incidentëve.

Një fushë veçanërisht e rëndësishme është mbrojtja kibernetike, ku IA tëjkalon sistëmet tradicionale duke identifikuar sulme dhe anomali përmes mësimit të vazhdueshëm të modeleve të trafikut digjital. Megjithatë, këto përparime shoqërohen me debatë serioze mbi privatësinë, transparencën dhe rrezikun e keqpërdorimit të të dhënave personale.

Ndikimi i intëligjencës artificiale në sigurinë ndërkombëtare

Në nivel ndërkombëtar, inteligjenca artificiale po transformon mënyrën se si shtetet bashkëpunojnë dhe konkurrojnë në fushën e sigurisë. Lufta kibernetike është bërë më e sofistikuar përmes automatizimit të sulmeve dhe manipulimit të informacionit. Njëkohësisht, zhvillimi i armëve autonome ka ngritur dilema të reja strategjike, pasi sistëmet që opërojnë pa ndërhyrje njërëzore rrisin rrezikun e përshkallëzimit të paqëllimshëm të konfliktëve.

Këto zhvillime po ndikojnë drejtpërdrejt në ekuilibrat e fuqisë globale, duke krijuar një garë teknologjike midis fuqive të mëdha si SHBA, Kina dhe Rusia. Organizatat ndërkombëtare, përfshirë Kombet e Bashkuara, po përpiqën të krijojnë korniza rregullatore për përdorimin etik të IA-së dhe kufizimin e armëve autonome, por mungesa e konsensusit global mbetet një sfidë e madhe.

Intëligjenca artificiale dhe rivaliteti gjeopolitik: SHBA – Kinë – BE

Gjatë dekadës së fundit, intëligjenca artificiale është konsoliduar si një element qëndror i fuqisë shtetërore dhe konkurrencës gjeopolitike. Sipas analizave bashkëkohore, IA nuk është më thjesht një teknologji ekonomike, por një burim pushtëti global, një instrument për dominim strategjik dhe një mjet ndikimi diplomatik. Shtetët e Bashkuara dhe Kina ndodhen në qëndër të asaj që shpesh përshkruhet si një “garë për dominim në epokën digjitale”, ndërsa Bashkimi Evropian përpiqet të afirmohet përmes fuqisë rregullatore dhe standardeve etike.

Rivaliteti teknologjik SHBA–Kinë në fushën e intëligjencës artificiale

Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të mbajnë një rol udhëheqës në zhvillimin e intëligjencës artificiale, veçanërisht përmes inovacionit, investimeve privatë dhe kërkimit akademik. Universitetët elitare, kompanitë teknologjike dhe institucionet e sigurisë kombëtare e konsiderojnë IA-në si një shtyllë strategjike të ruajtjes së epërsisë globale amerikane.

Në kontrast, Kina ka ndërtuar një model të centralizuar shtetëror për zhvillimin e IA-së, duke integruar politikat publike, industrinë dhe sektorin akademik me synimin e vetë-mjaftueshmërisë teknologjike dhe kontrollit të infrastrukturës digjitale. Ky model ka prodhuar rezultate të dukshme, veçanërisht në rritjen e kapaciteteve kërkimore dhe akademike.

Të dhënat mbi publikimet shkencore tregojnë një rritje të ndjeshme të kontributit kinez në kërkimin për intëligjencën artificiale gjatë dy dekadave të fundit, duke reflektuar përparimin e shpejtë të Kinës në këtë fushë. Megjithatë, SHBA vazhdon të ruajë avantazhin në aspektin e kapitalit, infrastrukturës teknologjike dhe kompanive privatë, të cilat mundësojnë komercializimin e shpejtë të inovacioneve, një faktor kyç për ruajtjen e dominimit global.

Roli i Bashkimit Evropian

Sipas analizave në literaturë, vende si Bashkimi Evropian (BE) nuk konkurrojnë për momentin me SHBA dhe Kinën në kapacitetin industrial apo inovativ për IA, por iu përqëndrohen aspekteve etike, ligjore dhe rregullative. BE tenton të imponojë standarde të përdorimit të sigurt dhe të drejtë të IA duke synuar që teknologjia të zhvillohet me respekt për privatësinë, të drejtat e njeriut dhe transparencën. Kjo qasje mund të jetë një “armë mjeksore” në diplomacinë teknologjike dhe në formësimin e rregullave globale për IA një lloj “fuqie normative” në epokën digjitale.

Rëndësia e garës për rendin ndërkombëtar

IA ka komponent “dual-use”: civil dhe ushtarak. Aftësia për të përdorur IA në sigurinë kombëtare, spiunazh kibernetik, mbikëqyrje masive, industrinë teknologjike, dhe manipulim informacioni, e ben atë një burim të fuqise strategjike shume me të madh se inovacionet tëknologjike konvencionale.

Vendet që dominojnëIA, kontrollojnë infrastrukturen, talentin dhe të dhenat globale mund të rrisin peshen e tyre nëarenen nderkombetare, dhe ta pozicionojnëvetën si “arkitektë” të rendit digjital.

Për me tëpër, intervali i përparimit teknologjik është sot kaq i shpejtë, saqë barazimi midis supërfuqive mund të ndodhe shume shpejt, duke destabilizuar ekuilibrat ekzistues.

IA po bëhet leve kryesore e konkurrencës nderkombetare. SHBA dhe Kina janë për momentin dy supërfuqi dominuese, por BE dhe aktore të tjerë përpiqen të ndikojnë nëpërmjet rregullave dhe normave. Rendja për dominim nëIA nuk është thjesht një gare tëknologjike, është gare për formesimin e rendit global në shekullin XXI. Shtetet që arrijnë të balancojnë zhvillimin teknologjik me rregulla, etike dhe bashkëpunim ndërkombëtar do të jenë fituese jo vetëm të tregut, por edhe të pozicionit strategjik global.⁴

Intëlligjenca artificiale si faktor transformues i konfliktëve bashkëkohore

Intëlligjenca artificiale dhe lufta kibernetike

Zhvillimi i tëknologjive digjitale ka ndryshuar ndjeshëm natyrën e kërcënimeve të sigurisë, duke e shndërruar hapësirën kibernetike në një fushë të re konflikti ndërkombëtar. Lufta kibernetike përfshin sulme ndaj rrjetëve kompjuterike me synimin për të komprometuar infrastrukurat kritike, për të vjedhur informacion

⁴ “Artificial Intelligence as Factor of Geopolitical Power.” *DOAJ*, 7 dhjetor 2025

<https://doaj.org/article/12c2e361dbb34356823c2beae41ca439>

“US–China Relations in the Age of Artificial Intelligence.” *Brookings Institution*, 7 dhjetor 2025

<https://www.brookings.edu/articles/us-china-relations-in-the-age-of-artificial-intelligence/>

Goldman Sachs. “The Generative World Order: AI, Geopolitics and Power.” *Goldman Sachs Insights*

Hung, J. “Trajectories and Comparative Analysis of Global Countries Dominating AI Publications, 2000–2025.”

arXiv, 2025, 7 dhjetor 2025 <https://arxiv.org/abs/2509.25298>

stratëgjik ose për të ndikuar në proceset politike. Në këtë kontekst, inteligjenca artificiale luan një rol të dyfishtë: mbrojtës dhe sulmues.

Në aspektin mbrojtës, sistemet e bazuara në IA mundësojnë analizën e sasive të mëdha të të dhënave në kohë reale, duke identifikuar shpejt anomali, malware të panjohur dhe tentativa ndërhyrjeje që shpesh i shpëtojnë mekanizmave tradicionalë të sigurisë. Për këtë arsye, IA është bërë një element thelbësor në strategjitë kombëtare të mbrojtjes kibernetike.

Nga ana tjetër, IA ka fuqizuar ndjeshëm kapacitetët sulmuese. Automatizimi i sulmeve kibernetike, përshtatja dinamike e kodeve dhe aftësia për të imituar trafikun normal të rrjetit i bëjnë këto sulme më të vështira për t'u zbuluar. Gjithashtu, inteligjenca artificiale përdoret në fushata dezinformimi dhe ndërhyrje politike, duke gjeneruar përmbajtje të rreme, por bindëse, që synon destabilizimin e shtetëve rivale.

Integrimi i IA në sulmet ndaj infrastrukturave kritike, si energjia, financat, transporti dhe shëndetësia, përbën një dimension veçanërisht shqetësues të luftës kibernetike. Ndërkohë që kjo rrit shpejtësinë dhe efikasitetin e konfliktëve, ajo ngre dilema serioze etike dhe ligjore, sidomos për shkak të mungesës së rregullimit ndërkombëtar dhe rrezikut të automatizimit të plotë të vendimmarrjes ushtarake, çka mund të ulë pragun e fillimit të konfliktëve.⁵

Qeverisja globale e inteligjencës artificiale: sfida dhe qasje rregullatore

Zhvillimi i përshpejtuar i inteligjencës artificiale ka thelluar hendekun midis inovacionit teknologjik dhe kornizave ligjore që synojnë garantimin e përdorimit të saj të sigurt, etik dhe të përgjegjshëm. Në nivel ndërkombëtar, mungesa e një mekanizmi të unifikuar rregullimi është shndërruar në një nga sfidat më komplekse të shekullit XXI, duke nxitur shqetësime lidhur me destabilizimin politik, shkeljen e të drejtave të njëriut dhe përshkallëzimin e rivalitetëve gjeopolitike.

Një nga përpjekjet më të strukturuar rregullatore është ajo e Bashkimit Evropian, i cili ka iniciuar Aktin e Intelligjencës Artificiale (EU AI Act). Kjo kornizë

⁵ Ertan, A., Kathryn H. Floyd, Piret Përnik, dhe Tim Stëvens, eds. *Cyber Threats and NATO 2030: Horizon Scanning and Analysis*. NATO Cooperative Cyber Defence Centre of Excellence (CCDCOE), 2020. <https://ccdcoc.org/library/publications/cyber-threats-and-nato-2030-horizon-scanning-and-analysis/> Brundage, Miles, Shahar Avin, Jack Clark, et al. *The Malicious Use of Artificial Intelligence: Forecasting, Prevention, and Mitigation*. 2018. <https://arxiv.org/abs/1802.07228> Nye, Joseph S. "Protecting Democracy in an Era of Cyber Information War." Belfer Centër for Science and International Affairs, Harvard Kennedy School, Feb. 2019. <https://www.hks.harvard.edu/publications/protecting-democracy-era-cyber-information-war> 7 dhjetor 2025

synon klasifikimin e sistëmeve të IA sipas niveleve të rrezikut dhe vendosjen e detyrimeve të qarta për zhvilluesit dhe përdoruesit e tyre. Qasja evropiane mbështetët në parime themelore si transparenca, mbikëqyrja njerëzore, mbrojtja e të dhënave personale dhe siguria, duke u konsideruar gjërësisht si një model referues për qëverisjen e IA-së në shkallë globale.

Në plan më të gjërë ndërkombëtar, Organizata e Kombeve të Bashkuara ka ndërmarrë iniciativa për ndërtimin e standardeve normative për intëligjencën artificiale, veçanërisht përmes UNESCO-s. “Rekomandimi për Etikën e Intëligjencës Artificiale” i miratuar në vitin 2021 synon krijimin e një kuadri universal që promovon drejtësinë algoritmike, mosdiskriminimin, mbrojtjen e privatësisë dhe transparençën. Megjithatë, karakteri jo-detyrues i këtyre dokumenteve kufizon efektivitetin e tyre praktik.

Ndërkohë, fuqitë kryesore teknologjike, si Shtetët e Bashkuara dhe Kina, ndjekin modele të ndryshme rregullimi të ndikuara nga prioritetët e tyre strategjike. SHBA favorizon një qasje më fleksibile të orientuar drejt inovacionit dhe sigurisë kombëtare, ndërsa Kina aplikon kontroll të centralizuar shtetëror mbi zhvillimin dhe përdorimin e IA-së. Këto qasje konkurruese ndikojnë drejtpërdrejt në formësimin e standardeve globale, shpesh duke reflektuar rivalitetin gjeopolitik mes tyre.

Një nga çështjet më të ndjeshme mbetet rregullimi ndërkombëtar i sistëmeve të armëve të bazuara në intëligjencë artificiale, veçanërisht i armëve autonome. Pavarësisht thirrjeve për ndalim ose kufizim, negociatat brenda kuadrit të Kombeve të Bashkuara kanë avancuar ngadalë për shkak të mospajtimeve politike, mungesës së transparençës teknologjike dhe intëresave të kundërta strategjike.

Në përfundim, qëverisja ndërkombëtare e intëligjencës artificiale kërkon një ekuilibër delikat ndërmjet nxitjes së inovacionit dhe garantimit të sigurisë kolektive, si dhe midis konkurrencës shtetërore dhe përgjegjësisë globale. Në mungesë të standardeve të përbashkëta dhe mekanizmave detyrues, rreziqët e abuzimit me IA, intënsifikimit të konfliktëve dhe thellimit të pabarazive ndërkombëtare mbeten të larta.

Përspektivat e ardhshme të intëligjencës artificiale në marrëdhëniet ndërkombëtare

Zhvillimi i intëligjencës artificiale pritët të ndikojë thellësisht evolucionin e marrëdhënieve ndërkombëtare, duke transformuar mënyrën se si shtetët bashkëpunojnë, konkurrojnë dhe menaxhojnë sfidat globale. Automatizimi, analiza e

avancuar e të dhënave dhe modelimi parashikues po rikonfigurojnë balancat e fuqisë dhe mekanizmat e vendimmarrjes në nivel global. Për shkak të kompleksitetit të këtij ndikimi, literatura akademike identifikon disa skenarë kryesorë mbi të cilët mund të zhvillohet rendi ndërkombëtar.

Dominimi teknologjik dhe rivaliteti i fuqive të mëdha

Në këtë skenar, fuqitë kryesore si Shtetet e Bashkuara, Kina dhe Bashkimi Evropian intensifikojnë konkurrencën për epërsi në zhvillimin e inteligjencës artificiale. SHBA ruan avantazhin në inovacion dhe sektorin privat, Kina përparon përmes investimeve të centralizuara dhe shfrytëzimit masiv të të dhënave, ndërsa BE pozicionohet si lider në standardet etike dhe rregullatore. Kjo dinamikë çon drejt formimit të “bllloqëve teknologjike”, me ndikim të drejtpërdrejtë në aleanca, tregti dhe siguri ndërkombëtare.

Bashkëpunimi global dhe qëverisja e përbashkët

Një skenar më optimist parashikon krijimin e mekanizmave të rinj ndërkombëtarë për rregullimin e inteligjencës artificiale. Në këtë kontekst, zhvillohen kode sjelljeje, marrëveshje për kufizimin e armëve autonome dhe instrumente transparence midis shtetëve. IA shndërrohet në mjet për adresimin e problemeve globale, si ndryshimet klimatike, pandemitë dhe siguria ushqimore, ndërsa suksesi i këtij skenari varet nga vullneti politik dhe ndërtimi i besimit ndërkombëtar.

Militarizimi i përshkallëzuar i inteligjencës artificiale

Ky skenar paraqet rreziqe të konsiderueshme për stabilitetin global, pasi inteligjenca artificiale përdoret gjithnjë e më shumë në sistemet e armëve autonome, luftën kibernetike dhe operacionet e informacionit. Automatizimi i vendimmarrjes ushtarake mund të ulë pragun e përshkallëzimit të konfliktëve, të rrisë rrezikun e incidentëve të paqëllimshme dhe të dobësojë normat ekzistuese të sigurisë ndërkombëtare.

Fragmentimi i hapësirës digjitale globale

Në këtë skenar, sistemi ndërkombëtar ndahet në arkitektura të veçanta digjitale dhe rregullatore. Kufizimet në qarkullimin e të dhënave, barrierat teknologjike dhe politikat protëksionistë çojnë drejt një “splintërnëti”, duke penguar bashkëpunimin ndërkombëtar, tregtinë globale dhe ndërtimin e besimit mes aktorëve shtetërorë.

Rendi i ri ndërkombëtar i bazuar në teknologji

Në një perspektivë afatgjatë, disa analiza sugjerojnë shfaqjen e një rendi të ri global, ku fuqia e shtëtëve matët kryesisht nga kapacitetët teknologjike dhe aftësia për të zhvilluar e kontrolluar sistemet e inteligjencës artificiale. Në këtë kontekst, edhe shtëtët e vogla që investojnë strategjikisht në teknologjitë emergjentë mund të rrisin rolin e tyre në arenën ndërkombëtare, duke sfiduar hierarkitë tradicionale të fuqisë.⁶

Inteligjenca artificiale dhe manipulimi i informacionit

Inteligjenca artificiale (IA) përfaqëson një fushë të avancuar teknologjike që u mundëson sistemeve digjitale të analizojnë të dhëna, të mësojnë dhe të veprojnë në mënyrë të ngjashme me inteligjencën njërëzore. Në kontekstin e marrëdhënieve ndërkombëtare, IA është shndërruar në një instrument të fuqishëm për ndikim informativ, duke u përdorur për manipulimin e opinionit publik, shpërndarjen e dezinformimit dhe përforcimin e propagandës politike në nivel ndërkombëtar.

Përmes përdorimit të teknikave të avancuara algoritmike, aktorët shtëtorë dhe jo-shtëtorë mund të ndikojnë perceptimet e qytetarëve në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të fshehtë, duke dobësuar besimin në institucionet demokratike dhe në rendin ndërkombëtar.

Metodat kryesore të manipulimit informativ të bazuara në IA

Deepfakes dhe keqinformimi vizual

Një nga format më të rrezikshme të manipulimit është përdorimi i teknologjisë deepfake, e cila mundëson krijimin e videove, audios ose imazheve të rreme, por shumë bindëse, që imitojnë liderë politikë, diplomatë ose figura publike. Këto përmbajtje mund të përdoren për të diskredituar individë apo institucione, për të prishur negociata ndërkombëtare, për të ndërhyrë në zgjedhje ose për të shkaktuar tënsione diplomatike.

Shembull: një video e rreme e një kryeministri që shpall luftë ndaj një shteti tjetër, duke nxitur panik dhe paqëndrueshmëri ndërkombëtare.

⁶ Brace for Impact : Facing the AI Revolution and Geopolitical Shifts in a Future Scenario for 2025-20407 dhjetor 2025 <https://www.mdpi.com/2075-4698/14/9/180> Exploring the Societal and Economic Impacts of Artificial Intelligence: A Scenario Generation Methodology 7 dhjetor 2025 <https://arxiv.org/abs/2504.01992>

Automatizimi i propagandës digjitale

IA mundëson përdorimin masiv të botëve dhe llogarive të rreme në rrjetët sociale për të shpërndarë përmbajtje manipulative në shkallë të gjerë. Këto mjetë përdoren për të ndikuar rezultatët zgjedhore, për të rritur ose ulur mbështetjen ndaj qeverive dhe për të diskredituar media apo organizata ndërkombëtare.

Shembull: gjatë zgjedhjeve në disa vende përfundimtare, mijëra botë automatike shpërndanë lajme të rreme në platforma sociale për të ndikuar opinionin publik dhe orientimin politik.

Profilizimi i opinionit përmes analizës së të dhënave

Përmes përpunimit të të dhënave personale dhe të sjelljes në rrjetë sociale, IA mund të krijojë profile të detajuara të individëve. Këto profile përdoren për marketing politik të synuar, duke dërguar mesazhe të personalizuar që ndikojnë bindjet dhe vendimmarrjen politike, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar.

Rasti “AI-Putin” si ilustrim i rrezikut të deepfake-ve

Një shembull domethënës i potencialit manipulues të IA-së është rasti i njohur si “AI-Putin”. Në fund të vitit 2023, gjatë një emisioni televiziv pyetje-përgjigje me qytetarë, u shfaq një video ku Vladimir Putin paraqitet duke bërë një pyetje si student nga Shën Petërburgu. Në fakt, bëhej fjalë për një version artificial të krijuar me inteligjencë artificiale, i cili imitonte në mënyrë shumë realistë pamjen, zërin dhe mimikën e tij.

Pyetja e drejtuar lidhej me rreziqet e inteligjencës artificiale dhe teoritë për ekzistencën e “doppelganger”-ëve të Putinit. Reagimi i liderit rus, i cili u shfaq i habitur për disa çastë, nxori në pah nivelin e lartë të realizmit të kësaj teknologjie dhe rreziqët që ajo paraqet për besueshmërinë e informacionit publik.

Ky rast demonstroi qartë se si inteligjenca artificiale mund të përdoret jo vetëm për argëtim apo eksperiment teknologjik, por edhe si mjet potencial për manipulim politik, dezinformim dhe destabilizim në marrëdhëniet ndërkombëtare.⁷

⁷ <https://youtu.be/KbaKTz9FW2E>

Konkluzion

Ky punim heritage trajtoi inteligjencën artificiale si një faktor të ri dhe me ndikim të thellë në marrëdhëniet ndërkombëtare bashkëkohore. Analiza tregoi se zhvillimi i shpejtë i kësaj teknologjie ka ndryshuar mënyrën se si shtëtët e përceptojnë fuqinë, sigurinë dhe pozicionimin e tyre në rendin ndërkombëtar. Intëligjenca artificiale nuk paraqitët më vetëm si një mjet teknik, por si një element strategjik që ndikon drejtpërdrejt në dinamikat globale.

Gjatë punimit u theksua se IA ka krijuar forma të reja konkurrence dhe bashkëpunimi ndërmjet aktorëve ndërkombëtarë, veçanërisht në kontëkstin e garës teknologjike dhe të sigurisë ndërkombëtare. Ajo ka ndikuar në transformimin e politikës globale, duke sfiduar konceptët tradicionale të sovranitëtit, balancës së fuqisë dhe kontrollit shtëtëror. Në të njëjtën kohë, intëligjenca artificiale ka hapur debatë të rëndësishme mbi etikën, përgjegjësinë dhe rregullimin ndërkombëtar të teknologjive të avancuara.

Si temë heritage, ky punim synoi të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme dhe reflektuese mbi rolin e inteligjencës artificiale në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke e vendosur këtë fenomen në kontekstin e zhvillimeve globale të shekullit XXI. Përfundimisht, mund të konstatohet se inteligjenca artificiale përfaqëson një nga sfidat dhe mundësitë më të mëdha për sistemin ndërkombëtar bashkëkohor, ndikimi i së cilës do të vazhdojë të thellohet në të ardhmen.

Referenca

1. “Artificial Intelligence.” *Encyclopaedia Britannica*, Encyclopaedia Britannica, Inc., <https://www.britannica.com/technology/artificial-intelligence>
2. “History of Artificial Intelligence.” *Encyclopaedia Britannica*, Encyclopaedia Britannica, Inc., <https://www.britannica.com/technology/artificial-intelligence/History-of-artificial-intelligence>.
3. “Types of Artificial Intelligence.” *GeeksforGeeks*, <https://www.geeksforgeeks.org/artificial-intelligence/types-of-artificial-intelligence/>
4. “Is Artificial General Intelligence (AGI) Possible?” *Encyclopaedia Britannica*, Encyclopaedia Britannica, Inc.,

- <https://www.britannica.com/technology/artificial-intelligence/Is-artificial-general-intelligence-AGI-possible>
5. *Artificial Intelligence in Geopolitics: Opportunities and Challenges for National Power, Digital Transformation and Administration Innovation*, journaldtIA.com, <https://www.journaldtai.com/index.php/jdtai/article/view/227>
 6. “AI, the International Balance of Power, and National Security Strategy,” *The Oxford Handbook of AI Governance*, Oxford University Press Academic,
 7. “International governance of advancing artificial intelligence,” *AI & Society*, Springer, 2024, <https://link.springer.com/article/10.1007/s00146-024-02050-7>.
 8. Allen, Gregory C., and Taniel Chan. *Artificial Intelligence and National Security*. Belfer Center for Science and International Affairs, Harvard Kennedy School, July 2017. <https://www.belfercenter.org/publication/artificial-intelligence-and-national-security>
 9. Afsah, Ebrahim. “Artificial Intelligence, Law, and National Security.” *The Cambridge Handbook of Responsible Artificial Intelligence: Interdisciplinary Perspectives*, edited by Silja Vöneky, Philipp Kellmeyer, Oliver Mueller, and Wolfram Burgard, Cambridge University Press, 2022, pp. 447–474. <https://doi.org/10.1017/9781009207898.035>.
 10. “Artificial Intelligence as Factor of Geopolitical Power.” *DOAJ*, <https://doaj.org/article/12c2e361dbb34356823c2beae41ca439>
 11. “US–China Relations in the Age of Artificial Intelligence.” *Brookings Institution*, <https://www.brookings.edu/articles/us-china-relations-in-the-age-of-artificial-intelligence/>
 12. Goldman Sachs. “The Generative World Order: AI, Geopolitics and Power.” *Goldman Sachs Insights*
 13. Hung, J. “Trajectories and Comparative Analysis of Global Countries Dominating AI Publications, 2000–2025.” *arXiv*, 2025, <https://arxiv.org/abs/2509.25298>
 14. Ertan, A., Kathryn H. Floyd, Piret Pernik, dhe Tim Stevens, eds. *Cyber Threats and NATO 2030: Horizon Scanning and Analysis*. NATO Cooperative Cyber Defence Centre of Excellence (CCDCOE), 2020. <https://ccdcoe.org/library/publications/cyber-threats-and-nato-2030-horizon-scanning-and-analysis/>

15. Brundage, Miles, Shahar Avin, Jack Clark, et al. *The Malicious Use of Artificial Intelligence: Forecasting, Prevention, and Mitigation*. 2018. <https://arxiv.org/abs/1802.07228>
16. Nye, Joseph S. "Protecting Democracy in an Era of Cyber Information War." Belfer Center for Science and International Affairs, Harvard Kennedy School, Feb. 2019. <https://www.hks.harvard.edu/publications/protecting-democracy-era-cyber-information-war>
17. Brace for Impact : Facing the AI Revolution and Geopolitical Shifts in a Future Scenario for 2025-2040 <https://www.mdpi.com/2075-4698/14/9/180>
18. Exploring the Societal and Economic Impacts of Artificial Intelligence: A Scenario Generation Methodology <https://arxiv.org/abs/2504.01992>
19. <https://www.assajournal.com/index.php/36/article/download/753/1105>

SULMET RANSOMWARE: ANALIZA, PARANDALIMI DHE RIKUPERIMI

Msc. Vjola Beqo¹

v.beqo@eust.edu.mk

Msc. Denisa Hani²

d.hani@eust.edu.mk

Abstrakt

Sulmet ransomware përbëjnë një nga kërcënimet më serioze dhe në rritje në fushën e sigurisë kibernetike, duke shkaktuar humbje të konsiderueshme financiare, ndërprerje të shërbimeve kritike dhe kompromentim të të dhënave. Ky punim synon të analizojë mekanizmat kryesorë të sulmeve ransomware, duke përfshirë vektorët e infektimit, teknikat e enkriptimit dhe modelet e shantazhit dixhital të përdorura nga sulmuesit. Gjithashtu, trajtohen strategjitë bashkëkohore të parandalimit, siç janë përdorimi i sistemeve të zbulimit dhe parandalimit të ndërhyrjeve, kopjet rezervë të sigurta, trajnimi i përdoruesve dhe arkitekturat Zero Trust. Një vëmendje e veçantë i kushtohet fazës së rikuperimit pas sulmit, duke analizuar praktikatat më efektive për restaurimin e sistemeve, menaxhimin e incidenteve dhe minimizimin e ndikimit operacional. Në përfundim, punimi thekson rëndësinë e një qasjeje të integruar dhe proaktive për menaxhimin e rrezikut nga ransomware, duke kombinuar teknologjinë, politikatat organizative dhe ndërgjegjësimin njerëzor.

Fjalë kyçe: *Ransomware, Siguri kibernetike, Sulme kibernetike, Enkriptim i të dhënave, Parandalimi i sulmeve, Menaxhimi i incidenteve, Zero Trust Architecture*

Hyrje

Në dekadat e fundit, transformimi digjital ka ndikuar thellësisht në mënyrën se si organizatat menaxhojnë informacionin, ofrojnë shërbime dhe ndërveprojnë me përdoruesit. Sistemet informatike janë bërë komponentë kritikë të infrastrukturës organizative, duke rritur ndjeshëm varësinë nga teknologjia e informacionit. Megjithatë, ky zhvillim i shpejtë ka sjellë edhe një rritje proporcionale të kërcënimeve kibernetike, të cilat paraqesin rreziqe serioze për sigurinë, stabilitetin dhe vazhdimësinë e operacioneve digjitale.

Ndër këto kërcënime, sulmet ransomware janë shfaqur si një nga format më të sofistikuar dhe me ndikimin më të madh ekonomik dhe shoqëror. Ransomware përkufizohet si një kategori malware-i që synon kufizimin e aksesit në të dhëna ose sisteme përmes enkriptimit ose bllokimit funksional, me qëllim përfitimin financiar përmes pagesës së shpërblimit¹. Në dallim nga format e tjera të malware-it, ransomware kombinon komponentë teknike me strategji psikologjike të shantazhit digjital, duke e bërë atë veçanërisht efektiv.

Evolucioni i sulmeve ransomware reflekton zhvillimin e ekosistemit të kimit kibernetik. Modelet moderne të sulmeve, si *double extortion* dhe *ransomware-as-a-service (RaaS)*, kanë transformuar ransomware-in nga një mjet teknik në një industri kriminale të organizuar, me role të ndara, struktura fitimi dhe zinxhirë furnizimi digjitalë². Kjo ka çuar në rritjen eksponenciale të numrit të incidenteve dhe në zgjerimin e gamës së objektivave, përfshirë sektorë kritikë si shëndetësia, energjia, financa dhe administrata publike.

Në këtë kontekst, siguria kundër ransomware nuk mund të trajtohet më si një çështje thjesht teknike. Ajo kërkon një qasje që përfshin politika organizative, menaxhim rreziku, ndërgjegjësim të përdoruesve dhe përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të sigurisë. Qëllimi i këtij punimi është të ofrojë një analizë të thelluar teorike dhe praktike të sulmeve ransomware, duke shqyrtuar mekanizmat e funksionimit, rreziqet kryesore, masat parandaluese dhe strategjitë e rikuperimit pas incidenteve të sigurisë.

Ransomware dhe Modelet e Sulmit

Ransomware përhapet përmes një sërë vektorësh sulmi, ndër të cilët më të zakonshmit janë email-et phishing, shfrytëzimi i dobësive në sisteme operative dhe aplikacione të papërditësuara, si dhe instalimi i softuerëve të rremë të maskuar si programe legjitime. Në disa raste, sulmuesit sigurojnë akses përmes vjedhjes së kredencialeve ose sulmeve ndaj shërbimeve të aksesit në distancë, si Remote Desktop Protocol³. Pas depërtimit fillestar, malware-i përhapet në mënyrë laterale brenda rrjetit dhe aktivizon procesin e enkriptimit duke përdorur algoritme të forta kriptografike.

¹ Kharraz, A., Robertson, W., Balzarotti, D., Bilge, L., & Kirda, E. (2015). Cutting the Gordian knot: A look under the hood of ransomware attacks. *DIMVA*.

² Conti, M., Gangwal, A., & Ruj, S. (2018). On the economic significance of ransomware campaigns. *Computers & Security*, 79, 162–189.

³ <https://www.akamai.com/glossary/what-are-the-types-of-ransomware>

Viktima përballet me një mesazh shantazhues që përmban udhëzime për pagesën e shpërblimit, megjithëse pagesa nuk garanton rikuperimin e plotë të të dhënave.

Nga pikëpamja konceptuale, ransomware klasifikohet në disa forma kryesore. Crypto-ransomware është varianti më i përhapur dhe synon enkriptimin e drejtpërdrejtë të skedarëve. Një formë më e avancuar është leakware, e njohur edhe si ransomware me zvatje të dyfishtë, ku përveç enkriptimit kërcënohet publikimi i të dhënave të ndjeshme. Forma të tjera përfshijnë locker ransomware, që bllokoi aksesin në pajisje, ransomware të bazuar në sulme të shpërndara të mohimit të shërbimit (DDoS)⁴, modelin kriminal ransomware-as-a-service, si dhe scareware, i cili synon frikësimin e përdoruesit pa realizuar realisht enkriptim. Këto variante tregojnë kompleksitetin dhe evolucionin e vazhdueshëm të këtij fenomeni kriminal.

Modelet më bashkëkohore, si double extortion, përfaqësojnë një evolucion të rëndësishëm të ransomware-it. Në këto sulme, të dhënat jo vetëm që enkriptohen, por edhe vidhen dhe kërcënohet publikimi i tyre në rast të mos-pagesës së shpërblimit. Ky mekanizëm rrit ndjeshëm presionin mbi viktimat, veçanërisht organizatat që përpunojnë të dhëna sensitive⁵. Një zhvillim veçanërisht shqetësues është shfaqja e Ransomware-as-a-Service (RaaS), i cili funksionon si një model biznesi kriminal. Në këtë model, zhvilluesit e ransomware-it ofrojnë platforma dhe mjete sulmi për aktorë të tjerë, kundrejt një përqindjeje të fitimit. Ky fenomen ka ulur ndjeshëm barrierat teknike për hyrjen në krimin kibernetik dhe ka kontribuar në profesionalizimin e sulmeve ransomware⁶.

Kërcënimet dhe Rreziqet e Sigurisë (Raste konkrete)

Ransomware përfaqëson një nga kërcënimet më të rënda të sigurisë kibernetike për organizatat moderne, për shkak të ndikimit të tij të drejtpërdrejtë në disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e informacionit⁷. Ky lloj malware-i synon paralizimin e sistemeve informatike përmes enkriptimit të të dhënave kritike, duke shkaktuar ndërprerje të operacioneve dhe humbje të

⁴ <https://aksk.gov.al/>

⁵ ENISA. (2022). *ENISA Threat Landscape for Ransomware Attacks*.

⁶ Conti, M., Gangwal, A., & Ruj, S. (2018). On the economic significance of ransomware campaigns. *Computers & Security*, 79, 162–189.

⁷ R. Anderson et al., "Measuring the changing cost of cybercrime," *Journal of Cybersecurity*, vol. 5, no. 1, pp. 1–27, 2019

konsiderueshme financiare, veçanërisht në sektorë me infrastrukturë kritike si shëndetësia dhe administrata publike ⁸.

Një nga rreziqet kryesore të ransomware-it është humbja e aksesit në të dhëna jetike për funksionimin e organizatës, e cila ndikon drejtpërdrejt në vazhdimësinë e biznesit dhe cilësinë e shërbimeve ⁹. Në mungesë të kopjeve rezervë funksionale, organizatat përballen me presion të lartë për pagesën e shpërblimit, megjithëse pagesa nuk garanton rikuperimin e plotë ose të sigurt të të dhënave .

Një nga sulmet më të njohura ransomware është WannaCry, i cili ndodhi në vitin 2017 dhe preku mbi 200,000 sisteme kompjuterike në më shumë se 150 shtete. Ky sulm shfrytëzoi dobësinë EternalBlue në sistemet operative Microsoft Windows dhe goditi veçanërisht sektorin e shëndetësisë, përfshirë Shërbimin Kombëtar Shëndetësor të Mbretërisë së Bashkuar (NHS). WannaCry tregoi qartë rrezikun që paraqesin sistemet e papërditësuara dhe ndikimin që ransomware mund të ketë në infrastrukturat kritike ¹⁰.

Një rast tjetër domethënës është sulmi ndaj Colonial Pipeline në vitin 2021, ku ransomware DarkSide çoi në ndërprerjen e furnizimit me karburant në Shtetet e Bashkuara. Ky sulm tregoi se ransomware nuk përbën vetëm një rrezik për të dhënat, por edhe për sigurinë ekonomike dhe shoqërore, duke ndikuar drejtpërdrejt në jetën e përditshme të qytetarëve ¹¹.

Ryuk është një familje ransomware-i e shfaqur për herë të parë në vitin 2018, e njohur për sulme të targetuara ndaj organizatave të mëdha dhe për kërkesa shumë të larta financiare. Në dhjetor 2018, Ryuk shkaktoi ndërprerje serioze në industrinë e medias, duke prekur Tribune Publishing, si dhe gazetat *The New York Times* dhe *The Wall Street Journal*, çka çoi në probleme të shpërndarjes së botimeve në disa shtete të SHBA-së. Sipas *CrowdStrike 2020 Global Threat Report*, Ryuk ishte përgjegjës për 3 nga 10 kërkesat më të mëdha për shpërblim gjatë vitit 2020, me shuma që arritën në 5.3 milionë USD, 9.9 milionë USD dhe 12.5 milionë USD¹².

⁸ Europol, *Internet Organised Crime Threat Assessment (IOCTA)*, Europol Innovation Lab, 2023.

⁹ N. Scaife, H. Carter, P. Traynor, and K. R. B. Butler, "Cryptolock (and drop it): Stopping ransomware attacks on user data," in *Proc. IEEE ICDCS*, 2016, pp. 303–312.

¹⁰ Europol. (2017). *Internet Organised Crime Threat Assessment (IOCTA)*. Europol.

¹¹ FBI. (2021). *DarkSide ransomware: Indicators of compromise*. Federal Bureau of Investigation.

¹² https://www.trendmicro.com/en_us/what-is/ransomware/ryuk-ransomware.html

Ryuk është një variant i ransomware-it Hermes dhe përdor një strategji sulmi të njohur si “big game hunting”, e cila synon organizata me kapacitet të lartë financiar. Operacionet e tij i atribuohen kryesisht grupit kibernetik rus WIZARD SPIDER¹³, si dhe aktorit kërcënues UNC1878 për disa sulme specifike ndaj sektorit të shëndetësisë. Infektimi nuk realizohet drejtpërdrejt, por përmes instalimit paraprak të malware-ve të tjerë që përgatisin mjedisin e sulmit.

Nga aspekti teknik, Ryuk është veçanërisht agresiv, pasi pas infektimit çaktivizon rreth 180 shërbime dhe 40 procese në sistem, duke neutralizuar mekanizmat mbrojtës dhe duke siguruar realizimin efektiv të procesit të enkriptimit. Këto karakteristika e rendisin Ryuk ndër format më të rrezikshme dhe më të sofistikuar të ransomware-it në nivel global.

Parandalimi i Sulmeve Ransomware

Hapi i parë konsiston në zhvillimin e politikave dhe procedurave të reagimit ndaj incidenteve. Organizatat duhet të krijojnë plane të qarta reagimi që përcaktojnë përgjegjësitë, mënyrat e komunikimit dhe ekipet e përfshira, përfshirë IT-në, sektorin ligjor dhe administrativ. Këto plane duhet të testohen rregullisht përmes ushtrimeve praktike (tabletop exercises) dhe të rishikohen periodikisht për t’u përshtatur me ndryshimet organizative dhe teknologjike¹⁴.

Hapi i dytë lidhet me ruajtjen dhe menaxhimin e kopjeve rezervë (backup), e cila konsiderohet masa më efektive për rikuperimin pas një sulmi ransomware. Backup-et duhet të jenë të mbrojtura, të izoluar offline ose jashtë rrjetit kryesor dhe të testohen rregullisht për funksionalitet dhe integritet. Në rast incidenti, është thelbësore të verifikohet që backup-et nuk janë të infektuara përpara restaurimit të të dhënave.

Hapi i tretë përqendrohet në njohjen e sipërfaqes së sulmit dhe forcimin e rrjetit. Kjo përfshin krijimin e inventarëve të asetëve harduerike dhe softuerike, konfigurimin e sigurt të sistemeve dhe reduktimin e ekspozimit të shërbimeve të panevojshme. Përditësimi i rregullt i sistemeve operative dhe aplikacioneve, si dhe rritja e dukshmërisë së rrjetit përmes diagrameve dhe menaxhimit të llogarive të përdoruesve, janë masa kyçe për reduktimin e rrezikut.

¹³ Europol. (2020). *Internet Organised Crime Threat Assessment (IOCTA)*. Europol.

¹⁴ <https://www.cisecurity.org/insights/blog/7-steps-to-help-prevent-limit-the-impact-of-ransomware>

Në kuadër të kontrollit të aksesit, rekomandohet përdorimi i autentikimit me shumë faktorë (MFA)¹⁵ për aksesin në distancë, VPN-të dhe burimet kritike, si dhe zbatimi i politikave të forta të fjalëkalimeve dhe bllokimit të llogarive pas përpjekjeve të pasuksesshme. Për më tepër, implementimi i sistemeve të zbulimit të ndërhyrjeve (IDS) ndihmon në identifikimin e hershëm të aktivitetit keqdashës përpara se të aktivizohet ransomware-i.

Hapi i katërt lidhet me mbrojtjen e pajisjeve fundore (endpoints)¹⁶. Meqenëse ransomware-i evoluon vazhdimisht, mbrojtja nuk duhet të mbështetet vetëm në nënshkrime të njohura, por edhe në monitorim të vazhdueshëm dhe reagim në kohë reale. Zgjidhjet e avancuara të detektimit dhe reagimit në endpoint ndihmojnë në bllokimin e kërcënimeve të njohura dhe të panjohura, izolimin e skedarëve të dëmshëm dhe analizën post-incident për të parandaluar sulme të ngjashme në të ardhmen.

Një vektor i shpeshtë i infektimit me ransomware është phishing-u, prandaj ndërgjegjësimi dhe trajnimi i përdoruesve përbëjnë një komponent thelbësor të parandalimit. Programet e rregullta të trajnimit ndihmojnë përdoruesit të identifikojnë email-et mashtruese, lidhjet e dyshimta dhe bashkëngjitjet e rrezikshme, duke reduktuar rrezikun e komprometimit të sistemeve¹⁷. Filtrimi i avancuar i email-eve dhe politikat e sigurisë për bashkëngjitjet forcojnë më tej mbrojtjen.

Arkitekturat moderne të sigurisë, si Zero Trust, ofrojnë një qasje të avancuar për kufizimin e aksesit dhe minimizimin e përhapjes së sulmeve brenda rrjetit. Kjo qasje bazohet në parimin se asnjë përdorues ose sistem nuk duhet të besohet automatikisht, pavarësisht vendndodhjes së tij.

Rikuperimi pas Sulmeve Ransomware

Rikuperimi pas sulmeve ransomware përbën një fazë kritike të menaxhimit të incidenteve kibernetike, pasi synon rikthimin e funksionimit normal të sistemeve, restaurimin e të dhënave dhe minimizimin e ndikimit afatgjatë operacional, financiar dhe reputacional. Një proces efektiv rikuperimi nuk kufizohet vetëm në restaurimin teknik të sistemeve, por përfshin gjithashtu analiza post-incident dhe përmirësimin e

¹⁵ Behl, A., & Behl, K. (2017). *Cyberwar: The next threat to national security and what to do about it*. Oxford University Press.

¹⁶ <https://www.cisecurity.org/insights/blog/7-steps-to-help-prevent-limit-the-impact-of-ransomware>

¹⁷ Europol. (2023). *Internet Organised Crime Threat Assessment (IOCTA)*. Europol.

masave të sigurisë për të parandaluar sulme të ngjashme në të ardhmen¹⁸. Hapi i parë në procesin e rikuperimit është sigurimi i mjedisit të IT-së, duke u siguruar që ransomware-i dhe çdo malware shoqërues janë eliminuar plotësisht nga sistemi. Rikthimi i sistemeve duhet të kryhet vetëm pasi të jetë konfirmuar se vektorët fillestarë të sulmit janë identifikuar dhe mbyllur, përndryshe ekziston rreziku i ri-infektimit të infrastrukturës¹⁹. Kjo fazë shpesh përfshin rindërtimin e sistemeve nga imazhe të pastra dhe ndryshimin e kredencialeve të komprometuara.

Një element thelbësor i rikuperimit është restaurimi i të dhënave nga kopjet rezervë të sigurta. Praktikant më të mira rekomandojnë përdorimin e backup-eve offline ose të izoluara nga rrjeti kryesor, të cilat duhet të testohen paraprakisht për integritet dhe autenticitet përpara restaurimit²⁰. Rikuperimi duhet të bëhet sipas një rendi prioritar, duke filluar nga sistemet dhe shërbimet kritike për funksionimin e organizatës. Një fazë e rëndësishme e rikuperimit është analiza post-incident, e cila synon të identifikojë dobësitë që mundësuan sulmin dhe të vlerësojë efektivitetin e masave ekzistuese të sigurisë. Dokumentimi i plotë i incidentit, përfshirë kronologjinë e sulmit dhe veprimet e ndërmarra, shërben si bazë për përmirësimin e planeve të reagimit ndaj incidenteve dhe strategjive të sigurisë kibernetike²¹. Përveç aspektit teknik, rikuperimi përfshin edhe menaxhimin e ndikimit organizativ dhe ligjor. Organizatat duhet të vlerësojnë shkallën e komprometimit të të dhënave, veçanërisht në rastet e ransomware-it me zhvajtje të dyfishtë, ku ekziston rreziku i rrjedhjes së informacionit të ndjeshëm. Në këto raste, njoftimi i autoriteteve përkatëse dhe palëve të prekura është një hap i domosdoshëm për përputhshmëri ligjore dhe ruajtje të besimit publik²².

Përfundime dhe Rekomandime

Sulmet ransomware përbëjnë një nga kërcënimet më serioze dhe në rritje të sigurisë kibernetike, duke prekur organizata të të gjitha madhësive dhe sektorëve. Analiza tregon se ransomware nuk është më vetëm një problem teknik, por një fenomen kompleks që përfshin aspekte teknologjike, organizative, ligjore dhe

¹⁸ CISA. (2021). *Ransomware guide*. Cybersecurity and Infrastructure Security Agency

¹⁹ Kharraz, A., Robertson, W., Balzarotti, D., Bilge, L., & Kirda, E. (2015). Cutting the Gordian knot: A look under the hood of ransomware attacks. In *Proceedings of the DIMVA Conference* (pp. 3–24). Springer.

https://doi.org/10.1007/978-3-319-20550-2_1

²⁰ Scaife, N., Carter, H., Traynor, P., & Butler, K. R. B. (2016). Cryptolock (and drop it): Stopping ransomware attacks on user data. *IEEE International Conference on Distributed Computing Systems*, 303–312.

<https://doi.org/10.1109/ICDCS.2016.46>

²¹ <https://www.embroker.com/blog/how-to-recover-from-a-cyber-attack/>

²² Europol. (2023). *Internet Organised Crime Threat Assessment (IOCTA)*. Europol.

njerëzore. Evolucioni i modeleve të sulmit, si *double extortion* dhe *ransomware-as-a-service*, ka rritur ndjeshëm ndikimin dhe sofistikimin e këtyre sulmeve.

Një përfundim i rëndësishëm është se mungesa e përgatitjes organizative, keqkonfigurimet e sistemeve dhe niveli i ulët i ndërgjegjësimit të përdoruesve janë ndër faktorët kryesorë që kontribuojnë në suksesin e sulmeve ransomware. Pagesa e shpërblimit nuk garanton rikuperimin e të dhënave dhe shpesh nxit vazhdimësinë e aktiviteteve kriminale.

Për të përballuar këtë kërcënim, rekomandohet një qasje gjithëpërfshirëse që kombinon masa teknike, organizative dhe edukative. Këto përfshijnë implementimin e mbrojtjes shumë-shtresore, krijimin e kopjeve rezervë të sigurta, zhvillimin e planeve të reagimit ndaj incidenteve dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare të sigurisë. Po aq i rëndësishëm është trajnimi i vazhdueshëm i përdoruesve dhe zhvillimi i një kulture organizative të sigurisë.

Menaxhimi efektiv i rrezikut nga ransomware kërkon angazhim të vazhdueshëm, bashkëpunim institucional dhe përmirësim të vazhdueshëm të praktikave të sigurisë, ndërsa kërkimet e ardhshme duhet të fokusohen në zgjidhje inovative për zbulimin dhe parandalimin e hershëm të këtyre sulmeve.

Referencat

1. Behl, A., & Behl, K. (2017). *Cyberwar: The next threat to national security and what to do about it*. Oxford University Press.
2. CISA. (2021). *Ransomware guide*. Cybersecurity and Infrastructure Security Agency
3. Conti, M., Gangwal, A., & Ruj, S. (2018). On the economic significance of ransomware campaigns. *Computers & Security*, 79, 162–189.
4. Conti, M., Gangwal, A., & Ruj, S. (2018). On the economic significance of ransomware campaigns. *Computers & Security*, 79, 162–189.
5. ENISA. (2022). *ENISA Threat Landscape for Ransomware Attacks*.
6. Europol, *Internet Organised Crime Threat Assessment (IOCTA)*, Europol Innovation Lab, 2023.
7. Europol. (2017). *Internet Organised Crime Threat Assessment (IOCTA)*. Europol.

8. Europol. (2020). *Internet Organised Crime Threat Assessment (IOCTA)*. Europol.
9. Europol. (2023). *Internet Organised Crime Threat Assessment (IOCTA)*. Europol.
10. FBI. (2021). *DarkSide ransomware: Indicators of compromise*. Federal Bureau of Investigation.
11. <https://aksk.gov.al/>
12. <https://www.akamai.com/glossary/what-are-the-types-of-ransomware>
13. <https://www.cisecurity.org/insights/blog/7-steps-to-help-prevent-limit-the-impact-of-ransomware>
14. <https://www.embroker.com/blog/how-to-recover-from-a-cyber-attack/>
15. https://www.trendmicro.com/en_us/what-is/ransomware/ryuk-ransomware.html
16. Kharraz, A., Robertson, W., Balzarotti, D., Bilge, L., & Kirda, E. (2015). Cutting the Gordian knot: A look under the hood of ransomware attacks. *DIMVA*.
17. Kharraz, A., Robertson, W., Balzarotti, D., Bilge, L., & Kirda, E. (2015). Cutting the Gordian knot: A look under the hood of ransomware attacks. In *Proceedings of the DIMVA Conference* (pp. 3–24). Springer. https://doi.org/10.1007/978-3-319-20550-2_1
18. N. Scaife, H. Carter, P. Traynor, and K. R. B. Butler, “Cryptolock (and drop it): Stopping ransomware attacks on user data,” in *Proc. IEEE ICDCS*, 2016, pp. 303–312.
19. R. Anderson et al., “Measuring the changing cost of cybercrime,” *Journal of Cybersecurity*, vol. 5, no. 1, pp. 1–27, 2019
20. Scaife, N., Carter, H., Traynor, P., & Butler, K. R. B. (2016). Cryptolock (and drop it): Stopping ransomware attacks on user data. *IEEE International Conference on Distributed Computing Systems*, 303–312. <https://doi.org/10.1109/ICDCS.2016.46>

TREGU I PUNËS NË MAQEDONINË E VERIUT: SFIDA E MUNGESËS SË KUADROVE DHE EMIGRIMI I TË RINJVE

Edita Arslani

e.arsllani@eust.edu.mk

Abstrakt

Ky punim trajton sfidat kryesore me të cilat përballet tregu i punës në Maqedoninë e Veriut, me fokus të veçantë tek fenomeni i mungesës së kuadrove profesionale dhe emigrimi në rritje i të rinjve. Analizohen faktorët që ndikojnë në këto fenomene, pasojat afatshkurtra dhe afatgjata për zhvillimin ekonomik, si dhe propozohen rekomandime strategjike për përmirësimin e situatës. Punimi bazohet në analiza sociologjike, ekonomike dhe demografike, duke marrë në konsideratë kontekstin rajonal dhe trendet globale të migrimit.

Fjalë kyçe: *tregu i punës, mungesa e kuadrove profesionale, emigrimi i të rinjve (Brain Drain), papunësia, politikat aktive të punësimit, arsimi profesional dhe dual, përputhje e aftësive me kërkesat e tregut, ndryshime demografike, strategji për zhvillim ekonomik, migracioni dhe diaspora profesionale*

Metodologjia

Metodologjia e punimit bazohet në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave kuantitative dhe kualitative nga burime zyrtare dhe literatura relevante. Për këtë qëllim, u realizuan këto hapa metodologjikë:

Mbledhja e të dhënave kuantitative përmes publikimeve, buletineve statistikore dhe analizave të Entit Shtetëror të Statistikave (ESHS) dhe Agjencisë për Punësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Këto të dhëna përfshijnë statistikat e punësimit, papunësisë, tregut të punës dhe tendencave demografike.

Analiza e dokumenteve strategjike dhe politikave ekzistuese, përfshirë strategjitë nacionale, programet qeveritare, planet e veprimit dhe dokumentet relevante në nivel lokal dhe rajonal që trajtojnë çështjen e papunësisë, mungesën e kuadrove dhe migrimin e të rinjve.

Rishikimi i literaturës shkencore dhe publikimeve studimore, të cilat ofrojnë perspektiva teorike dhe praktike mbi zhvillimet e tregut të punës dhe faktorët që ndikojnë në emigrimin e të rinjve.

Kjo qasje metodologjike mundëson një analizë gjithëpërfshirëse të situatës aktuale në tregun e punës në Maqedoninë e Veriut dhe identifikimin e sfidave kyçe që lidhen me mungesën e kuadrove dhe emigrimin e të rinjve.

Hyrje

Tregu i punës përbën një nga faktorët kyç në zhvillimin ekonomik, social dhe demografik të çdo shoqërie. Republika e Maqedonisë së Veriut përballet me sfida të dukshme në tregun e punës, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik, social dhe në perspektivat afatgjata të vendit. Ndër sfidat më të rëndësishme që karakterizojnë tregun e punës në Maqedoninë e Veriut janë:

Migracioni i popullsisë, me theks të veçantë tek të rinjtë (i njohur ndryshe si brain drain);

Mungesa e kuadrove profesionale;

Ndryshimet e pafavorshme demografike;

Mospërputhja midis ofertës dhe kërkesës në tregun e punës;

Papunësia.

Këto fenomene të lartpërmendura janë të ndërlidhura ngushtë me njëra-tjetrën, duke e vështirësuar funksionimin e tregut të brendshëm të punës. Me këtë punim synohet të ofrohet një analizë e detajuar e këtyre sfidave, duke theksuar faktorët kryesorë, ndikimet dhe perspektivat e së ardhmes.

Migracioni me theks të veçantë tek të rinjtë (i njohur ndryshe si brain drain)

Migracioni është një dukuri komplekse, ku faktorët makro, meso dhe mikro veprojnë së bashku dhe ndikojnë në vendimin individual për t'u shpërngulur brenda

ose jashtë vendit. Kjo qasje pasqyron teorinë e mirënjohur të “shtytjes dhe tërheqjes” (*push-pull*), e cila shpjegon arsyet e lëvizjeve migratore.¹

Faktorët kryesorë të migracionit

Arsyet për migracionin e jashtëm dhe të brendshëm në Maqedoninë e Veriut janë të shumta dhe komplekse. Në vendin tonë dominojnë problemet sociale, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve. Vendi vazhdimisht përballet me një nivel të lartë papunësie, që kontribuon në rritjen e pabarazisë dhe të përjashtimit social.²

Nga hulumtimet e kryera në Maqedoni rezulton se të rinjtë largohen për arsyet e mëposhtme:

Mungesë e vendeve të punës që kërkojnë kualifikime të përshtatshme arsimore

Perspektiva të dobëta për avancim në karrierë

Pagë e ulët krahasuar me kostot e jetesës

Korrupsion dhe nepotizëm

Mosbesim të sistemi i drejtësisë dhe institucionet

Këto arsye tregojnë qartë se të rinjtë në Maqedoninë e Veriut përballen me një mjedis socio-ekonomik dhe politik që nuk u ofron siguri, stabilitet dhe mundësi reale për zhvillim profesional dhe personal. Andaj edhe të rinjtë zgjedhin emigrimin si zgjidhjen e vetme për të ndërtuar një jetë më të mirë.

Tendencat aktuale të migrimit dhe ndikimi i emigrimit në tregun e punës

Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave, në vitin 2024 popullsia aktive në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka qenë 792.779 persona, prej të cilëve 694.506 të punësuar dhe 98.273 persona të papunë.

¹ Organizata Ndërkombëtare për Migrim, 2022. Republika e Maqedonisë së Veriut: Profili i Shtetit 2021. IOM, Shkup, fq 1.

² Në kuadër të projektit “Ndërmarrësi sociale për punësimin e të rinjve” të Shoqatës për Ofrimin e Shërbimeve Sociale “SOCIO”, i financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe i zbatuar nga të Rinjtë Agjentë të Ndryshimit, fq .7.

Norma e aktivitetit: 52.3%

Norma e punësimit: 45.8%

Norma e papunësisë: 12.4%³

Nga të dhënat shihet se norma e papunësisë është dukshëm më e lartë se mesatarja e Bashkimit Evropian, ku papunësia lëviz rreth 6%. Megjithatë, duhet theksuar se është regjistruar një ulje e papunësisë prej 0.4 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e mëparshëm dhe 0.7 pikë përqindje më pak krahasuar me vitin 2023. Paralelisht, norma e punësimit ka shënuar rritje dhe ka arritur në 46.2%. Por, pavarësisht uljes së lehtë të normës së papunësisë, shumë ekspertë të fushës vlerësojnë se ky trend nuk reflekton përmirësim real të tregut të punës. Sipas tyre, rënia e papunësisë lidhet kryesisht me emigrimin masiv të të rinjve, të cilët largohen për të punuar jashtë vendit, duke krijuar boshllëqe serioze në tregun vendor të punës dhe mungesë të kuadrove profesionale.⁴

Sipas një studimi të kryer në vitin 2021, në Maqedoninë e Veriut kishte rreth 94 000 të rinj në moshë 15–29 vjeç që nuk ishin as të punësuar, as në arsim apo trajnime. Kjo përbën rreth 24.2 % të të gjithë popullsisë së të rinjve,⁵ një shifër që tregon që të rinjë në RMV përballen me sfida të konsiderueshme sociale dhe ekonomike.

Në mungesë të strategjive dhe programeve tërheqëse nga institucionet, përpjekjet dhe premtimet për përmirësimin e situatës shpesh mbeten vetëm në letër, ndërkohë që në praktikë nuk ka ndryshime të mjaftueshme.

Papunësia mes të rinjve vazhdon të mbetet e lartë, ndërsa dëshira për emigrim dhe mosbesimi ndaj institucioneve shtetërore janë fenomenet dominuese. Të dhënat e fundit nga burime relevante tregojnë se situata për shumë të rinj nuk po përmirësohet, përkundrazi po përkeqësohet. Sipas të dhënave të CEIC, në dhjetor 2024 papunësia rinore arriti 32,3 %, duke e vendosur Maqedoninë e Veriut ndër vendet me papunësi të lartë rinore në Evropë. Kjo shifër është gati dyfish më e lartë se mesatarja e Bashkimit Evropian, që është rreth 15 %.⁶

³ Të dhënat janë zyrtare të publikuara nga Enti Shtetëror i Statistikave, për vitin 2024.

⁴ <https://sitel.com.mk/nevrabotenosta-vo-makedonija-na-najnisko-nivo-dosega>

⁵ CEIC – Data, “Global Economic and Financial Data Provider,” të dhëna të aksesueshme online, 2024.

⁶ CEIC – Data, “Global Economic and Financial Data Provider,” të dhëna të aksesueshme online, 2024.

Ky problem është i theksuar sidomos kur merret parasysh se shumë të rinj kanë kualifikime të larta arsimore, por nuk kanë mundësi të realizojnë potencialin e tyre në ekonominë kombëtare. Një anketë tjetër e kryer nga nje fonadcion prestigjioz si Westminster Foundation for Democracy (WFD) tregon se 62 % e të rinjve dëshirojnë të emigrojnë, dhe 77 % nuk planifikojnë të kthehen. Sa i përket largimit të të rinjve, sipas Institute for Democracy Societas Civilis (IDSC), rreth 12.000 të rinj deri në moshën 29 vjeç braktisin vendin çdo vit. Këto shifra janë alarmuese dhe tregojnë një mosbesim të thellë dhe pasiguri për perspektivat që ofron shteti. Niveli i lartë i emigracionit pritet të krijojë mungesa serioze të fuqisë punëtore në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe për të gjitha llojet e profesioneve. Largimi i personave të kualifikuar (fenomeni i njohur si “brain drain”) mund të ketë pasoja të konsiderueshme për zhvillimin ekonomik, pasi mungesa e të arsimuarve pengon tërheqjen e investimeve të huaja në sektorë me vlerë të lartë.⁷

Politikat aktuale për të adresuar shkallët e larta të papunësisë dhe emigracionit

Për të adresuar shkallët e larta të papunësisë dhe inaktivitetit rinor, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka hartuar Planin Operativ Vjetor për masat dhe programet aktive për punësim, ndërsa Agjencia për Punësim është përgjegjëse për implementimin e tyre. Masat aktive për vitin 2024 janë si në vijim:

Mbeshtetje për vetëpunësim (sipërmarrësi) – Kjo masë përfshin trajnime, mentorim për sipërmarrësi, si dhe grante / subvencione për hapje të bizneseve.

Mbeshtetje për krijimin e vendeve të reja të punës (subvencionim i punësimit), që dmth subvencionim i pagave ose ndihmë financiare për punëdhënësit që punësojnë të papunë.

Trajnime, rikualifikim dhe aftësi profesionale – që përfshinë kurse profesionale, aftësime në teknologji, IT dhe në sfera të tjera me qëllim përshtatjen e të papunëve me kërkesen e tregut të punës

Praktikë dhe programe të përvojës së punës (internship), kjo përfshinë mundësi për të rinjtë dhe të papunët për të fituar përvojë reale pune.

⁷ Heritage, reviste periodike, nr.22, 2019.

Masa për kategori vulnerabile të popullsisë, këto masa kanë si target grupë: të rinjtë nën 29 vjeç, të papunët afatgjatë, persona me aftësi të kufizuara, përfitues të ndihmës sociale etj.

Program për punësim përmes investimeve të gjelbra (Green Jobs), që në fakt nëkupton mbështetje financiare për ndërmarrjet që investojnë në teknologji ose procese “të gjelbra”.⁸

Masa më e popullarizuar, për të cilën është paraparë edhe shuma më e lartë prej 13,2 milionë euro, është “vetëpunësimi”. Megjithatë, lind pyetja: a japin efekt këto masa dhe a ekziston një kontroll sistematik mbi mënyrën, përfituesit dhe përdorimin e ndarjes së mjeteve?⁹ Nga studimi i kryer, u konstatuan disa mangësi: shteti nuk disponon të dhëna të sakta për numrin e bizneseve të hapura që mbijetojnë pas dy viteve, periudhë gjatë së cilës biznesi është i detyruar të funksionojë. D.m.th, mungon një qasje e koordinuar dhe sistematike në monitorimin, implementimin dhe vlerësimin e efikasitetit të programeve. Për më tepër, shpesh mungojnë burime njerëzore të mjaftueshme dhe ka nevojë për financim shtesë.¹⁰

Një problem tjetër lidhet me mungesën e të dhënave për migracionin e të rinjve. Enti Shtetëror për Statistika nuk disponon regjistra të vecant për këtë grupë. Nga prononcimet publike, arsyeja e mungesës së shifrave lidhet me faktin se shtetasit e Maqedonisë që shpërngulen nuk bëjnë lajmërimin nga vendi, nga frika se do të humbasin statusin e shtetasit të Maqedonisë, të cilin e mbajnë rezerv në rast se nuk arrijnë të sistemohen në shtetin ku shkojnë. Andaj, rekomandohet që shteti të gjejë një mekanizëm për të evidentuar numrin e të larguarve nga Maqedonia.

Në aspektin e papunësisë, gjithashtu ja vlen te ceket që funksionimi joefikas i tregut të punës, problemet e cilësisë në sistemin arsimor dhe mungesa e lidhjes ndërmjet arsimit dhe kërkesave reale të ekonomisë prodhojnë sfida shtesë, të cilat manifestohen në papunësinë e lartë të të rinjve, punësimin jo cilësor, nivelin e lartë të NEET-ëve (të rinj që nuk janë në arsim, punësim ose trajnim), tranzicionin e vështirë nga arsimi në punësim dhe mos-përputhjen serioze të aftësive.¹¹ Këto faktorë, të kombinuar me deficitin e fuqisë punëtore të kualifikuar që përkeqësohet nga emigrimi

⁸ PLANI OPERATIV PËR PROGRAMET DHE MASAT AKTIVE PËR PUNËSIM NË TREGUN E PUNËS PËR VITIN 2024 – #ShansPërTëGjithë, hartuar nga Ministria e Politikës Sociale, e Demografisë dhe e të Rinjve.

⁹ <https://meta.mk/analiza-za-vrabortuvanja-na-mladi-324-milioni-evra-dali-merkite-davaat-dolgorochni-efekti/>

¹⁰ Po, aty

¹¹ Education Sector Analysis: North Macedonia (2024), fq. 36. Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.

i vazhdueshëm i kuadrove, nxjerrin në pah domosdoshmërinë e reformimit të sistemit arsimor. Pikërisht në këtë drejtim orientohen edhe parashikimet e Strategjisë Kombëtare 2024–2044, e cila synon futjen e mësimi praktik të detyrueshëm si në arsimin e mesëm, ashtu edhe në atë të lartë, me përfshirje aktive të sektorit privat, duke ofruar aftësi praktike dhe përvojë pune për studentët para diplomimit. Kjo pritet të kontribuojë në uljen e papunësisë së të rinjve nën 30%, reduktimin e papunësisë së përgjithshme në 10% dhe zvogëlimin e punësimit informal në 8%.¹²

Në kuadër të rekomandimeve për të adresuar sfidat e tregut të punës, sektori i arsimit duhet të ndërmarrë politika dhe masa konkrete, të fokusuara në rritjen e cilësisë dhe relevancës së programeve arsimore në raport me kërkesat e tregut të punës. Këto masa duhet të përfshijnë modernizimin e vazhdueshëm të kurikulave të arsimit profesional, zgjerimin e modelit të arsimit dual, zhvillimin e moduleve praktike në bashkëpunim të ngushtë me bizneset, si dhe krijimin e kushteve më të favorshme për mësimdhënësit, përfshirë rritjen e pagave, ngritjen profesionale dhe motivimin për angazhim cilësor.

Një element tjetër i rëndësishëm që del në pah është mungesa e një strategjie aktive kundër emigrimit në vitet e fundit. Strategjia e mëparshme për periudhën 2013–2020, edhe pse formalisht ekzistonte, nuk u zbatua në mënyrë efektive dhe nuk u konsiderua prioritet institucional. Sipas të dhënave të “Rrjetit për Largimin e Trurit”, vetëm 11% e saj u realizua në praktikë.¹³ Andaj, për të adresuar në mënyrë efektive sfidat e emigrimit, është e domosdoshme që të hartohet një strategji gjithëpërfshirëse që përfshin:

Evidentimin sistematik të faktorëve socio-ekonomikë që nxisin emigracionin;

Monitorimin e vazhdueshëm të rrjedhave migratore dhe identifikimin e ndryshimeve strukturore;

Konkretizimin e pasojave negative të largimit të të rinjve në tregun e punës, produktivitetin dhe kapacitetet inovative të vendit;

Planifikimin e masave konkrete (plane akcionale) me afate kohore, përgjegjësi institucionale dhe indikatorë matës,

¹² <https://portalb.mk/analize-ambicie-te-medha-te-paketuara-ne-strategjine-kombetare-ne-rmv-punesim-i-te-huajve-rritje-prej-4-tatime-te-drejta/>

¹³ <https://alfa.mk/iseluvaneto-e-trend-koj-ne-zapira-vo-drzhavava-a-koj-e-zasilen-poslednive-godini/>

Mungesa e kuadrove profesionale në RMV

Mungesa e kuadrove profesionale në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV) paraqet një nga sfidat më të theksuara për zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Gjatë viteve të fundit, mijëra qytetarë – veçanërisht të rinjtë, të arsimuarit dhe personat me aftësi profesionale – e kanë braktisur vendin në kërkim të mundësive më të mira jashtë. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e deficitit të fuqisë punëtore në sektorët kyç të ekonomisë.¹⁴

Mungesa e kuadrove është rezultat i disa faktorëve të ndërlidhur. Migrimi i vazhdueshëm i të rinjve të kualifikuar ka zvogëluar bazën e burimeve njerëzore në vend,¹⁵ Arsimi profesional dhe teknik në RMV vazhdon të zhvillohet me ritëm relativisht të ngadalshëm, duke mos arritur t'i përgatisë në mënyrë adekuate studentët - punëtorët për profesionet në kërkesë të lartë.

Arsyet e deficitit të fuqisë punëtore dhe pasojat ekonomike dhe sociale

Shkallët e larta të emigrimit të popullsisë në moshë pune kanë shkaktuar mospërputhje të dukshme mes ofertës dhe kërkesës për fuqi punëtore, si në kuadrot me arsim të lartë – përfshirë mjekët, informaticienët, inxhinierët mekanikë dhe ata të ndërtimit – ashtu edhe në kuadrot me arsim të mesëm profesional, siç janë infermieret, teknikët e makinerive, ndërtimtarët dhe elektroteknikët. Si rezultat, sektorët e inxhinierisë, teknologjisë informative, shëndetësisë dhe zejtarive teknike po përballen me mungesa të theksuara të personelit, gjë që e vështirëson funksionimin e ndërmarrjeve dhe ul konkurrueshmërinë e ekonomisë.¹⁶

Kjo situatë është përkeqësuar edhe më tej gjatë periudhës 2009–2019, e cila është karakterizuar nga flukse të intensifikuara migratore drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Ndryshimet në regjimin e vizave kanë lehtësuar lëvizjen e qytetarëve, duke nxitur më shumë të rinj dhe profesionistë të kërkojnë kushte më të mira jashtë vendit. Pagat joatraktive, mungesa e kushteve të mira të punës dhe mungesa e mundësive për avancim profesional kontribuojnë në këtë trend dhe e forcojnë ciklin negativ: largimi

¹⁴ <https://balkanfoundation.com/north-macedonias-labour-emigration-can-the-country-afford-to-keep-losing-its-workforce/?utm>

¹⁵ Po, aty

¹⁶ Organizata Ndërkombëtare për Migrim, 2022. Republika e Maqedonisë së Veriut: Profili i Shtetit 2021. IOM

i profesionistëve krijon mungesa, mungesat ngadalësojnë rritjen ekonomike, ndërsa mungesa e rritjes motivon edhe më shumë njerëz të emigrojnë.¹⁷

Nevoja për reforma strukturore

Për ta adresuar këtë krizë të humbjes së fuqisë punëtore, kërkohet një qasje gjithëpërfshirëse. Së pari, është e domosdoshme rritja e pagave dhe përmirësimi i kushteve të punës në sektorët kritikë. Paralele me këtë, duhet të harmonizohen programet arsimore me nevojat e tregut të punës, duke forcuar arsimin profesional, mësimin dual dhe trajnimin praktik. Krijimi i mundësive të qarta për zhvillim profesional për të rinjtë është një tjetër hap kyç për t'i mbajtur ata në vend.

Masa të tjera strategjike përfshijnë mbështetjen e sipërmarrjes, thjeshtimin e procedurave të biznesit dhe ofrimin e stimujve si ndihma për riintegrimin e emigrantëve, lehtësime tatimore dhe programe për transferimin e njohurive përmes diasporës. Për më tepër, avancimi drejt standardeve të tregut evropian të punës dhe zgjerimi i bashkëpunimit ndërkuftar në trajnime profesionale mund të kontribuojnë në ruajtjen e kapitalit njerëzor.¹⁸

In the context of Kosovo, curriculum reform has served as a key mechanism for improving the quality and relevance of education. In 2011, the Ministry of Education, Science, and Technology (MASHT) approved the Pre-University Curriculum Framework in Kosovo, aiming to establish a regulatory framework for pre-university education reform. In 2016, following the second pilot phase, MASHT published a revised version of this document, titled the Pre-University Curriculum Framework in Kosovo. This framework regulates the entire pre-university education system and serves as an umbrella document for efforts to enhance quality and equity in educational services for all students. The guiding principles for implementing the new curriculum system relate to curriculum review and evaluation processes, redefining teacher roles, and fostering a new organizational and pedagogical culture in schools, with the aim of developing student competencies (Boshtrakaj, Rraci, & Bajrami, 2018).

Officially, the Curriculum Framework represents a shift from the traditional content-based model toward a competency-based curriculum, aiming to equip students not only with subject knowledge but also with practical skills and

competencies essential for their personal and professional development (Brown, 2019). Competency-based curricula focus on what students are expected to do, rather than solely on what they are expected to know.

Kosovo's curriculum system consists of two main pillars: the conceptual pillar, articulated in the Curriculum Framework, and the operational pillar, expressed through Core Curricula and subject-specific curricula. Through the Curriculum Framework, MASHT explicitly adopts a competency-based approach, oriented toward expected learning outcomes that all students should achieve across different educational stages. The framework also delineates the roles of key actors within schools to ensure a supportive environment for curriculum implementation, including students, teachers, professional support staff, school principals, student councils, parent councils, and school governing boards (Boshtrakaj, Rraci, & Bajrami, 2018).

In contrast to the conceptual nature of the Curriculum Framework, the Core Curricula constitute the primary operational curriculum documents for primary, lower-secondary, and upper-secondary education. Their provisions are mandated by MASHT and compulsory for all pre-university education institutions. They establish general and obligatory guidelines for planning, organizing, and implementing educational processes in schools. Within the Core Curricula, the key competencies defined in the Curriculum Framework are further translated into concrete learning outcomes, specified according to educational level and subject area, guiding schools and teachers in independently planning content and learning processes to achieve these outcomes (Boshtrakaj, Rraci, & Bajrami, 2018). Nevertheless, despite the clarity of roles, structures, and learning outcomes defined in the Curriculum Framework and Core Curricula, the success of a competency-based curriculum fundamentally depends on schools' capacity to foster collaborative practices and cultivate an organizational culture conducive to change.

Since the curriculum functions not only as a regulatory document but also as a framework guiding pedagogical and organizational practices in schools, its implementation cannot be understood separately from the cultural context of the educational institution. Schools, as organizational entities, operate based on formal and informal systems of guidance that regulate member interactions and directly contribute to the formation of organizational culture (Wibowo, 2020). In this regard, curriculum reforms, including the shift toward a competency-based curriculum in Kosovo, necessarily encounter existing school cultural structures.

According to Schein (1984, 1992), organizational culture comprises fundamental assumptions, shared values, and beliefs developed through collective experiences in confronting adaptation and integration challenges. Applied to the educational context, school culture encompasses the values, beliefs, norms, and written and unwritten rules that influence how teachers, administrators, and students interpret and implement the curriculum (Gruenert & Whitaker, 2015). School culture is neither static nor isolated; it is a dynamic system affecting nearly every aspect of school functioning, including lesson planning, professional collaboration, decision-making, and interpersonal relationships (Gruenert & Whitaker, 2015). Elements such as school climate, mission and vision, shared values and beliefs, professional norms, routines, rituals, and symbols create the framework through which school actors understand “how things are done” within the school. As Deal and Kennedy (1982) emphasize, culture defines customary ways of acting within an organization and often exerts a greater influence than formal policies.

Consequently, despite the conceptual clarity of the Curriculum Framework and Core Curricula, the way these documents are translated into practice largely depends on the dominant culture within schools. Successful implementation of this curriculum reform extends beyond technical curriculum design. It primarily relies on schools’ capacity to internalize and adapt to change, a process profoundly influenced by the school’s internal culture. In this context, school culture, defined as the collection of shared values, beliefs, and behaviors within the school community, can either facilitate or hinder the successful integration of new curricula. For instance, schools characterized by a culture of collaboration, trust, and shared values are typically better prepared to handle curriculum changes, as teachers and administrators are more willing to engage in the reform process and adopt new teaching practices (Hargreaves, 2003). The role of school culture in these reforms is particularly significant, as it can determine not only how reforms are implemented but also their long-term sustainability and effectiveness.

Methodological approach

This study is theoretical in nature, aiming to analyze and interpret the concept of school culture within the context of curriculum reform in Kosovo. To this end, the article examines the Pre-University Curriculum Framework and its derivative documents, which serve as the primary sources defining orientations, principles, and educational practices within the Kosovar pre-university education system.

The documents were selected based on clear criteria: they represent the official framework of curriculum policy, include operational guidance for teaching and assessment, and reflect the conceptual objectives of the curriculum reform. This selection ensures that the analysis focuses on the most relevant and representative materials for understanding how school culture is addressed in official documents.

The analysis employs a conceptual and interpretive approach, grounded in a theoretical-analytical perspective. It seeks to examine how school culture is reflected and conceptualized within the curriculum documents, while also identifying gaps and tensions between the conceptual orientations and the operational guidance provided by the curriculum reform.

Analysis of the conceptual and operational dimensions of the Kosovo Curriculum Framework in relation to school culture

School culture occupies an important place in the architecture of the Pre-University Curriculum Framework of the Republic of Kosovo, although it is not treated as a distinct concept or presented as a separate chapter. At both the conceptual and operational levels, school culture appears implicitly, horizontally integrated into the goals, competencies, principles, and the organization of roles and responsibilities of school actors. This approach suggests that school culture is perceived as an internal and essential dimension of school functioning, rather than as a direct target of curricular intervention.

At the conceptual level, school culture is clearly reflected in the objectives of pre-university education, which emphasize the development of personal and national identity, the promotion of civic values, social responsibility, respect for diversity, and individual and collective well-being. These orientations position the school not merely as a knowledge-transmitting institution but as a cultural, social, and moral space where values are lived daily. The fact that the Framework underscores that these objectives should be part of the “everyday school culture” indicates that school culture is seen as a key mechanism for achieving curriculum reform goals.

This conceptual vision is further reinforced through the model of key competencies, which requires a cultural transformation of teaching and learning. Competencies such as communication, critical thinking, lifelong learning, and personal and civic skills cannot be developed in a traditional school culture based on unilateral authority and passive knowledge transmission. Instead, they presuppose a culture that supports dialogue, reflection, student autonomy, and positive teacher–

student relationships. In this sense, school culture at the conceptual level is presented as an active and fundamental condition for achieving the intended learning outcomes.

The principles of the Curriculum Framework, particularly inclusivity, integrated teaching, and equity, constitute another dimension in which school culture is implicitly articulated. They require the creation of an open, supportive, and collaborative school culture, both in student relationships and in the professional culture of teachers. Integrated teaching, in particular, necessitates changes in the school's organizational culture, collegial planning, and interdisciplinary collaboration, shifting the school from traditional fragmentation toward a learning community.

However, when moving from the conceptual to the operational part of the Curriculum Framework, a shift is observed from a value-based vision toward functional operationalization. In the operational dimension, school culture is not articulated as a concept but appears through descriptions of roles, responsibilities, and interactions among students, teachers, professional support staff, school leaders, and representative bodies. At this level, school culture is conceptualized more as an outcome of institutional interaction than as a deliberately constructed system of values and beliefs.

A positive aspect of this operational dimension is the emphasis on collective engagement and collaboration among actors, suggesting a model of participatory and democratic school culture. The roles of the principal, professional services, and school councils are directly linked to creating a safe, friendly, and supportive environment for curriculum implementation. Nevertheless, a critical analysis shows that this description remains largely normative and declarative, as concrete mechanisms for building, developing, and evaluating school culture are absent.

One of the main gaps in the operational dimension relates to the reduction of school culture to individual behaviors and tasks of actors, without addressing it as a collective and dynamic phenomenon. The Framework presupposes the existence of a functional culture of collaboration, communication, and professional reflection but does not address real differences between schools in terms of climate, organizational traditions, and cultural capacities. This assumption creates a significant gap between the conceptual vision and the reality of implementation. Similarly, although the involvement of students and parents in decision-making is presented as a democratic principle, it remains largely formal, as the document does not provide clear guidance

for genuinely empowering their voices. This renders school culture more declarative than lived in everyday school practice.

Finally, linking curriculum implementation to the school development plan represents an important step toward institutionalizing the reform. Yet, even here, school culture is treated as an organizational backdrop rather than as a deliberate object of development. The absence of tools for assessing school culture and strategies for cultural intervention limits its potential as a decisive factor in the success of curriculum reform.

In summary, the Kosovo Curriculum Framework presents an advanced conceptual vision for school culture, integrated into goals, competencies, and principles. However, at the operational level, this culture remains implicit and not fully operationalized. The gap between the conceptual and operational levels renders school culture a critical yet understructured factor, leaving the success of curriculum reform dependent on the existing cultural capacities of schools.

Analysis of the representation of school culture in curriculum documents

Within the framework of the Kosovo Curriculum, a series of curricular documents have been developed covering all levels of pre-university education. These include the Core Curriculum for Early Childhood Education (birth–5 years, for age groups 0–3 and 3–5), the Core Curriculum for Primary Education, the Core Curriculum for Lower Secondary Education, as well as the Core Curriculum for Upper Secondary Education, both for general secondary schools and vocational schools, accompanied by subject plans and programs from preparatory classes to grade twelve. These documents define the characteristics of each educational level, the competencies expected at the end of each stage, curricular areas, learning outcomes for each area, and methodological and assessment guidelines to guide the teaching and learning process.

Analysis of these curriculum documents shows that school culture is not treated as an independent, clearly defined, or structured concept. Instead, it appears mostly implicitly, through terminology related to competencies, values, attitudes, behaviors, and pedagogical practices. None of the foundational documents provide an explicit definition of school culture or a conceptual framework to guide how it should be developed, managed, or evaluated at the school level.

This implicit approach creates a conceptual vacuum, as school culture is reduced to a secondary product of curriculum implementation rather than a

fundamental dimension that directly influences how the curriculum is interpreted, experienced, and applied in practice. Consequently, the curriculum documents treat school culture more as a desired outcome than as a structural prerequisite for the success of curriculum reform.

A common feature across all analyzed documents is a strong focus on individual student development through competencies, learning outcomes, and learner-centered pedagogical approaches. While this aligns with contemporary educational paradigms, it marginalizes the collective and institutional dimensions of school culture.

The documents extensively address the development of students' social, emotional, civic, and ethical skills, but they do not directly address the role of institutional norms, shared practices, school rituals, and professional relationships among teachers, leaders, and the community, elements widely recognized in the literature as key components of school culture.

Another major challenge lies in how school culture is distributed across the documents through key competencies, curricular areas, and cross-curricular themes. Values related to collaboration, communication, respect, responsibility, well-being, and democratic citizenship are repeatedly present, yet they are presented in a fragmented manner without clear linkage to a unified vision of school culture. This fragmentation makes it difficult to build a coherent cultural identity for the school, as cultural elements are treated as content to be achieved through teaching rather than as guiding principles structuring school life. Moreover, there is no conceptual mechanism enabling the integration of these elements into a functional and sustainable school culture.

The curriculum documents emphasize school autonomy, particularly in organizing instructional time, extracurricular activities, and student support forms. However, this autonomy is not accompanied by clear guidance for building and managing school culture, leaving room for varied and often contradictory interpretations in practice. In the absence of clear cultural guidance, autonomy risks becoming a formal element, dependent primarily on the individual capacities of school leaders and teachers rather than on a shared vision supported by policy and curriculum documents. This creates significant disparities between schools and weakens the consistency of curriculum reform at the system level.

Overall, the representation of school culture in Kosovo's curriculum documents is characterized by a normative and declarative approach that promotes positive values and attitudes but does not provide conceptual and structural instruments for operationalizing them in school practice. This creates a gap between curricular discourse and school reality, rendering school culture a concept present in rhetoric but not systematically addressed at the level of educational policy.

Discussion

The analysis of Kosovo's curriculum documents indicates that school culture is not treated as a distinct or clearly structured concept; rather, it appears predominantly implicitly and horizontally across goals, competencies, principles, and the roles of school actors. At the conceptual level, school culture is regarded as a fundamental dimension for achieving reform outcomes, closely linked to the development of personal and civic identity, ethical values, and students' social skills. These findings confirm that the Curriculum Framework envisions schools as cultural and social spaces where values must be actively incorporated into daily school life.

However, in the implementation section of the documents, school culture is largely reduced to operational roles and responsibilities of students, teachers, and school leaders. At this level, it is conceptualized more as a consequence of institutional interactions rather than as a deliberately planned and actionable dimension. This gap between the conceptual vision and operational implementation highlights the lack of concrete instruments for building, developing, and evaluating school culture, rendering it present in rhetoric but not systematically addressed in practice.

In light of this gap, school culture in curriculum documents is often perceived as an outcome of curriculum implementation rather than as a structural prerequisite for successful reform. This has significant theoretical and practical implications. First, it indicates that curriculum design should encompass not only orientations and learning outcomes but also clear guidance for developing and nurturing school culture at the institutional level. Second, it underscores the importance of aligning curriculum reform with existing cultural capacities of schools, identifying the need for deliberate cultural interventions and professional collaboration among school actors. This interpretation emphasizes that, for successful implementation, school culture cannot be treated merely as a by-product; it must be integrated as a key dimension in planning and managing curriculum reform.

From a theoretical perspective, this analysis reinforces the pivotal role of school culture as a facilitator or barrier to curriculum reforms (Hargreaves, 2003; Grgić & Jutzi, 2024). Implementation success depends not only on the clarity of documents and guidelines but also on how schools incorporate the prescribed values and practices into daily school life. This interpretive approach suggests that every curriculum reform should explicitly consider the cultural dimension as an integral component to ensure that designed changes are effectively reflected in school practice. This aligns with Finnan's (2000) findings, which emphasize that schools' cultural assumptions directly influence their readiness for reform. According to Finnan, a school's capacity to adopt change depends not only on formal structures and procedures but also on shared beliefs, values, and practices that shape its organizational culture. This underscores the need for policy and curriculum documents to actively and explicitly address the development and management of school culture, making it a planned and manageable component to enhance reform success.

Conclusion

The analysis demonstrates that school culture is essential for the success of curriculum reform in Kosovo, supporting the development of students' values, social skills, and competencies. Nevertheless, in the curriculum documents, school culture is presented more as an outcome of institutional interactions than as a structured and actively guided element.

This finding is critical because the success of reform depends not only on the clarity of the documents but also on schools' capacity to integrate cultural values and practices into daily routines. Current documents lack concrete guidance for building and evaluating school culture.

It is recommended that policy and curriculum frameworks actively address the cultural dimension as a prerequisite for successful reform. Future research could explore practical strategies for constructing, developing, and assessing school culture in practice.

References

1. Boshtrakaj, L., Rraci, E., & Bajrami, K. (2018). *Challenges of implementing the curricular reform in pre-university education in Kosovo*. Prishtina: Kosovo Education and Employment Network (KEEN). <http://www.keen-ks.net>

2. Deal, T. E., & Peterson, K. D. (2016). *Shaping School Culture* (3rd ed.). Jossey-Bass.
3. Deal, T., & Kennedy, A. (1982). *Corporate cultures: The rites and rituals of corporate life*. New York: Addison-Wesley
4. Finnan, C. (2000) *Implementing school reform models: Why is it so hard for some schools and easy for others?* Paper presented at the meeting of the American Educational Research Association, New Orleans. <https://eric.ed.gov/?id=ED446356>
5. Froiland, J. M. (2021). School climate. *Research Starters: Psychology*. Retrieved from <https://www.ebsco.com/research-starters/psychology/school-climate>
6. Grgić, M., & Jutzi, M. (2024). Linking school culture to successful curriculum reform. *Education Sciences*, 14(6), 558. <https://doi.org/10.3390/educsci14060558>
7. Gruenert, S., & Whitaker, T. (2015). *School culture rewired: How to define, assess, and transform it*. ASCD. <https://www.ascd.org/books/school-culture-rewired>
8. Hargreaves, A. (2003). *Teaching in the knowledge society: Education in the age of insecurity*. Teachers College Press.
9. Leithwood, K., Jantzi, D., & Fernandez, A. (1994). Transformational leadership and teachers' commitment to change. In J. Murphy & K. S. Louis (Eds.), *Reshaping the principalship: Insights from transformational reform efforts* (pp. 77–98). Corwin Press.
10. Lent, R. W., & Brown, S. D. (2019). Social cognitive career theory at 25: Empirical status of the interest, choice, and performance models. *Journal of Vocational Behavior*, 115, Article 103316. <https://doi.org/10.1016/j.jvb.2019.06.004>.
11. Ministry of Education, Science, and Technology (MEST). (2016). *Kosovo Curriculum Framework*.
12. Schein, E. (1992). *Organizational culture and leadership* (2nd ed.). San Francisco: Jossey-Bass.
13. Schein, E. H. (2010). *Organizational culture and leadership* (4th ed.). Jossey-Bass.
14. Wambua, M., & Waweru, S. (2019). Constraints Facing Successful Implementation of the Competency-Based Curriculum in Kenya. *American Journal of Educational Research*, 7(12), 943–947
15. Wibowo, D. (2020). *The role of school culture in teacher professional development for peace education: The case of three schools in post-conflict*

Aceh, Indonesia [Doctoral dissertation, University of Otago]. University of Otago Research Archive. <https://digitalnz.org/records/43758887>

ROLI I PARTIVE POLITIKE DHE PLURALIZMI PARTIAK NË QEVERISJE: ANALIZË TEORIKE DHE KRAHASUESE E SISTEMEVE POLITIKE

Saranda Hani

s.hani@eust.edu.mk

Abstrakt

Ky punim analizon rolin dhe funksionimin e partive politike në sisteme të ndryshme politike, me fokus të veçantë në pluralizmin partiak si një tregues kyç i nivelit demokratik të qeverisjes. Në pjesën teorike trajtohet nocioni i partive politike, karakteristikat themelore, funksionet dhe dallimet ndërmjet partive demokratike dhe totalitare. Më tej, punimi ndalet në analizën e pluralizmit partiak në Mbretërinë e Bashkuar, duke shqyrtuar strukturën, rolin dhe dallimet kryesore ndërmjet Partisë Konservatore dhe Partisë Laburiste si dy forcat dominuese të sistemit politik britanik. Në kuadër të analizës krahasuese, përfshihen edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermania dhe Kina, si raste studimore që përfaqësojnë modele të ndryshme të organizimit të sistemeve partiake, nga demokracitë dypartiake dhe shumëpartiake deri te regjimi autoritar njëpartiak. Krahasimi synon të vërë në pah ndikimin e pluralizmit partiak mbi stabilitetin politik, pjesëmarrjen qytetare dhe mekanizmat e llogaridhënies. Rezultatet tregojnë se pluralizmi dhe konkurrenca politike kontribuojnë në përfaqësim më të gjerë dhe kontroll më efektiv të pushtetit, ndërsa mungesa e tyre kufizon pjesëmarrjen dhe transparencën qeveritare.

Hyrje

Partitë politike përbëjnë një nga institucionet themelore të sistemeve politike bashkëkohore dhe luajnë një rol vendimtar në funksionimin e demokracisë përfaqësuese. Ato shërbejnë si mekanizma kyç për artikullimin e interesave shoqërore, mobilizimin politik të qytetarëve dhe strukturimin e konkurrencës elektorale. Nëpërmjet partive politike, qytetarët ushtrojnë të drejtën e tyre për përfaqësim dhe ndikojnë drejtpërdrejt në formësimin e politikave publike dhe në drejtimin e qeverisjes.

Pluralizmi partiak konsiderohet gjerësisht si një tregues thelbësor i nivelit demokratik të një sistemi politik. Ekzistenca e disa partive politike, konkurrenca e lirë ndërmjet tyre dhe mundësia e rotacionit të pushtetit krijojnë kushtet për llogaridhënie, transparencë dhe mbrojtje të interesave të ndryshme shoqërore. Në të kundërt,

sistemet politike që karakterizohen nga mungesa e pluralizmit dhe dominimi i një partie të vetme kufizojnë pjesëmarrjen qytetare dhe centralizojnë pushtetin politik.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë rolin, funksionimin dhe modelet e partive politike në kontekste të ndryshme institucionale, duke u përqendruar në marrëdhënien ndërmjet pluralizmit partiak dhe qeverisjes. Mbretëria e Bashkuar është zgjedhur si rasti kryesor i studimit për shkak të traditës së saj parlamentare dhe funksionimit të një sistemi bipartiak brenda një kornize pluraliste. Për të ofruar një perspektivë krahasuese më të gjerë, analiza përfshin gjithashtu Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermaninë dhe Kinën, si modele që përfaqësojnë forma të ndryshme të organizimit politik.

Përmes këtij krahasimi, punimi synon të evidentojë ndikimin e sistemeve partiake mbi stabilitetin politik, përfaqësimin demokratik dhe mekanizmat e kontrollit të pushtetit, duke krijuar një bazë teorike dhe empirike për kuptimin e rolit të partive politike në sistemet politike bashkëkohore.

Partitë politike

Partitë politike janë subjekte formale të përbëra nga individë që ndajnë bindje, objektiva dhe vizione të përbashkëta politike, me synimin për të ushtruar ndikim mbi qeverinë dhe peizazhin politik të një rajoni të caktuar. Këto organizata luajnë një rol vendimtar në sistemet politike demokratike duke ofruar një kornizë për konkurrencën elektorale dhe duke mbrojtur interesat dhe pikëpamjet e ndryshme të qytetarëve.

Ekzistojnë disa karakteristika kryesore që përcaktojnë partitë politike:

1. Ideologjia dhe platforma: Partitë politike zakonisht kanë një themel themelor ideologjik ose filozofik që formëson qëndrimet e tyre për çështjet politike, sociale dhe ekonomike. Ata shpesh zhvillojnë një platformë gjithëpërfshirëse që përshkruan qëndrimet e tyre për këto çështje.

2. Përfaqësimi: Partitë politike përpiqen të përfaqësojnë interesat dhe shqetësimet e grupeve të veçanta shoqërore. Ky përfaqësim mund të përfshijë aspekte të ndryshme, si ideologjitë politike, bashkësitë etnike, klasat socio-ekonomike ose segmente të tjera të popullsisë. Duke vepruar kështu, partitë synojnë të sigurojnë që zërat dhe perspektivat e këtyre grupeve të dëgjohen dhe të merren parasysh në procesin e vendimmarrjes politike. Si përmbledhje, partitë politike janë organizata formale që bashkojnë individë që ndajnë ide dhe qëllime të përbashkëta politike. Ato shërbejnë si një komponent jetik i sistemeve demokratike, duke siguruar një strukturë

për konkurrencën zgjedhore dhe duke mbrojtur interesat dhe opinionet e ndryshme të qytetarëve.

3.Pjesëmarrja në zgjedhje: Për të marrë pjesë në zgjedhje, partitë politike zakonisht nominojnë kandidatë për poste të ndryshme, si ligjvënësit, kryetarët e qeverisë dhe kryetarët e bashkive. Qytetarët ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar duke përzgjedhur kandidatët e preferuar dhe partitë që sigurojnë numrin më të madh të vendeve apo votave kanë fuqinë për të formuar politikën dhe qeverisjen.

4.Organizimi i brendshëm: Partitë politike krijojnë një strukturë të brendshme organizative që përfshin anëtarët, udhëheqësit, komitetet dhe proceset e vendimmarrjes. Ndërsa disa palë shfaqin një nivel të lartë organizimi, të tjerat mund të adoptojnë një qasje më informale.

5.Financimi: Burimet financiare janë thelbësore për funksionimin e partive politike, duke u mundësuar atyre të zhvillojnë fushata elektorale, të organizojnë ngjarje dhe të mbështesin aktivitetet e tyre. Këto burime mund të merren përmes kontributeve të anëtarëve, donacioneve private, granteve publike dhe mjeteve të tjera.

6.Komunikimi politik: Partitë politike përdorin komunikimin politik si një mjet për të përcjellë idetë, pozicionet dhe mesazhet e tyre tek elektorati. Kjo përfshin kanale të ndryshme si fjalimet, deklaratat e politikave, reklammat dhe platformat e mediave sociale.

Rëndësia e partive politike dhe funksionimi i tyre

Partitë politike përbëjnë një element thelbësor të sistemeve politike bashkëkohore dhe një shtyllë qendrore të pluralizmit partiak. Natyra, struktura dhe funksionimi i tyre ndryshojnë nga një shtet në tjetrin, të ndikuara nga traditat politike, sistemet zgjedhore dhe rrethanat historike specifike. Megjithatë, pavarësisht këtyre dallimeve, partitë politike luajnë një rol vendimtar në organizimin e jetës politike dhe në përfaqësimin e interesave të qytetarëve.

Në sistemet demokratike, partitë politike ofrojnë një platformë të strukturuar për pjesëmarrjen politike të qytetarëve, duke mundësuar përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse. Ato shërbejnë si ndërmjetës midis shoqërisë dhe shtetit, duke artikuluar kërkesat e grupeve të ndryshme shoqërore dhe duke i shndërruar ato në programe politike.

Në sistemet shumëpartiake, bashkëpunimi ndërmjet partive politike realizohet shpesh përmes koalicioneve qeverisëse. Koalicionet krijohen si rezultat i nevojës për të siguruar shumicën parlamentare dhe për të garantuar stabilitetin e qeverisjes, veçanërisht në sistemet parlamentare. Ky mekanizëm dëshmon fleksibilitetin e partive politike dhe aftësinë e tyre për të bashkëpunuar në funksion të interesit publik.

Partitë politike pozicionohen zakonisht në një spektër politik që shtrihet nga e majta në të djathtë, me partitë e qendrës që zënë një pozicion ndërmjetës. Ky pozicionim ideologjik ndihmon votuesit të kuptojnë orientimin e përgjithshëm të partive mbi çështje kyçe politike, ekonomike dhe sociale.

Një rol i rëndësishëm i partive politike është ai i opozitës. Partitë opozitare kontribuojnë në sigurimin e llogaridhënies së qeverisë duke monitoruar politikat publike, duke ofruar alternativa dhe duke ushtruar presion institucional. Një opozitë e fortë konsiderohet si kusht i domosdoshëm për funksionimin e një demokracie të shëndetshme.

Partitë politike ndikojnë drejtpërdrejt në formësimin e politikave publike. Kur janë në pushtet, ato zbatojnë programe politike në përputhje me platformat e tyre zgjedhore, ndërsa në opozitë kontribuojnë përmes debateve dhe ndikimit në opinionin publik. Për më tepër, partitë angazhohen në aktivizëm bazë, duke mobilizuar elektoratin përmes fushatave, takimeve dhe veprimtarive në nivel lokal.

Në kushtet e ndryshimeve shoqërore, ekonomike dhe politike, partitë politike demonstrojnë një proces të vazhdueshëm përshtatjeje. Ato rishikojnë programet e tyre, adresojnë sfida të reja dhe synojnë të tërheqin grupe të reja shoqërore. Në disa raste, partitë adoptojnë strategji populiste, duke u drejtuar drejtpërdrejt emocioneve dhe shqetësimeve të elektoratit, shpesh duke u pozicionuar si forca anti-establishment.¹

Roli i partive politike

Partitë politike luajnë një rol thelbësor në funksionimin e sistemeve demokratike, duke kryer funksione të rëndësishme në përfaqësim, qeverisje dhe

¹ <https://www.scribd.com/doc/93033886/Partite-politike-1>
<https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2013/01/Meidani3Partite1.pdf>
"Sistemet Politike bashkekohore", Prof. Dr. L. Lambro Filo
"Sistemet politike bashkekohore" Prof. dr. Etem Aziri

pjesëmarrje politike. Një nga funksionet kryesore të tyre është përfaqësimi i interesave të ndryshme shoqërore, ekonomike dhe kulturore, duke u ofruar qytetarëve një kanal institucional për shprehjen e qëndrimeve dhe kërkesave të tyre.

Në sistemet parlamentare, partitë politike kanë një rol kyç në formimin e qeverive. Partia ose koalicioni që siguron shumicën parlamentare merr mandatin për të formuar qeverinë dhe për të përcaktuar drejtimin e politikave shtetërore. Kjo nënvizon ndikimin e drejtpërdrejtë të partive politike në qeverisje dhe stabilitet institucional.

Partitë politike janë gjithashtu përgjegjëse për zhvillimin dhe promovimin e platformave politike. Kur janë në pushtet, ato hartojnë dhe zbatojnë politika publike në përputhje me premtimet zgjedhore, duke ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin socio-ekonomik të vendit. Në të njëjtën kohë, partitë opozitare ofrojnë alternativa politike dhe kontribuojnë në debatin publik.

Një funksion tjetër i rëndësishëm është angazhimi në fushata zgjedhore, përmes të cilave partitë informojnë elektoratin, mobilizojnë votuesit dhe nxisin pjesëmarrjen qytetare. Këto procese forcojnë demokracinë pjesëmarrëse dhe rrisin ndërgjegjësimin politik të shoqërisë.

Partitë politike luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në sigurimin e përgjegjësisë dhe mbikëqyrjes së qeverisë, veçanërisht përmes rolit të opozitës. Ato kontribuojnë në edukimin politik të qytetarëve dhe në ndërtimin e identiteteve politike, duke ndikuar në sjelljen elektorale dhe përfshirjen qytetare.²

Partitë politike demokratike dhe totalitare

Funksionimi i partive politike ndryshon ndjeshëm në varësi të regjimit politik në të cilin ato veprojnë. Dallimi më i theksuar shfaqet ndërmjet partive politike demokratike dhe atyre totalitare.

Partitë politike demokratike

Në sistemet demokratike, partitë politike veprojnë në një mjedis pluralist, ku ekzistojnë dhe konkurrojnë disa parti politike. Ato marrin pjesë në zgjedhje të lira, të

² Sistemet Politike bashkëkohore”, Prof. Dr. LLambro Filo
<https://telegafi.com/roli-i-partive-politike-ne-demokracine-parlamentare/>
<https://www.scribd.com/doc/87568471/Paraqitja-Dhe-Roli-Partive-Politike>

ndershme dhe periodike, të cilat përbëjnë bazën e legjitimitetit të qeverisjes. Qeveritë e dala nga zgjedhjet marrin autoritetin e tyre nga pëlqimi i qytetarëve.

Shteti i së drejtës përbën themelin e funksionimit të partive demokratike, ku institucionet e pavarura, gjyqësori dhe media e lirë sigurojnë kontroll dhe balancë efektive. Partitë demokratike mbështesin mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke garantuar lirinë e shprehjes, organizimit dhe pjesëmarrjes politike.

Një element i rëndësishëm është angazhimi i shoqërisë civile. Partitë demokratike ndërveprojnë me organizata të ndryshme shoqërore, duke krijuar një sferë publike aktive dhe duke u ofruar qytetarëve mundësi për të ndikuar në procesin vendimmarrës.

Partitë politike totalitare

Në regjimet totalitare, sistemi politik karakterizohet nga mungesa e pluralizmit partiak. Zakonisht ekziston një parti e vetme ose një parti dominuese që ushtron monopol mbi pushtetin politik. Vendimmarrja është e centralizuar dhe kontrollohet nga një udhëheqës ose një elitë e ngushtë politike.

Zgjedhjet, nëse zhvillohen, janë kryesisht formale dhe shërbejnë për legjitimimin simbolik të pushtetit ekzistues, pa ofruar konkurrencë reale politike. Institucionet shtetërore dhe sistemi ligjor janë të varura nga vullneti i partisë në pushtet, duke kufizuar kontrollin dhe balancat institucionale.

Partitë totalitare shtypin opozitën politike, kufizojnë liritë civile dhe ushtrojnë kontroll mbi median dhe shoqërinë civile. Kjo çon në cenimin e të drejtave të njeriut dhe në reduktimin e pjesëmarrjes politike të qytetarëve.³

³ <https://www.greelane.com/sq/shkencat-humane/%C3%A7%C3%ABshtjet/totalitarianism-definition-and-examples-5083506>
<https://shtetiweb.org/2021/11/11/dallimi-midis-autoritarizmit-dhe-totalitarizmit/>
<https://sq.delachieve.com/demokracia-liberale-perkufizimi-thelbi-karakteristikat-disavantazhet/> Prof.dr. Etem Aziri "Sistemet politike bashkëkohore

Tabela krahasuese: partitë politike demokratike dhe totalitare

Elementi krahasues	Parti politike demokratike	Parti politike totalitare
Pluralizmi partiak	Ekzistojnë disa parti politike	Një parti e vetme ose dominuese
Konkurrenca politike	Konkurrencë e lirë dhe reale	Mungesë konkurrencë reale
Zgjedhjet	Të lira, periodike dhe konkurruese	Formale ose të manipuluar
Sundimi i ligjit	Respektohet shteti i së drejtës	Sundim i kufizuar i ligjit
Ndarja e pushteteve	E garantuar institucionalisht	Pushtet i centralizuar
Të drejtat dhe liritë e njeriut	Të mbrojtura dhe të garantuara	Të kufizuara ose të shkelura
Roli i opozitës	Aktiv dhe legjitim	I ndaluar ose i shtypur
Shoqëria civile	E lirë dhe aktive	E kontrolluar ose e censuruar

Analiza e rolit, funksionimit dhe modeleve të partive politike dëshmon se pluralizmi partiak është një tregues thelbësor i nivelit demokratik të një sistemi politik. Ndërsa në demokraci partitë politike shërbejnë si mekanizma përfaqësimi dhe llogaridhënieje, në regjimet totalitare ato shndërrohen në instrumente kontrolli dhe centralizimi të pushtetit. Ky dallim krijon bazën teorike për analizën krahasuese të sistemeve politike në kapitujt vijues.

Pluralizmi partiak në Mbretërinë e Bashkuar

Mbretëria e Bashkuar përfaqëson një nga modelet më të konsoliduara të pluralizmit partiak në Evropë. Sistemi i saj politik karakterizohet nga konkurrenca e lirë ndërmjet partive, rotacioni periodik i pushtetit dhe një traditë e gjatë parlamentare. Ndonëse formalisht Mbretëria e Bashkuar funksionon si sistem shumëpartiak, në

praktikë ajo dominohet nga dy parti kryesore politike, çka e bën atë një shembull tipik të sistemit bipartiak brenda kornizës së pluralizmit demokratik.

Partitë politike në Mbretërinë e Bashkuar

Në Mbretërinë e Bashkuar veprojnë disa parti politike që përfaqësojnë ideologji, interesa dhe identitete të ndryshme shoqërore e territoriale. Krahas dy partive kryesore – Partisë Konservatore dhe Partisë Laburiste – në sistemin politik britanik janë të pranishme edhe parti të tjera, si Liberal Demokratët, Partia Kombëtare Skoceze (SNP), Partia e Gjelbër, si dhe parti rajonale në Uells dhe Irlandën e Veriut. Prania e këtyre partive pasqyron pluralizmin politik dhe shoqëror, megjithëse ndikimi real në qeverisje mbetet kryesisht në duart e dy partive dominuese.

Partia Konservatore

Partia Konservatore, e njohur tradicionalisht si “Tories”, është një nga partitë më të vjetra politike në Mbretërinë e Bashkuar. Origjina e saj lidhet me fraksionet parlamentare të shekullit XVII, ndërsa konsolidimi si parti moderne i atribuohet reformave organizative të shekullit XIX. Ajo pozicionohet ideologjikisht në qendrën e djathtë të spektrit politik dhe mbështet parime të tilla si ekonomia e tregut të lirë, përgjegjësia individuale, roli i kufizuar i shtetit në ekonomi dhe një mbrojtje e fortë kombëtare.

Historikisht, Partia Konservatore ka qenë e lidhur me interesat e biznesit, pronarëve të tokave dhe shtresave të mesme, duke gëzuar mbështetje të konsiderueshme në zonat rurale dhe jugore të vendit. Gjatë dekadave të fundit, ajo ka ruajtur një rol qendror në qeverisjen e Mbretërisë së Bashkuar, duke qenë shpesh forca dominuese në Dhomën e Komunave.

Në aspektin organizativ, Partia Konservatore është e strukturuar në mënyrë hierarkike, duke filluar nga shoqatat lokale në zonat elektorale, rajonet administrative, Konventa Kombëtare dhe Bordi i Partisë. Ky organizim siguron lidhjen midis bazës partiake dhe udhëheqjes qendrore, si dhe koordinimin e aktiviteteve politike dhe elektorale.

Procesi i zgjedhjes së udhëheqësit të Partisë Konservatore përfshin një fazë parlamentare dhe një fazë të votimit nga anëtarësia, duke reflektuar një kombinim të autoritetit parlamentar dhe demokracisë së brendshme partiake. Ky mekanizëm ka kontribuar në ruajtjen e stabilitetit dhe disiplinës brenda partisë.

Partia Laburiste

Partia Laburiste u formua në fillim të shekullit XX si përgjigje ndaj nevojës për përfaqësimin politik të klasës punëtore dhe sindikatave. Ajo u konsolidua gradualisht si forca kryesore e së majtës britanike, duke zëvendësuar Partinë Liberale si kundërpeshë kryesore e Partisë Konservatore.

Ideologjikisht, Partia Laburiste pozicionohet në qendrën e majtë dhe mbështet parimet e socialdemokracisë, drejtësisë sociale, të drejtave të punëtorëve dhe rolit aktiv të shtetit në sigurimin e shërbimeve publike dhe barazisë sociale. Gjatë historisë së saj, partia ka qenë e lidhur ngushtë me sindikatat dhe ka gëzuar mbështetje të fortë në zonat urbane dhe industriale.

Struktura organizative e Partisë Laburiste është federale dhe përfshin parti lokale, sindikata, Partinë Parlamentare të Punës dhe organizata të lidhura. Konferenca vjetore përbën organin më të lartë formal të vendimmarrjes, ndërsa Komiteti Ekzekutiv Kombëtar luan një rol kyç në drejtimin e përditshëm të partisë. Reforma të shumta organizative kanë synuar të balancojnë ndikimin e bazës partiake me autoritetin e udhëheqjes parlamentare.

Zgjedhja e udhëheqësit të Partisë Laburiste realizohet përmes një sistemi që përfshin anëtarësinë, deputetët dhe strukturat lokale, duke reflektuar përkushtimin e partisë ndaj parimeve të përfaqësimit dhe demokracisë së brendshme.

Dallimet kryesore ndërmjet Partisë Konservatore dhe Partisë Laburiste

Dallimet midis dy partive kryesore britanike shfaqen qartë në planin ideologjik, ekonomik dhe shoqëror. Partia Konservatore mbështet politikën e tregut të lirë, ndërhyrjen minimale të shtetit dhe theksin mbi përgjegjësinë individuale, ndërsa Partia Laburiste promovon një ekonomi të përzier, drejtësinë sociale dhe ndërhyrjen e shtetit për të reduktuar pabarazitë.

Në aspektin social, konservatorët kanë qenë tradicionalisht më të lidhur me vlerat konservatore, ndërsa laburistët mbështesin qasje më progresive dhe gjithëpërfshirëse. Po ashtu, bazat elektorale të dy partive ndryshojnë, me

Konservatorët që gëzojnë mbështetje më të madhe nga shtresat e mesme dhe zonat rurale, ndërsa Laburistët nga klasa punëtore dhe zonat urbane.⁴

Krahasim i sistemeve partiake

Në kuadër të studimit të pluralizmit partiak dhe rolit të partive politike në qeverisje, vendosa të përqendrohem në disa raste studimi që ofrojnë perspektiva të ndryshme mbi funksionimin e sistemeve politike. **Mbretëria e Bashkuar** u zgjodh si rasti kryesor për analizën, pasi sistemi i saj parlamentare dhe pluralizmi i partive ofron një shembull të qartë të konkurrencës politike dhe koalicioneve që ndikojnë në qeverisje.

Për të pasur një krahasim më të gjerë dhe për të kuptuar ndikimin e strukturave të ndryshme politike, vendosa të përfshij edhe:

Shtetet e Bashkuara (SHBA) – si një demokraci presidenciale me sistem dypartiak, ku konkurrenca midis dy partive kryesore ndikon në mënyrë të ndryshme mbi përfaqësimin dhe procesin vendimmarrës.

Gjermaninë – si një shembull i një demokracie parlamentare me shumë parti, ku koalicionet dhe pluralizmi partiak janë vendimtarë për formimin e qeverisë dhe stabilitetin politik.

Kinë – për të ilustruar kontrastin me sistemet demokratike, si një regjime autoritar me një parti të vetme që monopolizon pushtetin, duke kufizuar pluralizmin dhe pjesëmarrjen qytetare.

Ky përzgjedhim i rasteve studimore synon të ofrojë një pamje të gjerë të mënyrave të ndryshme të funksionimit të partive politike, nga pluralizmi i avancuar dhe konkurrenca demokratike te sistemi autoritar njëpartiak. Krahasimi midis këtyre vendeve do të lehtësojë analizën e ndikimit të pluralizmit mbi qeverisjen, pjesëmarrjen qytetare dhe llogaridhënien e qeverisë.

⁴ <https://sq.birmiss.com/partia-konservatore-e-britanise-se-madhe-ideologjia-udheheqesit/>
[https://it.wikipedia.org/wiki/Partito_Conservatore_\(Regno_Unito\)](https://it.wikipedia.org/wiki/Partito_Conservatore_(Regno_Unito))
https://en.wikipedia.org/wiki/Politics_of_the_United_Kingdom
<https://www.jstor.org/stable/20081705>

Krahasimi i sistemit partiak dhe pluralizmit

Vendi	Tipi i sistemit	Numri kryesor i partive	Roli partive të vogla	Stabiliteti politik	Llogaridhënie dhe kontrolli
Mbretëria e Bashkuar	Dypartiak me parti rajonale	2 kryesore + disa të vogla	I kufizuar, me ndikim lokal/koalicion	I lartë	Moderuar, rritet nga opozita
SHBA	Dypartiak	2 kryesore	Minimal	I lartë, por polarizim	Moderuar
Gjermania	Shumëpartiak proporcional	5–6 kryesore	I fuqishëm, pjesë e koalicioneve	I lartë	I lartë, kontroll i koalicioneve
Kina	Autoritar, një parti dominante	1 dominante	Nuk ka rol	I ulët (centralizuar)	Minimal, kontroll nga partia


5

⁵ Arend Lijphart, *Modelet e Demokracisë: Format e Qeverisjes dhe Performanca në Tridhjetë e Gjashtë Vende* (Nju Hejvën: Yale University Press, 2012).

² Giovanni Sartori, *Partitë dhe Sistemet Partiake: Një Kornizë për Analizë* (Kolçester: ECPR Press, 2005).

³ Andrew Heywood, *Politika*, botimi i 5-të (Londër: Palgrave Macmillan, 2021).

Analizë krahasuese



Grafikoni tregon krahasimin e katër sistemeve politike: Mbretëria e Bashkuar, SHBA, Gjermania dhe Kina, duke u fokusuar në numrin e partive kryesore, pluralizmin e partive të vogla dhe stabilitetin politik.

Rezultatet kryesore që dalin nga grafikoni:

Numri i partive kryesore – Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA kanë vetëm dy parti kryesore, ndërsa Gjermania ka më shumë parti kryesore për shkak të sistemit proporcional. Kina ka vetëm një parti dominante.

Pluralizmi i partive të vogla – Partitë e vogla në Gjermani kanë rol të fuqishëm për shkak të koalicioneve, ndërsa në SHBA ndikimi i tyre është minimal. Mbretëria e Bashkuar ka disa parti të vogla me ndikim lokal ose koalicionesh, ndërsa Kina nuk lejon pluralizëm.

Stabiliteti politik – Sistemet dypartiake (MB, SHBA) dhe shumëpartiake (Gjermania) tregojnë stabilitet të lartë, ndërsa Kina ka stabilitet të ulët për shkak të centralizimit të pushtetit.

Ky krahasim e bën të qartë se sistemi proporcional dhe pluralizmi i partive kontribuojnë në përfaqësim më të gjerë dhe kontroll më të lartë, ndërsa sistemi dypartiak favorizon qeverisjen efikase dhe stabilitetin, por kufizon ndikimin e partive

të vogla. Kina, nga ana tjetër, tregon se mungesa e pluralizmit sjell kontroll të fortë, por ul pjesëmarrjen dhe llogaridhënien.

Konkluzione

Analiza e rolit dhe funksionimit të partive politike në këtë punim konfirmon se ato përbëjnë institucione themelore të sistemeve politike moderne dhe elemente kyçe të ndërmjetësimit ndërmjet shoqërisë dhe shtetit. Përmes strukturimit të konkurrencës elektorale, artikulimit të interesave shoqërore dhe formësimit të politikave publike, partitë politike ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e qeverisjes dhe në legjitimitetin e pushtetit politik.

Gjetjet e punimit dëshmojnë se pluralizmi partiak përfaqëson një indikator qendror të demokracisë funksionale. Sistemet politike që garantojnë ekzistencën e konkurrencës së lirë ndërmjet subjekteve politike dhe mundësinë reale të rotacionit të pushtetit krijojnë mekanizma efektivë të llogaridhënies institucionale dhe të kontrollit demokratik. Në këto kushte, partitë politike shndërrohen në aktorë përgjegjës të qeverisjes dhe në instrumente të përfaqësimit të interesave të ndryshme shoqërore.

Studimi i rastit të Mbretërisë së Bashkuar evidencon se një sistem politik i dominuar nga dy parti kryesore mund të ruajë karakterin pluralist përmes institucioneve parlamentare të konsoliduara, rolit aktiv të opozitës dhe pjesëmarrjes së partive rajonale dhe të vogla në procesin politik. Ky model dëshmon se stabiliteti politik dhe pluralizmi nuk janë koncepte përjashtuese, por mund të bashkëekzistojnë në një kornizë institucionale demokratike të qëndrueshme.

Analiza krahasuese me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermaninë dhe Kinën nxjerr në pah ndikimin përcaktues të strukturave partiake mbi përfaqësimin politik, proceset vendimmarrëse dhe marrëdhënien ndërmjet pushtetit dhe qytetarëve. Ndërsa sistemet demokratike dypartiake dhe shumëpartiake ofrojnë forma të ndryshme të ekuilibrit ndërmjet efikasitetit qeverisës dhe përfaqësimit pluralist, sistemi njëpartiak autoritar karakterizohet nga centralizimi i pushtetit dhe dobësimi i mekanizmave të kontrollit demokratik.

Në përfundim, punimi konstaton se funksionimi demokratik i partive politike dhe ekzistenca e pluralizmit partiak përbëjnë parakushte thelbësore për ndërtimin dhe ruajtjen e qeverisjes legjitime, transparente dhe të përgjegjshme. Ky përfundim ofron një bazë teorike të qëndrueshme për analiza të mëtejshme krahasuese mbi evolucionin e sistemeve partiake dhe rolin e tyre në konsolidimin demokratik.

Referencat

1. Prof. Dr. Llambro Filo, Sistemet Politike Bashkëkohore
2. Prof. Dr. Etem Aziri, Sistemet Politike Bashkëkohore
3. Arend Lijphart, Modelet e Demokracisë: Format e Qeverisjes dhe Performanca në Tridhjetë e Gjashtë Vende (New Haven: Yale University Press, 2012)
4. Giovanni Sartori, Partitë dhe Sistemet Partiake: Një Kornizë për Analizë (Colchester: ECPR Press, 2005)
5. Andrew Heywood, Politika, botimi i 5-të (Londër: Palgrave Macmillan, 2021)
6. <https://www.scribd.com/doc/93033886/Partite-politike-1>
7. <https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2013/01/Meidani3Partite1.pdf>
8. <https://telegrafi.com/roli-i-partive-politike-ne-demokracine-parlamentare/>
9. <https://www.scribd.com/doc/87568471/Paraqitja-Dhe-Roli-Partive-Politike>
10. <https://www.greelane.com/sq/shkencat-humane/%C3%A7%C3%ABshtjet/totalitarianism-definition-and-examples-5083506>
11. <https://shtetiweb.org/2021/11/11/dallimi-midis-autoritarizmit-dhe-totalitarizmit/>
12. <https://sq.delachieve.com/demokracia-liberale-perkufizimi-thelbi-karakteristikat-disavantazhet/>
13. <https://sq.birmiss.com/partia-konservatore-e-britanise-se-madhe-ideologjia-udheheqesit/>
14. [https://it.wikipedia.org/wiki/Partito_Conservatore_\(Regno_Unito\)](https://it.wikipedia.org/wiki/Partito_Conservatore_(Regno_Unito))
15. https://en.wikipedia.org/wiki/Politics_of_the_United_Kingdom
16. · <https://www.jstor.org/stable/20081705>

FITIMI I PRONËSISË NËPËRMJET TRASHËGIMISË DHE HEQJA DORË NGA TRASHËGIMIA SIPAS LIGJIT PËR PROCEDURË JOKONTESTIMORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Prof.Dr. Shemsije Demiri¹

International University of Struga

sh.demiri@eust.edu.mk

Prof.Dr: Driton Haruni²

International University of Struga

d.haruni@eust.edu.mk

Abstrakt

Institucioni i trashëgimisë konsiderohet si një ndër institucionet më të vjetra të së drejtës civile dhe paraqitet edhe si një faktor social në ç' do shoqëri. Roli i të drejtës trashëgimore është i shumëfishtë, roli themelor i institutit të trashëgimisë është përfshirja në procesin e trashëgimisë të marrëdhënieve juridike të një individi. Në qoftë së më vdekjen e personave fizike do të merrnin fund të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tij, do të shkaktoheshin një sërë pasojash negative për shoqërinë dhe individët. Në radhë të parë marrëdhëniet juridike do të bëheshin të pasigurta, te shumëkush do të shfaqej rreziku se papritmas do të rrënohej për shkak të vdekjes së ndonjë subjekti. Kjo pasiguri do të veshtirësonte e ngadalësonte qarkullimin e mallrave, marrëdhëniet juridike midis personave fizike. Ato subjekte që do të merrnin guximin të jepenin hua ose kredi një trashëgimi: me ligj dhe më testament.

Objekti kryesor i këtij punimi është “ Fitimi i pronësisë nëpërmjet trashëgimit sipas Ligjit për Procedurë Jokontestimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ” në fillim të këtij punimi do i shtjelloj edhe disa pika

kryesore të së drejtës trashëgimore si: Nocioni i së drejtës trashëgimore, Kompetenca e gjykatës etj.

Fjalë kyçe: *pronësi, trahëgimi, procedurë jokontestimore, Republika e Maqedonisë së Veriut.*

Hyrje

Seanca për shqyrtimin e trashëgimisë mbahet atëherë kur parashihet me ligj ose ne rastet kur atë e propozon ndonjë person i thirrur në trashëgimi. Seanca për shqyrtimin e trashëgimisë mbahet në formë gojore.

Gjykata trashëgimore cakton seancë për shqyrtimin e trashëgimisë nëse konstaton se trashëgimlënësi ka lënë pasuri dhe trashëgimtarë. Në këtë seancë gjykata dhe pjesëmarrësit duhet t'i shqyrtojnë të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë, si të drejtat trashëgimore, e drejta e legut, zmadhimi i pjesëve të trashëgimisë dhe pyetje tjera të rëndësishme në këtë procedurë. Lidhur me këto pyetje gjykata si rregull vendos në bazë të deklaratave të personave të interesuar. Seanca për shqyrtimin e trashëgimisë do të mbahet edhe në rastet kur ndonjë prej personave të thirrur në mënyrë të rregullt me ftesë nuk merr pjesë në seancë. Në rastet e këtilla gjykata vendos në bazë të të dhënave me të cilat disponon.

Gjatë mbajtjes së seancës dhe ndërmarjes së veprimeve të caktuara gjykata përgatit procesverbal.¹

Për shqyrtimin e trashëgimisë gjykata thërret seancë. Personat e interesuar thirren në seancë me ftesë, (LPJ, neni 167, p.1). Persona të interesuar janë: personat që kanë të drejtë në trashëgimi, personat që mund të kërkojnë ndarrjen e masës trashëgimore ose ndarjen nga trashëgimia, si dhe personat që kanë kërkesa ndaj trashëgimlënësit.²

Në thirje gjykata i njofton këta persona për iniciimin e procedurës, dhe për egzistimin e testamentit nëse i tillë ekziston. Njëkohësisht me thirje gjykata do

¹ Јаневски Аерсен, Татјана Зороска-Камиловска, Граѓанско процесно право, Книга втора, Вонпарнично право, Скопје 2010, стр. 132

² По аты fq.132

t'i thërrasë personat t'ia dorëzojnë testamentin me shkrim, përkatësisht dokumentin për testament gojor, nëse gjendet tek ato ose t'i drejtojnë dëshmitarët në testamentin gojor.

Në thirrje gjykata do t'i paralajmërojë personat e interesuar se deri në përfundimin e procedurës mund të japin deklaratë për pranimin ose heqjen dorë nga trashëgimia dhe se, nëse nuk vijnë në seancë ose nuk japin deklaratë, për të drejtën e tyre do të vendos në bazë të të dhënave me të cilat disponon. Në rastin që trashëgimlënësi të ketë lënë testament, gjyqi do t'i thërrasë në seancë edhe ata persona të cilët në bazë të ligjit do të mund të kenë të drejtën e trashëgimisë. Nëse trashëgimlënësi ka emëruar përmbarues të testamentit, gjykata do ta thërrasë edhe atë në procedurë. (LPJ, neni 167).

Nëse gjykata nuk e ka të njohur se trashëgimlënësi ka lënë trashëgimtarë, personat të cilët kanë të drejtë në trashëgimi do t'i thërrasë me shpallje të lajmërohen në afat prej një viti nga dita e publikimit të shpalljes. Shpallja publikohet në „Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë“, dhe vendoset në tabelën për shpallje të gjykatës. Në të njëjtën mënyrë gjykata do të veprojë edhe kur trashëgimtarit i është vënë përfaqësues i përkohshëm për shkak se nuk është i njohur vendbanimi i tij përkatësisht vendqëndrimi, ndërsa ai nuk ka përfaqësues të vet, si dhe atëherë kur trashëgimtarit ose përfaqësuesit i tij ligjor ndodhen jashtë vendit, ndërsa ai nuk ka përfaqësues me prokurë, ashtu që dorëzimi nuk ka mundur të kryhet, (LPJ, neni 168,p.1,2,3).

Personat që kanë të drejtë në trashëgimi mund të thiren në seancë edhe në bazë të shpalljes. Thirja e këtyre personave me anë të shpalljes është e obligueshme në këto raste: 1) nëse gjykata nuk e ka të njohur nëse trashëgimlënësi ka lënë trashëgimtarë, 2) kur trashëgimtarit i është caktuar kujdestar i përkohshëm, dhe nuk dihet vendbanimi ose vendqëndrimi i tij, dhe ai nuk ka përfaqësues dhe 3) atëherë kur trashëgimtarit apo përfaqësuesit i tij ligjor ndodhen jashtë shtetit, dhe ai nuk ka përfaqësues, dhe si pasojë e kësaj dorëzimi nuk mund të realizohet. Në këto tre raste, personat që kanë të drejtë në trashëgimi thiren që të paraqiten në gjykatën trashëgimore në afat prej një viti nga dita e publikimit të shpalljes. Thirja e këtillë ka për qëllim zhvillimin e trashëgimisë në bazë të deklaratave të trashëgimtarëve.

Gjykata nuk mund ta zhvillojë procedurën trashëgimore, derisa nuk paraqiten personat e thirrur me shpallje, më vonë deri në kalimin e afatit prej një viti nga dita e publikimit të shpalljes në „Gazetën zyrtare të Republikës së

Maqedonisë,, Pas kalimit të këtij afati nëse personat e interesuar nuk paraqitet dhe nuk japin deklaratë të nevojshme, gjykata do të zhvillojë procedurën trashëgimore në bazë të deklaratës së kujdestarit të përkohshëm dhe në bazë të të dhënave me të cilat disponon.

Përveç rasteve të lartëpërmendura kur gjykata obligohet që me shpallje t'i thëras personat që kanë të drejtë në trashëgimi, gjykata mundet gjithashtu që me shpallje t'i thërasë dhe t'i dëgjojë personat, për të cilët dyshon se kanë të drejtë të njejtë ose me të fortë për të trashëguar se ata persona janë familjarë të vetëm dhe më të afërm të trashëgimlënësit.³

Deklarata mbi pranimin ose heqja dorë nga trashëgimia

Delarata trashëgimore jepet para gjykatës trashëgimore respektivisht noterit, por mund të jepet edhe para gjykatave tjera themelore, ndërsja jashta shtetit deklarata për trashëgiminë jepet para përfaqësisë Diplomatike konsulare të Republikës së Maqedonisë, ose para organit kompetent të shtetit të huaj.

Nëse gjykata dyshon se ai është trashëgimtarë i vetëm ose antarë i më i afërt i familjes me trashëgimlënësin, mund t'i ndëgjoj edhe personat e tjerë për të cilën mendon se kanë të drejtë trashëgimore, këto mund ti thëras edhe me shpallje. (neni 168, LPJ).

Deklarata trashëgimore nënkupton një prej veprimeve më të rëndësishme në procedurën trashëgimore. Deklarata për trashëgimi jepet para gjykatës trashëgimor respektivisht para noterit, por mund të jepet edhe para gjykatave tjera themelore. Jashta shtetit deklarata për trashëgiminë jepet para përfaqësisë Diplomatike konsulare të Republikës së Maqedonisë, ose para organit kompetent të shtetit të huaj. Deklarata për trashëgimi mund të jepet në formë gojore e konstatuar në procesverbal para gjykatës trashëgimore ose në formë të shkruar. Deklarata për trashëgimi mund të jetë pozitive ose negative, respektivisht deklaratë me të cilën trashëgimtari do të pranoj të jetë trashëgimtar dhe do ta pranoj masën trashëgimore, ose deklarata me të cilën heq dorë nga trashëgimia.

³ Јаневски Аерсен, Татјана Зороска-Камиловска, Граѓанско процесно право, Книга втора, Вонпарнично право, Скопје 2010, стр. 133,134

Trashëgimtari në deklaratë shënon nëse e pranon ose heq dorë nga pjesa e cila i takon në bazë të ligjit ose testamentit, ose deklarata ka të bëjë me pjesën e domosdoshme.

Deklaratën për trashëgimi e jep trashëgimtari personalisht nëse ka aftësi për të vepruar ndërsa, nëse i është marë aftësia e veprimit ose ende nuk e ka fituar zotësinë e veprimit, në emër të tij deklaratën trashëgimore e jep përfaqësuesi i tij ligjor. Deklarata për trashëgimi mund të jepet edhe nëpërmjet të autorizuarit. Nëse deklarata jepet nëpërmjet të autorizuarit, në këtë rast autorizimi duhet të vërtetohet. Autorizimi duhet të jetë special respektivisht në të duhet në mënyrë të qartë të jetë cekur se i autorizuari në emër dhe llogari të të autorizuesit si trashëgimtar të pranojë ose të heq dorë nga trashëgimia. Deklarata pozitive nuk është e nevojshme të jepet nëpërmjet të autorizuarit, sepse e njëjta llogaritet si e tillë.

Deklarata për heqje dorë nga trashëgimia jepet në procesverbal para gjykatës, ndërsa në përfaqësinë Diplommatike dhe konsulare të Maqedonisë para personit i cili së paku ka rangun e konsullit. Deklarata për trashëgimi mund të jepet edhe para noterit i cili udhëheq me procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë si i besuar i gjykatës, në bazë të asaj se LPJ ka dispozitë të veçantë sipas së cilës kur noteri ndërmer veprime në procedurën trashëgimore si i besuar i gjykatës është i autorizuar që ti ndërmer të gjitha veprimet në procedurë dhe ti sjell të gjitha vendimet të cilat i sjell gjykata në procedurën trashëgimore. Në të kundërtën roli i noterit si i besuar i gjykatës në rastet kur trashëgimtari jep deklaratë negative e hup kuptimin.

Deklarata trashëgimore për pranimin e trashëgimisë jepet në gjykatë para gjykatësit individual, këshilluesit gjyqsor dhe nënpunësit të kualifikuar gjyqsor ose para noterit, ndërsa në përfaqësinë diplomatike dhe konsulare të Maqedonisë, në shtetin e huaj para personit që së paku e ka rangun e konsullit. Deklaratën për trashëgimi e nënshkruan trashëgimtari personalisht ose përfaqësuesi i tij ligjor. Nënshkrimi i deklaratës e cila nuk është dhënë në gjykatë, noter ose përfaqësinë diplomatike dhe klonsulare të R.Maqedonisë në shtetin e huaj, si dhe nënshkrimi i autorizimit për deklaratë trashëgimore duhet të jetë e vërtetuar në noter.

Autorizimi me të cilën autorizohet avokati për të përfaqësuar palën në procedurë për të dhënë deklaratë negative nuk duhet të jetë e vërtetuar në noter.

Trashëgimtari mund të heqë dorë nga trashëgimia në emër të vet ose edhe në emër të pasardhësve të tij. Nëse trashëgimtari heq dorë nga trashëgimia pa mos konstatuar se heq dorë në emër të vet atëherë heqja dorë ndërlihet edhe me pasardhësit e tij. Për këtë arsye në ligj është paraparë se gjatë dhënies së deklaratë me të cilën hiqet dorë nga trashëgimia, trashëgimtari duhet të njoftohet se heq dorë nga trashëgimia vetëm në emër të vet ose edhe në emër të pasardhësve (neni 170, par.6, LPJ).

Nëqoftëse përfaqësuesi ligjor jep deklaratë me të cilën heq dorë nga trashëgimia, duhet patjetër të ketë pajtim nga qendra për punë sociale. (neni 170, par.7, LPJ).

Trashëgimtari që ka hequr dorë nga trashëgimia në emër të vet, llogaritet sikur asnjëherë nuk ka qenë trashëgimtar.

Deklarata për heqjen dorë nga trashëgimia për pranimin e masës trashëgimore e cila është dhënë një herë nuk mund të tërhiqet. Por nëse gjatë dhënies së deklaratës për heqjen dorë nga trashëgimia paraqitet pasuri e cila në kohën e dhënies së deklaratës nuk është ditur se i takon masës trashëgimore, trashëgimtari që e ka dhënë deklaratën mund të kërkoj që ti njihet e drejta në trashëgimi në pjesën e pasurisë së sapogjetur e cila sipas ligjit i takon, në afat prej një viti prej kohës kur nga ana e gjykatës është njoftuar për pasurinë e re të gjetur.

Deklarata trashëgimore duhet të jepet në mënyrë të lirë dhe ta shpreh vullnetin e vërtetë të personit që e jep. Nëse është dhënë nën ndikimin e shtypjes, kërcënimit, ose nën lajthim atëherë mund të kërkohet anulimi i saj. Deklarata për pranimin ose heqjen dorë nga trashëgimia nuk është e nevojshme të jepet para personave të tjerë të interesuar, dhe nuk është e nevojshme që personave të tjerë te ju jepet mundësia të deklarohen për deklaratat e personave të tjerë të interesuar.⁴

Personi i thirur në trashëgimi nuk do të shpallet trashëgimtar i cili ka dhënë deklaratë për heqjen dorë nga trashëgimia. Trashëgimtari mund të heq dorë nga trashëgimia me deklarta të dhënë në gjykatë deri në shqyrtimin e trashëgimisë (neni 128, par.1, LT). Kjo heqje dorë vlen edhe për pasardhësit e

⁴Јаневски Арсен, Зороска-Камиловска Татјана, Граѓанско процесно право, Книга втора, Вонпарнично право, Скопје 2010, стр.134,135,136

atij që ka hequr dorë nëse nuk deklaroi qartë se heq dorë vetëm në emër të vet. Përderisa pasardhësit janë të mitur për heqjen dorë nga trashëgimia nevojitet leje nga organi i kujdestarisë. (neni 128, par.3, LT). Nëse pasardhësit janë persona madhor ndërsa trashëgimtari nuk ka deklaruar qartë se heq dorë vetëm në emër të vet, deklarata e tillë i përmbledh edhe ata sepse ua pamundëson të trashëgojnë në bazë të së drejtës së përfaqësimit. Trashëgimtari i cili heq dorë vetëm në emër të vet llogaritet sikur asnjëherë nuk ka qenë trashëgimtar. Në raste të këtilla sipas të drejtës së përfaqësimit pjesa trashëgimore e cila do ti takonte trashëgimtarit po të mos hiqte dorë e trashëgojnë pasardhësit e tij. Nëse nga trashëgimia heqin dorë të gjithë trashëgimtarët e redit më të afërt të trashëgimlënësit, në trashëgimi thiren trashëgimtarët e rendit tjetër trashëgimor. Nëse heqin dorë nga trashëgimia pasardhësit e trashëgimlënësit të adoptuarit dhe pasardhësit tyre, bashklëshorti i trashëgimlënësit thiret në trashëgimi si trashëgimtarë i vetëm nga rendi i parë i trashëgimisë.

Praktikë gjyqësore:

1. Nuk llogaritet se ka pranuar të jetë trashëgimtar bashkëshortja e trashëgimlënësit, e cila ka delaruar se nuk kërkon pjesë nga trashëgimia që i takon sipas ligjit, ndërsa pas kësaj pjesën e saj trashëgimore i'a ka dhuruar djalit të saj dhe pajtohet djali të shpallet si trashëgimtarë i vetëm⁵. (Vendim i Gjykatës Supreme të R.M, Gzz.72/99 dhe rev.796/99).

2. Trashëgimtari ligjor i cili në procedurën trashëgimore ka hequr dorë nga trashëgimia respektivisht nuk ka pranuar të jetë trashëgimtarë i masës trashëgimore të priindërve të tij, nuk ka të drejtë të kërkoj të vërtetohet se në bazë të trashëgimisë ka të drejtë pronësie të një pjese të trashëgimisë. Përderisa trashëgimtari ligjor konstaton se deklarata për heqje dorë është dhënë nën ndikim të kërcënimit, lajthimit etj, duhet të kërkohej anulimi i deklaratës. (Vendim i Gjykatës së Qarkut në Shkup, gzh.2230/77 prej 20.22.1977 vit).

3. Deklarata për heqjen dorë nga trashëgimia ose për pranimin e trashëgimisë nuk mund të tërhiqet., por mundet të hidhet poshtë nëse dhënia e saj ka qenë si rezultat i ndikimeve të jashtme. (Aktvendim i Gjykatës Supreme të Jugosllavise, gz.58/64, prej 02.06.1964 viti.)

⁵ Vendim i Gjykatës Supreme të R.M, Gzz.72/99 dhe rev.796/99

4. Nëna si përfaqësues ligjor nuk mund të heq dorë nga trashëgimia në emër të vajzës së saj të mitur pa lejen e organit të kujdestarisë.(Vendim i gjykatës Supreme të Sërbisë, gzz.363/51 prej 16.11.1951 viti).⁶

Nuk mund të heqë dorë nga trashëgimia personi që ka pasur në disponim tërë masën trashëguese apo një pjesë të sajë.

Masat që do të ndërmarë trashëgimtari për rruajtjen e masës trashëguese si dhe masat e administrimit të rregullt, nuk e privojnë nga e drejta që të heqë dorë nga trashëgimia (neni 130,LT).

Heqja dorë nga trashëgimia nuk mund të jetë e pjesërishme dhe as e kushtëzuar. Heqja dorë në interes të trashëgimtarit të cakuar nuk llogaritet si heqje dorë nga trashëgimia, por si deklaratë për distancimin nga pjesa e tij trashëguese.

Kjo dorëheqje do të vlejë nëse trashëgimtari në interes të të cilit është bërë ajo, e pranon atë pjesë të trashëgimisë. (neni 131, LT)

Heqja dorë nga trashëgimia që nuk është hapur nuk ka asnjë efekt juridik. (neni 132, LT)

Deklarata për heqjen dorë nga trashëgimia apo për pranimin e saj nuk mund të revokohet. Trashëgimtari që e ka dhënë deklaratën mund të kërkoj anulimin e saj nëse ajo është dhënë nën ndikimin e dhunës apo kanosjes, mashtrimit dhe lajthimit. E drejta e kërkesës për anulimin e deklartaës pushon me kalimin e afatit prej një viti nga kuptimi i shkaqeve në bazë të të cilave mund të kërkohet anulimi i deklaratës respektivisht nga ndërprerja e kanosjes. Kjo e drejtë në ç’do rast skadon pas skadimit të afatit prej tre viteve nga plotëfuqishmëria e vendimit për trashëgimi.


Nëse pas dhënies së deklaratës për heqje dorë nga trashëgimia, paraqitet pasuri e re për të cilën në kohën e dhënies së deklaratës nuk është ditur se i takon masës trashëgimore, trashëgimtari i cili e ka dhënë deklaratën mund të kërkoj që ti njihet e drejta në trashëgimi mbi pjesën e cila sipas ligjit i takon pronës së re të gjetur, në afat prej një viti prej kur nga ana e gjykatës është njoftuar për pasurin e re.

⁶ Мицкович Дејан, Ристов Ангел, Наследно право, Скопје, 2014, ст.56,57

Masa e re trashëgimore dhe të shqyrtohet sipas dispozitave që kanë qenë në fuqi në kohën kur është kërkuar nga gjykata ta shqyrtoj trashëgiminë edhe në lidhje me atë pasuri. (neni 133, LT)⁷

1. Kush duhet të trashëgoj?

40 responses



Në pyetjen “Kush duhet të trashëgojë?”

Shumica dërrmuese e të anketuarve besojnë se trashëgimia duhet t’u takojë njësoj djemve dhe vajzave, çka tregon një nivel të lartë vetëdijesimi për barazinë gjinore, Të dy gjinitë janë përgjigjur 72.5%

Një pjesë ende mban qëndrimin tradicional se trashëgimia duhet t’u takojë kryesisht djemve 20%

Një përqindje e vogël mendon se vajzat duhet të trashëgojnë, ndoshta si reagim ndaj praktikave diskriminuese të së kaluarës 5%.


Një numër shumë i vogël i të anketuarve janë të pavendosur, 2.5%.

Rezultatet tregojnë një ndryshim pozitiv të mentalitetit shoqëror, ku barazia në trashëgimi po pranohet gjerësisht. Megjithatë, ekzistenca e qëndrimeve tradicionale tregon se nevojitet ende edukim dhe informim, sidomos në praktikë, për ta bërë këtë parim realitet të plotë.

⁷ Мицкович Дејан, Ристов Ангел, Наследно право, Скопје, 2014, ст.177

2. Pasuria e regjistruar - emri

40 responses



Në pyetjen “Pasuria e regjistruar – emri”

Përqindja më e lartë e pasurisë është ende e regjistruar në emër të babait, çka reflekton modelin tradicional të pronësisë familjare 30%


Një përqindje e konsiderueshme e pasurisë rezulton e regjistruar në emër të bashkëshortit, duke treguar se gratë shpesh nuk figurojnë si pronare formale, edhe kur pasuria është krijuar bashkërisht 27.5%

Gati një e katërta e të anketuarve deklarojnë se nuk kanë pasuri të regjistruar, çka mund të lidhet me kushte ekonomike, por edhe me përjashtim nga regjistrimi formal i pronës 22.5%.

Një përqindje relativisht e ulët e të anketuarve nuk kanë pasuri të regjistruar edhe atë 10%.

3. Sipas mendimit tuaj pse grat nuk kërkojnë të drejtën pronës


40 responses



Arsyet pse gratë nuk kërkojnë të drejtën e pronës: Nga 40 përgjigje, 52.5% tregojnë se arsyeja kryesore është zakoni, çka tregon ndikimin e fortë të normave tradicionale në shoqëri. Një përqindje e konsiderueshme 22.5% e lidh këtë me presionin apo ndikimin e prindërve dhe vëllezërve, ndërsa po aq 22.5% me mungesën e informacionit mbi të drejtat ligjore. Vetëm një pjesë shumë e vogël e të anketuarve mendojnë se kjo nuk ndodh fare, gjë që tregon se fenomeni është ende i pranishëm.

4. Faktoret ne trashëgimi

40 responses



Faktorët në trashëgimi janë pothuajse të shpërndarë në mënyrë të barabartë. Frika e transferimit të pasurisë të familja e bashkëshortit, mohimi i të drejtës së gruas dhe regjistrimi i pronës në emër të bashkëshortit përbëjnë secili nga 25.6% të përgjigjeve. Ndërkohë, mungesa e arsimit përfaqëson 23.1%, duke treguar se edhe niveli arsimor luan një rol të rëndësishëm në këtë çështje. Në përgjithësi, grafikët tregojnë se tradita, mentaliteti shoqëror dhe mungesa

e informacionit vazhdojnë të jenë pengesa kryesore për realizimin e plotë të të drejtave pronësore të grave.

Përfundime dhe konkluzione

Institucioni i trashëgimisë konsiderohet si një ndër institucionet më të vjetra të së drejtës civile dhe paraqitet edhe si një fakt social në çdo shoqëri. Sipas të drejtës pozitive, në R.M.V-së, ekzistojnë dy baza kryesore të thirrjes në trashëgimi: më ligj dhe më testament. Trashëgimi më ligj është kalim më ligj i pasurisë së personit të vdekur tek një apo më shumë persona sipas rregullave të caktuara ligjore, trashëgimi më ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka lënë testament. Duke parë rendësinë e madhe të testamentit në përcaktimin e fatit të të drejtave subjektive në rast vdekje, romakët e vjetër kanë thënë: është fatkëqësi të vdesësh, pa lënë testament .Por me gjithë këtë thënie të mençur, edhe sot e kësaj ditë pjesa më e madhe e njerëzve vdesin pa lënë testament, pa mos e rregulluar fatin e të drejtave subjektive për një pjesë të pasurisë apo për gjithë pasurinë e tyre. Kjo ka bërë që zbatimi i bazës trashëgimore më rastin e trashëgimisë së pasurisë në të gjitha fazat e zhvillimit të së drejtës të jetë i madh. Trashëgimtarët ligjorë thirren në trashëgimi sipas radhës dhe trashëgimtarët e një radhe perjashtojnë nga trashëgimia trashëgimtarët e radhës pasuese.

Nga punimi i lartpërmendur konkludojmë se rregullat e procedurës trashëgimore sipas të cilave, gjykata, noterët, organet tjera - personat e autorizuar që veprojnë në çështjet e trashëgimisë përcaktohen me dispozitat për procedurën jashtëkontestimore.

Zbatimi i ligjit të trashëgimisë i Republikës së Maqedonisë, dispozitat e Ligjit vlejnë për trashëgiminë e të gjithë qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. Në seancën për shqyrtimin e trashëgimisë noteri debatton për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë, ndërsa veçanërisht për të drejtën e trashëgimisë, për madhësinë e pjesës trashëgimore të ç' do trashëgimtari dhe të drejtën për trashëgimtarët.

Kjo tregon se vendimmarrja për trashëgiminë nuk udhëhiqet nga rrethanat individuale apo nevojat reale të trashëgimtarëve, por nga norma shoqërore dhe zakone të trashëguara.

Në këtë kontekst, vërehet një mospërputhje e dukshme ndërmjet ligjit dhe praktikës. Ndërsa legjislacioni në Republikën e Maqedonisë së Veriut njeh

barazinë e të gjithë trashëgimtarëve ligjorë pa dallim gjinie, kurse në praktikë vazhdojnë të dominojnë modele tradicionale që favorizojnë një grup të caktuar trashëgimtarësh. Kjo situatë ka pasoja të drejtpërdrejta në pozicionin ekonomik dhe shoqëror të grave, duke kufizuar qasjen e tyre në pasuri dhe siguri ekonomike.

Si përfundim, rezultatet e anketës dëshmojnë se përmirësimi i kornizës ligjore nuk është i mjaftueshëm në vetvete; është i domosdoshëm edhe ndryshimi i mentalitetit shoqëror, përmes edukimit juridik, vetëdijesimit publik dhe zbatimit më rigoroz të ligjit, në mënyrë që e drejta e trashëgimisë të realizohet realisht dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë.

Literaturë e shfrytëzuar

1. Јаневски Арсен, Зороска-Камиловска Татјана, Граѓанско процесно право, книга прва, парнично право, Скопје, 2012.
2. Јаневски Арсен, Зороска-Камиловска Татјана, Граѓанско процесно право, Книга втора, Вонпарнично право, Скопје 2010.
3. Brestovci Faik, E drejta procedural civile , Prishtinë 1997
4. Podvorica Hamdi, E drejta Trasgëgimore, Prishtinë 2006.
5. Zendeli Emine, Vizione n.11/12, pp. 78-87, Grafotex, Skopje, Macedonia, 1 / 2009, ISBN 1409-8962.
6. SEEU REVIEW, The Notary Service – Justice Services, Zendeli Emine, Selmani – Bakiu Arta, 2017
7. Мицкович Дејан, Ристов Ангел, Наследно право, Скопје, 2014,
8. Antic, B.Oliver, Nasledno pravo,NIP „Glas D.o.o., Beograd, 2004,
9. СпиРОВИЌ Трпеновска Љиљана, МицковиЌ Дејан и Ристов Ангел, Наследувањето во Европа, Скопје 2011,
10. СпиРОВИЌ Трпеновска Љиљана, МицковиЌ Дејан, Ристов Ангел, Наследното Право во Република Македонија.
11. Mihailo Konstantinović, Opšte napomene uz teze za predprojekt zakona o nasleđivanju, Arhiv za pravne i društvene nauke, br.3/1947,

12. Vlada Republike Srbije, Komisija za Izradu Građanskog zakonika, Rad na izradi na Građanskog zakonita, izveštaj Komisije za otvorenin pitanjima, Beograd, 2007,
13. Dejan Đurđević, „ Sloboda testiranja i formalizam olografskog testamenta, „ Pravni Život, br.11/2009.
14. Г.Г Черемных НАСЛЕДСТВЕННОЕ ПРАВО, учебник, Россииская академия, адвокатуры и нотариата, Москва 2009,
15. Podvorica Hamdi, E drejta trashëgimore e RPSH, Shtëpia botuese libri universitar , Tiranë, 1988.
16. Podvorica Hamdi, Trashëgimia e domosdoshme, revista, E drejta e fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës nr.1/7.
17. Bicaku Nazmi, E drejta e trashëgimisë e RPSH, shtëpia botuese libri universitar , Tiranë, 1988
18. Fuga Luliana, Trashëgimia me testament, Lilo, Tiranë, 1999.
19. Fuga Luliana, Trashëgimia, Iliri, 2002 , Tiranë.
20. Спировиќ Трпеновска Љиљана, Наследно Право, Скопје, 2009
21. Ligji për trashëgimi i Kosovës ,nr.2004/26.(LTK)
22. Kodi Civil i Shqipërisë i vitit 1994 (KCSH)
23. Kodi Civil i Shqipërisë i vitit 1929 (KCSH)
24. Kanuni i Lek Dugagjinit ,Rilindja ,Prishtinë ,1995 .(KLD).5. Kodi i Familjes i Shqipërisë .(KFSH).
25. Закон за вонпарнична постапка, Агенција „ Академик „ Скопје,2008,
26. Закон за вонпарнична постапка, сл.весник на РМ, стр.58-бр.9, 18.01.2008.
27. Закон за наследувањето, Дејан Мицковиќ Ангел Ристов, стр.40,41, Скопје 2015
28. Закон за нотаријатот, сл.весник, бр.72, стр.32, 12.04.2016
29. Коментар на Законот за наследувањето, со обрасци за практична примена, Скопје,1996, 10. Закон за наследување на Црна Гора, „ Službeni list CG,, br.74/200819.
30. Code civil des Français, (*Code Napoleon*, Francia, 1804)
31. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë,, nr.55/07,86/08 dhe 139/8 „Službeni glasnik,, 1/2009.

ПРАВНА РАМКА НА ПРЕКИНУВАЊЕ НА БРЕМЕНОСТ ВО МАКЕДОНСКОТО ЗАКОНОДАВСТВО

Рудина Каја¹

Меѓународен Универзитет на Струга и Универзитетот “Мајка
Тереза” во Скопје

r.sela@eust.edu.mk

Амела Кицара Ајети²

Соработник во Биро за јавни Набавки при Министерство за
Финансии

Апстракт

Прекинувањето на бременоста, уште се нарекува абортус, опфаќа многу сложена и чувствителна област на правото, која вклучува мноштво од правни, етички и социјални размислувања. Овој труд има за цел да ги разјасни правните и компаративно-правните аспекти околу абортусот, истакнувајќи ги различните регулаторни рамки и правни доктрини кои го регулираат ова спорно прашање низ различни правни системи. Во правни системи со рестриктивни закони за абортус, правниот дискурс се центрира околу заштитата на феталниот живот, со закони кои се врамени да го одразуваат верувањето дека животот започнува со зачнувањето и дека фетусот поседува права кои мора да бидат заштитени од државата. Ваквите законски рамки вклучуваат ретки исклучоци, доколку ги има, се карактеризираат со ригорозни процедурални барања кои мора да се исполнат пред да може легално да се изврши абортусот. Влијанието на овие рестриктивни закони врз здравјето и правата на жените е предмет на интензивна дебата, при што критичарите тврдат дека тие водат до низа негативни исходи, како продолжување на небезбедни абортуси, смртност и морбидитет кај мајките, како и нарушување на репродуктивниот систем на жените.

Клучни зборови: абортус, правен систем, регулатива, закон.

Вовед

Во суштината на правниот аспект на абортусот се наоѓа прашањето за кривичната одговорност. Различни правни системи пристапуваат кон криминализацијата или декриминализацијата на абортусот на различни начини, а со тоа, во голема мера одразувајќи ги културните, верските и моралните вредности на нивните општества.

Во некои земји, абортусот е криминализиран на високо ниво, со закони кои предвидуваат строги казни и за жените кои се подложени на процедурата и за здравствените лица кои ја вршат оваа процедура. Овие казни се движат од парични казни и затвор до построги казни мерки во одредени правни системи. Основното образложение за таквите строги регулативи произлегува од перцепцијата на абортусот како морално осудлив, со законски рамки кои бараат да се заштити феталниот живот од моментот на зачнувањето. Спротивно на тоа, се поголем број земји тргнаа кон декриминализација или легализација на абортусот, признавајќи ја автономијата на жените над нивните тела и нивното право да донесуваат одлуки во врска со нивното репродуктивно здравје. Овие правни системи дозволуваат абортус под различни околности, како што се ризик за здравјето на жената, фетално оштетување, силување или инцест, и сè повеќе, на барање во текот на почетните фази од бременоста.

Компаративно-правниот аспект на законот за абортус ни дава призма преку која може да се испитаат различните начини на кои различни правни системи се справуваат моралните, етичките и практичните предизвици што ги носи абортусот.

Оваа компаративна анализа открива бројни пристапи, директни забрани и многу рестриктивни закони, но и попопустливи закони кои им даваат приоритет на правата и здравјето на жените.

Во правни системи со рестриктивни закони за абортус, правниот дискурс се центрира околу заштитата на феталниот живот, со закони кои се врамени да го одразуваат верувањето дека животот започнува со зачнувањето и дека фетусот поседува права кои мора да бидат заштитени од државата. Ваквите законски рамки вклучуваат ретки исклучоци, доколку ги има, се карактеризираат со ригорозни процедурални барања кои мора да се исполнат пред да може легално да се изврши абортусот.

Влијанието на овие рестриктивни закони врз здравјето и правата на жените е предмет на интензивна дебата, при што критичарите тврдат дека тие водат до низа негативни исходи, како продолжување на небезбедни абортуси, смртност и морбидитет кај мајките, како и нарушување на репродуктивниот систем на жените. Спротивно на тоа, земјите со либерални закони за абортус го оправдуваат својот законски пристап со акцент на важноста на автономијата, здравјето и репродуктивните права на жените. Во овие правни системи, абортусот се смета за компонента на здравствената заштита, со закони дизајнирани да овозможат безбедни и достапни услуги за абортус. Ваквите закони дозволуваат абортус по барање во раните фази од бременоста, при што некои правни системи ги прошируваат правните основи за да се дозволи абортус и тие вклучуваат социо-економски фактори или состојби на менталното здравје.

Разликата во законите за абортус низ правните системи, исто така, одразува пошироки социо-политички и културни разлики, при што правните реформи честопати се под влијание на промените во општествените ставови, политичките поделби и меѓународните норми за човекови права. Улогата на меѓународното право за човекови права, особено правата на здравје, приватност и недискриминација, е клучна во обликувањето на законот за абортусот, овозможувајќи оспорување на рестриктивните закони и застапување за проширување на законските основи за абортус. Компаративната правна анализа на законите за абортус, исто така, го покажува влијанието на законските рамки врз пристапноста, безбедноста и квалитетот на услугите за абортус. Во земјите со либерални закони, фокусот е насочен кон регулирање на безбедноста и квалитетот на услугите за абортус, што ќе овозможи жените да имаат пристап до безбедни, законски процедури. Спротивно на тоа, во правни системи со рестриктивни закони, правните бариери за пристап резултираат со голем број жени кои бараат небезбедни абортуси, со сериозни импликации за нивното здравје и благосостојба.

Правна рамка на прекинување на бременоста во македонското законодавство

Историски гледано, законското регулирање на абортусот во Северна Македонија, како и во другите делови на светот, е под влијание на пошироки политички, социјални и културни промени. Законодавството на земјата за абортусот премина од порестриктивни во полиберални рамки, следејќи ги светските трендови кон признавање на репродуктивните права и автономија на жените. Оваа еволуција е показател за широко признавање на важноста на пристапот до безбедни и легални услуги за абортус како прашање на јавното здравје и човековите права. Сегашната законска рамка за прекинување на бременоста во Северна Македонија првенствено е регулирана со Законот за прекинување на бременоста, кој беше значително изменет и либерализиран во последните години за да се зголеми пристапноста до услугите за абортус и да се обезбеди заштита на здравјето и правата на жените. Овој закон ги наведува условите под кои абортусот може легално да се изврши, процедурите што треба да се следат и правата на жените кои бараат услуги за абортус.

Еден од основните принципи на македонското законодавство за абортус е признавањето на женската автономија. Законот им дозволува на жените да побараат абортус во првиот триместар (12 недели) од бременоста без да мора да наведат конкретни причини за нивната одлука. Оваа одредба ја покажува заложбата за почитување на автономијата и одлучувањето на жените за прашањата што се однесуваат на нивното репродуктивно здравје. Надвор од првиот триместар, законот дозволува абортус под одредени услови, како на пример кога бременоста претставува ризик за животот или здравјето на жената или во случаи на тешки аномалии на плодот. Овие одредби ја покажуваат етичка рамнотежа помеѓу заштитата на потенцијалниот живот на фетусот и заштитата на здравјето и правата на жената, нагласувајќи ја важноста на медицинската проценка во одредувањето на неопходноста од доцниот абортус. Законот за прекинување на бременоста вклучува и одредби насочени кон обезбедување на квалитетот и безбедноста на услугите за абортус. Тој предвидува дека абортусот мора да се врши во овластени здравствени установи од страна на квалификуван медицински персонал, со што се минимизираат здравствените ризици поврзани со небезбедните практики на абортус. Дополнително, законот ги задолжува советодавните служби да ги поддржат жените во донесувањето информирани одлуки и да им ја обезбедат потребната психолошка

поддршка пред и по постапката. Понатаму, македонската законска рамка ја покажува посветеноста за намалување на потребата од абортус преку превентивни мерки, вклучувајќи сеопфатно сексуално образование и пристапни контрацептивни услуги. Овој пристап ја прикажува природата на абортусот, што ги опфаќа не само правните и етичките димензии, туку и пошироката перспектива на јавното здравје.

Историски развој на законодавствата за абортус

Дискусијата за прашањето за прекинување на бременоста, без оглед на перцепцијата околу неговото разбирање, е секогаш поврзана со правото на живот, принцип од највисок ред загарантиран со устав. Уставот на Република Северна Македонија го обезбедува ова право со експлицитно наведување дека човечкиот живот е неприкосновен и дека смртната казна не може да се изрече под никакви околности. Понатамошната анализа на правната рамка која го разработува ова право јасно покажува дека законот абортусот не го смета за убиство, во спротивно би бил забранет. Во националниот кривично-правен систем, незаконското прекинување на бременоста спаѓа во кривични дела против потенцијалниот живот (фетус). Оваа класификација се заснова на теоретски ставови дека заштитата на човечкиот живот и телесниот интегритет како живо суштество започнува со раѓањето, а не со зачнувањето.

Кривичното законодавство во Северна Македонија го криминализира само незаконското прекинување на бременоста, односно вршење абортус спротивно на прописите што ја регулираат оваа материја. Посебно е важно да се истакне дека во вакви случаи предмет на кривично дело не е жената која одлучува за прекин на бременоста, туку лицата кои ја вршат интервенцијата во услови и на начини спротивно на законот. Делото станува отежнато ако интервенцијата се изврши врз малолетно женско лице или резултира со тешка телесна повреда или смрт на жената. Ваквата правна природа укажува дека кривичното дело е конституирано само кога интервенцијата се врши незаконски (надвор од медицински установи кои ги исполнуваат условите за спроведување на постапката за прекинување). Во однос на општата правна рамка за ова прашање, Северна Македонија спаѓа во групата земји со либерални правни регулативи, кои дозволуваат абортус како легитимно право на жената да одлучува за своето тело. Прашањето

е регулирано со Законот за прекинување на бременоста од 2013 година, што предизвикал различни реакции во јавноста. Уште пред новиот закон, материјата беше регулирана со истоимениот закон од 1971 година, покажувајќи ја потребата од целосно ново законодавство приспособено на сегашните услови. Повеќето од претходните законски решенија биле задржани, некои изменети или воведени нови, со основна цел да се зајакне контролниот систем на медицинските интервенции за прекинување на бременоста, со што се обезбедува поголема заштита на здравјето на жените. Но, мислењата за новите законски решенија се поделени и значително се разликуваат.

Во однос на дефинитивното определување, прекинувањето на бременоста отсекогаш било дефинирано како посебна медицинска интервенција по проценка на трудницата, со единствено ограничување дека таа мора да биде полнолетна и да има поминато најмалку една година од прекинувањето на претходна бременост, доколку ги има. Законот предвидува абортусот да го изврши лекар специјалист во медицинска установа опремена за вакви процедури. Дополнително, пред каква било интервенција, до надлежните органи мора да се достави доказ дека не поминале повеќе од 10 недели од зачнувањето, бидејќи надвор од оваа фаза, абортусот може да се изврши само од конкретни причини наведени во законот: медицински, етички, правни- криминални, биолошко-генетски и социјални. Новиот закон бара жената која сака да ја прекине бременоста до десеттата гестациска недела мора да поднесе писмено барање на формулар пропишан од министерот за здравство, да даде писмена согласност за интервенцијата и да присуствува на советување за потенцијалните ризици од прекиноот. и придобивките од продолжувањето на бременоста, што многумина го толкуваат како рестриктивен механизам кој значително го ограничува правото на жената на избор и го оптоварува со непотребни бирократски процедури. Притоа, раскинувањето не може да се изврши до три дена по советувањето, освен во посебни случаи утврдени со закон кога е потребна итна интервенција без одлагање. Новите законски решенија предвидуваат и формирање на примарни и секундарни комисии од директорот на здравствената установа каде се вршат вакви интервенции и од министерот за здравство на Република Северна Македонија, соодветно. Овие формалности го отежнуваат процесот и постои општ став дека ваквите процедурални ограничувања ќе доведат до

зголемување на нелегалните абортуси, а со тоа директно ќе го загрозат здравјето и животот на жените. Новиот закон прави исклучок од сите горенаведени рестриктивни правила во случаи кога постојат оправдани медицински индикации, но конфликтите кои произлегуваат од строгите правни формалности на постапките за прекинување се веќе очигледни во практиката. Ако пациентката треба да изврши абортус преку итна процедура поради околности опасни по живот, таа мора да подлежи на значително поскапи прегледи и процедури во споредба со стандардната процедура за прекинување. Како резултат на тоа, многумина одлучуваат да го чекаат законскиот тридневен период по советувањето за да се придржуваат до правната формалност и да избегнат повисоки трошоци за интервенцијата. Во такви случаи, периодот на чекање директно го загрозува здравјето на жената со одложување на медицинската нега, доведувајќи ја во прашање способноста на жените да пристапат до безбедни и легални услуги за абортус.

Споредбената анализа на старите и новите законски решенија недвосмислено покажува дека со новата законска регулатива е воспоставен порестриктивен механизам во однос на можностите за прекинување на бременоста. Сепак, тоа не го менува фактот дека абортусот во Северна Македонија, како и во многу други земји, е легализиран, што значи дека неговото практикување под законски предвидени услови не е казниво. Навистина, во вакви случаи, законот е речиси немоќен да дејствува за намалување на оваа деструктивна појава бидејќи самиот тоа го дозволува, па оттука единствениот начин да се работи превентивно е повикување на етичка и морална одговорност.

Позитивни законски одредби и ограничувања

Со новиот Закон, се укинуваат постојните административни процедури-барии, кои го одложуваа спроведувањето на постапката за прекин на бременоста.¹ За првпат, се воведува можноста за прекинување на бременоста до деветтата гестациска недела со медикаментозен метод и во здравствена установа од примарна здравствена заштита (ПЗЗ). Новиот закон предвидува прекинувањето на бременоста да може да се

¹ Закон за заштита на правата на пациентите (“Службен весник на Република Македонија”, бр.82/08, 12/09, 53/11, 150/11 и “Службен весник на Република Северна Македонија” бр. 190/19)

изврши до истекување на дванаесеттата гестациска недела со писмена согласност од бремената жена. Ако бремената жена е малолетна или и е одземена деловната способност, прекинувањето на бременоста може да се изврши со писмена согласност од родителот, односно старателот на бремената жена.

Прекилот на бременоста може да се изврши по барање и со писмена согласност од бремената жена и по истекот на дванаесеттата гестациска недела, во случаи кога врз основа на медицински индикации ќе се утврди дека бременоста претставува опасност по животот или ќе доведе до тешко нарушување на здравјето на жената за време на бременоста, породувањето или по породувањето, врз основа на научни сознанија може да се очекува дека детето ќе се роди со тешки телесни или душевни недостатоци, до зачнувањето дошло во врска со извршување на кривично дело: силување, обљуба врз немоќно лице, полов напад врз дете, обљуба со злоупотреба на положбата или родосквернавање и ќе се утврди дека во текот на бременоста или по породувањето би можела жената да дојде во тешки лични, семејни, материјални или други прилики што ќе имаат одраз врз нејзиното здравје.

